



**DOKUMENTI I ANALIZËS SË THELLUAR**  
**BASHKIA GRAMSH**

## Tabela e përmbajtjes

<b>1. Analiza historike dhe e vendbanimeve.....</b>	<b>11</b>
1.1 Analiza e vendbanimeve .....	13
1.2 Përfundime .....	17
<b>2. Analiza e përgjithshme e territorit .....</b>	<b>18</b>
2.1 Analiza topografike dhe klimatike.....	18
2.1.1 Analiza Topografike .....	18
2.1.2 Analiza Klimatike .....	20
2.2 Analiza gjeologo- inxhinierike, burimeve natyrore dhe pasuritë minerale. Analiza gjeologo- inxhinierike .....	21
2.3 Analiza hidrogjeologjike dhe hidrografike .....	28
2.3.1 Analiza Hidrogjeologjike.....	28
2.3.2 Analiza Hidrografike.....	28
2.4 Analiza Gjeorreziqueve.....	29
2.4.1 Rrëshqitjet dhe Vatrë e erozionit.....	30
2.4.2 Tërmetet .....	30
2.5 Boniteti i tokave bujqësore.....	31
2.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura.....	32
2.6.1 Zonat e mbrojtura natyrore.....	32
2.6.2 Zonat e mbrojtura kulturore .....	35
2.7 Përfundime .....	36
<b>3. Pozicioni dhe elementët e fortë në territor .....</b>	<b>37</b>
3.1 Pozicioni gjeografik i Bashkisë Gramsh .....	37
3.2 Elementët e fortë në territor dhe elementët përjashtues.....	38
3.2.1 Elementët e fortë natyrore.....	39
3.2.2 Elementët e fortë artificialë .....	43
3.3 Përfundime .....	44
<b>4. Dokumentet e Planifikimit të hartuara më parë .....</b>	<b>44</b>
4.1 Planifikimi rregullator e vendor.....	53
4.2 Përfundime .....	54
<b>5. Rëndësia Kombëtare në territor .....</b>	<b>55</b>
5.1 Monumente Kulturore .....	55
5.2 Zona të mbrojtura natyrore.....	55
5.3 Menaxhim i integruar i burimeve ujore .....	56
5.4 Tokat Bujqësore.....	57
5.5 Pyjet, drufrutorët dhe kullotat .....	58
5.6 Zonat industriale .....	58
5.7 Konkluzione dhe Rekomandime.....	59
<b>6. Analiza e thelluar mjedisore .....</b>	<b>59</b>
6.1 Burimet ujore dhe basenet .....	59
6.1.1 Burimet ujore sipërfaqësore .....	60
6.1.2 Burimet ujore nëntokësore.....	62
6.1.3 Përfundime dhe rekomandime .....	68
6.2 Ajri .....	68

6.2.1 Burimet e ndotjes së ajrit .....	69
6.2.2 Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut .....	74
<b>6.3 Pyjet, peisazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti .....</b>	<b>75</b>
6.3.1 Pyjet dhe kullotat .....	75
6.3.2 Peisazhi .....	79
6.3.3 Zonat e mbrojtura .....	84
6.3.4 Biodiversiteti .....	98
<b>6.4 Toka .....</b>	<b>104</b>
6.4.1 Toka Bujqësore .....	106
6.4.2 Problematikat e tokave në Gramsh .....	107
6.4.3 Përfundime e rekomandime .....	110
<b>6.5 Ndryshimet klimatike dhe rreziqet .....</b>	<b>111</b>
6.5.1 Ndryshimet klimatike në Shqipëri .....	112
6.5.2 Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike .....	115
<b>6.6 Zonat e nxehta (problematike) mjedisore .....</b>	<b>117</b>
6.6.1 Zona/aktivitete potenciale me ndotje të pavlerësuar .....	119
6.6.2 Përfundime dhe rekomandime .....	120
<b>7. Shërbimet publike .....</b>	<b>120</b>
<b>7.1 Furnizimi me ujë .....</b>	<b>120</b>
7.1.1 Pus-shpimet .....	124
7.1.2 Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm .....	124
<b>7.2 Ujërat e ndotura .....</b>	<b>125</b>
<b>7.3 Menaxhimi i mbetjeve .....</b>	<b>127</b>
7.3.1 Menxhimi I mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Gramsh .....	127
7.3.2 Vend-Depozitimi i mbetjeve urbane .....	127
7.3.3 Gjenerimi i mbetjeve të ngurta urbane .....	128
7.3.4 Mbetjet nga sektori i bujqësisë .....	130
7.3.5 Mbetjet spitalore .....	130
7.3.5 Mbetjet Elektronike .....	130
7.3.6 Përfundime dhe rekomandime .....	131
<b>7.4 Furnizimi me energji elektrike, telekomunikacion dhe ndriçimi publik .....</b>	<b>132</b>
7.4.1 Ndriçimi publik .....	132
7.4.2 Furnizimi me energji elektrike .....	134
7.4.3 Telekomunikacioni .....	135
<b>8. Demografia .....</b>	<b>136</b>
<b>8.1 Popullsia dhe treguesit demografik sipas bashkisë Gramsh .....</b>	<b>145</b>
<b>8.2 Përfundime .....</b>	<b>152</b>
<b>9. Zhvillimi dhe përfshirja sociale .....</b>	<b>153</b>
<b>9.1 Arsimi .....</b>	<b>153</b>
9.1.1 Niveli i përgjithshëm arsimor .....	153
9.1.2 Shkalla e Analfabetizmit .....	155
<b>9.2 Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Gramsh .....</b>	<b>156</b>
9.2.1 Raporti nxënës/mësues .....	160
9.2.2 Gjendja e infrastrukturës së institucioneve arsimore .....	163
<b>9.3 Punësimi .....</b>	<b>164</b>
9.3.1 Punësimi sipas degëve të ekonomisë .....	164

9.3.2 Paga mesatare mujore sipas degëve të ekonomisë.....	165
9.3.3 Punësimi sipas nivelit arsimor .....	166
9.3.4 Shkalla e Papunësisë.....	168
<b>9.4 Shëndetësia.....</b>	<b>170</b>
9.4.1 Personat me aftësi të kufizuar .....	173
9.4.2 Lindshmëria dhe Vdekshëria .....	175
<b>9.5 Mirëqënia ekonomike.....</b>	<b>175</b>
9.5.1 Burimi i të ardhurave të Njësi Ekonomike Familjare (NjEF).....	175
9.5.2 Varfëria.....	177
9.5.2 Kohezioni Social dhe Gjithëpërfshirja .....	178
<b>10. Analiza e nevojave për strehim .....</b>	<b>178</b>
<b>10.1 Vështrim i përgjithshëm i ndryshimit të popullsisë, dhe tregut të banesave në nivel vendor.....</b>	<b>179</b>
<b>10.2 Problematika.....</b>	<b>181</b>
<b>10.3 Objektiva.....</b>	<b>183</b>
<b>11. Zhvillimi ekonomik .....</b>	<b>183</b>
<b>11.1 Kuadri Makroekonomik.....</b>	<b>184</b>
11.1.1 Produkti I Brëndshëm Bruto(PBB).....	184
11.1.2 Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) dhe produktiviteti i sektorëve .....	184
11.1.3 Prirjet e ndërmarrjeve ekonomike .....	185
<b>11.2 Klima e Biznesit.....</b>	<b>187</b>
11.2.1 Bujqësia dhe Prodhimi .....	188
11.2.2 Turizmi .....	190
11.2.3 Industria.....	190
11.2.4 Hidro - energjitika.....	190
<b>12. Analiza e bujqësisë .....</b>	<b>191</b>
<b>12.1 Kuadri Ligjor për bujqësinë dhe zhvillimin rural .....</b>	<b>191</b>
<b>12.2 Strategjitë dhe Planet Kombëtare për Bujqësinë dhe për Zhvillimin rural .....</b>	<b>193</b>
12.2.1 Plani Kombëtar.....	194
12.2.2 Rajonizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë.....	195
<b>12.3 Klima.....</b>	<b>197</b>
<b>12.4 Zhvillimi I bujqësisë në vite të Bashkisë Gramsh.....</b>	<b>197</b>
12.4.1 Historiku i zhvillimit të bujqësisë.....	197
<b>12.5 Toka Bujqësore.....</b>	<b>199</b>
<b>12.6 Infrastruktura Bujqësore.....</b>	<b>204</b>
12.6.1 Ujitja dhe kullimi .....	204
<b>12.7 Inovacionet në Bujqësi.....</b>	<b>205</b>
<b>12.8 Sfidat dhe Konkluzionet .....</b>	<b>205</b>
<b>12.8 Rekomandime .....</b>	<b>206</b>
<b>13 Sistemi i kullimit dhe vaditjes .....</b>	<b>207</b>
<b>14 Pronësia mbi tokën dhe pronat publike .....</b>	<b>209</b>
<b>14.1 Pronat Publike .....</b>	<b>210</b>
<b>15. Cilësia e hapësirave publike, strukturave dhe territoreve.....</b>	<b>213</b>
<b>16. Sistemi rrugor dhe transporti publik .....</b>	<b>216</b>

<b>16.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik .....</b>	<b>216</b>
16.1.1 Trasporti ndërqytetas (Interurban) .....	217
<b>16.2 Profilet e infrastrukturës rrugore bazuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë</b>	<b>220</b>
<b>16.3 Analiza sipas funksionalitetit .....</b>	<b>222</b>
<b>16.4 Rrugët urbane dhe rurale .....</b>	<b>223</b>
<b>16.5 Pikat potenciale të rrezikut .....</b>	<b>223</b>
<b>16.6 Gjëndja e infrastrukturës rrugore .....</b>	<b>224</b>
<b>16.7 Lëvizshmëria (Mobiliteti) dhe transporti publik rreth-qytetas .....</b>	<b>225</b>
<b>16.8 Përfundime.....</b>	<b>228</b>
<b>17. Analiza e periferialitetit.....</b>	<b>229</b>
<b>18. Përdorimi i tokës dhe sistemet e territorit .....</b>	<b>236</b>
18.1 Analiza e përdorimit ekzistues të tokës .....	237
18.2 Sistemet Territoriale Gramsh.....	242
18.3 Mbivendosjet/kundravajtjet e përdorimit të tokës .....	245
<b>19. Tipologjitë hapësinore .....</b>	<b>246</b>
19.1 Bashkia Gramsh në nivel territorial .....	246
19.2 Tipologjitë rurale .....	247
19.3 Tipologjitë në nivel zone .....	255
19.4 Përfundime.....	263
<b>20. Metabolizmi i territorit.....</b>	<b>264</b>
20.1 Energjia në Rajon .....	264
20.2 Uji në Rajon .....	265
20.3 Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Gramsh .....	266
20.3.1 Fluksi i Energjisë .....	266
20.3.2 Fluksi i ujit.....	268
20.3.3 Fluksi i ushqimit .....	270
20.3.4 Fluksi i Mbetjeve.....	271
20.3.5 Përfundime .....	272
<b>21. Analiza SËOT .....</b>	<b>272</b>
<b>22. Konkluzione dhe Rekomandime për Planin.....</b>	<b>274</b>
<b>Aneksë.....</b>	<b>283</b>
Planifikimi me pjesmarrje dhe aktorët e përfshirë në proces.....	283
Raporte nga dëgjesat publike dhe konsultat.....	284

## Tabela e Figurave

Figura 1 Shpërndarja e vendbanimeve në vitet '88.....	13
Figura 2 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitet 2007 .....	14
Figura 3 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitin 2015 .....	15
Figura 4 Shtrirja e vendbanimeve në vite .....	16
Figura 5 Harta e Pjerrësisë së terrenit në përqindje.....	19
Figura 6 Harta e territorit.....	19
Figura 7: Harta e Shpejtësisë së Erës .....	20
Figura 8: Harta e Rrezatimit Diellor.....	21
Figura 9: Harta Gjeologjike- Inxhinierike .....	23
Figura 10: Harta e Gjeologo- Inxhinierike dhe pasuritë minerale .....	27
Figura 11: Harta Hidrografike dhe Hidrogeologjike.....	29
Figura 12: Harta e Rrezikut gjeologjik .....	31
Figura 13: Harta e zonave të mbrojtura.....	36
Figura 14 Pozicioni gjeografik .....	38
Figura 15 Shpella e Kabashit .....	40
Figura 16 Karsti i Tërvolit .....	40
Figura 17 Ujërat në kanionin e Holtës .....	41
Figura 18 Zambakët në Liqenin e Dushkut.....	41
Figura 19 Liqeni i Zi .....	42
Figura 20 Ujëvara e Sotirës .....	42
Figura 21 Harta e elementëve të fortë në Bashkinë Gramsh .....	44
Figura 22 Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar .....	45
Figura 23 Vizioni i Polit të Zhvillimit të Qarkut Elbasan sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar.....	47
Figura 24 Vizioni i Polit të Zhvillimit të Qarkut Elbasan sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar.....	48
Figura 25 Vizioni i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal i Bashkisë Gramsh.....	51
Figura 26 Përdorimi ekzistues i tokës sipas Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Gramshit 2008.....	53
Figura 27 Rëndësia Kombëtare .....	59
Figura 28 Hidrogeologjia dhe hidrografia në Bashkinë Gramsh .....	60
Figura 29 Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Gramsh.....	61
Figura 30 Harta hidrogeologjike, Bashkia Gramsh.....	62
Figura 31Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat) .....	80
Figura 32 Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë.....	82
Figura 33 Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës .....	82
Figura 34 Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi .....	99
Figura 35 Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh.....	105
Figura 36 Mbivendosje e përdorimit të tokës .....	109
Figura 37 Vendepozitimi i vjetër i mbetjeve, Cërrujë, Bashkia Gramsh .....	120
Figura 38 Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Gramsh .....	123

Figura 39 Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Gramsh .....	125
Figura 40 Vend-depozitimi i ri i mbetjeve urbane, Bashkia Gramsh .....	128
Figura 41 Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Gramsh, .....	129
Figura 42 Harta me fiderat kryesor në territorin e bashkisë Gramsh.....	135
Figura 43 Shpërndarja e nivelit arsimor të përfunduar sipas NjA-ve; Shkollimi fillor dhe 9- vjeçar, analfabetizmi, shkollimi i mesëm, shkollimi universitar. ....	154
Figura 44 Rreze shërbimi për kopshtet dhe çerdhe.....	157
Figura 45 Rreze shërbimi për arsimin fillor dhe 9-vjeçarë .....	159
Figura 46 Rreze shërbimi shkollë e mesme.....	160
Figura 47 Raporti fëmijë-edukator, Bashkia Gramsh .....	161
Figura 48 Raporti mësues-shkollë 9-vjeçare, Bashkia Gramsh.....	162
Figura 49 Raporti mësues-shkollë e mesme, Bashkia Gramsh .....	163
Figura 50 Shpërndarja e shëndetësisë.....	173
Figura 51 Zhvillimi ekonomik.....	191
Figura 52 Ullishtet ekzistuese Qarku Elbasan .....	202
Figura 53 Territoret e ullishteve të reja qarku Elbasan.....	203
Figura 54 Harta e pronave të NjA Gramsh .....	212
Figura 55 Harta e pronave të NjA Gramsh .....	212
Figura 56 Foto nga hapësirat publike në Gramsh .....	214
Figura 57 Gramshi në raport me infrastrukturën rajonale .....	217
Figura 58 Transporti ndërqytetës (nisja nga qyteti Gramshit).....	218
Figura 59 Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor .....	220
Figura 60 Profil rrugë interurbane dytësore (majtas) dhe rrugë lokale (djathtas) .....	221
Figura 61 Profil rrugë urbane kryesore .....	221
Figura 62 Profil rrugë urbane dytësore .....	222
Figura 63 Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit .....	223
Figura 64 Kryqëzimet e rrugëve lokale rrugët interurbane dytësore .....	224
Figura 65 Cilësia e infrastrukturës rrugore Bashkia Gramsh.....	225
Figura 66 Linjat e transportit publik rrethqytetas, Bashkia Gramsh .....	226
Figura 67 Fluksi i levizjeve sipas numrit të orareve, Bashkia Gramsh .....	227
Figura 68 Stacionet e Transportit publik rrethqytetas, Bashkia Gramsh .....	228
Figura 69 Mbulimi me shërbime sipas katër kategorive të periferialitetit në Njësinë Administrative Gramsh.....	231
Figura 70 Mbulimi me shërbime sipas katër kategorive të periferialitetit në Bashkinë Gramsh .....	236
Figura 71 Përdorimi ekzistues i tokës i qytetit të Gramshit.....	238
Figura 72 Përdorimi ekzistues i tokës në Bashkinë Gramsh.....	242
Figura 73 Sistemet territoriale ekzistuese në Bashkinë Gramsh .....	243
Figura 74 Sistemet territoriale ekzistuese në Qytetin e Gramshit.....	244
Figura 75 Mbivendosjetet/kundravajtjet e përdorimit të tokës .....	245
Figura 76 Skema e lidhjeve territoriale, nivel bashkie .....	247
Figura 77 Energjia në Rajon.....	265
Figura 78 Figura Uji në Rajon.....	266
Figura 79 Fluksi i Energjisë në Bashkinë Gramsh .....	267

Figura 80 Fluksi i Ujit në Bashkinë Gramsh.....	269
Figura 81 Fluksi i ushqimit në Bashkinë Gramsh.....	270
Figura 82 Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Gramsh .....	271

## Lista e tabelave

Tabela 1 Shpërndarja e vendbanimeve në vitet '88 .....	14
Tabela 2 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitet 2007.....	15
Tabela 3 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitin 2015.....	16
Tabela 4 Shtrirja e vendbanimeve në vite.....	17
Tabela 5 Shpërhapja totale e vendbanimeve në vite.....	17
Tabela 6 Boniteti i tokave bujqësore sipas NjA-ve dhe Fshatrave në Bashkinë Gramsh .....	31
Tabela 7 Klasifikimi dhe sipërfaqja e Akuiferëve në Bashkinë Gramsh (në km <sup>2</sup> ).....	63
Tabela 8 Vendndodhja e aktivitetetve të liçencuara për shfrytëzimin e inerteve lumore ....	67
Tabela 9 Sasia e CO <sub>2</sub> që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë.....	69
Tabela 10 Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite.....	70
Tabela 11 Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vend .....	70
Tabela 12 Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuar .....	71
Tabela 13 Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri.....	71
Tabela 14 Përmbajtja e squfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %) .....	72
Tabela 15 . % Makinave që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër.....	73
Tabela 16 Struktura e fondit pyjor e kullësor, Bashkia Gramsh (ha) .....	76
Tabela 17 Përdorimi i tokës sipas zonave, Bashkia Gramsh.....	76
Tabela 18 Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave .....	85
Tabela 19 Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh .....	87
Tabela 20 Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave.....	97
Tabela 21 Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri .....	99
Tabela 22 Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Gramsh.....	100
Tabela 23 Sistemet territoriale, Bashkia Gramsh.....	105
Tabela 24 Kategoritë bazë të përdorimit të tokës (km <sup>2</sup> ).....	105
Tabela 25 Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik.....	106
Tabela 26 Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë .....	107
Tabela 27 Sasia e plehrave kimik të përdorur në Bashkinë Gramsh, 2016.....	110
Tabela 28 Skenaret e parashikimit të rritjes së temperatures (Referuar Tem. Mes. 1990) .....	112
Tabela 29 Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës.....	113
Tabela 30 Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend .....	113
Tabela 31 Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime.....	114
Tabela 32 Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990 .....	114
Tabela 33. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm .....	121



Tabela 34 Rrjeti i tenisionit të mesëm dhe të ulët në territorin e Bashkisë Gramsh.....	134
Tabela 35 Popullsia shqiptare në vite.....	136
Tabela 36 Piramida e popullsisë për vitet 2011; 2015. ....	137
Tabela 37 Struktura moshore, Shqipëria në censuset e popullsisë.....	138
Tabela 38 Popullsia shqiptare sipas 3 skenarëve të projeksioneve, 2016 - 2031.....	138
Tabela 39 Popullsia në 1 janar për periudhën, 2001-2016.....	139
Tabela 40 Ndryshimi vjetor i popullsisë sipas indekseve me vit bazë dhe zinxhir,Elbasan .....	140
Tabela 41 Struktura urban/rurale e popullsisë gjithsej dhe për qarqet, Elbasan, 2001-2016 .....	141
Tabela 42 Levizjet migratore të brëndshme, 2001-2016.....	141
Tabela 43 Koeficienti gjinor sipas qarqeve për periudhën 2001-2016.....	142
Tabela 44 Struktura moshore në Qarkun, Elbasan.....	143
Tabela 45 Treguesit e varesisë moshore, për popullatën Gjithsej dhe qarkun Elbasan .....	144
Tabela 46 Popullsia e Shqipërisë dhe qarqeve sipas skenarit të rritjes së mesme 2015-2031 .....	145
Tabela 47 Popullsia sipas ndarjes së re administrative për bashkinë Gramsh .....	145
Tabela 48 Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2016.....	146
Tabela 49 Popullsia sipas gjinisë Bashkia Gramsh, për vitet 2011-2016, .....	147
Tabela 50 Raporti gjinor për bashkinë Gramsh, 2011-2016 .....	147
Tabela 51 Popullsia rezidente, sipas grup-moshave.....	148
Tabela 52 Struktura moshore e popullatës, bashkia Gramsh.....	149
Tabela 53 Koeficientët e varësisë .....	150
Tabela 54 Projeksionet e popullsisë, bashkia Gramsh 2011-2031.....	152
Tabela 55 Niveli Arsimor .....	153
Tabela 56 Niveli arsimor përfundimtar, Bashkia Gramsh i krahasuar .....	154
Tabela 57 Vitet e Shkollimit.....	155
Tabela 58 Përqindja e shkallës së analfabetizimit sipas NjA-ve në Bashkinë Gramsh.....	155
Tabela 59 Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Gramsh .....	156
Tabela 60 Diagrama e institucioneve arsimore .....	156
Tabela 61 Raporti nxënës-mësues në kopshte, Bashkia Gramsh.....	161
Tabela 62 Përbërja e popullsisë në Bashkinë Gramsh.....	164
Tabela 63 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (%) .....	164
Tabela 64 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (%).....	165
Tabela 65 Aktiviteti ekonomik (2000-2013) .....	166
Tabela 66 Diagrama e punësimit sipas nivelit arsimor.....	167
Tabela 67 Punësimi sipas nivelit arsimor .....	167
Tabela 68 Diagrama e papunësisë.....	168
Tabela 69 Shkalla e papunësisë sipas gjinive.....	168
Tabela 70 Diagrama e shkallës së papunësisë sipas Nj.A.....	169
Tabela 71 Tabelë e papunësisë në nivel Bashkie.....	170
Tabela 72 Tabela e papunësisë në nivel Qarku. ....	170
Tabela 73 Raportet staf mjekësor/banorë në Bashkinë Gramsh .....	171
Tabela 74 Personat me aftësi të kufizuar, Bashkia Gramsh .....	174

Tabela 75 Shërbimet sociale në Qarkun e Elbasanit (*Ky shërbim është iniciuar nga Këshilli Rajonal).....	174
Tabela 76 Burimi i të ardhurave të NjEF .....	175
Tabela 77 Diagrama e burimit të ardhura për NjEF.....	175
Tabela 78 Burimi i të ardhurave për NjEF sipas Njësive administrative .....	176
Tabela 79 Diagrama e burimit të ardhurave për NjEF sipas Njësive administrative .....	177
Tabela 80 Treguesit e varfërisë.....	178
Tabela 81 Numri i aplikimeve për strehim social në Bashkinë Gramsh.....	179
Tabela 82 Numri i familjeve përfituese (2010-2013).....	180
Tabela 83 Banesat e pazëna dhe bosh për Njësitë Administrative.....	181
Tabela 84 Vlerat mesatare të banesave.....	181
Tabela 85 Rënia e popullsisë në zonën urbane .....	182
Tabela 86 Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas përdorimit viti 2015.....	198
Tabela 87 Prodhimet blegtorale 2015.....	199
Tabela 88 Prodhimet blegtorale 2015.....	201
Tabela 89 Struktura e kultivarëve të ullirit sipas NjA Gramsh .....	202
Tabela 90 Sipërfaqet e kultivuara dhe Produkte Bujqësore dhe Blegtorale 2015 .....	203
Tabela 91 Lista e provane publike për Njësinë Administrative Gramsh.....	210
Tabela 92 Lista e objekteve sipas njësive administrative .....	211
Tabela 93 Lista totale e objekteve për Bashkinë Gramsh .....	211
Tabela 94 Infrastruktura rrugore e Bashkisë Gramsh sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë .....	219
Tabela 95 Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse.....	222
Tabela 96 Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore .....	230
Tabela 97 Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore .....	230
Tabela 98 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Gramsh.....	231
Tabela 99 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kodovjat.....	232
Tabela 100 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kukur .....	232
Tabela 101 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kushovë .....	233
Tabela 102 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Lenie .....	233
Tabela 103 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Pishaj.....	233
Tabela 104 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Poroçan .....	234
Tabela 105 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Skënderbegas.....	234
Tabela 106 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Sult .....	234

Tabela 107 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Tunjë .....	235
Tabela 108 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit në Bashkinë Gramsh .....	236
Tabela 109 Kategoritë bazë të përdorimit në Bashkinë Gramsh sipas sipërfaqes dhe në % .....	240
Tabela 110 Sistemet Territoriale ekzistuese Bashkinë Gramsh sipas sipërfaqes dhe në % .....	242
Tabela 111 Rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011 .....	268
Tabela 112 Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale.....	268

## 1. Analiza historike dhe e vendbanimeve

Vendi ku sot është qyteti ka qenë qendra e fshatit Gramsh e përmendur me këtë emër rreth 600 vjet më parë. Gojëdhënat flasin se pasi u dogj nga turqit, ai u ndërtua lart rreze malit të Vinës, aty ku sot është fshati Gramsh. Si qendër banimi, Gramshi përmendet si emër që nga shekulli XV, më vonë u spostua si qendër banimi e mbase edhe administrative në Gramshfshat. Nga gjysma e dytë e shekullit XIX ajo fillon e dëshmohej si qendër e vogël banimi e sidomos qendër administrative tregtare. Pozicioni gjeografik dhe vendosja në kryqëzimin e disa rrugëve që vinini nga Elbasani, Sulova, Berati, Tomorriva dhe nga Korça nëpërmjet luginave të cilat ndikuan në rritjen e rëndësisë të kësaj qendre. Nga dokumentat historike shikohet se në Gramsh u vendos administrata Turke, u ngrit xhamia, një zyrë e gjëndjes civile, mestepi (shkolla fiillore) e disa dyqane. Më 29 Korrik 1909 u hap dega e klubit Bashkimi, e cila zhvilloi një veprimtari të gjërë patriotike, kulturore e arsimore. Në Gramsh, në Shtator të 1909 u hap pranë xhamisë e para shkollë shqipe ndërsa më 26 Nëntor 1912 u ngrit flamuri I pavarësisë kombëtare. Pas shpalljes së Pavarësisë e fillimeve të shtetit shqiptar, Gramshi përsëri u caktua si qendër e administratës shtetërore në kuadër të nën/prefekturës e kështu vazhdoi edhe gjatë periudhës së monarkisë, dhe gjatë viteve të luftës së dytë botërore. Pas saj edhe për disa vite Gramshi funksionoi si nën/prefekturë dhe qyteti ishte qendra e saj. Kushtet e reja të pas luftës sollen ndryshime e Gramshi filloi të ndryshonte gradualisht.

Gramshi, si qendër banimi administrative, filloi të zhvillohet pas vitit 1945. Është domethënë fakti që nga Qershori i vitit 1945, me vendim të nën/prefekturës së Gramshit, edhe pse ai nuk ka statusin e qytetit, por si qendër nën/prefekturë emërtohet rruga kryesore që kalon mospërmas qendrës si dhe sheshi kryesor i saj. Në vitin 1946 Gramshi kishte 4 shtëpi banimi private me 8 dhoma, 1 shtëpi banimi shtetërore me 4 dhoma, 3 dyqane shitjeje, ndërtesën ku është vendosur sot institucioni N/prefektit, por jo plotësisht e ndërtuar, 1 furrë bukë, seksioni i brendshëm me 4 dhoma (ku është sot Komisariati i Policisë), ndërtesa e frontit me 4 dhoma (ku kanë qenë forcat vullnetare).

Zhvillimi i ekonomisë së rrethit si dhe vetë qendrës kërkonte intensifikim të ndërtimeve e infrastrukturës. Deri në vitin 1950 u hapën edhe 2 dyqane shtetërore, u ndërtua salla e leximit, spitali, një furrë bukë e shkolla 7-vjeçare si dhe 2-3 baraka për strehimin e banorëve apo nënpunësve që shërbenin këtu. Këto zhvillime, edhe pse të pakëta, po i jepnin Gramshit fizionomine e qytetit dhe rëndësinë ekonomike e sociale si qendër administrative e rrethit. E tërë periudha 1945-1950 shërbeu edhe si fillimi i ndërtimit të qytetit, madje edhe i perspektivës së tij, me elementet e tregtisë, industrisë, e ndërtimit, por edhe shtimit të popullsisë. Në vitin 1950, kjo qendër administrative ka 721 banorë, 150 familje dhe 211 të punësuar në shtet. Kufijtë e saj janë brënda një trekëndëshi, nga ura e sotme afër hotel “Tomorrit”, shtëpitë një katëshe të Muzeu i rrethit, hoteli i vjetër e deri të çezmat binjake, shatervani i sotëm i lagjes “Holta”. Pas viteve 1950-1953 zhvillimet janë më intensive e më të thella, ekonomia ka relativisht një ritëm më të shpejtë. Deri në vitin 1960, ngrihen edhe ndërmarrje apo sektorë të rinj lokale, si ajo e ndërtimit, e artizanatit dhe tregtare. Po kështu edhe në sektorin e arsim-kulturës rritet numri i nxënësve e i

klasave në arsimin 7-vjeçar, hapet konvikti i shkollës, kinemaja, u realizua furnizimi me energji elektrike me orar etj.

Në vitin 1960 arrin disa tregues të cilët plotësonin kriteret për t'u cilësuar qytet. Kështu, me 18 shkurt të vitit 1960 shpallet qytet me dekretin nr.3060 të Presidiumit të Kuvendit Popullor dhe kishte 1463 banorë ose 7 % të popullsisë të rrethit. Natyrisht në histori 50-vjet nuk janë shumë, por për kushtet që kanë kaluar shumë treva të vendit tonë kanë luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimit ekonomike-shoqërore të zonave. Shpallja e Gramshit qytet përveç se një akt administrative ishte edhe një zhvillim i mëtejshëm i tij.

Gjatë vitit 1961 u ngrit kantieri i ndërtimit të Ndërmarrjes së Ndërtimit, në vitin 1962 u krijuan dega e Bankës së Shtetit dhe zyra e PTT-së, në vitin 1963, më VKM nr.63, datë 22.02.1963, Çekinit (fshat në hyrje të Gramshit) i është hequr pronësia 9 ha tokë e punueshme për ndërtimin e Uzinës mekanike, e cila në 1966 arriti në 408 punonjës, në vitin 1966 u krijua Zyra e Sigurimeve Shoqërore dhe Arka e Kursimeve, u krijuan qendrat ekonomike të arsimit dhe të shëndetësisë, në vitin 1967 krijohet S.M.T-ja dhe Dega e farnave, në vitin 1968 Ndërmarrja Pyjore, në vitin 1970 krijohet Ndërmarrja e Ujrave.

Po kështu gjatë kësaj periudhe kemi zhvillime të mëdha në sektorët e arsimit e kulturës. Në Shtator të vitit 1960 u hap e para shkollë e mesme në rreth. Më 1965 ndërtohet godina e re e Shtëpisë së Kulturës, bibliotekës dhe kinemasë së qytetit, më 1966 godina e re e shkollës 7-vjecare, më 1969 ndërmarrja e përhapjes së librit, u krijua klubi i sportit, fusha e futbollit si dhe ajo e lojërave me dorë. Po kështu në vitin 1960 hapet spitali i qytetit me 20 shtretër dhe me një repart lindjeje, ambulanca e vizitave me një mjek, reparti i mjekimit dhe injeksioneve, reparti dentar dhe farmacia. Më vonë u zgjeruan shërbimet mjekësore në qytet me repartet e kirurgjisë në vitet 1965-1967 dhe në vitin 1970 spitali u zgjerua me 70 shtretër.

Ngritja dhe funksionimi i Uzinës Mekanike i dha një zhvillim të madh dhe të menjëhershëm qytetit. Vetëm kjo ndërmarrje brënda një 10-vjeçari kishte të punësuar afërsisht rreth 1400 punëtorë (aq sa kishte banorë qyteti më 1960 kur u deklarua qytet).

Në vitin 1970 qyteti i Gramshit kishte një ekonomi shumëdegëshe. Mbas vitit 1970 karakteristik dalluese është fillimi i zgjerimit të ndërmarrjeve me ritme të shpejta. Në vitin 1972 krijohet Ndërmarrja e Furnizimit të Bujqësisë, e vitin 1974 Ndërmarrja e Grumbullim-Përpunimit, e 140 punonjës që më pas arriti deri në 500 punëtorë. Pas vitit 1985 fillojnë punimet për H/C Banjës.

Periudha 1987-1991 ka një shtim dhe zhvillim të investimeve. Gjatë këtyre 4 viteve janë investuar sipas çmimeve të asaj periudhe 53 milion lekë. Filluan ndërtime banesash, fabrikash, poligoni i ndërtimit. Në vitin 1987 filloi ndërtimi i ujësjellësit të qytetit. U hartua në vitin 1987 plani I ri rregullues i qytetit i cili parashikonte heqjen e zonës industriale nga qyteti dhe spostimin e zgjerimin e saj në jug të qytetit duke krijuar kështu potenciale të reja zhvillimi.

Është për tu vlerësuar fakti që pas viteve '90, megjithë ndryshimet politike dhe ekonomike që ndodhën në vendin tonë si dhe me lëvizjen e madhe e të pakontrolluar të popullsisë, ndërtimet e reja nuk dolën jashtë kontrollit të strukturave dhe organeve kompetente shtetërore. Në këtë aspekt

Gramshi është nga qytetet e pakta ku struktura e qytetit është ruajtur dhe ndërtimet pa leje janë të një sasive të pakonsiderueshme dhe mbi të gjitha ndërtimet në shumicën e tyre janë përsëri në linjën urbanistike të qytetit.

Ndryshimi I sistemit politik dhe ekonomik si dhe fenomenet demografike me të cilat është përballur qyteti I Gramshit pas viteve '90, përbëjnë një nga faktorët kryesorë ë të rëndësishëm të këtij dokumenti.

### 1.1 Analiza e vendbanimeve

Analiza e vendbanimeve ka për qëllimin studimin e tendencave të zhvillimit të vendbanimeve në Bashkinë Gramsh, përgjatë rrjedhës kohore. Janë marrë në studim tre faza kryesore: Periudha para viteve '88, '88 – 2007 dhe 2008-2015.

Figura 1 Shpërndarja e vendbanimeve në vitet '88





Tabela 1 Shpërndarja e vendbanimeve në vitet '88



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Siç shihet nga harta dhe grafiku i mësipërm, njësia administrative me sipërfaqe vendbanimesh më të madhe është Njësia Tunjë me një diferencë shumë të vogël sipërfaqe me Nj.A Pishaj. Njësia administrative me sipërfaqe vendbanimesh më të vogël është Poroçan. Gjithashtu edhe njësia administrative Gramsh rezulton të ketë pasur sipërfaqen të vogël vendbanimesh gati 40% më të vogël se Nj.A Tunjë.

Figura 2 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitet 2007





Tabela 2 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitet 2007



Nga grafiku I mësipërm vihet re se njësia administrative Pishaj pëson rritje të sipërfaqes deri në 40%, duke lënë shumë pas edhe Gramshin. Ndryshe nga vitet '88 Poroçan nuk është më Nj.A me numrin më të vogël të vendbanimeve, por është Nj.A Sult. Në përgjithësi vihet re një shtim I vendbanimeve në Gramsh, kjo për shkak të lëvizjeve të shumta migratore drejt qendrave të qyteteve ku ofroheshin pjesa më e madhe e shërbimeve.

Figura 3 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitin 2015







Tabela 3 Shpërndarja e vendbanimeve deri në vitin 2015



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Nga viti 2007 deri në vitin 2015 mund të themi se kemi një dyfishim të sipërfaqes së vendbanimeve në Bashkinë Gramsh, sërisht në krye kemi Nj.A Pishaj. Gjithashtu Nj.A Sultë mbetet njësia me shpërndarjen më të vogël të vendbanimeve.

Figura 4 Shtirja e vendbanimeve në vite






Tabela 4 Shtrirja e vendbanimeve në vite



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Tabela 5 Shpërhapja totale e vendbanimeve në vite



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

## 1.2 Përfundime

Analiza e shpërhapjes së popullsisë në Bashkinë Gramsh e fokusuar në tre periudhat kryesore para viteve '88, '88-2007 dhe 2008-2015, tregon disa rezultate që shkojnë sipas trendeve në pjesën tjetër të vendit. Para viteve '90 njësitë administrative me sipërfaqen më të madhe të vendbanimeve në territorin e Bashkisë rezultojnë Nj.A Pishaj. Ndërsa sipërfaqen më të vogël e regjistrojnë Sultë, Poroçan, Lenie, Kushovë. Gjithashtu edhe për periudhën 1988-2007 Nj. A Pishaj rezultojnë të ketë sipërfaqen më të madhe. Gjatë kësaj periudhe vihet re një shtim i vendbanimeve në Kodovjat dhe Kukur. Nga viti 2007 deri në vitin 2015 ka ndryshime të theksuar në statistika. Të gjitha njësitë pësojnë një dyfishim të sipërfaqes të përgjithshme të tyre, por sërish Nj. A Pishaj mbetet njësi më e madhe ndërsa Nj.A Sultë me e vogla.

Sipas tabelës së llogaritjes së sipërfaqes totale të Bashkisë Gramsh, sipërfaqja totale e bashkisë ka pësuar një rritje me 30%. Ndryshimet e ndodhura pas viteve '90 lidhen me përmbysjen e sistemit totalitar para këtyre viteve, pasi kemi lëvizjen e lire të popullsisë. Popullsia është shpërngulur nga zonat e thella malore drejt qendrave kryesore të cilat ofrojnë relief më të përshtatshëm dhe më të urbanizuara.

## **2. Analiza e përgjithshme e territorit**


### **2.1 Analiza topografike dhe klimatike**

#### **2.1.1 Analiza Topografike**

Territori i Bashkisë Gramsh është pjesë e Krahinës Malore Qëndrore, Ultësirës Perëndimore, dhe Krahinës Malore Jugore me një relief Kodrinoro-malor. Zonat më të larta në këtë bashki gjenden në pjesën lidore dhe jug-lindore. Në zonën perëndimore kemi në përgjithësi relief kodrinor, ndërkohë zona më e ulët ndodhet përgjatë luginës së lumit Devoll<sup>1</sup>, që kalon në zonën qendrore të bashkisë. Lartësia maksimale arrin 2,373 metra mbi nivelin e detit, me majën e Valamarës. Pranë përroit të Grabovës ndodhet masivi malor i Valamarës, ndërsa përroi i Tomorricës buron nga Mali i Tomorrit në jug-lindje të territorit të Bashkisë Gramsh. Në pjesën lindore të bashkisë kemi krijimin e liqeneve në lartësitë 1,500-1,800m mbi nivelin e detit<sup>2</sup>.


Niveli i pjerrësive në Bashkinë Gramsh fillon nga 0.0075% deri në 128.36%. Zona fushore në pjesën qendrore të bashkisë, karakterizohet nga një pjerrësi e ulët që varion nga 0.0075 deri në 18.12%. Zonat e buta kodrinore kanë pjerrësi që shkojnë deri në 40.77%. Megjithatë, në zonat kodrinore hasim edhe pjerrësi që shkojnë deri në 45%, por kjo më shumë haset në zonat e majave të kodrave dhe kurrizive kodrinore. Në shpatet e thepisura të maleve që ndodhen në pjesën juglindore pjerrësia varion 46 mbi 128.36%. Pjerrësia e terrenit tregon edhe për kanionet e shumta që krijohen përgjatë rrjedhjes së lumenjve si kanioni I Holtës. Ndikimi i relievit dallohet edhe në shpërdarjen e vendbanimeve duke qënë se zonat kryesore të banimit janë përgjatë Luginës Lumore të Devollit.

Figura 5 Harta e Pjerrësisë së terrenit në përqindje



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Figura 6 Harta e territorit



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

Hartat e mësipërme paraqesin leximin e terrenit përmes pjerrësisë në përqindje dhe lartësisë në metra. Siç mund të shihet nga këto lexime, kuptohet që pjesa më e lartë është pikërisht në kufirin lindor të bashkisë dhe zonat qendrore dhe perëndimore janë më lehtësisht të aksesueshme pasi


kanë terren më të ulët. Ky lexim i territorit ndihmon për të kuptuar jo vetëm gjëndjen ekzistuese në bashki përsa i përket shpërndarjes së vendbanimeve. Karakteri kodrinoro - malor i kësaj bashkie tregon edhe potencialet për shfrytëzimin e turizmit malor, duke qënë se kemi male, pyje të dendura dhe të paprekura, kanione, shpella dhe liqene në lartësi të madhe mbidetare.

### 2.1.2 Analiza Klimatike

Në Bashkinë e Gramshit mbizotëron klima mesdhetare kodrinore, nënzona jugperëndimore, që shtrihet deri në 800-1,000m mbi nivelin e detit dhe në zonën klimatike mesdhetare malore, nënzona juglindore, në pjesën e sipërme të relievit deri në lartësinë 2,373m. Klima, relievi i larmishëm dhe sipërfaqet ujore, krijojnë mundësinë për plotësimin e nevojave për të gjitha kulturat bujqësore<sup>3</sup>. Temperatura mesatare e ajrit është 12.3°C-15.1°C për zonat e ulëta dhe 9.5°C-10.9°C për zonën malore<sup>4</sup>.

Për sa i takon erërave siç mund ta vëmë re edhe në figurën më poshtë, shpejtësia e tyre nuk është e madhe. Në pjesën veriore të bashkisë shpejtësia mesatare e erës është 1.5 m/s, në zonën qendrore të bashkisë është 1.6-2 m/s. Zona jugore e bashkisë ka shpejtësinë më të lartë, me vlera që shkojnë 2.1-2.5 m/s. Megjithatë edhe këto vlera nuk paraqesin potencial të madh për zhvillimin e energjisë së erës<sup>5</sup>.

Figura 7: Harta e Shpejtësisë së Erës




Burimi: Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore<sup>6</sup>; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

Pjesa më e madhe e reshjeve bien gjatë stinës së vjeshtës dhe dimrit dhe më pak në periudhën e verës dhe pranverës për shkak të aktivitetit ciklonik. Sasia mesatare e reshjeve vjetore është rreth 1,200 mm shi në vit. Muaji më i lagësht i vitit është nëntori, kurse muaji më i thatë është korriku, ndërsa reshjet e dëborës bien në zonat malore dhe qëndrojnë aty pa shkrirë 2-3 muaj<sup>7</sup>.

Në territorin e Bashkisë Gramsh vlera mesatare e rrezatimit diellor më e ulët ndodh në muajin Dhjetor, dhe vlera më e lartë në Korrik. Në pjesën lindore të luginës Devollit mesatarja e orëve me

diell në vit varion nga 2,300 deri në 2,500; ndërkohë në anën perëndimore të luginës kjo shifër shkon nga 2,500 deri në 2,700. Për sa i përket energjisë dhe rrezatimit diellor, në zonën lindore, ku relievi është më malor, kemi një mesatare ditore prej 3.79-4.11 kWh/m<sup>2</sup>, kurse pjesa perëndimore rezulton me 4.11 – 4.25 kWh/m<sup>2</sup>. Mesatarja vjetore e rrezatimit shfaq që zonat me energji më të madhe janë në zonën perëndimore me 1,500-1,600 kWh/m<sup>2</sup>, dhe zona lindore paraqet vlera më të ulëta nga 1,300-1,500 kWh/m<sup>2</sup>. Kjo shpërndarje e rrezatimit diellor tregon që zonat më të favorshme për shfrytëzimin e energjisë diellore gjenden në skajet perëndimore të Bashkisë Gramsh.

Figura 8: Harta e Rrezatimit Diellor



Burimi: SolarGIS<sup>8</sup>; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

## 2.2 Analiza gjeologo- inxhinierike, burimeve natyrore dhe pasuritë minerale.

### Analiza gjeologo- inxhinierike

Bashkia Gramsh bën pjesë në pllakën tektonike të Albanideve<sup>9</sup> të Jashtme, si në atë Perëndimore edhe në atë Lindore (të ndërmjetme); më saktë në nën zonën Berat, nën zonën Tomorr dhe nën zonën Cukall. Kjo bashki bën pjesë edhe në pllakën tektonike të Albanideve të Brendshme, më saktë në zonën Mirdita me Ofiolite të Jurasikut të mesëm.

Klasifikimi gjeologo-inxhinierik i shkëmbinjve dhe dherave të rajonit është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe përfshin tre kategori shkëmbinjsh, të cilat janë bërë duke marrë si kriter bazë rezistencën në shtypje një boshtore (Rsh). Në territorin e bashkisë Gramsh shkëmbinj të pëfshihen në dy nga tre kategoritë e këtij klasifikimi:

- shkëmbinj mesatarë Rsh = 50 – 500 bar
- shkëmbinj të fortë Rsh > 500 kg/cm<sup>2</sup>

Në shkëmbinj të mesatarë përfshihen:

- Shkëmbinjtë efuzivo-sedimentarë të Triasikut të mesëm-Jurasikut të poshtëm, të vendosur në pjesën lindore;
- Depozitimet e melanzhit “bllaqe në matriks” të Jurasikut të sipërm;
- Depozitime e flishit të hershëm me moshë Jurasik i sipërm (Titionian) - Kretak i Poshtëm në periferitë e masivëve Shpat e Devoll;
- Depozimet e kalimtare të Kretakut të sipërm të nënzonës Krasta, me përhapje në lindje të rajonit;
- Gëlqerorët biomikritikë të Paleocenit të zonës tektonike Kruja me përhapje në antiklinalin e Tërvollit;
- Të gjithë llojet e flisheve me moshë nga Paleocen – Eoceni, Eoceni dhe Oligoceni që i përkasin të tre zonave tektonike të përfaqësuara në territorin e Bashkisë Gramsh.

Në shkëmbinjtë e fortë përfshihen:

- Dunitet dhe lercolitet plagjioklazike të Jurasikut të mesëm (masivet ofiolitike Shpat, Vallamarë e Devoll), pra të gjithë shkëmbinjtë ultrabazikë të territorit.
- Shkëmbinjtë gëlqerorë pllakorë të Triasikut të mesëm – Jurasikut të mesëm në veri të Gurit të Topit. Gëlqerorët e Triasikut të sipërm-Jurasikut të poshtëm me përhapje të kufizuar në perëndim të masivëve ofiolitikë Shpat e Vallamarë.
- Flishi i kuq i Kretakut të poshtëm i nënzonës tektonike Krasta me përhapje në Gribë e Listec.
- Gëlqerorët e Kretakut të sipërm të zonës tektonike Kruja në Tërvoll dhe formacioni karbonatik “Kosorja” i nënzonës tektonike Krasta në zonat e Lisecit, Gribës Grabovës, Lenies e Vidhanit.
- Gëlqerorëve organogjeno-coprizorë të Eocenit që i përkasin zonës Kruja me përhapje në antiklinalet Tërvoll dhe Valesh dhe zonës Jonike në periklinalin e Marakut.

Dherat, të cilat nga pikëpamja gjeologjike - inxhinierike janë formime që kërkojnë në mënyrë kategorike përmirësim të vetive gjeoteknike gjatë hapjes së themeleve për ndërtim klasifikohen në bazë të kriterit të kohezionit (forcat lidhëse midis kokrrizave përbërëse). Në Bashkinë Gramsh dallohen si dhera pa kohezion ashtu dhe me kohezion.

Në dherat pa kohezion përfshihen depozitime aluviale të shtratit të lumenjve me moshë Holocen dhe brekçiet kryesisht peridotite me çimentim ranor të Pleistocenit.

Në dherat me kohezion futen depozitime taracore aluviale, zhavore, popla, ranorë, argjila, suargjila; me trashësi që arrijnë deri 2-3 metra me të formuara gjatë Pleistocenit të sipërm.

### ***Vlerësimi i kushteve gjeologjike-inxhinierike të trojeve të ndërtimit***


Janë vlerësuar duke kombinuar kushtet geomorfologjike dhe vetitë fiziko mekanike të shkëmbinjve. Siç mund të shihet edhe në analizën topografike në territorin e Bashkisë Gramsh mbizotëron një terren i thyer, me një zhillim të madh të erozionit.

Në bazë të klasifikimit gjeologjiko-inxhinierik të shkëmbinjve të kryer më lart, shihet se në territor ndahen dy kategori shkëmbinjsh dhe dy kategori dherash, secila me karakteristikat e veta specifike fiziko-mekanike. Përhapje të madhe kanë depozitimet e flishit, karakteristikat e të cilave duhen marrë parasysh me vëmendje të veçantë gjatë projekteve të ndërtimit apo veprave të infrastrukturës, por edhe të veprave për shfrytëzim mineral. Në kuadër të këtij plani mund të jepen

rekomandime të përgjithshme, të cilat duhet të mbahen parasysh dhe të thellohen në projektimet e veprave konkrete inxhinierike.

Duhet mbajtur parasysh dhe fakti se rajoni ku gjendet qyteti i Gramshit si qendra më e madhe e banuar ndodhet mbi shkëmbinj të butë, dhe pranë depozitimeve të dherave pa kohezion. Karakteristikat gjeologjike, gjeologo – inxhinierike të kombinuara me fenomenet e rrezikut gjeologjik, kushtet klimaterike dhe ato gjeomorfologjike mund të sjellin dëme jashtëzakonisht të mëdha me shkatërrime e me humbje jetësh njerëzore nëse nuk merren parasysh dhe bëhen llogaritje të ndërthuruara.

Figura 9: Harta Gjeologjike- Inxhinierike



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

### Analiza gjeologjike dhe e pasurive minerale.

Në pikëpamjen e ndarjes në zona tektonike, në këtë hapësirë administrative takohen në pjesën lindore formacione të zonës tektonike Mirdita, pjesë e e Albanideve të brendshme. Pjesë përbërëse të kësaj zone tektonike që përfaqësohen këtu janë formacione që i përkasin nënzonës Hajmeli dhe pjesë të masivëve ofiolitikë të Shpatit në veri të rajonit dhe masivëve ofiolitikë të Vallamarës e Devollit përkatësisht në jugperëndim e perëndim të territorit të kësaj bashkie.

Albanideve të jashtme i përkasin formacionet që bëjnë pjesë në nënzonën tektonike Krasta pjesë përbërëse e zonës tektonike Krasta-Cukali, formacione të nënzonës tektonike Dajti pjesë përbërëse e zonës tektonike Kruja dhe të nënzonës tektonike Berati përbërëse e zonës tektonike Jonike.

Përhapjen më të madhe e kanë formacionet gjeologjike që i përkasin zonës tektonike Kruja. Më poshtë vijojmë me përshkrimi stratigrafik të bashkisë.

- Depozitimet e **Triasikut të poshtëm të mesëm** janë formacionet më të vjetra të kësaj bashkie. Përfaqësohen litologjikisht nga ranorë, gëlqerorë rreshporë e gëlqerorë



ranorikë, të alternuar me gëlqerorë të kuq nyjorë amonitikë, gëlqerorë silicorë, shiste argjillore e silicorë radiolaritikë, të shoqëruar me shkëmbinj vullkanikë bazikë, mesatarë dhe acidë. Këto depozitime vendosen në pjesën lindore të rajonit të Bashkisë Gramsh në veri të Gurit të Topit.

- Depozitimet e **Triasikut të mesëm-Jurasikut të poshtëm** përfaqësohen nga fragmente të vegjël në skajet perendimore të masivëve të Shpatit dhe Devollit të depozitimeve të formacionit vullkanogjeno sedimentar.
- **Mosha Triasik i mesëm – Jurasik i mesëm** takohet kryesisht në veri të Gurit të Topit me gëlqerorët pllakorë me sicilorë.
- **Triasiku i sipërm – Jurasiku i poshtëm**, përfaqësohet nga gëlqerorë në trajtë fragmentesh në perëndim të masivëve ofiolitikë të Shpatit e Vallamarës.
- **Mosha e Jurasikut** përfaqësohet nga depozitime karbonatike të Jurasikut të mesëm të sipërm dhe nga depozitimet e Jurasikut të sipërm. Depozitimet e **Jurasikut të mesëm** të sipërm janë në trajtën e blloqeve të përbëra nga ndërshtresa silicorësh radiolaritikë, me gëlqerorë biomikritikë pllakor që vendosen në jugperëndim dhe perëndim të masivit të Vallamarës. Depozitimet e **Jurasikut të sipërm** i përkasin melanzhit “blloqe në matriks” masa kryesore e të cilit ndërtohet nga argjilite alevrolitorë. Pjesa më e sipërme e këtij melanzhi përbëhet nga brekçet dhe tufo brekçet ofiolitike. Përhapja e këtyre depozitimeve është mjaft e vogël në jug dhe në lindje të masivit të Devollit dhe në perëndim të masivit të Vallamarës
- **Jurasiku i sipërm-Kretaku i poshtëm.** Këto depozitime i përkasin flishit të hershëm i cili përhapjen më të madhe e ka midis masivëve të Shpatit dhe Vallamarës. Gjithashtu ka përhapje fragmentare në veri dhe jug të masivit të Devollit. Ky flish përfaqësohet nga ndërthurje mergelorësh e gëlqerorësh mergelorë radiolaritikë me tintinidë, argjilite, alevrolite, ranorë si dhe material brekçoz e konglobrekçoz. Materiali copëzor mbizotëruar është ai ofiolitik.
- **Depozitimet Kretake.** Në këto depozitime përfshihen depozitimet e Kretkut të poshtëm atij të sipërm dhe depozitimet e kalimtare të Kretakut të sipërm. **Kretaku i poshtëm** përfaqësohet prej flishit gëlqeror-argjilor-mergelor i zonës së Krastës. Takohen në rajonet e Gribës dhe Lisecit ku përbën bërthamat e antiklinaleve. Përbëhen nga pakoja e poshtme e “flishit gri” dhe ajo e sipërme e “flishit të kuq”. **Kretaku i sipërm** përfaqësohet nga formacione karbonatike që i përkasin zonës tektonike Kruja dhe nënzonës tektonike Krasta. *Zonës tektonike Kruja* i përkasin depozitimet karbonatike që ndërtojnë bërthamën e antiklinalit të Tërvollit ku dallohen dy pako ajo dolomitore dhe ajo e gëlqerorëve organogjene dhe gëlqerorëve shpatik me pamje masive. Pjesa e sipërme e kësaj pakoje vazhdon deri në Paleogjen. *Nënzonës tektonike Krasta* në rajon i takojnë depozitimet e formacionit karbonatik “Kosore” me përhapje në zonat e Lisecit, Gribës Grabovës, Lenies e Vidhanit si pjesë përbërëse e antiklinaleve.
- **Depozimet e kalimtare të Kretakut të sipërm** i përkasin gjysmës së sipërme të Maastichtianit. Përfaqësojnë një kalim nga formacioni karbonatik në atë flishor të paleogjenit. Pjesa e poshtme përbëhet nga gëlqerorë, alevrolite, mergele e ranorë dhe mbi to vendoset material terrigjen që kalohen në flish. Gjendet në antiklinalet e Gribës, Lisecit, Grabovës dhe Lenies.
- **Depozitimet e Paleogjenit** kanë përhapjen më të madhe sipërfaqësore në rajonin e Bashkisë së Gramshit. Depozitimet e kësaj moshe përhapen në nënzonën Krasta, zonën

Kruja dhe atë Jonike. Takohen këtu depozitime të Paleocenit, Paleocen – Eocenit, Eocenit, Oligocenit (i poshtëm, i mesëm dhe i sipërm).

- **Depozitimet e Paleocenit** takohen në formacione që i përkasin zonës tektonike Kruja. Ato takohen në antiklinalin e Tërvollit dhe përbëhen kryesisht nga gëlqerorë shtresë mesëm deri shtresë trashë. Këta gëlqerorë u përkasin dy pakove, nga të cilat pakoja më e sipërme ka vazhdim edhe në Eocen (Paleogjen i mesëm). Në pjesën më të sipërme tek gëlqerorët dallohet zhvillimi i gropave karstike të mbushura me bokside.
- **Depozitimet e Paleocen – Eocenit** përhapen nga Shënepremtja në Porçani në veri e në kufirin perëndimor të masivit ofiolitik të Devollit në jug. Sipërfaqja e përhapjes është e madhe nëpër të gjithë rajonin e përhapjes së nënzonës Krasta. Depozitimet përfaqësohen nga flish dhe flishoide, kryesisht ranoro-alevrolitor, të alternuar me ranorë shtresë trashë deri masivë, horizonte vithisëse e konglomerate.
- **Depozitimet e Eocenit** të nënzonës Krasta takohen vetëm në sektorin e krahut lindor të Gribës dhe përfaqësohen nga flishe argjilo-ranor me konglomerate e gëlqerorë konglomerate. Në territorin që i përket zonës Kruja ato shfaqen në përbërje të bërthamave antiklinale të Tërvollit dhe Valeshit. Në territorin që i përket zonës Jonike depozitimet e Eocenit takohen në formën e gëlqerorëve organogjeno-coprizorë dhe mikritikë ashtu si dhe në zonën Kruja, në zonën e periklinalit të Marakut (territori i fshatit Luzaj).
- **Depozitimet e Oligocenit** kanë përhapje të madhe në territorin e bashkisë. Ato përhapen në hapësirën që zenë zonat tektonike Kruja dhe Jonike. Depozitimet e Oligocenit të poshtëm që i përkasin zonës Kruja rrethojnë antiklinalin e Tërvollit, duke zënë një hapësirë të madhe mes flishit të Paleocen – Eocenit të nënzonës Krasta në lindje dhe depozitimeve flishit të Oligocenit të mesëm në perëndim që i përkasin zonës Kruja. Në jug kontaktojnë me masivin e Devollit. Përfaqësohen nga flish argjilo-alevrito-ranor me horizonte vithisëse dhe olistolite gëlqerorësh. Po të njëjta përbërje kanë edhe depozitimet e kësaj moshe që i përket zonës tektonike Jonike. Ato shtrihen në perëndim të territorit të kësaj bashkie në zonat e Belesovës, Përrenjasit. Mbi këto depozitime kalon kufiri i bashkisë me bashkitë e Cërrikut dhe Kuçovës.
- **Oligocenit të mesëm** i përkasin zonës tektonike Kruja dhe Jonike. Depozitimet që i përkasin zonës Kruja përbëjnë aksin qendror të bashkisë Gramsh. Mbi këto depozitime është vendosur dhe vetë qyteti i Gramshit. Përbëhen nga flish argjilo-alevrito-ranor.
- Po të njëjtën përbërje kanë **depozitimet që i përkasin zonës Jonike** të cilat janë të pranishme në pjesën perëndimore të rajonit dhe marrin pjese në ndërtimin e krahut lindor të antiklinalit të Marakut dhe të sinklinalit të Tunjës. Përshkojnë territorin e bashkisë në trajtën e një brezi nga veriu ku kufizohen me liqenin e Banjës deri në kufirin jugor me bashkitë Berat dhe Skrapar
- **Oligoceni i sipërm** përfaqësohet nga depozitime që i përkasin zonës tektonike Kruja, të përbëra nga flish argjilor-ranor, copa gëlqerorësh dhe gëlqerorë masivë, të cilat takohen në veri të Galigatit.
- **Mosha Neogjen** përfaqësohen vetëm nga depozitime me moshë Akuitanian të cilat takohen në jug të Tërvollit me një përhapje mjaft të vogël sipërfaqësore. Përbërja është konglomerate me zaje kryesisht magmatike e më pak karbonatike.
- **Depozitimet Kuaternare** gjejnë përhapje në rajonin e Bashkisë Gramsh. Në pikëpamje moshore përkasin Pleistocenit, Pleistocen-Holocenit dhe Holocenit. Janë të

llojeve të ndryshme gjenetike. *Depozitimet e Pleistocenit* kanë përhapje të vogël dhe origjinë kryesisht glaciale. *Depozitimet e Pleistocen – Holocenit* përbëhen nga një facie e përzier, koluvionesh, deluvionesh, proluvionesh që përfaqësohen litologjikisht nga rëra, alevrite e argjila. Përfaqësimin më të madh e kanë në pjesën lindore të rajonit. Depozitimet e Holocenit në këtë rajon kanë përhapje përgjatë rrjedhjes së lumit Devoll dhe përrenjve Holtë dhe Vërçë. Dallojmë depozitime të shtratit të lumit edhe formime të vjetra taracore në kuota më të larta se shtrati i sotëm i lumit. Këto formime aluviale përfaqësohen litologjikisht nga zhavorre, rëra, alevrite, argjila. Janë objekt i shfrytëzimit si inerte.

- **Shkëmbinjtë magmatikë.** Këto shkëmbinj i përkasin formacioneve që përfshihen në zonën Mirdita. Në Bashkinë Gramsh gjejnë përhapje: *Shkëmbinjtë vullkanikë* të Triasikut të poshtëm dhe të mesëm që takohen në sektorin e Gurit të Topit. Përbëhen nga vullkanite bazaltikë mesatarë dhe acidë. Fragmente vullkanogjeno-sedimentarë (Triasik i mesëm-Jurasik i poshtëm) që përhapen kryesisht në periferi të masivëve ofiolitikë të Shpatit dhe Devollit, të përfaqësuara nga llava jastëkore bazaltike, rryma lavore e më rrallë shkëmbinj piroklastike bazaltikë, të ndërthurur me radiolarite e rreshpe silicoro-argjilore. Formacioni ofiolitik i Jurasikut të mesëm pjesë e brezit perëndimor të ofioliteve me përhapje në masivin e Shpatit, Devollit dhe Vallamarës. Shtroja metamorfike me moshë të Jurasikut të mesëm që ndeshet në perëndim të masivit të Shpatit (në jug të Poroçanit) dhe masivit të Devollit, si brez i ngushtë fragmentesh të shkëputur.

Përsa i përket pasurive minerale, Bashkia e Gramshit ka një numër të vogël vendburimesh dhe shfaqesh të mineralizuara, kryesisht jometalorësh. Këto përmbliken në vendburime e shfaqje argjilash, dolomitesh dhe tufesh. Lënda e parë karbonatike, argjilat, magnezitet etj. që gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh, plotëson kushtet sasiore e cilësore të nevojshme në fushën e industrisë së ndërtimit, infrastrukturës, etj.

Por në këtë rajon ka dhe depozitime të cilat megjithëse nuk janë zbuluar deri më tash shtritime naftë-gazmbajtëse, përsëri paraqesin perspektivë në këtë drejtim.

### **Mineralet jometalore**

Përsa i përket *argjilave* më i rëndësishmi është vendburimi i argjilave Kodovjat. Ky vendburim ka përmasat të mëdha në shtrirje midis 40 - 50 m deri në 250-300 m dhe trashësi mesatare deri 80 m. Sasia e rezervave gjeologjike është disa mijëra tonë me përmbajtje  $\text{SiO}_2$  në 53.4%.,  $\text{Al}_2\text{O}_3=11.11\%$ ,  $\text{MgO} = 5.38\%$  dhe  $\text{CaO} = 7.56\%$ .

*Dolomitët* përfaqësohen nga vendburimi i Tërvollit me një gjeëndje rezervash gjeologjike prej rreth 52 milionë tonësh. Përmasat e vendburimit janë 240 metra në rënie dhe 1500 metra në shtrirje. Trashësia maksimale e tyre shkon deri në 50 metra. Kalçiumi dhe magneziti janë mineralet kryesore. Origjina e vendburimit është sedimentare.

*Tufet* përfaqësohen nga tufet potasike të vendburimit me origjinë sedimentare të Qerretit. Mineralet kryesore në këtë vendburim janë xhami vullkanik, kuarci, feldshpati, shoqërues potasi, biotiti, kalçiti, magnezit etj., ndërsa mineralet dytësorë janë ranorë dhe argjilorë. Vendburimi i Qerretit gjendet rreth 10 km nga qyteti i Gramshit. Perspektiva e këtij vendburimi

mbetet e hapur në drejtim të rënies. Gjëndja aktuale e rezervave gjeologjike është 207,000 ton me përmbajtje  $K_2O = 5.28\%$ ,  $Na_2O = 1.74\%$ ,  $Al_2O_3 = 11.2\%$ ,  $SiO_2 = 54.3\%$ .


Gjithashtu në Bashkinë Gramsh dallohen disa shfaqje të këtij mineralizimi jometalor në Sultë, Dufaban, Lubinjë, Duzhë, Tunjë, Jançe, Katerlis, Ermenj, Përroi Qershisë, Llallaj e Drizë.

**Magnezitet** gjenden në vendburimin e Gramshit. Ky vendburim është i tipit gjenetik sedimentar me moshë kuaternare. Përmasat janë në shtrirje 50-100 metra, me trashësi 0.4 m - 0.6 metra dhe trashësi mesatare 0.5 m. Format e magneziteve janë shtresore. Janë zbuluar 100,000 ton rezerva magneziti me përmbajtje  $MgO = 41.5\%$ . Gjithashtu në Bashkinë Gramsh takohen edhe disa shfaqje të mineralizuara të magneziteve në Bulçar, Kodovjat, Oseuth, Qerret, Cerujë e Trashovice. Mineralizimi i magneziteve gjendet në tarracat lumore të lumit Devoll midis depozitimeve flishore të oligocenit të mesëm. Origjina e tyre është sedimentare lumore dhe përfaqësojnë produkte të shkatërruara dhe të transportuara të magneziteve.

### Perspektiva naftë-gaz mbajtëse

Bashkia Gramsh përfshihet në bllokun 2 të kërkimit të naftës. Prania e vendburimeve të naftës në vendburimet e Kuçovës dhe Pekishtit në perëndim të kësaj bashkie dhe e shenjave të naftës në flishin e rajonit të Dumresë flet për mundësinë e një perspektivë të mundshme dhe në këtë rajon. Strukturat më perspektive janë Vargu antiklinal Letan-Valesh-Tërvoll i cili është vargu antiklinal më lindor në rajonin e kësaj bashkie, ku gjejnë zhvillim nga jugu në veri strukturat e Tërvollit, Valeshit dhe Letanit dhe vargu strukturor Galigat-Kozan ku ndodhet ngritja antiklinale e Galigatit, e cila është njësi strukturore më jugore e këtij vargu strukturor. Në këto struktura mungojnë studimet e thelluara për naftë-gazmbajtjen.

Figura 10: Harta e Gjeologjike dhe pasuritë minerale



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

## 2.3 Analiza hidrogeologjike dhe hidrografike

### 2.3.1 Analiza Hidrogeologjike

Burimet nëntokësore i klasifikojmë sipas llojeve të akuiferëve. Llojet e këtyre akuiferëve që ndeshen këtu janë:

1. **Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje të ulët;
2. **Akuiferët me porozitet çarje-karst**, me ujëmbajtje tepër të ndryshueshme, vende - vende shumë të lartë;
3. **Akuiferët me porozitet poro- çarje**, me përhapje të kufizuar dhe ujëmbajtje lokale të ulët;
4. **Akuiferët me porozitet çarjesh**, me ujëmbajtje shumë të ndryshueshme, mesatare deri shumë të ulët;
5. **Praktikisht jo akuiferë**, që përfaqësojnë një mjedis gjeologjik me porozitet të pamjaftueshëm për të mbajtur e qarkulluar në sasira të mjaftueshme ujrash për të furnizuar komunitetet me ujë të pijshëm.

Akuiferët me porozitet çarje (tipi 1) kanë përhapjen më të madhe, por akuiferët karstik (tipi 2), që vlerësohen me ujëmbajtjen më lartë, janë burimet më të rëndësishme për furnizimin me ujë të pijshëm. Akuiferë të tillë mund të përmendim akuiferin e Tërvollit apo atë të Tomorrit. Nga akuiferi i Tërvollit ushqehen burimet ujore që burojnë në fshatrat Kërpic e Sotirë, nga ku furnizohet dhe qyteti i Gramshit dhe zonat përreth.

Në përgjithësi të gjithë burimet e rrethit Gramsh pavarësisht prurjes së tyre që luhatet nga 0,001 deri në 1000 l/s. Resurset e përgjithshme dinamike vlerësohen të jenë 2030 l/s.

Resurset ujore sipërfaqësore të kësaj bashkie përfaqësohen kryesisht nga prurjet ujore të lumenjve Devoll dhe Tomorricë të cilat përshkojnë nga jugu drejt veriut territorin e bashkisë Gramsh. Lumi Devoll ka prurje mesatare 49.5 m<sup>3</sup>/s, dhe mineralizimi të ujit 390 mg/l.

### 2.3.2 Analiza Hidrografike

Pasuria ujore e Gramshit përbëhet kryesisht nga lumenj, përrenj dhe nga liqene. Lumi i Devollit është lumi kryesor, i cili e përshkon bashkinë nga jugu në veri. Ai ushqehet nga Përroi i Tomorrocës, Përroi i Grabovës, Përroi i Vërrces, Përroi i Holtës dhe Përroi i Pashtreshit.


**Lumi Devoll** përshkon bashkinë e Gramshit nga jug-lindja në veri-perëndim në një gjatësi prej 49km. Regjimi i rrjedhjes së këtij lumi përcaktohet nga reshjet dhe nga shkrirja e dëborës, pra nga ushqyerja me përrenjt më të vegjël. Si i tillë ai ka dy periudha me prurje të madhe, një në Nëntor/ Dhjetor dhe tjetra në Mars/ Prill. Prurjet e mëdha në këto periudha shpesh rezultojnë edhe në përmytje sidomos në pjesën veriore të bashkisë. Lumi fillon në bashki nga fshati i Kullollasit në NjA të Skënderbegasit dhe përroi i Tomorricës i cili vjen nga Kotka në Nj.A të Kushovës. Këto dy degë bashkohen në Mashan duke vazhduar ndërmjet fshatrave Pishaj dhe Ostenthi. Lumi përshkon qytetin e Gramshit duke vazhduar më tej në Zgjupa, Kuterqara e Cingar dhe del nga territori i bashkisë për të vazhduar në drejtim të Qytetit të Cërrikut. Brenda territorit të bashkisë, Devolli mbledh ujërat e një sërë përrenjsh të ndryshëm si Përroi i Grabovës, Përroi i Tomorricës, i Vërrçes, të cilët ndodhen në jug të bashkisë. Në pjesën veriore të lumit Devoll, në zonën ku lumi është në dalje nga territori i bashkisë, Devolli mbledh ujërat e Përroit të Holtës dhe Përroit të Pashtreshit. Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër të madh burimesh ujore sipërfaqësore, siç janë kanioni i Holtës, ujëvara e Sotirës dhe burimet termo-minerale në Holtë.

Në rezervuarët dallohet **ujëmbledhësi i Banjës** i rrethuar me kodra të veshura me pyje. Ky ujëmbledhës ka ardhur si rezultat i ndërtimit të digës së Banjës. Si rezultat rrjedhja e lumit të Devollit ka ndryshuar. Kapaciteti<sup>10</sup> i këtij rezervuari është 200 milion m<sup>3</sup>, dhe lartësia e digës është 158 m. Pavarësisht nga impakti pozitiv për sa i përket krijimit të energjisë me anë të kësaj dige, do kemi edhe disa impakte të karakterit negativ. Duke qënë se në vende të caktuara tashmë lumi i Devollit<sup>11</sup> do të sillet si liqen, kemi humbjen e disa specieve endemike që ishin më parë prezente, duke qënë se edhe cilësia e ujit do të ketë ndryshime. Gjithashtu mund të themi se humbja e tokave bujqësore në këto zona, ndikojnë negativisht në aspektin socio- ekonomik të familjeve që mbahen nga këto toka.

Në Bashkinë Gramsh duhet të përmendim edhe liqenet, të tillë si: **Liqeni i Zi**, **Liqeni Bratilës**, **Liqeni i Dushkut** (në Kumian) dhe **Posnovishtë**, etj. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit. Këto liqene në përgjithësi kanë karakter allkunajor, sidomos ato që gjenden në zonën e Grabovës.

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujëtime, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

Figura 11: Harta Hidrografike dhe Hidrogeologjike



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

## 2.4 Analiza Gjeorreziqeve

Gjeorreziqet janë reziqe me natyrë natyrore që mund ti kanosen një zone. Origjina e këtyre reziqeve është:

- Gjeologjike- Termete, rënie shkëmbinjsh, rrëshqitje tokash
- Atmosferike- stuhi bore, stuhi ere, thatësira
- Hidrologjike- përmbytje

- Biofizike-zjarrje në pyje, epidemic

Në Bashkinë Gramsh hasim në përgjithësi vatra erozioni, dhe në disa raste hasim edhe fenomenet e termeteve.

#### 2.4.1 Rrëshqitjet dhe Vatrat e erozionit

Rrëshqitjet, vatrat e erozionit, shtretërit e lumenjeve dhe tërmetet janë fenomenet me përhapje në këtë rajon.

Rrëshqitjet shfaqen përgjithësisht në ato zona ku bazamenti i truallit përbëhet kryesisht nga argjila, flishe dhe flishoidale dhe më pak në shkëmbinj ranorë dhe konglomerate, ku ka dhe kontraste më të theksuara të ndërtimit gjeologo-inxhinierik, gjeomorfologjisë dhe elementeve të shtrueshmërisë së shtresave gjeologjike.

Nga përshkrimi që ju bë më lart llojeve shkëmbore të rajonit si dhe i mbizotërimit të relievit kryesisht kodrinor, duket qartë se rajoni i studimit është mjaft i prekshëm nga ky fenomen. Deri më tani janë evidentuar rreth 26 raste rrëshqitjesh nga rievimet gjeologo – inxhinierike të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Ndikojnë për ta nxitur këtë fenomen faktorët si ndërtimi gjeologjik, litologjia, struktura shëmbore, zhvillimi tektonik, erozioni, përmbajtja e lartë e ujrave nëntokësore, reshjet e dendura të shiut, ndërhyrjet antropogjene etj. Fenomeni i rrëshqitjeve është kryesisht i përhapur gjeografikisht në rajonin lindor - verilindor të bashkisë në rajonet ku përhapen flishe.

Erozioni gjithashtu është një fenomen me përhapje në rrethin e Gramshit, me përhapje dhe ky në zonat flishore e flishoidale. Përhapet në zonat kodrinore dhe nxitet mjaft nga mungesa e pyllëzimit.

Shtretërit e lumenjve janë zona të ekspozuara ndaj rrezikut gjeologjik, për shkak të gërryerjeve që shkaktojnë rrymat lumore të cilat kanë ndryshime të vazhdueshme të prurjes dhe drejtimit të lëvizjes. Këto nxiten edhe prej formacioneve të dherave pa kohezion që vendosen në shtretërit dhe taracat lumore. Ky rrezik shtohet mjaft me afrimin e periudhës së lagësht. Ai çon deri në dëmtim apo shkatërrim të veprave inxhinierike, si ura, rrugë që shkojnë paralel brigjeve mbi taraca lumore apo ndërtesa.


#### 2.4.2 Tërmetet

Tërmetet janë dukuri natyrore ose artificiale të cilat mund të shkaktojnë dëme të mëdha në njerëz dhe në material. Ato shkaktohen nga disa faktorë si përplasja e pllakave të Tokës, shpërthimet nëntokësore etj. Dukë qënë se janë të paparashikueshëm ato shkaktojnë akoma më shumë dëme pasi parandalimi i tyre është i paarritshëm. Megjithatë njohja e efekteve, dhe zonave më të prirura për aktivitet të lartë sizmik pakëson pasojat negative të termeteve. Shqipëria bën pjesë në zonën sizmike Alpine, ku gjenerohet rreth 15% e energjisë sizmike të globit tokësor<sup>12</sup>. Përveç pllakave sizmike, kemi edhe mikropllaka, njësi më të vogla ndarëse, dhe për vendin tonë me rëndësi paraqet mikropllaka Adria, që shtrihet ndërmjet pllakës Afrikane dhe Euro-Aziate. Përplasja e pllakës Adria me Albanidet është shkaku kryesor i termeteve në vënd, dhe si pasojë kemi një aktivitet të theksuar sizmik. Shqipëria karakterizohet nga zona me aktivitet sizmik të ndryshëm:

- Mikro aktivitet sizmik intensive:  $1.0 < M < 3.0$
- Tërmete të vegjël:  $3.0 < M < 5.0$  këto janë më të shpeshtë
- Tërmete të rrallë me madhësi mesatarë:  $5.0 < M < 7$
- Tërmete më të rrallë të fortë:  $M > 7$

Kalimi i thyrjes Vlorë – Elbasan – Shkup, nga e cila gjenerohet një pjesë e mirë e lëvizjeve sizmike në Shqipëri, kalon në veri të kufinjve të bashkisë së Gramshit, duke e vendosur atë brenda zonës VII – VIII ballë, pra në një zonë me rrezikshmëri të lartë sizmike (kujtojmë se zona maksimale është ajo me intensitet IX ballë). Në Bashkinë e Gramshit kemi një termet të shënuar në vitet e fundit. Ai ka ndodhur me datë 26 Nëntor 2015, 3 km në jug të qytetit të Gramshit, me Magnitudë 3, i thellë 17 km<sup>13</sup>.

Figura 12: Harta e Rrezikut gjeologjik



Burimi: SHGJSH; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

## 2.5 Boniteti i tokave bujqësore

Tabela 6 Boniteti i tokave bujqësore sipas NjA-ve dhe Fshatrave në Bashkinë Gramsh

Fshati	Boniteti	Fshati	Boniteti	Fshati	Boniteti	Fshati	Boniteti
<b>NjA Pishaj</b>		Kokël	5	Kukuçovë	6	Kukur	6
Pishaj	4	Posnovisht	7	Kutërçarë	6	Grazhdan	6
Trashovicë	4	Shelcan	6	Kodër	5	Gribë	7
Shëmrizë	5	Bersnik I Sipërm	4	Zgjupë	4	Kalaj	6
Ostrenth	6	Bersnik I Poshtëm	4	Fushë	4	Mukaj	6
Gurrëz	6	Mashan	5	Dufshan	6	Rashtan	6
Cerunjë	5	Broshtan	7	Grekan	7	Rmath	7
Çekin	4	Zamishtë	7	<b>NjA Tunjë</b>		Snosën	6
Qerret	4	<b>NjA Skenderbegas</b>		Tunjë	5	Sojnik	6
Koçaj	5	Skenderbegas	5	Duzhë	6	Vreshtas	6
Vinë	6	Bletëz	6	Irmanj	6	<b>NjA Kushovë</b>	
Fshat-Gramsh	6	Ermenj	5	Jançe	6	Kushovë	5



Drizë	4	Fushëz	4	Katërlis	7	Bregas	4
Cingar I Sipërm	7	Harunas	5	Lubinjë	5	Gjeraqinë	6
Cingar I Poshtëm	5	Kotkë	6	Oban	6	Dumderas	6
Galigat	7	Kullotas	6	Përrenjas	6	Brasnik	6
Kotorr	5	Lemnushë	6	Plepas	6	Ulovë	5
Gjergjovinë	6	Nartë	4	Sarasel	6	Kërpicë	5
Strore	6	Siman	7	Tunjë e Re	6	Sotirë	5
Liras	6	Shembërdhenjë	5	<b>NjA Poroçan</b>		<b>NjA Lenie</b>	
Tërvol	7	Vidhan	6	Poroçan	6	Lenie	6
<b>NjA Kodovjat</b>		Zenelas	5	Lleshan	7	Bicaj	7
Kodovjat	4	<b>NjA Sult</b>		Gjërë	7	Grabovë e Sipërme	6
Bratilë	5	Sult	6	Kabash	6	Grabovë e Poshtme	6
Bulçar	5	Mazrek	6	Holtas	6	Karatë	7
Kishtë		Dushk	4	<b>NjA Kukur</b>		Valth	6

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

Tabela e mësipërme paraqet bonitetin e tokave në bashkinë Gramsh sipas NjA-ve dhe fshatrave të tyre. Boniteti i tokave paraqet cilësinë e tokave në bazë të prodhueshmërisë së tyre duke renditur cilësinë nga 1 në 10 ku 1 është cilësia më e mirë e tokave dhe 10 është cilësia më dobët e tokave.

Në Bashkinë Gramsh vërehet se tokat e NjA-ve nuk janë shumë cilësore përse i përket prodhueshmërisë së tyre. Si pasojë e terrenit malor dhe kodrinor NjA-të e skajeve në bashki kanë toka më pak cilësore siç janë NjA-të Poroçan, Kukur dhe Lenie. Në NjA-të Pishaj, Kodovjat, Sult, Skenderbegas, Tunjë dhe Kushovë tolësia e tokës sëhtë më e mirë por gjithashtu në këto NjA ka fshatra të cilat nuk kanë toka cilësore. Përgjithësisht cilësia e tokavë përse I përket prodhueshmërisë është me e lartë në pjesën qendrore të bashkisë përgjatë luginës së Lumit Devoll.

## 2.6 Analiza e monumenteve dhe zonave të mbrojtura

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore<sup>14</sup>. Zonat e mbrojtura mund të jenë të tipit të gjeomonumenteve, zonave natyrore ose zona me rëndësi kulturore.

### 2.6.1 Zonat e mbrojtura natyrore

Në territorin e Bashkisë së Gramshit gjenden pasuri të shumta natyrore. Në territorin e bashkisë gjendet një pjesë e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit (Pjesa veriore e parkut), i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 21 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zonë. Gjeomonumentet janë shumë fenomene të rralla gjeologjike e gjeomorfologjike. Për nga rëndësia gjeomonumentet në territorin e kësaj bashkie listohen pesë gjeomonumente me vlera kombëtare dhe dhjetë gjeomonumente me vlera lokale të cilat po i listojmë në vijim:

Me vlera kombëtare:

- Kanionet e Sinecit (Saraselit);
- Liqenet e Vallamarës;
- Ujëvara e Sotirës;
- Kanioni i Holtës;
- Shpella e Kabashit;

Me vlera lokale:

- Gryka e Grabovës;
- Karsti i Tërvollit;
- Tarraca e Ballorës (Qytezës);
- Gurët e Krushqëve në Lisec;
- Liqeni i Dushkut;
- Burimet e Kërpicës;
- Liqeni i Zi (Lenie);
- Gëlqerorët me makrofaunë Tërvoll;
- Terracat e Sulovës;
- Burimi termal i Holtës;

Monumentet e Natyrës ndahen në 7 gjeo-monumente dhe 14 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjëndje të mirë biologjike dhe estetike. Më poshtë vijon një përshkrim më i detajuar i këtyre zonave të mbrojtura.

**Parku Kombëtar i Malit të Tomorrit:** Në pjesën jugore të territorit të Bashkisë Gramsh ndodhet një pjesë prej 1,280 ha e PK Mali i Tomorrit. Parku shquhet për biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Specie dominuese në floristike përmendim ahun, pishën e zezë, robullin dhe kullotat subalpine e alpine. Gjithashtu parku është një habitat i rëndësishëm për një gamë të gjerë të specieve faunistike, ndër të tjera përmendim gjitarët e mëdhënj ariu – *Ursus arctos*, ujku – *Canis lupus*, ndërsa shpendët përfaqësohen nga rrëmbenjësit e ditës dhe të natës, harabelat, etj<sup>15</sup>. Krahas vlerave shkencore dhe ekonomisë natyrore, parku i Tomorrit ofron një gamë të gjerë vlerash peizazhi, çlodhëse dhe historiko-kulturore, të cilat mundësojnë zhvillimin e turizmit në natyrë dhe atij historiko-kulturor në këtë zonë. Parku kombëtar “Mali i Tomorrit” menaxhohet nga AKZM-ja. Parku ka një projektplan menaxhimi që është hartuar në vitin 2014 nga Ministria e Mjedisit<sup>16</sup>.

**Shpella e Kabashit<sup>17</sup>:** Ndodhet në afërsi të fshatit Kabash, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. E formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretës së sipërmë, është e gjatë rreth 120 m. Ende nuk është eksploruar. Pjesa e njohur formon një labirinth të vërtetë dhe është e mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë.

**Karsti i Tërvollit<sup>18</sup>:** Ndodhet në malin e Tërvollit, i cili është i përbërë nga gëlqerorët e kretës së sipërme. Në kreshtën e tij të sheshtë është i zhvilluar fuqimisht procesi i karstit, i cili ka formuar një peizazh të mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik.

**Gurrët e Krushqëve<sup>19</sup>:** Ndodhen në afërsi të fshatit Lisec të Bashkisë të Gramshit. Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çuditshme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria

gërryrrëse e erës. Legjenda i lidh ata me "ngrirjen e krushqëve, që kishin shkuar për të marrë nusen".

**Kanioni i Sinecit ose Saraselit<sup>20</sup>:** Nodohet pranë fshatit të Saraselit të NJA-së së Sultit. Përfaqëson një kanion të madh të formuar në gëlqerorët e kretës së sipërme nga veprimtaria karstike dhe erozive e përroit të Seraselit. Është i gjatë rreth 15 km, i thellë rreth 300 m dhe i gjerë rreth 20-30 m. Ka shpate të thepisura.

**Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit<sup>21</sup>:** Nodohet në afërsi të Grabovës së Sipërme dhe është i formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit Homonim, degë e Devollit. Është rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1.5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m. Ka shpate të thepisura.

**Tarraca e Ballores (Qytezës)<sup>22</sup>:** Nodohet në krahun e majtë të lumit të Devollit, në afërsi të fshatit të Ballores. Përfaqëson një fragment të nivelit të parë të tarracës lumore të formuar nga lumi i Devollit dhe lumi i Tomorricës, degë e tij. Është e gjatë rreth 800 m dhe e gjerë rreth 200 m. Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepisur, 15 m të lartë. Në shpinën e saj ka mbetje arkeologjike, që tregojnë për praninë e një vendbanimi prehistoric.

**Liqeni i Dushkut<sup>23</sup>:** Nodohet në afërsi të fshatit Lenie, në rrëzën veriperëndimore të malit të Komianit, në lartësinë 1,105 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m. Ka botë të pasur të gjallë, në të cilën dallohen sidomos zambakët e mbëdhenj të ujit. Rrethohet nga një pyll i dendur pishash me sipërfaqe rreth 12 ha. Së bashku me pyllin rrethues formon një ekosistem tepër interesant liqenor e pyjor. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Kodovjat – liqeni i Dushkut.

**Liqenet e Valamarës<sup>24</sup>:** Nodohen në malin e Valamarës, të vendosura në një cirk të madh kompleks akullnajor, në lartësinë rreth 2,200 m mbi nivelin e detit, pranë fshatit Lenie. Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m, të veçuara nga njeri tjetri prej depozitimesh morenike. Liqeni më i madh ka përmasa mesatare 600 m gjatësi dhe 200 m gjerësi. Kanë ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Janë të pasura me një botë të gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpinë.

**Liqeni i Zi – Lenie<sup>25</sup>:** Gjendet në lartësinë 1,634 m, në afërsi të fshatit Lenie. Përfaqëson një liqen me origjinë akullnajore. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe. Forma e liqenit është e përzgatur, rreth 1,000 – 1,200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m. Drurët e pyllit janë drurë me moshë shekullore. Ujërat e liqenit përdoren edhe për kurim sëmundjesh si reumatizma, por ende nuk ka studime të këtij lloji.

**Moçalet e Grabovës<sup>26</sup>:** Gjendet në shpatin e malit të Valamarës, në lartësinë 1,550 m mbi nivelin e detit. Nga ana administrative i përket fshatit Grabovë e Sipërme. Njihet edhe me emrat Moçalet, Gropa e Kryqit dhe Prishtakoll. Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1,000 m, gjerësi 400 – 450 m e sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungut 25 – 35 cm, perimetri trungjeve 80 – 100 cm, ndërsa mosha është 150 vjeçare. Pylli është përreth një livadhi, ku derdhen mjaft burime nga ana lindore e tij.

**Burimet e Kërpicës<sup>27</sup>:** Ndodhet në afërsi të fshatit Kërpicë. Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flishit të luginës së Tomorricës. Dallohen për regjim të rregullt të prurjes, ujin e pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një pamje me bukuri mahnitëse.

**Ujëvara e Sotirës<sup>28</sup>:** Ndodhet në shpatin lindor të malit të Tomorrit, në afërsi të fshatit të Sotirës. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distancë mjaft të madhe. Krijon një pamje me bukuri mahnitëse.

**Robulli i Valamarës<sup>29</sup>:** Gjëndet në malin e Valamarës, 1,500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 10 ha. Lartësia e drurëve është rreth 30 m, diametri i trungjeve është mbi 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 70 – 100 cm. Moshja e tyre është 150 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë.

**Rrobulli i Grabovës<sup>30</sup>:** Gjëndet në afërsi të malit të Valamarës, ndaj nga banorët njihet edhe me emrin Valamara e Vogël. I përket fshatit Grabovë e Sipërme. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 8 ha. Pylli i rrobullit ka formë drejtkëndëshe me gjatësi 400 – 500 m, e gjerësi 150 – 200. Lartësia mbi nivelin e detit është 1,500 m. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungjeve është 25 – 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 60 – 100 cm. Moshja e tyre është 100 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë.

**Dushku i Bulçarit<sup>31</sup>:** Ndodhet në fshatin Sojnik në lartësinë 1,100 mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grupe drurësh dushku. Ka formë të përzgatur me gjatësi 2,000 – 3,000 m, gjerësi 200 – 300 m. Drurët përfaqësohen nga pisha e zezë dhe dushk, përreth liqenit të Dushkut rreth 12 ha. Në afërsi të liqenit ka livadhe me bimësi barishtore, bimësi ujore e gjallesa të tjera. Lartësia e drurëve është 15 – 25 m, diametri i trungjeve është 15 – 35 cm, perimetri i tyre është 50 – 110 cm. Moshja e drurëve të pishës është 150 vjeçare. Janë të ruajtur mirë.

**Dushkaja e Katër Lisave<sup>32</sup>:** Gjëndet në fshatin Katërlis, NJA Tunjë të Bashkisë Gramsh, në lartësinë 850 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll dushku, me sipërfaqe rreth 1 ha. Grupi i drurëve ka formë drejtkëndëshi me gjatësi 200 – 250 m e gjerësi 40 – 50 cm. Lartësia e drurëve është 15 – 18 m, diametri i trungjeve është 30 – 40 cm, ndërsa perimetri i tyre arrin deri 120 cm. Moshja e drurëve është 80 – 100 vjeçare. Pas vitit 1990 ka patur dëmtim të pjesshëm të drurëve. Është në pronësi shtetërore.

**Ahishtia e Rovjes<sup>33</sup>:** Gjëndet në afërsi të fshatit Kukër (Rovë) të NJA-së me të njëjtin emër të Bashkisë Gramsh, 1,400 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll ahu. Pylli ka formën e një amfiteatri në shpatin malor me sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 15 – 35 m, diametri i trungut është 50 – 70 cm, perimetri i trungjeve është 100 – 200 cm, ndërsa mosha e tyre është 80 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë.


## 2.6.2 Zonat e mbrojtura kulturore

Monumentet e Kulturës në këtë Bashki variojnë që nga kalatë e fortifikimet mesjetare, në ndërtesa me rëndësi fetare. Ato janë të gjithë monumente të kategorisë së parë, pra janë ndërtimet me vlera të spikatura dhe me rëndësi të veçantë për trashëgiminë kulturore. Ato ruhen në tërësinë e përbërësve të tyre arkitektonike dhe teknike. Lista e tyre vijon më poshtë:

1. Kalaja e Kabashit

2. Kalaja e Tërvolit
3. Ujësjellësi në përroin e Ranxës
4. Fortifikim mesjetar
5. Kalaja e Irmajt<sup>34</sup> – përfaqëson një vendbanim të hershëm ilir, rreth 2400 vjeçar, që vërtetohet nga zbulimet arkeologjike dhe gjetjet e ndryshme rreth saj. Mbetjet e kalasë, përfaqsohen nga një murë guri reth 25 m linear në formën e shkronjës L.
6. Kalaja e Prrenjasit
7. Kezma
8. Kisha e Grabovës
9. Kalaja e Grabovës së Poshtme
10. Ura e gurtë
11. Rrënojat e urës antike

Figura 13: Harta e zonave të mbrojtura



Burimi: AKZM; Përpunim grafik: METROPOLIS 2017

## 2.7 Përfundime

Nga studimi i problematikës gjeologjike në Bashkinë Gramsh që përfshin ndërtimin gjeologjik, kushtet gjeologo-inxhinierike, faktorët e rrezikut gjeologjik, karakteristikat e akuiferëve e resurset dinamike të ujrave nëntokësorë, por dhe sipërfaqësorë dhe praninë e gjeomonumenteve mund të nxjerrim këto përfundime:

- Në këtë rajon megjithëse shfaqet prania e një game të gjerë shkëmbinjsh duke filluar nga ata magmatikë e deri në depozitime Kuaternare të krijuar prej Triasikut të mesëm (afërsisht 242 milion vjet më parë) e deri në kohët e sotme e që i përkasin tre zonve tektonike të Albanideve të brendshme e të jashtme, formacionet kryesore shkëmbore që mbizotërojnë janë ato fliohoidale.

- Depozitimet flishoidale shfaqen që nga lloji i flishit i vjetër i Jurasikut të sipërm-Kretakut të poshtëm, por mbizotërues janë llojet e flisheve që i përkasin zonave Krasta Cukali, Kruja dhe Jonike. Në kuadër të planit rregullues ky lloj formacioni shkëmbor duhet marrë seriozisht në konsideratë. Ai përfshihet në llojin e *shkëmbinjve mestarisht të fortë dhe ndërtojnë kryesisht zonën kodrinore e pjesërisht atë malore, në të cilat mundësia e lindjes së fenomenit të rrezikut gjeologjik është më e madhe.*
- Në zonën kodrinore për momentin dallohet një hapësirë mbizotëruese, ku momentalisht nuk dallohen dëmtime në banesa të ndodhuara nga fenomene të rrezikut gjeologjik, dhe pjesa tjetër ku këto fenomene (rëshqitje, erozion) janë të shfaqura. Mungesa e shfaqjes së fenomeneve të tilla ndodh për faktin se ndërtimet nuk e kanë prishur ekuilibrin e shpateve. Ky ekuilibër duhet vazhuar të ruhet dhe në të ardhmen. Rritja e ekzagjeruar e dëndësisë së ndërtimeve, lartësisë së ndërtesave dhe sipërfaqes së tyre mund të çojë në prishje të ekuilibrit të sipërpërmendur.
- Zona përfshihet në rajonizimin sizmik VII-VIII ballë, çka e ekspozon ndaj një rreziku sizmik të lartë. Shkaku kryesor për këtë është afërsia me thyerjen Vlorë – Elbasan – Shkup. Kjo gjithashtu duhet marrë parasysh nga plani rregullues.
- Rreziku i erozionit lumor sugjeron që në brigjet lumore të mos parashikohen ndërtime, por të planifikohen mbjellje pemësh, me rrënjë të cilat të mundësojnë në rritjen e kohezionit të dherave pa kohezion që janë depozituar në brigjet e lumenjve duke ulur kështu erozionin dhe minimizimin e rrezikut.
- Gjithashtu fenomenet e erozionit dhe rëshqitjeve në këtë rajon janë ndikuar mjaft nga shpyllëzimet, prandaj plani duhet të nxisë pyllëzimin, sidomos në zona të planifikuar për ekskursionet turistike në rrugëtimet drejt gjeomonumenteve të zonës.
- Bazuar në këto që u thanë më sipër plani mund të parashikojë ndërtime jo shumë të larta në këtë zonë, maksimumi i të cilave të mos i kalojë 5 – 6 kate, ndërtesa të cilat duhet të ndërtohen në terrene të studiuara mirë në pikpamjen gjeologo inxhinierike, në nivelin e ujrave nëntokësore në rënien e shtresave shkëmbore e sidomos të shtresëzimit të flisheve. Megjithatë lartësia dominuese e ndërtesave nuk duhet ti kalojë 3-4 kate.
- Bashkia e Gramshit merr sasinë më të madhe të ujit të pijshëm nga burime që burojnë nga akuiferët karstikë. Këto zenë 5% të burimeve por mbajnë mbi 90% të resurseve dinamike. Problemi i këtyre lloj akuiferësh është se ata janë mjaft të ekspozuar ndaj ndotjeve, prandaj planifikimi duhet të marrë parasysh që mos të parashikoj ndërtesa apo objekte të infrastrukturës në hapësirat e këtyre akuiferëve.
- Planit rregullues duhet të marrë parasysh dhe mbrojtjen nga ndotja të rrjedhave sipërfaqësore të cilat gjithashtu përbëjnë rezerva të rëndësishme ujore. Kjo duhet bërë duke marrë parasysh orientimin e duhur të derdhjeve të kanalizimeve të zonave të banuara, dhe gjithashtu duke caktuar një zonë për një landfill për grumbullimin e mbetjeve urbane, të cilat sot shkarkohen në brigjet e lumit dhe në liqenin e Banjës.

### **3. Pozicioni dhe elementët e fortë në territor**

#### **3.1 Pozicioni gjeografik i Bashkisë Gramsh**


Bashkia Gramsh gjendet në qendër të vendit tonë. Ajo përbëhet nga 10 NjA: Gramsh, Pishaj, Poroçan, Kukur, Lënie, Kodovjat, Skëndërbegas, Kushovë, Tunjë dhe Sult. Ajo kufizohet nga bashkitë e Elbasanit dhe Përrenjasit në Veri, nga bashkitë Pogradec dhe Maliq në Lindje, nga

Skrapari në Jug, dhe nga bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik në Perëndim. Bashkia Gramsh ka lidhje relativisht të mira me bashkitë e tjera përmes rrugëve interurbane.

Distancat më të favorshme me qytetet kryesore janë:

- Tiranë, 83.3 km, 1 orë dhe 43 minuta- Përmes rrugës Autostradës Tiranë- Elbasan, dhe më pas duke ndjekur rrugë interurbane.
- Durrës, 99.8 km, 1 orë dhe 55 minuta- Duke ndjekur rrugën nga Kavajë- Rrogozhinë- Cërrik.
- Elbasan, 44.2 km, 1 orë.
- Fier, 108 km, 2 orë
- Vlorë, 144 km, 2 orë e 36 minuta.
- Lushnjë, 80.1 km, 1 orë e 30 minuta
- Korçë, 83.3 km, 2 orë.

Figura 14 Pozicioni gjeografik



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

### 3.2 Elementët e fortë në territor dhe elementët përjashtues

Territori përbëhet nga shumë pjesë të ndryshme të cilat ushtrojnë ndikim te njëri - tjetri. Pjesët apo elementët të cilët ndikojnë më shumë, apo kanë veçori më spikatëse mund të konsiderohen si elementë të fortë në territor. Elementët mund të shfaqen në forma apo situata që favorizojnë, por edhe kundërshtojnë/ pengojnë zhvillimin. Shtrirja e tyre fizike dhe ndikimi i tyre në territor mund të jetë pikësor/qëndror, por edhe sipërfaqësor në formën e fashave të ndikimit. Elementët e tillë mund të jenë natyrorë, por edhe artificialisht të krijuar nga njeriu.

### 3.2.1 Elementët e fortë natyrore

Vetë morfologjia e terrenit të Bashkisë Gramsh paraqet një element të fortë që ka ndikuar në shtrirjen e vendbanimeve, dhe paraqet potencialet për zhvillimin e kësaj bashkie në të ardhmen. Karakteri malor që përshkohet nga lugina lumore që krijojnë kanione, është ndoshta elementi më i fortë e terheqës i kësaj bashkië. Një element tjetër natyror është edhe pasuria e shumtë ujore, si liqenet, Lumi i Devollit dhe Përrenjtë e shumtë që e ushqejnë atë. Lumi i Devollit lidhet jo vetëm me ujitjen e tokave dhe peshkimin, por edhe me vlerat turistike e peizazhistike.

Tokat bujqësore janë gjithashtu një element me rëndësi për këtë bashki. Ato shtrihen përgjatë luginës së Devollit. Duke qënë se klima në bashki është e favorshme për rritjen e kulturave të ndryshme, mund të paraqiten potenciale për kultivimin në masë të produkteve bujqësore.

Liqenet në Gramsh përbëjnë pika të forta që mund të terheqin më shumë vizitorë, për shkak edhe të biodiversitetit si psh Liqeni i Dushkut i cili në sezonin e verës mbulohet nga zambakët e ujit. Ndër këto elementë natyre, mund të përmendim edhe monumentet e natyrës të cilat janë jo vetëm pika me interes zhvillimi, por duke pasur statusin e monumentit janë më të njohura dhe të mbrojtura si pjesë të tjera të territorit.

Monumentet e natyrës që shërbejnë edhe si pika të forta të territorit mund të përmendim:

1. Parku i Tomorrit- Gjendet në jug perëndim të bashkië. Pavarësisht se sipërfaqja e këtij parku në Gramsh nuk është shumë e madhe, ai mund të konsiderohet si një pikë e fortë. Ky park ka rëndësi jo vetëm si zonë pyjore me biodiversitet por edhe se lidhet me një nga malet më të njohura të Shqipërisë, me Malin e Tomorrit. Ky park mund të konsiderohet si pika fillestare për krijimin e itinerareve që lidhin zonat natyrore pyjore në Gramsh.
2. Shpella e Kabashit- është një shpellë e cila vetëm vitet e fundit ka filluar të ekspolohej. Ajo mund të shndërrohet në një pikë turistike, gjithmonë duke marrë masat e duhura për mbrojtjen e monumentit.



Figura 15 Shpella e Kabashit



Burimi: Arkiva Co- PLAN, 2017

3. Karsti i Tërvolit- ofron një peisazh interesant në formën e hojeve të bletës, i cili vjen nga procesi i vazhduar i karstit.

Figura 16 Karsti i Tërvolit



Burimi: Arkiva Co- PLAN, 2017

4. Kanioni i Holtës- është një nga pikat tashmë më të vizituara në Gramsh. Ky kanion paraqet bukuri të rrallë me ujërat dhe shkëmbinjtë, duke ofruar mundësi për aktivitete të ndryshme si ngjitje në shkëmbinj, notim, piknikë etj.

Figura 17 Ujërat në kanionin e Holtës



Burimi: Arkiva Co- PLAN, 2017

5. Gurrët e Krushqëve,
6. Kanioni i Sinecit ose Saraselit- ky kanion ka shpate të thepisura, është i gjatë rreth 15 km, i thellë 300m dhe me gjerësi 20-30m.
7. Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit,
8. Tarraca e Ballores,
9. Liqeni i Dushkut- është një liqen allkunajor, i cili ofron edhe një pasuri të madhe të zambakëve të ujit. Ky liqen rrethohet edhe një pyll i dendur pishash, dhe së bashku krijojnë një ekosistem me vlera peisazhistike dhe natyrore.

Figura 18 Zambakët në Liqenin e Dushkut



Burimi: Arkiva Co- PLAN, 2017

10. Liqenet e Valamarës- janë tre liqene allkunajore. Ofrojnë pamje fantastike përgjatë gjithë vitit. Gjatë verës kanë ujë të pastër dhe të freskët, ndërsa gjatë dimrit sipërfaqja e tyre ngrin.
11. Liqeni i Zi – Lenie- bën pjesë gjithashtu në liqenet allkunajore të Bashkisë Gramsh. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe Ujërat e këtij liqeni janë përdorur nga banorët edhe për kurim nga reumatizma.

Figura 19 Liqeni i Zi



Burimi: Arkiva Co- PLAN, 2017

12. Moçalet e Grabovës,
13. Burimet e Kërpicës,
14. Ujëvara e Sotirës- është një nga bukuritë më madhështore të Bashkisë së Gramshit. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m.

Figura 20 Ujëvara e Sotirës



15. Robulli i Valamarës,
16. Rrobulli i Grabovës.


### **3.2.2 Elementët e fortë artificialë**

Elementët e fortë artificialë në këtë bashki nuk janë aq të shumtë në numër si ata natyrorë, por kanë një ndikim shumë të madh. Mund të përmendim këtu rezervuarin e Banjës, i cili u krijuar artificialisht me ndërtimin e HEC të Banjës. Ky rezervuar gjendet në hyrjen Veriore të Bashkisë Gramsh, dhe pamja e tij të shoqëron përgjatë rrugës. Rezervuari rrethohet nga kodra të veshura me pyje dhe përbën një element shumë të fortë për zhvillimin e turizmit ujqor për aktivitete si lundrim, ecje etj. Përvcesë këtij rezervuari me rëndësi në territorin e bashkisë janë edhe monumentet e kulturës:

1. Kalaja e Kabashit
2. Kalaja e Tërvolit
3. Ujësjellësi në përroin e Ranxës
4. Fortifikim mesjetar
5. Kalaja e Irmajt
6. Kalaja e Prrenjasit
7. Kezma
8. Kisha e Grabovës
9. Kalaja e Grabovës së Poshtme
10. Ura e gurtë
11. Rrënojat e urës antike

Kalaja e Tërvolit, Kalaja e Irmajt tregojnë që në bashki kemi vendbanime të hershme ilire dhe janë një provë e vazhdimësisë së ilirëve në territor. Disa nga monumentet e tjera si Kisha e Grabovës, janë të rëndësishme edhe për kulturën fetare në bashki. Mbrojtja e këtyre monumenteve është me rëndësi për Bashkinë Gramsh, pasi ata mund të përdoren si pika turistike, të cilat ndërthuren me pasurinë e shumë natyrore të bashkisë.

Figura 21 Harta e elementëve të fortë në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe METROPOLIS, 2017

### 3.3 Përfundime

Bashkia Gramsh ka një pozicion të favorshëm gjeografik pas ndodhet në distanca të vogla nga qytetet e mëdha të vendit dhe rrugët janë në përgjithësi me cilësi të mirë. Gjithashtu në këtë bashki kemi shumë pasuri natyrore e kulturore të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e vendbanimeve, por edhe paraqesin potenciale për zhvillimin e turizmit malor dhe kulturor. Duke qënë se në përgjithësi kjo bashki mbetet në përgjithësi e pazbuluar nga masa turistike, duhet patur kujdes me ndërhyrjet turistike, pasi vlerat duhet të mbrohen krahas promovimit të tyre.

### 4. Dokumentet e Planifikimit të hartuara më parë

Gjatë hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor është e rëndësishme të merren në konsideratë planet dhe propozimet e parashtuara në dokumentet e mëparshme të planifikimit, në kuadër të bashkërendimit horizontal dhe vertikal me proceset e planifikimit që ndikojnë mbi territorin e bashkisë, si dhe për të ndikuar në një planifikim më të mirë, duke rimarrë ide dhe propozime ende të vlefshme.

Dokumentet e planifikimit që kanë ndikuar mbi territorin e bashkisë së Gramshit janë të dy llojeve:

- Strategji zhvillimi ekonomik, hapësinor etj.
- Plane rregulluese dhe planifikim vendor.
- Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK)

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) “Shqipëria 2030”, është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të tërë.

Figura 22 Vizioni i Planit të Përgjithshëm Kombëtar



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2016

### Vizioni për Shqipërinë:

“Shqipëria një qendër e integruar në sistemin ekonomik dhe infrastrukturor Europian, një ekonomi e shumëllojshme dhe konkurruese në hapsirën Ballkanike, një shtet që synon barazinë në akses, infrastrukturë, ekonomi dhe dije e cila siguron mbrojtje të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore me synimin për t’u shndërruar në një destinacion autentik.”

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Kombëtar bazohen në objektivat e planifikimit të qendrueshëm të dokumenteve më të rëndësishëm të planifikimit europian, si Axfenda Evropiane e Territorit 2020, Strategjia Evropa 2020, Vizioni Territorial i Evropës 2050, etj.

### Objektivat strategjikë të PPK-së:

- Integrimi shumëdimensional në kontekstin europian;
- Krijimi dhe forcimi i një pozite ekonomike të fortë dhe konkurruese të Shqipërisë në rajonin e Ballkanit dhe të Mesdheut;
- Sigurimi i integritetit fizik dhe territorial të peizazhit historik, kulturor, natyror dhe urban në të gjithë territorin shqiptar;
- Rritja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës për njerëzit, duke promovuar zhvillimin ekonomik, eliminuar pabarazitë hapësinore, hequr barrierat e aksesit në ekonomi, infrastrukture dhe dije;
- Promovimi i "së drejtës për qytetin”;

- Krijimi i bazave për zhvillim rajonal.

### **Objektivat specifikë të planit**

Këta objektiva që burojnë nga ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar janë:


- përcaktimi i parimeve dhe i drejtimeve për një zhvillim të qendrueshëm e të balancuar të territorit;
- krijimi i kushteve territoriale për zhvillimin rajonal;
- drejtimi i krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës publike kombëtare;
- krijimi i kushteve për ruajtjen e ekosistemeve, biodiversiteteve, burimeve natyrore mbi e nën tokë dhe të pasurisë natyrore e kulturore, balancimi i efekteve të sistemeve të banimit e veprimtarive ekonomike. Mbrojtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe sipërfaqeve të tjera të kultivueshme;
- orientimi i objektivave për planifikimin rajonal, ndërvendor e vendor;
- bashkërendimi i punës, harmonizimi dhe orientimi i objektivave sektoriale të zhvillimit me efekt në territor;
- përputhja me orientimet dhe udhezimet e dokumentit të Perspektivës Europiane për Zhvillimin Hapsinor.

### **Politikat**

- Zhvillimi i infrastrukturës kombëtare që lidh Shqipërinë me korridoret e transportit pan-europian;
- Zhvillimi i Shqipërisë si qendër ndërlidhëse infrastrukturore dhe energjetike për rajonin e Ballkanit;
- Rritje inteligjente e sistemit urban përmes zhvillimit: policentrik, densifikues dhe gjithëpërfshirës;
- Promovimi dhe akses i zonave me karakteristika natyrore dhe të peizazhit. Menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore, i cili siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor përballë rritjes dhe globalizimit. Në të njëjtën kohë i bën ato aktive dhe kontribuuese në rritjen ekonomike të vendit duke i riaktivizuar si asete, përmirësuar dhe rritur aksesin e përshtatshëm në to;
- Zhvillimi i sistemit të transportit multimodal dhe miqësor ndaj mjedisit. Promovimi i transportit të integruar dhe i koncepteve të reja të lëvizjes miqësore ndaj mjedisit. Ky transport mbështetet në zhvillimin policentrik të territorit, për të arritur një progres gradual që siguron akses të barabartë në infrastrukturë dhe ekonomi;
- Zhvillimi i infrastrukturës energjetike të diversifikuar drejt energjisë së rinovueshme;
- Planifikimi dhe zhvillimi i integruar i flukseve shpërndarës dhe ndërlidhës të komunikimit, transportit, ushqimit dhe energjisë që siguron zhvillim koheziv, eficient dhe cilësor të korridoreve të mësipërm;
- Hierarkizimi, specializimi dhe grupimi funksional i qendrave urbane;
- Promovimi i "së drejtës për qytetin" për zonat informale.

### **Poli i zhvillimit rajonal – Elbasan**


Figura 23 Vizioni i Polit të Zhvillimit të Qarkut Elbasan sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2017



Figura 24 Vizioni i Polit të Zhvillimit të Qarkut Elbasan sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar



Burimi: Plani i Përgjithshëm Kombëtar, AKPT 2017

Duhet theksuar se për shkak të vendosjes qendrore që ka bashkia Elbasan në lidhje me shtrirjen gjeografike të territorit, përmirësimin e lidhjes me Tiranën dhe me rrugen Elbasan- Tiranë, bashkëpunimi i tij me polin e zhvillimit rajonal Tiranë-Durrës është parësor, duke konsideruar në këtë kuptim një pol zhvillimi me tri qendra primare, Tiranë, Durrës, Elbasan.

Nga ana tjetër realizimi i boshtit qendror, që do të lidhe Elbasanin me Beratin për të dalë në Gjirokastrë, rrit mundësinë e asocimit dhe të vlerësimit të potencialeve të reja bashkëpunuese midis këtyre dy qendrave, duke konsideruar një pol ekonomik qendrat Elbasan, Korçë, Berat, fuqizuar kjo edhe nga lidhjet e reja të propozuara për Korçën me Beratin.

Projektet strategjike ndër-rajonale dhe rajonale që propozohen nga PPK-ja janë:

- Vlerësimi i potencialit natyror në aspektin e diversifikimit të energjisë alternative.
- Vlerësimi i mundësisë së krijimit të parqeve fotovoltaike, me qëllim shfrytëzimin e 2500 orëve vjetore diellore.
- Riaktivizimi i linjës hekurudhore, pjesë e korridorit VIII, për një lidhje të qendrueshme që mbështet zhvillimin e tregtisë dhe transportin e qendrueshëm të mallrave nga Deti i Zi në portin e Durrësit.
- Projekti strategjik i rjetimit të itinerarit antik të "Via Egnatia" në nxitje të turizmit që mbështet dhe vlerëson vlerat traditave dhe historinë e vendit tonë.
- Mbështetje për nxitjen e turizmit elitare në zonat termale, turizmit malor në pika turistike si Gjinari, etj.

### Strategjia e Zhvillimit të Qarkut Elbasan 2009-2016

Kjo strategji është hartuar në kuadër të Projektit Mbështetje e Integruar për Decentralizimin, i cili është një projekt i financuar nga BE-PNUD. Ky Projekt u zbatua nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD), Zyra e PNUD-it në Shqipëri si dhe asistencë teknike e konsorciumit ECORYS, OPM dhe Co-PLAN.

Kjo strategji zhvillimi si fillim bën një përshkrim të përgjithshëm të situatës aktuale ku analizon komponentë të ndryshëm të zhvillimit ku shfaqen problematikat që ka çdo sektor që ndikon në zhvillimin e territorit të këtij qarku gjithashtu dhe analizimin e potencialeve të zhvillimit që ka çdo sektor. Si hap i dytë është ndërmarrja e analizës SËOT që analizon pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe rreziqet hap i tretë është ndërmarrja e vizionit dhe objektivave strategjike të cilat kthehen në prioritet dhe projekte për zhvillimin e territorit të Qarkut Elbasan.

### **Vizioni**

**Në 5 vite Elbasani do të jetë një rajon ekonomikisht i qëndrueshëm që mund të ofrojë shanse reale për të jetuar dhe punuar për brezat e sotëm dhe të ardhshëm, që do të tërheqë investimet e huaja, do të nxisë sipërmarrjen dhe bizneset e vogla dhe të mesme, ku industria, bujqësia dhe turizmi do të marrin mbështetjen e duhur dhe çështjet madhore mjedisore do të gjejnë zgjidhje.**

Ky vizion nënkupton:

- Një thyerje të shumë tendencave/mentalitetesh tradicionale, që përfshijë qëndrime, sjellje apo performanca institucionale apo individuale.
- Një angazhim për të farkëtuar një formë të re bashkëpunimi përmes sistemeve dhe niveleve të qeverisjes.
- Një angazhim për të punuar për një shkallë më të lartë performance ekonomike e veçanërisht rritjen e produktivitetit të saj.
- Një angazhim për të rishikuar dhe ndryshuar (kur kërkohet) praktika regullatore dhe administrative, që janë në kundërshtim me vizionin e kësaj strategjie.
- Një thirrje për qeverinë qëndrore, e cila është përgjegjëse për aspekte të ndryshme brenda kësaj strategjie, për të përvijuar politikat dhe praktikën e saj me këtë strategji dhe të pranojnë thirrjen për t'u angazhuar në partneritetet rajonale.
- Një thirrje për organizatat donatore për ta studiuar këtë vizion dhe strategji dhe për të identifikuar veprime specifike të cilat ata ti mbështesnin.

Vizioni mund të realizohet përmes objektivave strategjike të poshtëshënuar dhe veprimeve dhe instrumentave të zhvillimit e investimeve që bëjnë pjesë në fushat prioritare.

### **Objektivat Strategjikë**

**OS1**– Të zhvillohen kapacitetet e aktorëve rajonalë për të për të menaxhuar dhe mbështetur në mënyrë të zgjuar, të përshtatshme dhe strategjike procesin e zhvillimit të rajonit, përfshirë këtu edhe zhvillimin e duhur urban dhe rural.

**OS2**– Ti japi formë një mjedisi ekonomik konkurrues dhe sipërmarrës, veçanërisht në sektorë kryesorë të tillë si industria bujqësia dhe turizmi

**OS3**– Të zhvillohet Elbasani si një destinacion tërheqës turistik dhe të promovohen në një mënyrë qëndrueshme potencialet e saj turistike.

**OS4**– Kujdes për mjedisin natyror dhe ruajtjen e burimeve të tij natyrore, të rritet ndërgjegjësimi i individëve dhe bizneseve dhe të nxitet një sjellje e përgjegjshme e tyre ndaj mjedisit.

**OS5**– Të fuqizohet njerëzit përmes edukimit dhe të furnizohet tregu i punës, veçanërisht në sektorin e biznesit, me individë konkurrues dhe lehtësisht të punësueshem si një faktor kyç i një shoqërie dhe ekonomie të ditur dhe të begate.

**OS6**– Të sigurojë ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe thelbësore që garantojnë shëndet të mirë për qytetarët.

**OS7**– Të përmirësojë dhe të mirëmbajë më tej rrjetin e brendshëm dhe të jashtëm rrugor në mënyrë që t'i paraprijë rritjes së ardhshme socio-ekonomike të rajonit.

Prioritetet janë të orientuara nga rezultatet, por gjithashtu edhe tregues të veprimeve që duhet të ndërmerren. Ata caktojnë drejtime që qartësisht shkojnë përtej burimeve financiare në dispozicion. Në shumë raste ndërkohë që Partneritetit Rajonal thellohet dhe fiton përvojë mbi projektet, atëherë ato do të fokusohen vetëm në aspekte të caktuara të zonave prioritare të përkufizuara gjerësisht. Në këtë kuptim kjo strategji i përngjan më shumë një procesi se sa një dokumenti përfundimtar.

Prioritetet strategjike janë përshkruar në detaje më poshtë:

**Prioriteti 1:** Forcimi i kapaciteteve të zhvillimit njerëzor për të zhvilluar rajonin

**Objektivi përkatës strategjik:** Të zhvillojë kapacitetet e aktorëve rajonalë për të menaxhuar dhe mbështetur në një mënyrë të zgjuar, të përshtatshme dhe strategjike procesin e zhvillimit të rajonit, përfshirë edhe zhvillimin e duhur urban dhe rural.

**Prioriteti 2:** Zgjerimi i bazës produktive të ekonomisë rajonale

**Objektivi përkatës strategjik:** T'i japi formë një mjedisi ekonomik konkurrues dhe sipërmarrës, veçanërisht në sektorë kryesorë, të tillë si industria, bujqësia dhe turizmi.

**Prioriteti 3:** Zhvillimi i turizmit

**Objektivi përkatës strategjik:** Të zhvillohet Elbasani si një destinacion tërheqës turistik dhe të promovohen potencialet e tij turistike në mënyrë të qëndrueshme.

**Prioriteti 4:** Zhvillimi i qëndrueshëm mjedisor dhe infrastruktura mbështetëse

**Objektivi përkatës strategjik:** Të tregohet kujdes për mjedisin natyror dhe të ruhen burimet e saj natyrore, të rritet ndërgjegjësimi i njerëzve dhe bizneseve si dhe të nxitet ata të kenë një qëndrim të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

**Prioriteti 5:** Zhvillimi i njerëzve me anë të arsimit

**Objektivi përkatës strategjik:** Të fuqizohen njerëzit me anë të arsimit dhe të furnizohet tregu i punës, veçanërisht sektori i biznesit, me individë konkurrues dhe lehtësisht të punësueshëm si faktor kryesor për lulëzimin e shoqërisë dhe ekonomisë.

**Prioriteti 6:** Shëndeti publik dhe zhvillimi social

**Objektivi përkatës strategjik:** Të sigurojë ofrimin e shërbimeve të përshtatshme dhe thelbësore që u garantojnë qytetarëve shëndet të mirë dhe përfshirje sociale.

**Prioriteti 7:** Aksesi dhe ndërlidhja

**Objektivi përkatës strategjik:** Të përmirësohet më tej dhe të mirëmbahet rrjeti i brendshëm dhe i jashtëm rrugor me qëllim që t'i paraprijë rritjes së ardhshme social-ekonomike të rajonit.

### **Plani Operacional për Zhvillimin Lokal Bashkia Gramsh 2015**

Ky dokument u përgatit nga Bashkia Gramsh dhe Universiteti POLIS në kuadër të Projektit STAR, me mbështetjen teknike të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe Ministrisë të Shtetit për Çështjet Vendore.


Më poshtë do të gjejme vizionin e territorit të bashkisë Gramsh dhe Prioritet që ndërmerr ky dokument.

Ky dokument bën një analizim të problematikave që ka Bashkia Gramsh dhe vendos disa prioritate zhvillimi në formën e Objektivave Strategjike për përmbushjen e Vizionit. Është një dokument që mbart një rëndësi të madhe për sa i përket analizimit të territorit sepse është dokumenti i parë që u hartua mbas Reformës Administrative –Territoriale. Gjithashtu ky dokument është një bazë mjaft e mirë për zhvillimin dhe hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor.

### Vizioni:

**“Gramshi një park i rëndësishëm energjitik rajonal, një nyje kalimi midis rajonit jug-lindor dhe atij qendror; pikë atraktive turistike malore/liqenore dhe një zonë me zhvillim ekonomik, bujqësoro-blegtorale.”**

Figura 25 Vizioni i Planit Operacional për Zhvillimin Lokal i Bashkisë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

### Prioriteti 1- Ngritja e Kapaciteteve Lokale dhe trajnimi i burimeve njerëzore

- Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor;
- Nxitja e zhvillimit të sektorit privat të ekonomisë dhe sipërmarrjes;
- Hapësirë për pjesëmarrjen qytetare në vendim-marrje dhe transparencë më e madhe;
- Integrim i të gjithë territorit në zhvillimin social-ekonomik.

### Prioriteti 2- Diversifikimi i Ekonomisë dhe Zhvillimi Ekonomik

- Ngritja e kapaciteteve tek të rinjtë dhe mbështetja e sipërmarrjeve të reja lokale;
- Rritja e vizibilitetit, aksesueshmërisë në tregje dhe promovimi i produkteve lokale;

- Diversifikimi dhe specializimi i ekonomisë me fokus më të madh në turizmin malor, eko-turizmin, agro-turizëm, dhe agro-përpunimin;
- Krijimi i qendrave të grumbullimit dhe baxhove për grumbullimin e produkteve bujqësore që prodhohen në zonë;
- Hapja e tregjeve lokale me kushte të përshtatshme për shitjen e produkteve bujqësore (tregu i propozuar në njësinë Gramsh);
- Krijimi i politikave nxitëse për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, blegtorisë, pemtarisë, dhe bimëve medicinale në veçanti.

### **Prioriteti 3- Përmirësimi i Infrastrukturës Rrugore**

Përmirësimi i aksesit dhe asfaltimi i segmenteve rrugore:

- Rr. Gramsh-Kukur 16.4 km;
- Rr. Gramsh-Lënie 14.7 km;
- Rr. Gramsh-Tunjë 10.6 km;
- Rr. Gramsh-Skëndërbegas 11.2 km;
- Rr. Gramsh-Kushovë 9.4 km;
- Rr. Gramsh Sult 12.4 km;
- Rr. Gramsh-Grabovë;
- Rr. Gramsh-Irmajit;
- Rr. Gramsh-Liqeni i Zi;
- Rr. Gramsh-Ujëvara e Sotirsë.

### **Prioriteti 4- Përmirësimi i Shërbimeve Publike dhe Sociale**

- Krijimi i një qendre multifunkionale, për të cilën mund të përdoret Pallati i Sportit dhe ku mund të zhvillohen lojëra të ndryshme si: shah, voleyboll, basketboll, balet, kurse gjuhësh të huaja, kinema në sallë të vogël etj.;
- Konstruksioni i Këndit Sportiv pranë Pallatit të Kulturës;
- Rigjenerimi i parqeve të kategorive të ndryshme: park lojërash, park i gjelbër, hapësirë publike në lagje etj., për grupmosha të ndryshme;
- Rikonstruksion i Qendrës Kulturore dhe shtimi i funksioneve të tjera brenda saj, siç mund të jenë biblioteka, organizimi i koncerteve të hapura gjatë periudhës së verës, duke promovuar muzikën popullore të zonës dhe festat tradicionale, kinema, teatri etj.;
- Hapja e një pike “info-point” në qytet, e cila do të shërbejë për promovimin e pasurive kryesore të Bashkisë së Gramshit, atraksioneve turistike, si dhe të programeve social-kulturore që organizohen;
- Hapja e kurseve të ndryshme për të rinjtë (sporte, arte, gjuhë të huaja, etj).
- Përmirësimi i mjediseve të shkollave;
- Përmirësimi i ambjentëve të shërbimit mjekësor;
- Përmirësimi i sistemit të furnizimit me ujë të pishëm;
- Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve.

### **Prioriteti 5- Rehabilitimi i Mjedisit**


- Përcaktimi i një vend-grumbullimi për mbetjet urbane dhe kompostimin e tyre;
- Evidentimi i hapësirave problematike të prekura nga efekti i shpyllëzimit që ka shkaktuar rrëshqitje të dherave, duke sjellë humbje të tokës, sidomos asaj bujqësore;

- Pyllëzimi i zonave të evidentuara më sipër, me bimësi të përshtatshme për të bërë të mundur ruajtjen e tokës nga erozioni;
- Ndërtimi i kolektorit kryesor të Ujërave të Zeza në qytet.
- Ndalim i derdhjes së ujërave të ndotura në sipërfaqet ujore (lumenj, liqene);

#### 4.1 Planifikimi rregullator e vendor

#### Detyra e Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Gramshit 2008

Figura 26 Përdorimi ekzistues i tokës sipas Detyrës së Projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të Qytetit të Gramshit 2008



Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

Detyra e Projektimit të Planit Rregullues është një studim i cili i paraprinte Dokumentit të Planit Rregullues dhe me legjislacionin e vjetër ishte elementi bazë teknik dhe ligjor për hartimin e këtij plani, e cila kishte si qëllim: Grumbullimin dhe sistemimin e të dhënave për të paraqitur gjëndjen ekzistuese të Qytetit të Gramshit. Analizën e gjëndjes ekzistuese mbi bazën e të dhënave të paraqitura dhe identifikimin e problematikave kryesore të cilat duhet të merren parasysh gjatë hartimit të Planit Rregullues. Parashtrimin e udhezimeve orientuese mbi zhvillimin perspektiv dhe zgjidhjen e problemeve kryesore urbane, të cilat do të merren parasysh gjatë hartimit të Planit Rregullues.

Objekti i këtij studimi ishte paraqitja e një baze të bollshme të dhënash statistikore, sasiore dhe cilësore mbi situatën atëherëshme të zhvillimit urban të qytetit të Gramshit, analizimin e faktorëve që ndikojnë në këtë zhvillim, si edhe evidentimi i problematikave dhe tendencave të ndryshme, pozitive ose negative me të cilat perballej qyteti i Gramshit, me qëllim kryesor krijimin e një vizioni të qartë mbi situatën e zhvillimit urban të qytetit të Gramshit. Gjithashtu, ky studim nxirrte në pah një sërë çështjesh të rëndësishme urbanistike, ndërtimore, sociale, ekonomike, higjieno-sanitare, inxhiniero-teknike dhe mjedisore me të cilat perballej qyteti dhe që janë objekt i zhvillimit afatgjatë urban të tij. Gjithashtu ky studim paraqet disa rekomandime të cilat do të ishin baza e propozimeve të Planit të Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Gramshit por që nuk u hartua si dokument.

## 4.2 Përfundime

- Shtrirja perspektive e qytetit të parashikohet në jug të qytetit ekzistues.
- Të zgjerohet vija e verdhe e qytetit duke futur brenda saj edhe ato territore që janë shumë afër me qytetin dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetit të Gramshit, duke shtuar ëë këtë mënyrë siperfaqen e teritorit të qytetit me siperfaqe të domosdoshme për funksionimin normal të tij.
- Të merren masa për mbrojtjen e nivelit të ndotjes së ajrit nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë.
- Territori i ish zonës industriale në hyrje të qytetit (veri) të parashikohet për krijimin e zonës ekonomike të qytetit dhe për zgjerimin dhe sistemimin e zonës së transportit të jashtëm.
- Territori i ish SMT dhe uzinës 85 si edhe territori i repatrit ushtarak të parshikohet për krijimin e zonave të reja të banimit si edhe për funksione publike të cilat sot i mungojnë qytetit të Gramshit.
- Të rivlerësohet ideja e zonës industriale në perspektive e parashikuar nga plani rregullues (projekt ide) i vitit 1987 në bazë të kushteve të reja të pronësise mbi truallin, të ruhet dhe të zhvillohet për zhvillimin perspektiv ekonomik të qytetit.
- Hyrja e qytetit të rivlerësohet.
- Të rivlerësohet ideja e krijimit të unazes së re të qytetit në drejtimin veri – jug e propozuar nga plani rregullues (projekt ide) i vitit 1987.
- Të rivlerësohet qendra e qytetit në bazë të zhvillimeve të reja sociale ekonomike dhe administrative, si edhe të rivlerësohet ideja e krijimit të një shetitoreje në pjesën perendimore të zonës së qendrës në buzë të lumit Devoll.
- Ndërtimi i zonave të reja të banimit të jetë në përputhje me terrenin dhe preferencat e banoreve si edhe të respektohet tradita pozitive e lartësisë së kateve të objekteve të banimit.
- Zona e re e varrezave të parashikohet në jug të qytetit.

## **5. Rëndësia Kombëtare në territor**

### **5.1 Monumente Kulturore**

E hershme është shpallja me Ligj. Nr. 609 datë, 24.05.1948 me Vendimi Nr.586 për shpalljen monument Kulture e kategorisë së I-rë për Kalanë e Irmajt në fshatin Tunjë. Ajo ndodhet në përrëndim të Gramshit, në kuotën 982m, pllaja është e kufizuar nga jugu me mure me një distancë 20 metra larg tyre. Më datën 23.09.1971 pati një aprovim të kësaj shpallje.

Gjithashtu pati shpallje nga Rektorati I Universitetit Shtetëror me Vendim Nr.6 më datë 15.01.1963 për monumentet e kulturës së Kategorisë së I-rë si Kalaja e Tervolit në fshatin Tervol të Komunës Pishaj dhe Kalaja e Gradishtës në fshatin Bresnik të Komunës Kushovë.

Gjithashtu si zona arkeologjike renditet zonat e Grabovës, Tërvolit dhe Irmajit.

Në listën e monumenteve kulturore të kategorisë së I-rë të shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës me datë 10.06.1973, Vendim Nr.1886 janë monumentet e mëposhtme:

Çezma e Gramshit (Skënderbegas); Fortifikim mesjetar (Prrenjas) ; Kalaja e Gradishtës (Bresnik),; Kalaja e Galigatit (Galigat); , Kalaja e Grabovës së Poshtme (Grabovë e Poshtme); Kalaja e Prrenjasit (Prrenjasit), Tuma pranë lumit Holtë (Cerunjë); Ujësjellësi në përroin e Ranxës në fshatrat Sult dhe Grakan;

Në listën e monumenteve të kategorisë së I-rë të shpallur nga Ministria e Arsimit dhe e Kulturës më datë 05.11.1984 me Vendim Nr.786/1 janë Ura Mesjetare e Gurit, Kisha e Shëm Kollit dhe Rrënojat e urës antike me dy relieve të gdhendura në fshatin Grabovë e Sipërme pjesë e komunës Lënjë. Ura e Gurtë e Grabovës së Sipërme është shpallur Monument Kulture më datë 18.01.1986.

### **5.2 Zona të mbrojtura natyrore**

Në territorin e Bashkisë Gramsh shtrihet Mali i Tomorrit, me sipërfaqe 1278.9 ha, I shpallur Park Kombëtar I kategorisë së II-të, me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.472datë 18.07.2012, “Për shpalljen Park Kombëtar të ekosistemit natyror Mali i Tomorrit, me sipërfaqe të zgjeruar”. Sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtar Mali I Tomorrit është 24723.1 ha, nga ku 1278.9 ha është sipërfaqja që përfshihet në kufijt administrativë të rrethit Gramsh. Sipërfaqja prej 15045.8 ha, përfshihet në rrethin e Skraparit dhe 8398.4 ha në rrethin e Beratit.<sup>35</sup>

Gjithsej janë 20(njëzet), Monumente Natyrore të kategorisë së III-të, më sipërfaqe 196 ha, shpallur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.676, datë 20.12.2002 “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare’ janë shpallur 11 (njëmbëdhjet) Gjeo-Monumente dhe 9 (nëntë) Bio-Monumente të natyrës shqiptare.

Lista e Gjeo-Monumenteve:

1. Shpella e Kabashit
2. Kanioni I Sinecit (Saraselit)



3. Shkëmbi (kanioni) I Kopaçit (Grabovë)
4. Karsti i Tërvollit
5. Kanioni i Holtës
6. Tarraca e Ballores (Qytezës)
7. Gurët e Krushqeve, Lisec
8. Liqenet e Valamarës
9. Liqeni I Dushkut
10. Burimet e Kërpicës
11. Ujvara e Sotirës

#### Lista e Bio-Monumenteve

1. Arra e Tunjës
2. Rrobulli I Valamarës
3. Dushkaja e Katër – Lisave
4. Moçalet e Grabovës
5. Dushku I Bulçarit
6. Ahishja e Rovjes
7. Liqeni i Zi (Lenie)
8. Gështenja dhe Pisha në Teqene e Skënderbegasit
9. Rrobulli i Grabovës

### 5.3 Menaxhim i integruar i burimeve ujore

Bashkia Gramsh ka një hidrografi të pasur me ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore. Ajo shtrihet në sektorin e mesëm të lumit të Devollit, i cili brenda kufijve të zonës ka një gjatësi prej 49 km, dhe së bashku me lumin e Tomoricës me gjatësi 14km e ndajnë Gramshin në 3 krahina. Territori përshkohet edhe nga disa lumenj të tjerë më të vegjël si ai i Holtës, Lënies, etj. Lugina e Devollit dhe e Tomoricës përbëjnë pjesën më të shtruar të terrenit, dhe ku gjenden edhe tokat më pjellore të tij. Këto ujëra janë shumë të rëndësishme edhe sepse përdoren për të ujitur tokat bujqësore që ndodhen në të dy krahët e rrjedhave.

Të gjitha burimet ujore së bashku me të gjitha brigjet dhe shtretërit e trupave të ujit pa përjashtim, sipas specifikimit të Ligjit nr.111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore. Përgjatë trupave ujore, ky ligj specifikon distanca sigurie në dy breza në varësi të këndit të bregut më pak ose më shumë se 10%. Zona A shtrihet nga 5 m deri në 20 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe përdoret për qëllime publike me dispozita të veçanta. Zona B shtrihet nga 100 m deri në 200 m (përkatësisht për brigje të pjerrëta e të sheshta) dhe çdo veprimtari e zhvilluar përcaktohet nga organet e administrimit e menaxhimit të burimeve ujore.

Sistemet e kanalizimeve dhe dranzhimit për mbarëvajtjen e tokave bujqësorë rregullohen nëpërmjet t nr.8518 i datës 30.07.1999 “Për ujitjen dhe kullimin” i ndryshuar. Sistemet e kullimit që janë pronë shtetërore mund të kalojnë në përdorim apo në pronësi të një federate, organizate ose bordi pa ndryshuar destinacionin vetëm me vendim të Këshillit të Ministrave (Neni 9). Sipas

strategjisë të decentralizimit dhe Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, sistemet dytësore dhe tretësore të ujitjes dhe kullimit i kalojnë në administrim bashkive si funksion i vetë.

Ligji nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura” i ndryshuar, përcakton rregullat e trajtimit mjedisor të ujërave të ndotura, duke përfshirë ujërat e ndotura urbane, ujërat e ndotura industriale, ujërat nga kullimi i tokave bujqësore dhe ujërat e ndotura të çdo lloji. Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, distancat minimale të mbrojtjes nga impiantet për trajtimin e ujërave të zeza janë 200 m për kapacitet më pak se 5,000 banorë dhe 1,000 m për kapacitet 1,000 – 50,000 banorë.

## **5.4 Tokat Bujqësore**

Bashkia e Gramshit ka toka të buta dhe mjaft pjellore, diellëzim të lartë, kullota në sipërfaqe të mëdha dhe burime të shumta ujore, ndaj dhe potencialet për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe frutikulturës janë të mëdha. Pjesa më e madhe e Bashkisë, me rreth  $\frac{3}{4}$  e saj ka karakter kodrinor-malor dhe zhvillim përgjithësisht rural. Këto zona janë mjaft të pasura me prodhime bujqësore, të cilat kultivohen thuajse në të tërë territorin. Mund të përmendim vreshtat dhe ullishtat që përbëjnë dy nga kulturat kryesore, si dhe frutikulturën që është gjithashtu mjaft e përhapur.

Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit nr.9244, datë 17.06.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”i ndryshuar, specifikohet mbrojtja nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuar në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kriterëve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore” Gjithashtu theksojmë se rregullat dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim shërbejnë dhe janë të detyrueshme për zbatim nga ana e autoriteteve përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit për hartimin e dokumenteve të planifikimit në të gjitha nivelet. Në të gjitha kategoritë e bonitetit miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtim bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor.

Po ashtu, ligji nr. 16/2012, “Për disa shtesa në ligjin 8752, date 26.3.2001,” Për krijimin dhe funksionimin strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, cilëson që në tokat bujqësore mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall) bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndërkohë pika 4/5 e nenit 11/1 shpreh që kalimi i tokave bujqësore në kategori të resurseve të tjera, si pyll, tokë pyjore, kullotë dhe livadh, si dhe anasjelltas bëhet me miratimin e përbashkët të ministrave përkatës, që i administrojnë këto resurse për sipërfaqe deri në 5 ha dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 5 ha.

## **5.5 Pyjet, drufrutorët dhe kullotat**

Bashkia Gramsh ka një territor, i cili është i mbuluar nga një sipërfaqe pyjore rreth 31,000 ha, ose 44.5% e territorit. Sipërfaqja e kullotave arrin në 10,000 hektar ku 1,500 ha janë kullota dimërore dhe 8,500 ha janë kullota verore. Brenda kufirit të ri administrativ të Bashkisë Gramsh shtrihet edhe një pjesë e zonës së mbrojtur të Parkut “Mali Tomorrit”.

Përcaktuar në ligjin nr.9385, Datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor” i ndryshuar “Toka pyjore” janë sipërfaqe tokë me drurë, shkurre e bimësi tjetër jopyjore, me shkallë mbulimi nga 5 deri në 30 për qind, së bashku me sipërfaqet e tjera që sigurojnë funksionet e pyllit. Fondi pyjor publik zotërohet e administrohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Pyjor dhe organet e qeverisjes vendore. Pjesë e këtij fondi pyjor kombëtar, mund të kërkohen nga subjekte juridike ose fizike apo nga organet e qeverisjes vendore, për t'u kthyer në truall për destinacione specifike të parashikuara në ligjin e mësipërm: me miratim të ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha; me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe nga 1 deri në 100 ha; dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 100 ha. Sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 16/2012, “Për disa shtesa në ligjin 8752, datë 26.3.2001,” Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për Administrimin dhe Mbrojtjen e Tokës”, pjesë të fondit pyjor kombëtar kthehen në kategorinë e resursit të tokës bujqësore vetëm për mbjelljen e këtyre sipërfaqeve me kultura të drurëve, të cilët janë pjesë e programeve dhe të politikave prioritare shtetërore afatgjata. Ndërsa për të ndryshuar vëllimin e tokës pyjore nevojitet miratimi i organeve të shërbimit pyjor, kalimi i resursit të tokës së pafrytshme, që është në pronësi private apo të organeve të qeverisjes vendore, bëhet me kërkesë të pronarit apo organit të qeverisjes vendore dhe miratohet nga ministri përkatës.

Në bazë të ligjit 7929 datë 11.05.1995 “Për mbrojtjen e drufrutoreve”, pemët frutore, vreshtat, agrumet dhe ullishtet, pavarësisht se në pronësi të kujt janë, janë pasuri kombëtare dhe mbrohen me ligj nga shteti. Pasuria shtetërore drufrutore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, i është dhënë në administrim organeve të pushtetit lokal me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 473 datë 14.10.1999.

Fondi kullor i përbëre nga kullotat dhe livadhet në pronësi publike dhe private është burim natyror dhe pjesë e pasurisë kombëtare. Ai mbrohet, administrohet dhe përdoret sipas kërkesave të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, i ndryshuar e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Heqja e një kullote, apo livadhi nga fondi kullor, ose ndryshimi i destinacionit për një sipërfaqe kullote bëhet me miratimin e ministrit për sipërfaqe deri në 1 ha dhe me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe mbi 1 ha.

## **5.6 Zonat industriale**

Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, objektet industriale, ato të prodhimit, transmetimit e shpërndarjes së energjisë elektrike, përveçse kur është përcaktuar ndryshe në legjislacionin e posaçëm, kanë një gjerësi minimale të zonës mbrojtëse sanitare prej 50 m përgjatë gjithë vijës kufizuese të saj dhe një distancë minimale të mbrojtjes prej 200 m. Këto vlera rriten sipas llojit të objektit e teknologjisë së përdorur, si dhe shkallës së ndotjes së zonës industriale gjatë projektimit të saj.

Momenalisht në Bashkinë Gramsh zhvillojnë aktivitetin e tyre shumë pak industri. Mund të përmendim Uzinën Mekanike të Çekinit, ku momentalisht funksionon vetëm pjesa e demontimit të


armëve, por që pritet të mbyllet; si dhe Uzinën e Prodhimit të Baterive, që momentalisht është jashte funksionit dhe një pjesë e godinave të së cilës janë përshtatur për banesa dhe janë privatizuar. Një godinë 4 katëshe e po këtij kompleksi industrial është dhënë me kontratë për disa vjet për t'u përdorur si qendër tregëtare, dhe momentalisht është në ndërtim e sipër.

## 5.7 Konkluzione dhe Rekomandime

Bashkia Gramsh ka një sërë pontencialesh të rëndësishme të veçantë kombëtare të cilat gjenden brenda territorit të saj. Gjithësesi, këto elementë nuk shfrytëzohen në mënyrën e duhur për të rritur të ardhurat ekonomike të banorëve. Veçanërisht, monumentet e kulturës nuk kanë akses të mirëfilltë dhe i mungon promovimi. Gjithashtu, edhe potencialet natyrore nuk kanë një akses të mirë si dhe nuk kanë infrastruktura mbështetëse të cilat të lejojnë zhvillimin e turizmit. Bashkia Gramsh ka jo vetëm monumente të spikatura natyrore, Ujëvara e Sotirës, Kanioni I Holtës, por dhe ofron një turizëm mjaft tërheqës malor.

Ndërkohë, përsa i përket shfrytëzimit të energjistikës, Bashkia Gramsh ka burime të shumta ujore të cilat kanë filluar të shfrytëzohen për hidrocentrale, për shembull, Hidrocentali I Banjës. Gjithësesi, këto hidrocentrale duhet të kenë kujdes të veçantë përsa i përket dëmtimit të mjedisit dhe të ekosistemeve.

Figura 27 Rëndësia Kombëtare



Burimi: Baskia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

## 6. Analiza e thelluar mjedisore

### 6.1 Burimet ujore dhe basenet

Figura më poshtë, pasqyron larminë e rrjetit hidrik të Bashkisë së Gramshit, ku ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe të konsiderueshme të territorit<sup>36</sup>. Trupi ujqor kryesor është Lumi Devoll, i cili përshkon Bashkinë e Gramshit nga jugu në veri në një gjatësi prej 49 km. Devolli mbledh ujërat e


një sërë përrenjësh të ndryshëm si Përroi i Tomorricës, Përroi i Grabovës, Përroi i Vërrces dhe Përroi i Holtës të cilët ndodhen në anën e majtë dhe të djathtë të Lumi Devoll. Lumi Devoll bashkohet me Lumin Osum, për të vazhduar më tej dhe duke formuar lumin e Semanit.

Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër liqenesh e rezervuarësh siç janë Liqeni i Zi, Liqeni i Dushkut dhe burimet termale në Holtë.

Edhe përsa i përket ujërave nëntokësore (akuiferë), kjo bashki ka një rrjet mjaft të pasur, të cilët (siç vihet re në figurën më poshtë) shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike dhe si rrjedhojë kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës. Në Bashkinë e Gramshit mbizotërojnë shkëmbinj kompakt sedimentar me përbërje flishore, pa porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizor ose çarjesh.

Në pjesën qëndrore mbizotërojnë sedimente (rëra, suargjila, argjila) ku ndodhen akuifere me porozitet ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët. Kemi të pranishme edhe zonat gëlqerore me akuifere me porozitet poro-çarje karst me ujëpërcjellshmëri shumë të ndryshueshëm (shumë e lartë-shumë e ulët). Gjithashtu edhe shkëmbinj sedimentar (ranore, merengle dhe konglomerate) ku ka akuifere me porozitet poro-çarje me ujëpërcjellshmëri mesatare-të ulët).

Figura 28 Hidrogeologjia dhe hidrografia në Bashkinë Gramsh



Burimi: SHGJSH, Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017


### 6.1.1 Burimet ujore sipërfaqësore

Bashkia e Gramshit ka një rrjet të pasur hidrik. Territori i Bashkisë përshkohet nga Lumi Devollit, i cili mbetet trupi uhor kryesor në Bashki. Lumi Devoll përshkon bashkinë e Gramshit nga juglindja në veri-perëndim në një gjatësi prej 49km<sup>37</sup>. Lumi fillon në bashki nga fshati i Kullollasit në NjA të Skënderegasit dhe përroi i Tomorricës i cili vjen nga Kotka në NjA të Kushovës. Këto dy degë bashkohen në Mashani duke vazhduar ndërmjet fshatrave Pishaj dhe Ostenthi. Lumi përshkon qytetin e Gramshit duke vazhduar më tej në Zgjupa, Kuterqara e Cingar dhe del nga territori i

bashkisë për të vazhduar në drejtim të Qytetit të Cërrikut. Lumi Devollit gjatë gjithë rrjedhës së tij konstatohet të ketë një furnizim të fuqishëm. Duke qënë se lugina e lumit Devoll mbledh ujërat e lartësive mbi 2000m të Tomorrit dhe Gurit të Zi, shpjegon edhe faktin që prurjen më të madhe e ka në muajt prill dhe maj, ku edhe lumi del nga shtrati, duke përmbytur tokat përgjatë bregut dhe gërryerjen e tyre, kryesisht në pjesën veriore të qytetit.

Brenda territorit të bashkisë, Devolli mbledh ujërat e një sërë përrenjsh të ndryshëm si Përroi i Grabovës, Përroi i Tomorricës, i Verrces, të cilët ndodhen në jug të bashkisë. Në pjesën veriore të lumit Devoll, në zonën ku lumi është në dalje nga territori i bashkisë, Devolli mbledh ujërat e Përroit të Holtës dhe Përroit të Pashtreshit. Përveç lumenjve, Bashkia ka edhe një numër të madh burimesh ujore sipërfaqësore, siç janë kanioni i Holtës, ujëvara e Sotirës dhe burimet termo-minerale në Holtë. Ndër rezervuarët dallohet ujëmbledhësi në zonën e Banjës me të njëjtin emër, të rrethuar me kodra të veshura me pyje. Në Bashkinë Gramsh duhet të përmendim edhe liqenet, të tillë si: Liqeni i Zi, Liqeni Bratil, Liqeni i Dushkut (në Kumian) dhe Posnovishtë, etj. Ruajtja, mirëmbajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tyre nga Bashkia mund të sjellë fitime të mëdha për vendin në fushën e turizmit.

Figura 29 Lumenjtë dhe rezervuarët kryesorë në Bashkinë Gramsh



Burimi: SHGJSH; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016

Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, ujë industrial etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.


### Gjëndja e burimeve ujore sipërfaqësore (problematikat)

Në dy dhjetëvjeçet e fundit në vendin tonë, burimet ujore dhe kryesisht lumenjtë, janë shfrytëzuar për bujqësi, industri, për materialin e tyre inert dhe për sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe njëkohësisht, janë përdorur si kanale për derdhjen e ujërave të ndotura. Për më tepër, mungesa e planeve për mbrojtjen e lumenjve e shoqëruar me ndërhyrje pa kriter të njeriut në shfrytëzimin e tyre (shfrytëzimi i inerteve në shtratin e lumenjve, punimi i brezave të gjelbër mbrojtës etj.) ka përshpejtuar shumë procese natyrore gjeologjike në shtratin e lumenjve siç janë gërryerja e shtratit, erozioni anësor dhe sipërfaqësor i brigjeve, rrëshqitjet e tyre etj. të cilat kanë ndikuar ndjeshëm në përkeqësimin e gjëndjes së tyre.<sup>38</sup> Si rrjedhojë, sot lumenjtë vuajnë pasojat e një keqmenaxhimi të gjatë që janë kryesisht i) *ndyshime në hidro-morfologjinë e lumenjve*; ii) *humbje të florës & faunës ujore*, dhe iii) *ndotje*.

### 6.1.2 Burimet ujore nëntokësore

Bashkia Gramsh ka një rrjet të kufizuar burimesh ujore nëntokësore (akuiferë). Akuiferët shtrihen në zona me përbërje të ndryshme gjeologjike (Figura më poshtë). Si rrjedhojë, ata kanë kapacitet të ndryshëm ujëmbajtës.<sup>39</sup> Akuiferët përbëjnë burimet kryesore të furnizimit me ujë për popullsinë, bujqësinë dhe aktivitetet të tjera ekonomike në territorin e Bashkisë së Gramshit.


Figura 30 Harta hidrogeologjike, Bashkia Gramsh



Burimi: SHGJSH, 2014; Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Akuiferët kanë një shtrirje të vogël në territorin e Bashkisë, krahasuar kjo me sipërfaqen e saj. Studimet e mëparshme të bëra rreth burimeve ujore nëntokësore bazoheshin në sipërfaqen e Qarkut të Elbasanit sipas ndarjes administrative të territorit përpara Reformës së Re Administrative. Ende nuk ka një studim që përcakton sipërfaqen e akuiferëve për çdo bashki, por nëpërmjet dixhitalizimit të tyre kemi arritur të klasifikojmë akuiferët në Bashkinë e Gramshit<sup>40</sup>.

Tabela 7 Klasifikimi dhe sipërfaqja e Akuiferëve në Bashkinë Gramsh (në km<sup>2</sup>)



Burimi: SHGJSH, 2014; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Bashkia e Gramshit përfshin akuiferët e mëposhtëm:

- Akuiferë me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët)
- Akuiferë me porozitet poro-çarje
- Akuiferë me porozitet çarje-karst
- Akuiferë me porozitet çarje
- Jo-akuiferët, të cilët kanë porozitet të pamjaftueshëm për të lejuar qarkullimin e ujit nëntokësor në sasi të shfrytëzueshme

Akuiferët shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë së bashkisë, për ujitje, etj. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i akuiferëve që shtrihen në territorin e Bashkisë së Gramshit dhe shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë, dhe që janë i) akuiferë me porozitet ndërkokrrizor , ii) akuiferë me porozitet poro-çarje , iii) akuiferë me porozitet çarje-karst, iv) akuiferë me porozitet çarje.

**Akuiferët me porozitet ndërkokrrizor të shkrifët:** Akuiferi me porozitet ndërkokrrizor (të shkrifët) është formuar nga grumbullimi i zhavorreve dhe materialeve të tjera nga Lumi Seman dhe Lumi Devoll<sup>41</sup>. Në këtë akuifer dallohen disa zona të cilat ndahen ndërmjet tyre për nga kapaciteti përcjellës i ujit. Në Bashkinë e Gramshit bën pjesë zona me ujëpërcjellshmëri mesatare dhe të ulët (argjilë, rërë, suargjilë)<sup>42</sup>. Kjo zonë shtrihet në pjesën e Luginës së Devollit, fillimisht



shtrihet në zonën e Kodovjatit dhe shkon deri në Sult, për të kaluar më tej në territorin e Bashkisë Elbasan.

Ky akuifer ka lidhje hidraulike të mirë të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe rezerva uji të konsiderueshme për shfrytëzim. Drejtimi kryesor i lëvizjes së ujërave nëntokësore përputhet me drejtimin kryesor të luginës së Devollit, paralel me lumin. Ujërat nëntokësore të luginës së Devollit ushqehen kryesisht nga lumi me të njëjtin emër. Sipas SHGJSH-së, ky akuifer ka ujëpërcjellshmëri mesatare dhe është në gjëndje të furnizojë me ujë të pijshëm një komunitet të vogël.

**Akuiferët me porozitet çarje-karst:** Këto akuiferë lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë ku përfshihen kryesisht depozitimet gëlqerore. Dallohen ndërmjet tyre për përcjellshmërinë tepër të ndryshueshme. *Masivi karbonatik i Tervollit* është një akuifer i cili shtrihet nga Kishta në jug, deri në afërsi të Kabashit në veri<sup>43</sup>. Këto akuiferë, për shkak të karstit kanë forma karstike shumë të zhvilluara (copëtime të theksuara, kreshta malore, pllaja të vogla, shpate të thepisura ose shpella, dhe forma akullnajore karstike). Në pjesën veriore të Masivit dalin një sërë burimesh si Burimet e Holtës dhe Burimi i Tervollit.

Depozitime gëlqerore ose siç njihen ndryshe depozitime të Krekut të sipërm dhe të poshtëm (Cr<sub>1</sub> dhe Cr<sub>2</sub>) kemi gjithashtu dhe në pjesën lindore të Bashkisë Gramsh, në pjesën qendrore të NjA Kukuri<sup>44</sup>.

I rëndësishëm për Bashkinë e Beratit është Akuiferi karstik i Tomorrit, i cili ndërtohet nga gëlqerorë të kretarkut dhe paleocenit. Burimet ujore, që dalin nga ky akuifer janë shumë të rëndësishëm sepse furnizojnë me ujë qytetin e Gramshit dhe zonat përreth. Të tillë janë burimi i Sotirës dhe ai i Kërpicës. Prurjet e tyre janë të mëdha duke variuar nga 1000-1500 l/sek<sup>45</sup>.

Në zonën veri-lindore të Bashkisë Gramsh është i pozicionuar, në një sipërfaqe të vogël akuiferi me porozitet çarje-karst Luzajt. Nga ky akuifer në Bashkinë Gramsh del burimi i Sinecit i cili furnizon me ujë Bashkinë e Kuçovës.

Burimet ujore të cilat shërbejnë për furnizimin me ujë të popullsisë të Bashkisë së Gramshit janë: Burimi i Kërpicës, Proshovës, Duzhës, Bulcarit, Komjanit, Shkozës, Shkuriqit, Sekës, Gurrës dhe Kroj Bardhë.

Burimet e lartpërmendura furnizojnë me ujë fshatrat, si : Pishaj, Shëmrizë, Cërunjë, Çekin, Qerret, Drizë, Galigat, Kotorr, Gjerovinë, Storë, Kodovjat, Bersnik, Mashan, Zamshe, Kushovë, Bregas, Gjeraqinë, Sotirë, Lenie, Proçan, Skënderbegas, Bletëz, Ermenj, Fushëz, Harunas, Kotkë, Nartë, Siman, Vidhas, Zenelas, Lubinjë dhe qyteti i Gramshit.

**Akuifer me porozitet çarje:** Lidhen ngushtë me shkëmbinjtë kompaktë dhe të çarë ultrabazikë. Dallohen për kapacitet ujëmbajtës të ulët me burime që rrjedhin kryesisht gjatë dimrit, në periudhën e reshjeve dhe që kanë prurje të vogla. Akuiferët me porozitet çarje shtrihen në Grabovë të sipërme dhe të poshtme, gjithashtu edhe në NjA Poroçan. Burime të tilla janë burimet rrëzë malit të Valamarës me prurje 15 l/s<sup>46</sup>. Këto burime dalin në kuota të larta me ushqim kryesisht nga liqenet akullnajore. Këto burime përbëjnë edhe pikënisjen e përrrenjëve dhe më tej të Lumit të Seman.

**Jo-akuiferët:** Sipërfaqja e jo-akuiferëve shtrihet në pjesën më të madhe të territorit të Bashkisë Gramsh. Jo-akuiferët lidhen ngushtë me depozitimet argjilore, flishore dhe gipseve. Ato karakterizohen nga mungesa e porozitetit për të lejuar qarkullimin e ujërave nëntokësore, në sasi të tilla që të mund të shfrytëzohen. Këto zona nuk paraqiten me porozitet të mjaftueshëm ndërkokrrizorë ose çarjesh. Në Bashkinë Gramsh gjenden depozitime të Oligocenit të mesëm dhe të Paleocenit-Eocenit<sup>47</sup>.

### **Problematikat e Pellgjeve Ujore Nëntokësore**

Në 20 vitet e fundit, vendi ynë ka njohur një rritje të lartë të numrit të popullsisë, shtrirje të urbanizimit në zona dikur të pamundura, zhvillim të sektorit të bujqësisë dhe zhvillim e diversifikim të industrisë pothuajse në të gjithë territorin. Si rrjedhojë, kërkesa për ujë të pijshëm nga popullsia dhe për përdorim nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë (kryesisht bujqësia) është shtuar duke ushtruar një presion të jashtëzakonshëm mbi lumenjtë dhe akuiferët<sup>48</sup>.

Për më tepër, Bashkia e Gramshit është zonë me veprimtari bujqësore dhe urbanizim të vazhdueshëm, që kanë çuar në ndotjen e lumenjve kryesorë (Devollit dhe degëve të tij). Ndotja e lumenjve ka sjellë si pasojë edhe ndotjen e burimeve ujore nëntokësore nëpërmjet dëpërtimit të ujërave të lumenjve nëpër akuiferë. Ndotja e akuiferëve, që shërbëjnë për furnizimin me ujë të popullsisë, përbën rrezik për shëndetin e njeriut dhe banorëve. Më poshtë paraqiten problemet kryesore të ujërave nëntokësore të Bashkisë Devoll (ndotja dhe shfrytëzimi).

**Mungesa e njohjes së kapacitet ujqor të shfrytëzuar:** Akuiferët ndërkokrrizorë dhe me çarje-karst dallohen për një kapacitet të lartë ujëmbajtës. Për këtë arsye, akuiferët shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi, në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme<sup>49</sup>. Në vitet e fundit, shfrytëzimi i ujit të këtyre akuiferëve është bërë pa u bazuar në një plan manaxhimi, gjë që do të bënte të mundur shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre. Si rrjedhojë, ujërat e akuiferëve janë shfrytëzuar përtej kapacitetit furnizues. SHGJSH-ja<sup>50</sup> raporton se mbishfrytëzimi i akuiferëve në Qarkun e Elbasanit ka ardhur si rezultat i i) shtimit të kërkesës për ujë të pijshëm, industri dhe bujqësi sidomos në periudhën e thatë (qershor-shtator), kur burimet e ujërave nëntokësore janë në nivelet më minimale, ii) rritjes së numrit të shpimeve private ose ilegale për shfrytëzimin e ujit për bujqësi dhe industri, dhe iii) shfrytëzimit pa kriter të shumë shpimeve të vjetra dhe të reja të kryera në akuiferë dhe iv) ritmeve të larta të urbanizimit në zonën fushore, sidomos në dy dekadat e fundit.

Në Bashkinë e Gramshit, për plotësimin e nevojave të popullsisë së bashkisë me ujë nëpërmjet pus-shpimeve, nuk ka një studim ku të tregohet sasia që shfrytëzohet ose kërkesa aktuale për ujë.

Zonat pa lidhje me rrjetin janë kryesisht zonat rurale dhe përfshijnë<sup>51</sup>:

- *NjA Pishaj* (Ostent, Gurrëz, Koçaj, Vinë, Fshat Gramsh, Cingar i Sipërm dhe i Poshtëm, Liras dhe Tërvol)
- *NjA Sult* (Sult, Mazrek, Dushk, Kukuçovë, Kutërqqar, Kodër Zgjupe, Zgjuj Fushë, Dufshan, Grekan )
- *NjA Tunjë* (Tunjë, Duzh, Irmanj, Jançe Qendër dhe Mal, Ktërlis, Oban, Prrrenjas, Pleas, Saraselë, Tunjë e Re)
- *NjA Kushovë* (Dumberas, Bësnik, Ulovë, Kërpicë)

- *NjA Skënderbegas* (Kullollas, Lemnushë)
- *NjA Kodovjak* (Bratilë, Bulçar, Kishtë, Kokel, Posnovishtë, Shelcan, Broshtan)
- *NjA Poroçan* (Kabash, Holtas, Lleshan, Gjerë)
- *NjA Kukur* (Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Snosëm, Sojnik)
- *NjA Lenie* (Bicaj, Grabovë e Sipërme dhe e Poshtme, Kuratë dhe Valth )

Mungesa e shtrirjes së rrjetit të ujit të pijshëm i detyron banorët që të gjejnë zgjidhje individuale, të cilat janë kryesisht hapja e puseve ose përdorimi i burimeve më të afërta të mundshme. Këto burime apo pus-shpime, përveçse hapen pa u bazuar në studime të mirëfillta hidrogjeologjike, e bëjnë të pamundur llogaritjen dhe kontrollin e sasisë së shfrytëzuar të ujit të akuiferëve<sup>52</sup>.

Siç u theksua më sipër, përveç furnizimit me ujë të pijshëm, ujërat e akuiferëve shfrytëzohen edhe për industri dhe bujqësi. Për fat të keq këto akuiferë shfrytëzohen gjerësisht edhe në mënyrë të jashtëligjshme<sup>53</sup>. Shfrytëzimi i akuiferëve do të shtohet edhe më tej po të kihet parasysh se në vitet e ardhshme, kërkesa për ujë do të rritet.

Sasia e ujit, që shfrytëzohet për çdo akuifer nga industria, bujqësia dhe sektorët e tjerë të ekonomisë nuk njihet. Ndaj mbetet urgjente krijimi i një pasqyre ujore për akuiferët (hyrje dhe dalje të ujit) me qëllim shfrytëzimin e ujit të akuiferit në mënyrë të qëndrueshme.

### **Burimet e ndotjes të Akuiferëve të Gramshit brenda Bashkisë**

Burimet e ndotjes së Akuiferëve që shtrihen në territorin e Bashkisë janë të shumta. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes.

**Mungesa e zonave higjieno-sanitare:** SHGJSH-ja përcakton mungesën e zonave higjieno-sanitare përreth pus-shpimeve, si një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së akuiferëve. Këto zona mungojnë si përreth pus-shpimeve legale ashtu edhe përreth pus-shpimeve të jashtëligjshme. Pus-shpimet e ligjshme janë të shumta dhe përdoren nga ujësjellësit e Bashkisë për furnizim me ujë të popullsisë dhe nga industria. Uji sigurohet kryesisht nga vetë banorët, duke përdorur burimin më të afërt të mundshëm ose nëpërmjet pus-shpimeve. Mbi akuiferin me porozitet ndërkokrrizor ndodhet edhe vend depozitimi i mbetjeve kimikate në qytetin e Gramshit dhe aktivitetet e tjera, të cilat kryejnë aktivitetin e tyre shumë afër tij, të tilla si Uzina për çmontimin e predhave dhe kapsollave në Çekin apo vend depozitimi i mbetjeve përgjatë lumit Devoll.

Ky shfrytëzim i ujërave nëntokësore në mënyrë jo profesionale, si dhe të pakontrolluar si nga popullsia ashtu edhe nga industria rrezikon i) uljen e prurjeve në stacione, si dhe ii) prishjen e cilësisë së ujërave të këtij akuiferi duke rrezikuar seriozisht furnizimin me ujë të rrethit në tërësi<sup>54</sup>. Mungesa e zonave higjieno-sanitare bën të mundur që e gjithë ndotja përreth pus-shpimeve të kalojë drejtpërdrejt në akuifer.

**Ndotja e Akuiferit ndërkokrrizor nëpërmjet lumit Devoll:** Një burim ndotjeje për Akuiferin ndërkokrrizor të Gramshit mbetet lumi Devoll. Ky i fundit ndotet nga shumë burime të ndryshme, ndër të cilat edhe nga derdhja e ujërave të ndotur në të. Sipas studimeve të kryera, sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura të qytetit të Gramshit është i kombinuar. Kjo do të thotë se ky sistem grumbullon së bashku ujërat e reshjeve atmosferike dhe ujërat e përdorura nga qendrat e

banimit. Sistemi shtrihet në të gjithë qytetin dhe të gjitha ujërat e përdorura shkarkohen në mjediset pritëse (në Lumin Devoll dhe përrenjtë e tij) pa asnjë trajtim paraprak.

Edhe ujërat e ndotura të zonave rurale të Bashkisë së Gramshit përfundojnë në Lumin Devoll në të gjitha zonat ku e lejon relievi. Nga analizat në terren është vënë re se zonat rurale nuk mbulohen nga sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane. Zakonisht, shtëpitë e banimit kanë gropa septike në oborret e shtëpiave, të cilat nuk janë ndërtuar sipas standardeve tekniko-sanitare. Në rastet kur është e mundur, ujërat e ndotura largohen në kanale të hapura kulluese pranë shtëpive, edhe kjo në mospërputhje me ligjin për mbrojtjen e burimeve ujore dhe mjedisit. Për fat të keq, nuk dihet se cilat nga këto kanale kanë lidhje të drejtpërdrejtë me lumin Devoll, dhe se në cilat zona ujërat e ndotura të zonave rurale ndikojnë në ndotjen e ujërave të akuiferëve.

Deri më sot, në mungesë të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe industriale, Devolli ka shërbyer si kolektor ujërash të ndotur urbane, të bardha dhe industriale. Për këtë arsye, ka shumë mundësi që Devolli të ketë ndotur edhe akuiferin e luginës së së tij.

Duke qenë se ujërat e lumit Devoll shërbejnë si burim për akuiferin e luginës së Devollit, dhe se rreziku i ndotjes së Akuiferit ndërkokrrizor të Gramshit me shtrirje përgjatë lumit Devoll është i lartë, derdhja e ujërave të ndotura në Devoll përbën element ndotjeje të Akuiferit. Rreziku i ndotjes së Akuiferit ndërkokrrizor të Gramshit me shtrirje përgjatë lumit Devoll është i lartë si pasojë e *mungesës pothuajse të plotë të mbulesës ekranizuese të shtresave ujëmbajtëse*, sidomos prej *popullimit të zonës së mbrojtjes sanitare dhe si pasojë e shkarkimeve urbane dhe industriale në zonën e Gramshit*<sup>55</sup>. Për këtë arsye, keqmanaxhimi i mbetjeve të ngurta, të lëngëta dhe i ujërave sipërfaqësore si dhe mosmarrja e masave për mbrojtjen e lumit Devoll nga ndotja, shkakton ndotjen e këtij akuiferi.

**Mungesa e monitorimit të akuiferëve** në Bashkinë e Gramshit në mënyrë që të pasqyrohet gjëndja aktuale e tyre dhe si rrjedhojë të merren masat e nevojshme dhe domosdoshme për përmirësimin e tyre.

**Ndotja e akuiferëve nga shfrytëzimi i inerteve lumore të Devollit:** Lumi Devoll është një burim i rëndësishëm që ushqen me ujë akuiferin ndërkokrrizor të Gramshit. Si rrjedhojë, përkeqësimi i cilësisë së ujit të lumit ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e ujërave të akuiferit. Sipas SHGJSH-së,<sup>56</sup> shfrytëzimi i zhavorreve të lumenjve dëmton rëndë burimet ujore, si nga ana sasiore, ashtu edhe cilësore sepse zvogëlon zonën e ushqimit të akuiferëve dhe prish regjimin e ujërave nëntokësore në zonat e gjerrmimeve.

Për fat të keq, në vendin tonë lumenjtë janë shfrytëzuar në të gjitha mënyrat e mundshme. Semani është shfrytëzuar dhe vazhdon të shfrytëzohet vazhdimisht në mënyrë të ligjshme ose jo për materialin e tij inert në rrjedhën e mesme dhe të poshtme.

Deri më sot, është vetëm 1 aktivitet i regjistruara që ushtron veprimtarinë e tij përgjatë lumit Devoll vetëm në territorin e Bashkisë Gramsh në Çerkez, me pasojë për akuiferin dhe bashkinë (përmybtje të zonave përreth lumit duke çuar në humbje të tokave bujqësore si dhe ndotje të ujërave të akuiferit për shkak të prishjes së ekuilibrave hidrogeologjikë.

Tabela 8 Vëndndodhja e aktivitetetve të liçencuara për shfrytëzimin e inerteve lumore

Nr.	Vendi	Emërtimi i aktivitetit	x	y
-----	-------	------------------------	---	---

1	Çekrez	Larje inertesh	431515	4522292
---	--------	----------------	--------	---------

Burimi: SHGJSH; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN, 2016

### 6.1.3 Përfundime dhe rekomandime

Bashkia e Gramshit është e pasur me burime ujore sipërfaqësore e nëntokësore, të cilat kanë problematikat e tyre. Një faktor që vlen të studiohet për Devollin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga barrierat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Devollin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Këto HEC-e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MË deri mbi 50MË. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Devollit që depërtojnë deri në burimet e tij në Bashkinë e Korçës (Kamenicë, Sul, Miras, Qytezë, etj.). HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si barrierë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e inerteve të transportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen.

Akuiferët e Lumit Devoll, sidomos Akuiferi Karstik i Tomorrit, ka një rëndësi të veçantë për shkak se shërben si burim furnizimi me ujë për qytetin e Gramshit dhe komunat përreth. Si i tillë, duhet treguar kujdes për çdo mundësi të ndotjes së tij, ndotje të cilat mund të shkaktohen nga njerëzit ose industria. Ndaj për akuiferë të këtij niveli rëndësie duhet të tregohet një kujdes i veçantë, veçanërisht për monitorimin e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm do të jepte një pasqyrë të qartë për mënyrën e shfrytëzimit dhe cilësisë së akuiferit.

*Duke parë keqmanaxhimin e burimeve ujore në 20 vitet e fundit, dhe rrezikshmërinë që paraqet ndotja e burimeve ujore nëntokësore për shëndetin e popullsisë, rivlerësimi i ndërtimit të HEC-eve, dhënies së lejeve për karriera lumore, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të ndotura urbane dhe mbetjeve industriale) dhe nga burimet ujore nëntokësore apo rehabilitimin e tyre, duhet të kenë përparësi për Bashkinë. Në këto projekte, Gramshi duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me Bashkitë e tjera që preken nga lumi i Devollit me qëllim manaxhimin e integruar të tij.*

## 6.2 Ajri

Ndotja e ajrit mbetet problem serioz në Shqipëri për shkak të rritjes së theksuar të numrit të makinave, numrit të mjeteve të vjetra të transportit, rritjes së trafikut në zonat urbane dhe ritmeve të shpejta të urbanizimit<sup>57</sup>. Ky i fundit ka çuar në një zhvillim me ritme tejet të shpejta edhe të sektorit të ndërtimeve dhe përkeqësimit të kushteve të rrugëve brenda zonave urbane.

Të dhënat rreth cilësisë së ajrit në Qytetin e Gramshit dhe Bashkinë Gramsh në përgjithësi mungojnë. Megjithatë, për arsye të mësipërme, mendohet se të paktën në qytet, në afërsi të zonave me fluks trafik të lartë, cilësia e ajrit ndryshon (përkeqësohet) nga ajo e zonave rurale, ku cilësia e ajrit është e mirë. Edhe pse nuk njihet përmbajtja e gazrave ndotës në ajër, është e mundur të arrihet një vlerësim i përafërt i rreziqeve që i shkaktohen shëndetit të njeriut nëpërmjet ndotjes së ajrit nga disa sektorë, veçanërisht ai i transportit.

Marrë si reference të dhënat nga Raporti i Gjëndjes në Mjedis për Shqipërinë dhe veçanërisht RGJM - 2015 të cilat tregojnë se ka tejkalim të normave të elementëve ndotës në ajër, mund të

themi se faktor në këtë situatë, krahas shkarkimeve në atmosferë nga industrinë, mjetet e transportit publik dhe privat si dhe nga ndërhyrjet infrastrukturore, është edhe mungesa e gjelbërimit dhe hapsirave për rekreacion të cilat kryejnë, ndër të tjera, edhe funksionin e filtrimit të ajrit të ndotur dhe prodhimin e sasive të vogla të O<sub>2</sub> me rëndësi në cilësinë e ajrit në qendrat urbane.

Hapësirat e gjelbra ose bimësia urbane, siç quhet shpesh në literaturë<sup>58</sup>, ndikojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në përmirësimin e cilësisë së ajrit. Konkretisht, bimësia urbane ndikon në uljen e ndotjes nëpërmjet thithjes së ndotësve në gjëndje të gaztë nga gjethet e tyre. Krahas filtrimit të ajrit të ndotur, hapsirat e gjelbra shërbejnë dhe janë faktor në mbrojtjen e tokës dhe shëndetit publik.

### 6.2.1 Burimet e ndotjes së ajrit


Siç u theksua më sipër, burimet e ndotjes së ajrit janë të ndryshme (urbanizimi, mjetet e transportit, industria, etj.). Megjithatë, në Bashkinë Gramsh, ndotja nga makinat mbetet burimi kryesor. Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i burimeve kryesore të ndotjes së ajrit në Gramsh.

**Ndotja nga mjetet e transportit:** Sipas RGJM-së në Bashkinë Gramsh, ndikim të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në mjedis në territorin e Bashkisë kanë mjetet e transportit të cilat shkarkojnë në ajër një numër të konsiderueshëm gazrash të dëmshme. Ndër gazrat kryesore renditen:

- monoksidi dhe dioksidi i karbonit (CO dhe CO<sub>2</sub> përkatësisht)
- substancat sulfurike (SO<sub>x</sub>),
- lëndë e ngurtë pezull e përmasave të ndryshme (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>, kryesisht),
- THC (sasia totale e shkarkimeve në ajër të hidrokarbureve)
- përbërësit organikë të avullueshëm (VOC),

Sasia e ndotësve që makinat shkarkojnë në ajër është e konsiderueshme. Nga llogaritjet e Agjencisë Amerikane të Mjedisit, një makinë e tonazhit të vogël (makinat për transport njerëzish deri në 12-vendëshe) shkarkon rreth **5 ton CO<sub>2</sub> në vit** (4.7 metric tons)<sup>59</sup>. Kjo shifër vlen për makinat e prodhuara mbas vitit 2008 dhe me teknologji të përparuar. Nisur nga këto shifra, llogaritja e sasisë së ndotjes për 1 litër lëndë djegëse paraqitet si më poshtë.

Tabela 9 Sasia e CO<sub>2</sub> që shkarkohet në ajër për çdo litër benzinë e naftë




Burimi: US EPA, 2016; Përpunoi: Bashkia Gramsh/Metropolis, 2017

Sasia e ndotësve që shkarkohet në ajër nga një makinë e vogël individuale/pasagjerësh varet nga një sërë faktorësh që janë lloji dhe përmasat e makinës (makinë e vogël, autobus urban, kamion etj.), mosha dhe kilometrazhi, lloji i lëndës djegëse që përdor, kushtet atmosferike (shi apo diell etj.), gjëndja e makinës, mënyra e drejtimit të makinës, etj.<sup>60</sup> Në rast ndryshimesh të këtyre

kushteve, shkarkimet në ajër shtohen. Por, duhet patur parasysh se llogaritjet e mësipërme janë bërë për makina me teknologji më të zhvilluar se një pjesë e mirë e automjeteve që përdoren në Shqipëri, dhe për cilësi më të mirë të lëndës djegëse (shih seksionin e mëposhtëm). Për rrjedhojë, sasia e gazrave të shkarkuara nga një makinë në Shqipëri mund të jetë më e lartë se shifrat e sjella më sipër.

**Rritja e numrit të makinave:** Numri i makinave ka ardhur duke u shtuar nga viti në vit në mënyrë të theksuar në rang vendi. Nëse në vitin 2000 numëroheshin rreth 55 makina /1,000 banorë, në vitin 2010 numri i makinave në Shqipëri arriti 120.8 makina për 1,000 banorë.<sup>61</sup>


Tabela 10 Numri i makinave në Shqipëri për 1,000 banorë ndër vite



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016<sup>62</sup>

Ndërsa numri i makinave për banorë ka ardhur duke u rritur në mënyrë të theksuar në vend, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me tren është ulur në mënyrë drastike. Nga statistikat e viteve 2005-2013,<sup>63</sup> ky numër ka pësuar rënie të ndjeshme.

Tabela 11 Nr i pasagjerëve dhe tonazhi i mallrave të transportuara me tren në vend



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe UNDP, 2016<sup>64</sup>

Me rritjen e makinave, rritet edhe sasia e shkarkimeve në ajër të ndotësve. Në rastin e CO<sub>2</sub>, në qoftë se do të marrim për bazë shifrën 5 ton CO<sub>2</sub> në vit/makinë, sasia e CO<sub>2</sub> e shkarkuar në ajër vetëm nga mjetet individuale të transportit (makinat familjare) **në nivel bashkie është rreth 14,700 ton CO<sub>2</sub>/vit** (2,940 automjete x 5 ton CO<sub>2</sub>/automjet në vit = 14,700 ton/CO<sub>2</sub>/vit). Në vitet në vijim, ekziston mundësia që ndotja nga mjetet e transportit të shtohet për arsye se numri i makinave dhe investimet e Qeverisë Shqiptare në ndërtimin e infrastrukturës rrugore (dhe jo në investime në zhvillimin e llojeve alternative si treni etj.) po shtohen.

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, rreth 55% e investimeve publike të Shtetit Shqiptar kanë shkuar në infrastrukturë rrugore<sup>65</sup>.


Ndërkohë, transporti hekurudhor është lënë pas dore edhe pse Shqipëria është angazhuar për përmirësimin e tij në vitet në vijim. Në vitin 2006, Shqipëria nënshkroi Aktin e Stabilizim-Asocimit, i cili nënkupton rindërtimin e hekurudhës sipas kodeve dhe standardeve të BE-së<sup>66</sup>. Megjithatë, fondet për zhvillimin e transportit hekurudhor mendohet të përftohen nga donatorët.

**Ndotja nga cilësia jo e mirë e lëndës djegëse:** Në vendin tonë, lënda djegëse për mjetet e transportit nuk është e mirë dhe kjo është e dukshme edhe vizualisht. Për më tepër, është vërtetuar edhe nga Inspektorati Qëndror Teknik.

Në periudhën janar-shtator 2014, Inspektorati Qëndror Teknik (sipas të dhënave të publikuar nga AKM-ja) ka monitoruar cilësinë e lëndës djegëse në vend, konkretisht të *naftës*<sup>67</sup>, *benzinës* dhe *solar-mazutit*.

Mostrat e analizuar për vlerësimin e cilësisë së ajrit janë marrë para zhdoganimit të lëndës djegëse dhe pas hyrjes në tregun e brendshëm shqiptar. Në total, janë analizuar 164 mostra, të ndara në tre grupe, 122 për naftën, 31 mostra për benzinën dhe 11 për solar-mazutin (Figura 69).

Tabela 12 Numri i mostrave të lëndës djegëse të analizuar



Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik); Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017  
68

Rezultatet e monitorimit të lëndës djegëse për naftën dhe benzinën janë paraqitur më poshtë:<sup>69</sup>

Tabela 13 Rezultatet e monitorimit të cilësisë së lëndës djegëse në Shqipëri

Vlerat e Sulfurit	Lënda djegëse			
	Gazoil		Benzinë	
	Mostrat (numër)	Mostrat (%)	Mostrat (%)	Mostrat (numer)



11-15ppm	6	4.9	16.1	5
16-20ppm	2	1.6	19.4	6
20-50ppm	14	11.5	29.0	9
>50ppm	100	82.0	35.5	11
<b>Totali</b>	<b>122</b>			<b>31</b>

Burimi: AKM (Inspektorati Qëndror Teknik)<sup>70</sup>


Për naftën, nga 122 mostrat e analizuar, 82% e mostrave (100 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 11.5% e tyre (ose 14 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 6.5% e mostrave (8 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm. Në rastin e benzinës, nga 31 mostrat e analizuar, 35.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë mbi 50ppm sulfur, 12.9% e tyre (ose 9 mostra) përmbajnë nga 20-50ppm, ndërsa 3.5% e mostrave (11 mostra) përmbajnë nga 11-20ppm.

Në bazë të standardit EN 590 për naftën dhe EN 228 për benzinën, vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së sqfurit në naftë është 10 ppm. Nga analiza e mostrave të benzinës dhe naftës rezultojnë se përmbajtja e sulfurit është mbi vlerën e lejuar në të gjitha mostrat. Ndryshimi ndërmjet naftës dhe benzinës qëndron vetëm në vlerat më të larta të shkaktuara në ajër.

Nafta ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë të sulfurit (82% kundrejt 35.5%). Përmbajtja e sulfurit ndryshon tendencë në rastin e grupimit 20-50ppm. Në këtë rast është benzina që ka numrin e mostrave me përmbajtje më të lartë sqfuri (29% të mostrave të benzinës kundrejt 11.5 të gazoilit).

Si përfundim, në bazë të rezultateve të mësipërme rrjedh se të dyja llojet e lëndës djegëse që përdoren në vendin tonë (nafta dhe benzina) kanë përmbajtje të lartë të sqfurit. Ndryshimi i vetëm qëndron në faktin se përmbajtja e sqfurit, në rastin e naftës, arrin kufinj më të lartë se sa në rastin e benzinës.

Tabela 14 Përmbajtja e sqfurit në naftë dhe benzinë (numri i mostrave në %)



Burimi: AKM (IQT<sup>71</sup>), ; Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017<sup>72</sup>


Testime janë bërë edhe për Solar-Mazutin<sup>73</sup>. Të 11 mostrat e monitoruara rezultojnë me përmbajtje më të lartë sqfuri (mbi 3% ). Në bazë të standardit SSH UNI 6579, për analizimin e lëndës djegëse (gazoil), vlera kufi e lejuar e përmbajtjes së sqfurit në gazoil është < 3%. Mostrat e analizuar rezultojnë se përmbajtja e sqfurit është mbi 3%. Si përfundim, mund të thuhet se lëndë djegëse (nënproduktet e naftës) që shitet në tregun shqiptar është e një cilësie jo të mirë.<sup>74</sup> Veç kësaj, në përgjithësi, në Shqipëri preferohet përdorimi i naftës përkundrejt benzinës, për shkak të kostove relativisht më të ulëta. Sipas të dhënave të publikuara në Manualin e Kontrollit, Mirëmbajtjes dhe

Sigurisë Së Automjeteve, përgatitur nga ECAT<sup>75</sup>, në seksionin e shkarkimeve në ajër nga automjetet raportohet *87% e automjeteve në vend përdorin si lëndë djegëse naftën dhe 13% benzinën.*

**Ndotja nga vjetërsia e mjeteve të transportit:** Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, Shqipëria ka rreth 350,000 makina pjesa më e madhe e të cilave janë makina të përdorura<sup>76</sup>. Me rritjen dramatike të numrit të makinave dhe mbi të gjitha të numrit të makinave të vjetra, trafiku në zonat urbane është tashmë një ndër shkaqet kryesore të ndotjes së ajrit.<sup>77</sup> Siç e theksuam edhe më parë, shkarkimet në ajër nga makinat shtohen edhe me rritjen e vjetërsisë së automjeteve për shkak se këto të fundit nuk arrijnë të bëjnë djegien e plotë të lëndës diegëse.

Sipas një studimi të kryer për automjetet në Tiranë, del se 36% e automjeteve me benzinë të prodhuara para vitit 1986 dhe 27% e atyre pas vitit 1986 shkarkojnë CO mbi normat e lejuara. Në rastin e automjeteve me naftë, pavarësisht nga viti i prodhimit, 39.7% e tyre i tejkalojnë normat e lejuara për koeficientin K të tejdukshmërisë së lejuar, i cili është K 2.5<sup>78</sup>.

Tabela 15 . % Makinave që shkarkojnë CO e HC mbi vlerat e lejuara në ajër.



Burimi: ECAT 2008<sup>79</sup>; Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Sipas Ministrisë së Mjedisit dhe UNDP-së, mjetet me benzinë çlirojnë sasi më të mëdha CO dhe HC në ajër në krahasim me mjetet me naftë. Nga ana tjetër, mjetet me naftë çlirojnë më shumë grimca prej karboni elementar, përbërës organikë të karburantit dhe vajra lubrifikante të motorit, sulfate të formuara nga squfuri i karbonit dhe gjurmë përbërjesh metalike. Përbërësit organikë, zakonisht përbëjnë 10-30% të grimcave totale. Por, në motorat e vjetër, përbëjnë deri në 90%. Ky është rasti tipik i Shqipërisë ku shumica e motorave diezel janë prodhime të vjetra dhe pa pajisje të sistemeve mbrojtëse.<sup>80</sup>

**Ndotje nga burime të tjera: vend-depozitimet e mbetjeve, industria etj.:** Venddepozitimi i mbetjeve është një burim i konsiderueshëm ndotës i ajrit, pasi nuk është në standardet e kërkuara teknike dhe higjeno-sanitare për depozitimin e mbetjeve. Depozitimi i mbetjeve kryesisht shkarkon në ajër gazin metan, i cili ka aromë të keqe dhe në përqëndrim të lartë, është irritues dhe shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes dhe në sistemin nervor.

**Spektori i bujqësisë:** gjithashtu ka një kontribut të rëndësishëm në ndotjen e ajrit në territorin e bashkisë, kryesisht në çlirimin e gazrave gjatë shpërbërjes së mbetjeve organike dhe plehut organik.

## 6.2.2 Ndikimi i ndotjes në shëndetin e njeriut

Siç e pamë më sipër, makinat, industria etj. shkarkojnë në ajër një numër jo të vogël ndotësish me ndikim në shëndetin e njeriut. Ndër më kryesorët janë O<sub>3</sub>, CO, CO<sub>2</sub>, SO<sub>x</sub> (SO<sub>2</sub>), PM (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>), Pb, VOC dhe O<sub>3</sub>. Më poshtë sillen një përmbledhje e rreziqeve që i kanosen shëndetit të njeriut nga çdo ndotës në veçanti. Vlen të theksohet se nuk është studiuar ndikimi në shëndetin e njeriut i efekteve që vijnë nga ndërveprimi i ndotësve së bashku (pasojat akumulative/grumbulluese).

**Monoksidi i karbonit (CO)**<sup>81</sup>: Ekspozimi ndaj përqendrimeve të larta të monoksidit të karbonit mund të shkaktojë probleme akute me frymëmarrjen, helmim, humbjen e vetëdijes, vdekje, humbje ekulibri, dhimbje koke, dobësim të muskujve, të përziera dhe të vjella. Probleme kritike ndaj ekspozimit të monoksidit të karbonit kanë gratë shtatzëna tek të cilat mund të shkaktojë abort, të rrisë rrezikun e dëmtimit të fetusit, të lindjes së foshnjës nën peshë dhe të dëmtimit të sistemit nervor. Grupet më të ndjeshme ndaj helmimit nga monoksidi i karbonit janë fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna, të moshuarit, njerëzit me anemi, njerëzit që vuajnë nga sëmundjet e zemrës dhe mushkërisë dhe përdoruesit e duhanit. Në afate të gjata, ekspozimi ndaj monoksidit të karbonit me vlera të ulta, mund të shkaktojë lodhje, dhimbje gjoksi, humbje të kujtesës, sëmundje të zemrës, dëmtim të sistemit nervor, simptoma gripi dhe probleme me lëkurën në rastet kur mund të ketë kontakt me monoksidin e karbonit në formë të lëngshme.

**Dioksidi i karbonit (CO<sub>2</sub>)**<sup>82</sup>: Dioksidi i Karbonit në formë e tij të gaztë është asfiksues për arsye se vështirëson furnizimin normal të trupit oksigjen gjatë frymëmarrjes, sidomos në hapësira të mbyllura. Ekspozimi në një mjedis me përqendrim të CO<sub>2</sub> ≥ 10% mund të shkaktojë vdekje, humbje ndjenjash, apo marrje mendsh. Gjithashtu ekspozimi ndaj një përqendrimi të lartë të CO<sub>2</sub> mund të demtojë zhvillimin e fetusit. Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj CO<sub>2</sub>, në përqindje më të ulët se 10% mund të shkaktojë probleme me shikimin, bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, dëmtim të sistemit nervor qëndror, kontraktim të muskujve, ngritje të tensionit të gjakut. Gjithashtu, ekspozimi mund të shkaktojë marrje mendsh, dhimbje të vazhdueshme koke, djersitje të vazhdueshme, lodhje, mpirje, humbje të kujtesës, të përziera, të vjella, depresion, probleme me lëkurën, djegie të syve dhe zhurma në veshë.

**SO<sub>2</sub>**<sup>83</sup>: Ekspozimi afatshkurtër ndaj niveleve të larta të SO<sub>2</sub> në ajër mund të jetë i rrezikshëm për jetën duke shkaktuar vështirësi në frymëmarrje dhe bllokim të rrugëve të frymëmarrjes, sidomos për njerëzit me sëmundje të mushkërive. Ekspozimi afatgjatë ndaj niveleve më të ulta të SO<sub>2</sub> mund të shkaktojë bronkit kronik, emfizemë, sëmundje të frymëmarrjes dhe mund të përkeqësojë sëmundjet ekzistuese të zemrës.

Kur dioksidi i squfurit reagon me kimikate të tjera në ajër, formon grimca të vogla sulfate. Këto grimca mund të mblidhen në mushkëri gjatë frymëmarrjes dhe të shkaktojë rritjen e problemeve të frymëmarrjes dhe vështirësi në frymëmarrje. Ekspozimi afatgjatë ndaj grimcave sulfate mund të shkaktojë sëmundje të frymëmarrjes, madje edhe vdekje të parakohshme.

Të sëmurët me astmë janë shumë të ndjeshëm ndaj ekspozimit të dioksidit të squfurit, por edhe të njerëzit të cilët vuajnë nga sëmundjet e zemrës mund të përkeqësohen gjatë ekspozimit ndaj SO<sub>2</sub>

**PM (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>)**<sup>84</sup>: Është vërtetuar shkencërisht se përqendrime të larta të grimcave në ajër (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>) paraqesin një kërcënim serioz për shëndetin e njeriut. Grimcat me diametër më të vogël në ajër shfaqin probleme të rënda në shëndet, pasi ato depozitohen në pjesët fundore të

mushkërive dhe qëndrojnë aty për një kohë të gjatë ose depërtojnë në gjak. Ekspozimi në periudha të gjata ndaj lëndës së ngurtë në ajër shkakton rritjen e sëmundjeve të frymëmarrjes, ul funksionin e mushkërive, shkakton bronkit kronik, madje dhe vdekje të parakohshme për shkak të problemeve me frymëmarrjen. Grimcat e shkarkuara nga automjetet, që përdorin lëndë djegëse diezel, janë vertetuar të kenë ndikim në shtimin e mundësisë për t'u prekur nga kanceri.

Grupet e njerëzve më të prekur nga problemet shëndetësore që shkaktojnë grimcat janë fëmijët, të moshuarit dhe njerzit që vuajnë nga sëmundje të mushkërisë dhe zemrës.

**Pb<sup>85</sup>:** Sipas Agjencisë Amerikane të Mjedisit, plumbi mund të jetë lëndë kanceroze për shëndetin e njeriut. Plumbi përbën rrezik për shëndetin e fëmijëve, sepse mund të shkaktojë sistemin nervor në mënyrë të përhershme dhe të shkaktojë sëmundje në veshka, zemër, dhe në sistemin riprodhues. Niveli i plumbit në gjak konsiderohet si shumë i rrezikshëm pavarësisht nga sasia e tij. Plumbi gjendet në formë inorganike, si në lëndë djegëse, bojëra, kompjutera, bizhuteri, dhera, edhe produkte të tjera, në miniera, që është edhe forma më e përhapur sot. Plumbi në trup merret nëpërmjet të ushqyerit apo frymëmarrjes.

**VOC<sup>86</sup>:** Ekspozimi afatgjatë ndaj komponimeve organike të paqëndrueshme mund të shkaktojë dëmtimin e mëlçisë, veshkave dhe të sistemit nervor qendror. Ndësa ekspozimi afatshkurtër mund të shkaktojë probleme në sy, acarim të rugëve të frymëmarrjes, dhimbje koke, marrje mendsh, çrregullime vizuale, lodhje, reaksione alergjike të lëkurës, vjellje, dhe dëmtim të kujtesës.

**O<sub>3</sub>:** Ekspozimi ndaj përqendrimit të lartë të Ozonit (O<sub>3</sub>) mund të shkaktojë dëmtim të përhershëm të mushkërive, sidomos tek fëmijët, mushkëritë e të cilëve janë në zhvillim. O<sub>3</sub> mund të shkaktojë probleme me lindshmërinë dhe probleme gjenetike, si dhe mund të rritë mundësinë e dëmtimit të fetusit. Ekspozimi ndaj këtij gazi mund të përkeqësojë sëmundjet kronike të mushkërive, të zvogëlojë sistemin imunitar, të përkeqësojë sëmundjet e astmës dhe ato të zemrës dhe shkaktojë depozitime të lëngëta në mushkëri, duke vështirësuar ndjeshëm frymëmarrjen. Simptomat fillestare të ndikimit të O<sub>3</sub> në shëndet fillojnë me iritimin e rrugëve të frymëmarrjes, shkaktimin e kollës si dhe ndjesi shqetësuese në fyt dhe në gjoks. Futja e O<sub>3</sub> në organizëm nëpërmjet frymëmarrjes shkakton gjithashtu dhimbje koke, dhimbje stomaku, si dhe lodhje dhe të vjella.


## **6.3 Pyjet, peisazhi, zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti**

### **6.3.1 Pyjet dhe kullotat**

Në vitin 2016, fondi pyjor dhe kullor kaloi në pronësi të Bashkisë Gramsh, me përjashtim të sipërfaqes pyjore e kullor që është pjesë e territorit të zonave të mbrojtura (VKM nr. 433, datë 8/6/2016 “Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë”).

Sot, Bashkia Gramsh ka në pronësi të saj 54,840.34 ha sipërfaqe fond pyjor, struktura e të cilit përbëhet nga rreth 35,731 ha pyje, 10,095 kullotë dhe 9,012 ha sipërfaqë djerrë, inproduktive, ujore dhe bimë pyjore. Gjithashtu në territorin e Bashkisë rezulton të ketë një sipërfaqe prej 6680 ha zona të mbrojtura, të cilat shtojnë sipërfaqen e pyjeve në territor, por që nuk i përkasin fondit pyjor dhe mbeten në pronësi të qëverisjes qendrore.<sup>87</sup>

Tabela 16 Struktura e fondit pyjor e kullosor, Bashkia Gramsh (ha)



Burimi: Bashkia Gramsh; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Sipas të dhënave për shpërndarjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në territorin e NjA-ve të Bashkisë Gramsh, dallohet qartë që NjA-ja me sipërfaqe më të madhë të fondit pyjor është Pishaj e cila ka sipërfaqen prej 9,693.4 ha, ndjekur nga NjA-të Kodovjat me 7,621.7ha, Kukur me 7,331 ha dhe Skënderbegas me 6,057 ha. Ndërsa NjA-të e tjera kanë sipërfaqe më të vogla të fondit pyjor. NjA-të të cilat kanë sipërfaqe më të madhë të kullotave përmendim NjA-në Poroçan me sipërfaqe kullosore 1,784 dhe Kukur me 902 ha. Ndërsa NjA-të me sipërfaqe më të vogël të fondit kullosor përmendim NjA-në Lenie, Tunjë dhe Skënderbegas. Duke analizuar me kujdes të dhënat vihet re që zona inproduktive me sipërfaqen më të madhe ndodhet në NjA-të Kukur dhe Skënderbegas, përkatësisht 1,295 ha dhe 1,134 ha. NjA-ja Skënderbegas ka edhe zona pyjore me status të mbrojtur me ligji (zona të mbrojtura) të cilat aktualisht menaxhohen nga AdZM Elbasan dhe Berat.

Tabela 17 Përdorimi i tokës sipas zonave, Bashkia Gramsh

Nr.	NJA	Kategoria	Sip. ha	Sip. Totale ha
1	<b>Pishaj</b>	djerrë	325.7	9,693.4
		inproduktive	85	
		kullotë	453.7	
		bujqësore	2,814.3	
		ujore	1.9	
		pyll	6,012.8	
2	<b>Sult</b>	djerrë	4,92.55	5,987.55
		inproduktive	174.2	
		kullotë	227.4	
		bujqësore	1,551.6	
		ujore	2.1	
		pyll	3,539.7	
3	<b>Tunjë</b>	djerrë	359.67	5,072.08
		inproduktive	407.12	
		kullotë	19.54	

		bujqësore	1,562.5	
		ujore	2.26	
		pyll	2,720.99	
4	<b>Skënderbegas</b>	djerrë	70.74	6,057.9
		inproduktive	1,134.22	
		kullotë		
		bujqësore	1,760.99	
		ujore	1.64	
		pyll	3,090.31	
5	<b>Lenie</b>	djerrë		2,403.5
		inproduktive	663.4	
		kullotë	430	
		bujqësore	70.3	
		ujore		
		pyll	1,239.8	
6	<b>Kodovjat</b>	djerrë	318.06	7,621.7
		inproduktive	889.31	
		kullotë	868.89	
		bujqësore	1,946.24	
		ujore	15.01	
		pyll	3,584.19	
7	<b>Kukur</b>	djerrë	422.84	7,331.22
		inproduktive	1295.96	
		kullotë	902.62	
		bujqësore	1739.87	
		ujore		
		pyll	2969.93	
8	<b>Poroçan</b>	djerrë	459.28	5,589.57
		inproduktive	116.28	
		kullotë	1784.26	
		bujqësore	1279.44	
		ujore		
		pyll	1950.31	
9	<b>Kushovë</b>	djerrë	148.33	5,265.18
		inproduktive	602.69	
		kullotë	66.29	
		bujqësore	1395.44	
		ujore	0.29	
		pyll	3052.14	
Bashkia Gramsh sipërfaqe totale F. Pyjor			55,022.1	

Fondi pyjor në territorin e bashkisë Gramsh përbëhet nga specie të shumta drusore dhe shkurre, ndër më të prashishmet përmendim: Pishën e egër dhe të detit (Pinus), Akacia, Ahu, Makja, Shkoza, etj. Në vijim analizohen sipërfaqet dhe llojet e specieve drusorë për çdo NjA në territorin e bashkisë:

- **NjA Pishaj:** Fondi pyjor në këtë NjA përfaqësohet nga rreth 882 ha trungishte dhe 531 ha shkurre. Sipërfaqja e trungishtave përbëhet nga 481 ha pishë e egër dhe pishë deti, 8 ha akacie, 420 ha ahishte, shpardh dhe panjë, 1 ha arrë dhe rreth 34 ha qarri dhe shkozë. Ndërsa shkurret përfaqësohen nga shkoza, dëllënja, mareja, ilqe, qarr, frash dhe dell<sup>88</sup>.
- **NjA Poroçan:** Në zonën e Poroçanit ndodhen rreth 1078 ha trungishte dhe 872 ha shkurre. Trungishtet përbëhen nga rreth 334 ha pyllë ahu, 43 ha gështenjë, 13 ha pylla akacie, 551 Qarr dhe 136 ha pyllë më pisha. Ndërsa shkurret përfaqësohen nga Dëllënja, Shkoza, Lisi, Frashëri dhe Murrizi<sup>89</sup>.
- **NjA Kukur:** Speciet floristike lehtësisht të identifikueshme në zonën e Kukurit janë shkurret dhe trungishtet, ku përkatësisht formojnë një sipërfaqe prej 2113 ha shkurre dhe rreth 857 ha cungishte dhe trungishte<sup>90</sup>. Shkurret përfaqësohen nga Shkoza, ndërsa cungishtet dhe trungishtet nga Pisha e egër, Pisha e zezë, Ahu dhe Akacia.
- **NjA Skënderbegas:** Në Skënderbegas ndër të tjera gjendet 1591 ha trungisht dhe 1310 shkurre. Trungishtet përfaqësohen nga Pisha e zezë e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 1339 ha, ndërsa shkurretat përfaqësohen nga makja, shkoza dhe lajthia<sup>91</sup>.
- **NjA Kushovë:** Në zonën e Kushovës gjenden sipërfaqe të konsiderueshme më pyje, shkurre dhe bimë barishtore. Trungishtet zënë 671 hektarë, ndërsa shkurret 2830 ha<sup>92</sup>. Trungishtet përfaqësohen nga pisha e zezë dhe shpardhi, ndërsa shkurret nga makie dhe shkozë. Problemet kryesore në këtë zonë shkaktohen nga prerja e jashtëligjshme e pyjeve dhe mbi kullotja.
- **NjA Tunjë:** Në territorin administrativ të Tunjës ndodhet 402 ha trungishte e cungishte dhe 2318 ha shkurre<sup>93</sup>. Shkurret në Tunjë përfaqësohen nga Shkoza, Marea, Dëllënja dhe Cermedelli, ndërsa pyjet përfaqësohen nga pisha e egër, lisi, akacia dhe Arra.
- **NjA Sult:** Trungishtet dhe cungishtet zënë rreth 555 ha, të përfaqësuara nga pisha e Egër, Lisi dhe Akacia. Shkurret zënë rreth 2984 ha, të cilat përfaqësohen nga Mare, Marete, Dëllënja dhe Shkoza<sup>94</sup>. Në këtë zonë ka edhe shumë specie barishtore dhe të kultivuara të cilat kanë kontribut të rëndësishëm në rritjen e diversitetit floristik të zonës.
- **NjA Kodovjat:** Trungishte dhe cungishte zënë 725<sup>95</sup> ha, të përfaqësuara nga Pisha e zezë, pisha e egër, Shpardhi dhe Qarri. Ndërsa shkurret zënë një sipërfaqe prej 2859 ha, e cila përfaqësohet nga Shkoza, Dëllënja, Mareja, Frashëri, etj.

#### Problematikat kryesore të fondit pyjor

**Mungesa e inventarizimit periodik i fondit pyjor e kullosor:** të dhënat rreth sipërfaqeve pyjore e kullosore në vendin tonë dhe në Bashkinë Gramsh bazohen në inventarin e fundit të këtij fondi i

cili i përket viteve 1984-1985. Që nga regjistrimi i fundit, nuk ka patur përpjekje të reja për një inventar të përditësuar edhe pse me ligj parashikohet inventarizimi çdo dhjetëvjeçar. Si rrjedhojë, në vendin tonë dhe në Bashkinë Gramsh, të dhënat e inventarëve shpesh janë kontradiktore.

**Humbja e sipërfaqes pyjore:** Një ndër problematikat kryesore të pyjeve në Bashki është humbja e sipërfaqes pyjore në dy dhjetëvjeçarët e fundit.

**Prerja e pyjeve:** Në territorin e Bashkisë janë vërejtur prerje të vazhdueshme të pyjeve për lëndë djegëse dhe për tregëtim të lëndës drusore. Aktualisht, prerja e pyjeve është e ndaluar (Moratoriumi 10 vjeçar i pyjeve), ndaj zbatimi i moratoriumit është jetik për mbarështimin e pyjeve.

**Djegia e pyjeve:** Ashtu si në të gjithë vendin, edhe në Bashkinë Gramsh janë vënë re raste të djegies së pyjeve. Duke qënë një terren i thyer, kontrolli dhe ndërhyrja në raste zjarri është tejet i vështirë.

**Tjetërsimi i sipërfaqeve të fondit pyjor:** Tjetërsimi i fondit pyjor në kullotë është një fenomen i cili praktikohet gjërësisht në vend, në rastet më të shumta ndodh fenomeni i zjarrë vënies e më pas, kthimi në kullotë për bagëtinë.

#### Përfundime dhe rekomandime

Mirëadministrimi i Pyjeve dhe Kullotave nga Bashkia Gramsh, sigurimi në realizimin e reformës së decentralizimit të kompetencave në administrimin e pyjeve dhe kullotave publike dhe dixhitalizimi i hartave të fondit pyjor nën administrim mbeten pikënisjet drejt suksesit për përmirësimin e gjëndjes aktuale të Pyjeve. Njësitë Administrative, nëpërmjet planeve të manaxhimit të pyjeve dhe kullotave mund t'i ofrojnë banorëve të tyre mundësi punësimi në periudha kur ka aktivitete të punimeve pyjore. Njësitë Administrative, nëpërmjet mbjelljes dhe rimbjelljes së drunjëve të lartë mund të përfitojnë më shumë të ardhura, mbështetje financiare në realizimin e projekteve, si dhe të ardhura të vazhdueshme e të sigurta nga shitja e kapaciteteve të lira të karbonit.

Për ruajtjen dhe mbarështimin e fondit pyjor e kullor në territorin e Bashkisë së Gramshit rekomandohet të merren një sërë masash, disa prej të cilave mund të jenë:

- Hartimi i një *Plani Veprimi për rehabilitimitimin e sipërfaqeve të djegura* që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale
- Marrja e *masave paraprake për parandalimin e fenomeneve të zjarrit*, si: ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënien para përgjegjësisë të të gjithë kundërvajtësve që shkaktojnë zjarret, shtrirjen e një sistemi lajmërimi zjarri (rol të rëndësishëm luajnë barinjët e zonës në këtë rast, etj.)
- *Mbajtja nën kontroll e sëmundjeve dhe e dëmtuesve*, ku shkalla e prekjës është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet zonave me shtrirje të mëdha bimësie dhe ruajtjes së bimëve shumëvjeçare.

### **6.3.2 Peisazhi**

Peisazhi është gjithçka që duket në territor mbi sipërfaqen e tokës dhe mund të studiohet në drejtimin estetik dhe drejtimin funksional që lidhet me shërbimet e ekosistemit. Të dyja këto




drejtime janë të lidhura ngushtë me njëra-tjerën dhe në fakt, aspekti funksional ndikon atë estetik. Në territorin e Bashkisë Gramsh peizazhi ndahet në pesë fasha (tipologji) kryesore: **urbane, industriale, rurale, natyrore** dhe **ujore**.

Krijimi i fashave peizazhistike në territorin e Bashkisë lidhet ngushtë me formacionet territoriale, hidrogjeologjinë dhe hidrografinë, si dhe pjerrësitë e terrenit. Megjithëse këta komponentë kanë tipologji të ndryshme nga njeri-tjetri dhe gjenden në zona të ndryshme të territorit, porë në shkallë peizazhi ata përbëjnë një të vetëm, duke ofruar shumëllojshmëri peizazhistike brenda kufirit bashkiak.

Në këtë larmishmëri peizazhistike dallohet **fasha natyrore**, e cila është edhe fasha më e ndërlikuar në matricën peizazhistike. Kjo fashë karakterizohet nga sipërfaqe pyjore, fusha të hapura, korridore të gjelbëra apo ujore, zona tampon, zona ripariante, zemra e habitatit, ngastra, si dhe mozaikë. Po në këtë fashë përfshihet edhe sipërfaqja më e madhe e fondit pyjor dhe zonat e mbrojtura natyrore brenda territorit të Bashkisë. Gjithashtu, shumë e dallueshme në territor është **fasha rurale**, e cila karakterizohet nga toka bujqësore, toka të hapura të pozicionuara në mënyrë “informale”, grupime pemësh/shkurresh, pemë të mbjella në rrjesht, të cilat herë duken të mbjella nga njeriu e herë vetvetiu nga natyra, trupa ujorë (Liqene, lumenj, kanale, rezervuare, etj.)

Figura 31 Harta e tipologjive të Peizazhit (Fashat)



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017.

Tipologji tjetër peizazh-krijuese në Bashkinë Gramsh është **fasha urbane** ku peizazhi shpaloet në zona banimi dhe shërbimesh me një karakter **formal**. Këtu, peizazhi karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetres përgjatë akseve rrugore, pemë apo grupime pemësh zbukuruese, parqe si dhe zona tampon.

**Peizazhi industrial** shfaqet i pandashëm nga fasha urbane, specifikisht në NjA-në Gramsh dhe Pishaj. Ky peizazh ka po ashtu karakter “**formal**”, ndonëse bimësia është më e rallë. Po ashtu, në krasitjen e paraqitjen e tyre i përkushtohet rëndësi dekorimit, më tepër se sa funksionit dhe shërbimit mjedisor. Si në rastin e pemëve në peizazhin urban, edhe këtu ato preferohen të jenë vendase dhe me kurorë të gjerë për të hijëzuar hapësira parkimi, apo publike.

Fasha e fundit është ajo e **sipërfaqeve ujore**, e cila karakterizohet nga të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë, duke përfshirë lumenjtë, rezervuarët, kanalet vaditëse, shatërvanet dhe zonat ujëmbajtëse sezonale. Peizazhi ujqor dominohet nga lumi Devoll dhe degët e tij, liqeni i Banjës dhe gjithë liqenet dhe rezervuarët e shpërndarë në gjithë territorin e bashkisë.

Ndonëse pjesë kryesore dhe e pandashme e peizazhit urban, **rrugët** ashtu si edhe sipërfaqet ujore, shtrihen në mbarë territorin e Bashkisë, duke krijuar “çarje” të tipologjive peizazhistike. Nga ana tjetër, ato krijojnë edhe lidhje fizike e pamore mes tipologjive peizazhistike. Këto rrugë u përkasin kategorive të ndryshme nga madhësia, po ashtu edhe funksioni, por elementi i përbashkët dhe i pa ndryshuar mbetet peizazhi. Në hartën e peizazhit, rrugët shfaqen si “kanale” lidhëse pa trashësi të përcaktuar, apo kategorizim funksional. Pra, në vend të funksionit e lidhjes që ato krijojnë mes zonave, në analizën peizazhistike, ato karakterizohen vetëm nëpërmjet imazhit që secila përcjell në fashën peizazhistike ku kalon.

#### Elementet përbërëse të peizazhit

**Elementët e peizazhit natyror:** Identifikimi i elementeve peizazhistike në fashën natyrore të territorit të Bashkisë Gramsh, ku pjesë e pandashme janë edhe sipërfaqet e Fondit Pyjor dhe të Zonave të Mbrojtura Natyrore merr rëndësi të veçantë, pasi identifikimi dhe leximi i këtyre elementeve ndikon drejtpërsëdrejti në të kuptuarin e biodiversitetit lokal, potencialin e ekoturizmit si dhe gjëndjen e fondit pyjor, përfshirë mbrojtjen e tij e të fashës natyrore në tërësi nga rreziqet natyrore dhe njerëzore. Elemente të peizazhit natyror që gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh, si **zonat ripariane, korridoret, kopshtet ujëmbajtëse** etj., luajnë një rol të rëndësishëm edhe në krijimin e mikroklimës në zonat ku ato shtrihen. Zonat **ripariane**, të cilat natyrshëm shtrihen përgjatë trupave ujore si lumenj, përrenj, kanale dhe rezervuare parandalojnë erozionin ujqor, krijojnë strehë dhe ofrojnë ushqim për gjallesat e ndryshme ujore e tokësore që frekuentojnë këtë mjedis, krijojnë mikroklimë të vetën, ofrojnë habitatin e nevojshëm për mbarëshkrimin e këtyre specieve dhe mbrojnë burimet ujore nga derdhja e nutrientëve (ushqyesve me tepicë), që rezultojnë nga përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve në tokë bujqësore.

Figura 32 Zonë ripariane e zhveshur nga bimësia autoktone si pasojë e zhvillimit të bujqësisë



Burimi: Google Imagery, 2017

Rripat e gjelbër, korridoret dhe korridoret lidhës<sup>96</sup> marrin një rol po aq të rëndësishëm sa edhe zonat ripariane, pasi ato luajnë rolin e venave në peizazh duke lidhur parcelat, ngastrat, sipërfaqet ujore, apo matricat peizazhistike me njëra-tjetrën. Ato ofrojnë edhe vend kalime për specie të ndryshme, mbrojnë biodiversitetin lokal si dhe krijojnë barrierë natyrore për erën.

Figura 33 Rrip i gjelbër me bimësi të ulët përgjatë një kanali vaditës



Burimi: Google Imagery, 2017

Korridorët, krahas rëndësisë peizazhistike që mbartin, karakterizohen nga shërbime të shumta ekologjike në përgjithësi të përherëshme si strehimi, ushqimi e vendet e riprodhimit për jetën e egër, por edhe ato të përkohëshme si vendkalimet dhe ushqimi sezonal, ndërsa korridoret lidhës të cilët janë në shkallë më të vogël ofrojnë shërbime ekologjike të përkohëshme ku shërbimi kryesor mbetet kalimi i jetës së egër nga një pikë në tjetrën. Korridoret (të mëdhenj dhe të vegjël, lidhës) shfaqen të copëzuar herë-herë në formë parcele apo ngastrë.

**Elementët e Peizazhit Urban dhe Industrial:** karakterizohet nga pemë të mbjella afër njëra-tjetrës përgjatë akseve rrugore ku llojet e tyre shfaqen të ndryshueshme sipas rrugës. Elementet urbane dhe industriale të forta/mbizotëruese apo edhe të padëshiruara shfaqen herë-herë në zona të ndryshme të qytetit. Zona tampon apo brezat e gjelbër pengues të erës dhe imazheve urbane apo industriale të padëshiruara ndodh në mënyrë spontane e të paplanifikuara. Pjesa më e madhe e

sipërfaqeve parkim shfaqet e ekspozuar ndaj diellit pasi bimë gjethore për hijëzimin e këtyre hapësirave mungojnë.

**Elementët e peizazhit ujqor** në tërësi dhe në veçanti ai liqenor shfaqet i “qëndëruar” mes peizazhit urban dhe atij natyror. Bimësia “ripariane” mungon dhe tkurret dukshëm kur trupi ujqor ndodhet në fashën rurale, ndërkohë gjatë fashës natyrore sërisht humb një pjesë të vogël të zonës së tij ripariane si pasojë e tjetërsimit në tokë bujqësore dhe fenomenit gjeologjik të përshpejtuar si pasojë e prerjes së bimësisë në këto zona. Pra peizazhi ujqor shfaqet si lidhës mes peizazhit rural dhe atij natyror.

### Rreziku ndaj elementëve peizazhistik

Peizazhi në territorin e Bashkisë Gramsh paraqitet i ndryshëm, në varësi të territorit dhe zonave ku mbizotëron aktiviteti njerëzor. Problematikat kryesore që has peizazhi në territorin e bashkisë kanë të bëjnë kryesisht me fragmentimin/copëzimin e peizazhit natyror, dhe mos-futjen e elementëve të peizazhit natyror në zonat urbane. Krahas problemeve në shkallë të madhe, vlen për t’u theksuar prania e problemeve me peizazhin urban e atë industrial, të cilët deri më tani nuk kanë gjetur një rrugë të përbashkët ndërthurjeje me atë natyror. Në qytet mbetet problem krijimi i një peizazhi të mirëfilltë urban, duke përfshirë të gjithë elementët e gjelbërimit, arkitektonikës, kopshteve, monumenteve kulturor dhe historike, të cilët së bashku do të krijojnë një peizazh të ndërthurur dhe të pëlqyeshëm për qytetarët. Shpesh, praktikatat e mira të peizazhit nuk ndiqen, apo përcaktohen si detyësore. Këto praktikat janë spontane, ku zonat urbane dhe industriale kanë përdorur elementë të peizazhit në mënyrë rastësore, apo duke patur një orientim të lehtë mbi çështjen e dizajnit të peizazhit. Kryesisht, rrugët dhe sheshet kanë qënë pjesë e futjes së dizajnit të peizazhit, me mbjellje pemësh në formë lineare, duke ndjekur linja strikte, në rastet më të shpeshta, duke ndjekur konturet e infrastrukturës. Kjo është një mënyrë sigurisht jo universale në rregullimin dhe krijimin e peizazhit apo përdorimit të elementëve të tij në funksion të dekorit urban e më gjerë.

Studimi i peizazhit në tërësi dhe elementëve të tij kërkon studime të thelluara duke analizuar të gjithë përbërësit e tij (planifikimi, arkitektonika, historia, kultura, kultura bujqësore, natyra, bimësia lokale, e deri tek përbërësit më elementar si ndryshimi i ngjyrës së pemëve përgjatë stinëve të vitit) dhe gjetjen e rrugëve të përbashkëta për ndërthurjen e pikave që mund të ndërthuren me njëra-tjetrën për të krijuar një peizazh të pëlqyeshëm dhe funksional. Ndër rreziqet kryesore ndaj elementëve peizazhistikë në territorin e Bashkisë Gramsh përmendim:

- *Zhvillimi dhe zgjerimi i tokave bujqësore* në tërësi të territorit dhe sidomos përgjatë trupave ujqorë ka ngushtuar, copëzuar dhe zhveshur në mënyrë të theksuar zonat ripariane nga bimësia si në burime *Lentike* (liqenet dhe pellgjet) dhe *Lotike* (afër ujërave rrjedhëse, si lumenjtë dhe përrenjtë). Lumi Devoll e shfaq dukshëm këtë fenomen. Bimësia lokale në to karakterizohet me bimësi si robinja (*Robinia Pseudoacacia*), rrapi (*Platanus*), shëlgju (*Salix*), plepi i bardhë (*Populus Alba*) dhe shkurrja autoktone. Në sipërfaqet ku ka mbijetuar zona ripariane, shtresat përbërëse të saj si ajo e sipërme, e mesme dhe e mbulimit të tendës, rrallë gjenden të pandikuara nga aktiviteti njerëzor. Herë ka humbje të shtresës së mbulimit të terrenit në zonën e sipërme të tokës, e cila kryen filtrimin e ndotësve dhe të sedimenteve të derdhjeve sipërfaqësore dhe herë të shtresës së mesme të tendës në zonën bregore ku gjenden shkurret e larta dhe pemët të cilat nëpërmjet rrënjëve stabilizojnë anët e përroit. Si pasojë, nga një anë aktiviteti bujqësor ka dëmtuar zonën ripariane e, nga ana

tjetër, erozioni lumor ka përparuar në dëm të tokave bujqësore duke gërryer brigjet, marrë tokë, shkaktuar përmytje dhe shkarkuar sedimentet ujore mbi tokë.

- *Përbërësit peizazh-formues* si ai **urban, industrial, rural, natyror** dhe **ujor** të analizuar më sipër shfaqen në zona të ndryshme të territorit. Por, problematika mbetet e njëjtë si pasojë e ndërveprimit mes tyre. Në këtë kontekst vërehet një mospërputhje e elementëve peizazhistike në territorin e Bashkisë, duke mos u përdorur elementët peizazhistik në funksion të përmirësimit të tij.
- *Fragmentimi i zonave natyrore* ka cënuar peizazhin natyror, duke e cinguar dhe ndaluar vijshmërinë natyrore. Kjo shfaq probleme krahas fragmentimit të habitateve dhe fragmentit pamor.
- *Zonat e ndotura (hotspot)* të cilat janë të pranishme në territorin e bashkisë luajnë një rol të rëndësishëm në përkeqësimin e cilësisë peizazhistike të territorit.

### Përfundime dhe rekomandime

Territori i Bashkisë Gramsh rezulton të ketë një larmishmëri peizazhistike, natyrore, ubrane, rurale, ujore, etj., duke u përkthyer kjo në një potencial të pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit. Larmishmëria e peizazhit është kushtëzuar nga territori dhe përdorimi i tokës. Kryesisht në pjesën e NjA-ve dy skajet e bashkisë mbizotëron peizazhi natyror, ndërsa në pjesë qendrore të Bashkisë Gramsh mbizotëron peizazhi me tipologji rurale e bujqësore. Qendra e territorit, gjithashtu është i përqëndruar tipologjia urbane dhe industriale e peizazhit.

Në territorin e bashkisë mbetet problematik fragmentimi i peizazhit natyror, i cili është dëmtuar nga zhvillimi urban, industrial e kryesisht ai bujqësor. Zonat e ndotura, kryesisht nga mbetjet urbane dhe shkarkimi i ujrave të ndotura, apo dhe zonat industriale, ndikojnë në përkeqësimin e peizazhit dhe natyrës. Ndërthurja e tipologjive të ndryshme të peizazhit në territor haset me vështirësi të mëdha, pasi gjatë zhvillimeve të ndryshme në territor nuk janë marrë parasysh elementët peizazhistikë dhe rëndësia e tyre. Kjo vazhdon të jetë një pengesë për përmirësimin e peizazhit.

Me qëllim përmirësimin e peizazhit dhe ndërthurjen e tipologjive të tij, duke përmirësuar aspektin pamor dhe ruajtur funksionalitetin, nevojitet të merren masa të cilat lidhen me:

- futjen e përbërësve natyrorë në brëndësi të zonave urbane dhe industriale,
- mbjelljen e pemëve të larta për të fshehur objektet industriale të padëshirueshme nga pikëpamja vizuale/pamore,
- ruajtjen dhe mbrojtjen e të gjithave tipologjive të peizazhit në territorin e Bashkisë,
- krijimin e zonave ripariane dhe korridoreve përgjatë tokave bujqësore,
- gjatë hartimit dhe zbatimit të planeve sektoriale, rekomandohet futja e elementit peizazhistik.

### **6.3.3 Zonat e mbrojtura**

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore<sup>97</sup>.

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj<sup>98</sup> dhe zënë rreth 16%<sup>99</sup> të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kriteret:<sup>100</sup> i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 18 Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

<b>Kategoria</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Karakteristikat</b>
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror <sup>101</sup> .
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me reliev të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.

Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluara dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.
--------------	--	--

Burimi: Ligji Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”

o Manaxhimi i zonave të mbrojtura në vend

Kohët e fundit, Shteti Shqiptar ka bërë hapa të rëndësishëm përpara për zhvillimin e zonave të mbrojtura. Qeveria ka plotësuar më tej kadrin ligjor dhe institucional për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Shqipëria ka miratuar Ligjin Nr.81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”, i cili ka si qëllim kryesor shpalljen, ruajtjen, manaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tyre. Një hap shumë i rëndësishëm në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në vend është edhe miratimi i VKM-së Nr. 102 i datës 12.02.2015 i cili krijoi dhe përcaktoi funksionet e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM). AKZM-ja dhe AdZM-ja kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend, mbështetjen që i japin Ministrisë për hartimin dhe zbatimin e politikave për zonat e mbrojtura, hartimin dhe zbatimin e planeve të manaxhimit dhe të veprimit, monitorimin, mbledhjen e informacionit dhe lajmërimin e organeve kompetente kur vërehen shkelje në zonat e mbrojtura.<sup>102</sup> Pas përpjekjeve të shtetit shqiptar për plotësimin e kuadrit ligjor dhe institucional, mund të themi që manaxhimi dhe administrimi i zonave të mbrojtura është qartësuar në kontekstin e përgjegjësiwe institucionale.





Në këtë fazë, AKZM-ja<sup>103</sup> ka hartuar Programin Strategjik afatshkurtër dhe afatmesëm 2015-2020 për manaxhimin e zonave të mbrojtura në vend. Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i manaxhimit të ZM-ve sipas standardeve të BE-së, duke ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme burimet natyrore. Për më tepër, Qeveria ka marrë masa konkrete për zbatimin e ligjeve mbi zonat e mbrojtura dhe manaxhimin e tyre. AKZM-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, ka hartuar planet e manaxhimit për disa zona të mbrojtura (Plani i manaxhimit të Parkut kombëtar të Malit të Tomorrit, Divjakë- Karavasta etj.) dhe është drejt përfundimit të hartimit të planeve të manaxhimit<sup>104</sup> për zona të tjera. AKZM-ja e shtrin aktivitetin e saj në çdo qark nëpërmjet degës së saj rajonale (AdZM-të e qarqeve). AdZM-të kanë në fokus të tyre zbatimin e planeve dhe monitorimin e zonave të mbrojtura në territorin e tyre të kompetencës (të qarkut përkatës) dhe bashkëpunimi më AdZM-të e tjera përkatëse kur zona e mbrojtur i kalon kufinj të qarkut. AdZM-të kanë një staf të caktuar në varësi të sipërfaqeve të zonave të mbrojtura që ndodhen në territorin e administruar prej tyre (disa punonjës në rastet e manaxhimit të një parku kombëtar, që llogaritet të ketë një sipërfaqe të madhe ku përfshihen kryesisht specialistë monitorimi dhe disa roje).<sup>105</sup>

Me gjithë punën e mirë të bërë nga AKZM, zbatueshmëria e ligjit për zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura ende has vështirësi. Mungesa e planeve të manaxhimit dhe mungesa e kapaciteteve për zbatimin e planeve të manaxhimit për disa zona mbetet ndër vështirësitë kryesore. Për kapërcimin e këtyre vështirësive, momentalisht AKZM-ja është duke bërë një punë të mirë në drejtim të rritjes së kapaciteteve lokale dhe plotësimin të stafit të nevojshëm për manaxhimin sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura.






○ Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh

Në territorin e Bashkisë së re të Gramshit gjenden pasuri të shumta natyrore. Format e larmishme të relievit dhe luhatjet e lartësive kanë ndikuar në formimin e mikroklimave të ndryshme të cilat ofrojnë mundësinë për zhvillimin e florës dhe faunës në territor. Në territorin e bashkisë gjendet një pjesë e Parkut Kombëtar Mali i Tomorrit (Pjesa veriore e parkut), i cili shquhet për larmi të lartë biologjike me endemizma dhe subendemizma. Gjithashtu, në territorin e bashkisë gjenden 21 Monumente Natyre dhe Gjeo-monumente, të cilët shtojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurisë natyrore në këtë zonë. Monumentet e Natyrës ndahen në 7 gjeo-monumente dhe 14 Monumente natyre. Në përgjithësi zonat e mbrojtura në territorin e Bashkisë kanë një gjëndje të mirë biologjike dhe estetike. Në tabelën më poshtë gjenden të listuara Zonat e Mbrojtura në territorin e Bashkisë Gramsh dhe karakteristikat kryesore të tyre.



Tabela 19 Zonat e mbrojtura në Bashkinë Gramsh

Emërtimi i ZM-së	Kategori a	Përshkrim i shkurtër	Rëndësia	Foto
<b>Kategoria II – Park Kombëtar</b>				
Mali i Tomorrit	II	Biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma	Shkencore, biologjike, ekologjike, ekonomik, kulturore, didaktike dhe turistike	
<b>Kategoria III – Monument Natyre dhe Gjeo - Monumente</b>				
Shpella e Kabashit	III	Lartësia mnd: 900 m Gjatësia: 120 m Mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Karsti i Tërvolit	III	Peizazh i mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Gurrët e Krushqëve	III	Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çudiçme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria gërryrese e erës	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	



Kanioni i Sinecit ose Saraselit	III	Gjatësia: 1,500m Thellësia: 300m Gjerësia: 20-30 m Shpate të thepisura dhe një ekosistem interesant krasti	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike	
Ahishtia e Rovjes	III	Lartësia mnd 1,400 m Sipërfaqja:50 ha Lartësia e drurëve: 15-35m Diametri i trungut: 50-70cm Moshë: 80 vjecar Gjendja: shumë e mirë	Biologjike, didaktike, estetike e turistike	
Dushkaja e Katër Lisave	III	Lartësia mnd: 850m Sipërfaqja: 1ha Lartësia: 15-18m Diametri i trungut: 30-40cm Perimetri i trungut: 120cm Moshë: 80 - 100 vjecar Gjendja: Dëmtim të pjesshëm të drurëve	Biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike	
Arra e Tunjës	III	-	-	
Tarraca e Ballores (Qytezës)	III	Gjatësi: 800m Gjerësi: 200m Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepisur, 15 m të lartë, ka mbetje arkeologjike, pra përbën një vendbanim prehistorik.	Gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Dushku i Bulçarit	III	Lartësia mnd: 1100 m Sipërfaqja: 2 ha Lartësia e Drurëve: 15 – 25 m Diametri: 15 – 35 cm	Shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike	

		Perimetri: 50 – 110 cm Moshë: 150 vjeçare Gjendja: E mirë		
Liqeni i Dushkut	III	Lartësia mnd: 1105 m Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m	Shkencore, didaktike, turistike.	
Rrobulli i Grabovës	III	Lartësia mnd: 1500 m Sipërfaqja: 8 ha Moshë 100 vjeçare Lartësia e pemëve: 25 – 30 m Diametri i Trungut: 25 – 35 cm Perimetri i trungut: 60 – 100 cm Gjendja: Shumë e mirë	biologjike, didaktike, estetiko- turistike dhe klimaterike	
Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit	III	formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit homonym, rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1,5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike	
Liqenet e Valamarës	III	Lartësia mnd: 2,200 m Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore	

Robulli i Valamarës	III	Lartësia mnd: 1,500 m Lartësia e drurëve: 30 m Diametri i trungjeve: >35cm Perimetri i tyre: 70 – 100 cm Moshë: 150 vjeçare	Shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike e turistike	
Liçeni i Zi – Lenie	III	Lartësia mnd: 1634 m Forma e liqenit është e përzgjatur, rreth 1000 – 1200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m	Shkencore (hidrogeologjike), didaktike, turistike e kurative	
Moçalet e Grabovës	III	Lartësia mnd: 1550 m Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1000 m,	Shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike	
Burimet e Kërpicës	III	Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flihit të luginës së Tomorricës	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Ujëvara e Sotirës	III	Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m	Shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike	
Kanioni i Holtës	III			
Ahishnja e Rovjes	III			

Gështenja dhe pisha në Teqenë e Skënderbegasit	III			
--	-----	--	--	--

Burimi: AKZM 2016; Përpunoi: Co-PLAN, 2017

○ **Park Kombëtar (kategoria II)**

Parku kombëtar përfaqëson territore të gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative.<sup>106</sup>

**Parku Kombëtar (PK) “Mali i Tomorrit (K. 2):** Në pjesën jugore të territorit të Bashkisë Gramsh ndodhet një pjesë prej 1606 ha PK Mali i Tomorrit. Parku Kombëtar mali i Tomorrit shtrihet në dy Qarqe të vendit, Elbasan dhe Berat, ka një sipërfaqe të përgjithshme rreth 24,723 ha<sup>107</sup>. Parku shquhet për biodiversitet të pasur me endemizma dhe subendemizma. Specie dominuese në floristike përmendim ahun, pishën e zezë, robullin dhe kullotat subalpine e alpine. Gjithashtu parku është një habitat i rëndësishëm për një gamë të gjerë të specieve faunistike, ndër të tjera përmendim gjitarët e mëdhënj ariu – *Ursus arctos*, ujku – *Canis lupus*, ndërsa shpendët përfaqësohen nga rrëmbenjësit e ditës dhe të natës, harabelat, etj.<sup>108</sup>

Krahas vlerave shkencore dhe ekonomisë natyrore, parku i Tomorrit ofron një gamë të gjerë vlerash peizazhi, çlodhëse dhe historiko-kulturore, të cilat mundësojnë zhvillimin e turizmit në natyrë dhe atij historiko-kulturor në këtë zonë. Në të gjenden habitatet pyjore (pyje të larta dhe të ulëta) me mbulesë bimore të larmishme si pasojë e ndryshimit të lartësisë, e dukshme në largësi të vogël, lagështi e përshtatshme në stinën e verës dhe dhera të pasura e prodhuese. Pyjet e larta mbizotërohen nga kombinimi i ahishtave dhe pishës. Në lartësinë 1,100-1,700m gjenden pyjet e ahut, të cilat rrallëherë përzihen me pyjet e pishës. Në lartësinë 1,500-1,800m mbi nivelin e detit gjendet rrobulli (*Pinus Heldreichii*), mjaft i rëndësishëm në ato pjesë ku thatësira është e lartë. Ndërsa mbi kuotën 1,800m mbi nivelin e detit takohen livadhe dhe kullota alpine. Pyjet e pastra të ahut (*Fagus sylvatica*) gjenden në lartësitë 1,100-1,400m mbi nivelin e detit. Në rajon gjenden edhe pemë të tjera gjetherënëse përveç panjës (*Acer sp.*). Në brezin 1,400-1,800m mbi nivelin e detit mbizotëron pisha e zezë (*Pinus nigra*) dhe rrobulli (*P. Hedldreichii*), në përzierje më dëllinjë (*Juniperus spp.*), si dhe zona të hapura kullotash. Mbi 1,800m hasen lëndinat dhe kullotat alpine.

Pyjet e ulëta vendosen kryesisht në pjesën lindore të parkut, pasi shpatet në këtë pjesë janë më të thata. Në lartësinë deri në 800m mbi nivelin e detit rriten shkurret me përzierje shkozë e zezë (*Carpinus orientalis*) dhe dëllinjë (*Juniperus spp.*) dhe nga 800-1,100m rritet lajthia (*Corylus sp.*), shkoza e zezë (*Carpinus orientalis*), arra e butë (*Juglans regia*), frashëri (*Fraxinus excelsior*) dhe panja (*Acer sp.*) me pak bungëbutë (*Quercus pubescens*) të shpërndarë. Në zonat me kushte shumë të thata bimësia është shumë e ulët, ku gjenden kryesisht kullotat e hapura dhe dëllinja e kuqe (*J. oxycedrus*).

Shkurret dhe pemët përfaqësohen nga *Pholmis sp.*, dhe në masë relativisht të ulët nga molla e egër (*Malus sylvestris*). Në këtë zonë kullotat ndikojnë intensivisht. Në pjesën e poshtme të shpateve, nën 500m, gjenden shkurreta mesdhetare, si: shqopa (*Erica arborea*), *Phillyrea media*, *P. angustifolia*, mareja (*Arbutus unedo*), xina (*Pistacia lentiscus*) dhe pak pemët e dushkut (*Quercus ilex*, dhe *Q. trojana*). Ndërsa niveli i florës barishtore në zonën e parkut përbëhet nga barëra të

ndryshme, shumë prej të cilave shquhen për vlerat e tyre kuruese. Për këtë arsye ato kanë gjetur përdorim të gjerë në popullsi. Në këtë zonë ndodhen edhe bimë barishtore si iriqëza gjetherrotullare (*Saxifraga rotundifolia*), luleshtrydhja (*Fragaria vesca*) dhe sherebela veshtullore (*Salvia glutinosa*). Çaji i malit (*Sideritis raeseri*), krahas përdorimit të tij në masë për vlerat kuruese që ai mbart, është një lloj endemik për zonën. Parku kombëtar i malit të Tomorrit strehon edhe një numër llojesh endemike dhe subendemike si: *Aubrieta intermedia*, *Astragalus austraci*, *Cupris baldacii* ose *Nepeta spursesi*.

*Fauna* në parkun kombëtar të malit të Tomorrit është shumë e rëndësishme, pasi përfshin edhe vertebrorët e mëdhenj. Habitatet e shumëllojshme brenda parkut shërbejnë si strehëza për faunën e kësaj zone. Disa lloje jovertebrorësh që jetojnë në Parkun e Tomorrit janë *coleopteran*, brisqari (*Cerambyx cerdo*) etj., të cilët kanë rëndësi të madhe në ruajtjen e ekulibrit biologjik të zonës. Edhe komunitetet e amfibëve janë një pjesë e rëndësishme e faunës në Parkun e Tomorrit. Ato përfaqësohen nga thithlopa barkverdhë, (*Bombina variegata*), thithlopa (*Biffo bufo*) dhe tritoni me kreshtë (*Triturus cristatus*). Për sa i përket zvarranikëve, ata përfaqësohen nga bolla laramane (*Elaphe situla*), bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata-CR*), breshka (*Testudo hermanni* dhe *Emys orbicularis*) etj. Në këtë zonë është e pranishme edhe një shumëllojshmëri shpendësh, përfshirë lloje të rralla apo të kërcënuara. Llojet rezidente janë bufi (*Bubo bubo*), shqipja e maleve (*Aquila chrysaetos*) dhe krahëthati (*Falco peregrinus*). Gjithashtu, pyjet strehojnë edhe gjelin e egër (*Tetrao urogallus*), qukapikun e zi (*Dryocopus martius*) dhe shqiponjën e vogël të rosave (*Aquila pomarina*). Lloje që riprodhohen në zonën e parkut janë gjeraqina e shkurtës (*Accipiter nisus - EN*), gjeraqina (*Accipiter gentilis*) (*Circaetus gallicus*) dhe huta grenxa ngrënëse (*Pernis apivorus*). Në masë relativisht të madhe gjendet thëllëza e malit (*Alectoris graeca*). Gjitarët e mëdhenj ose mishngrënësit e zakonshëm janë ariu i murrmë (*Ursus arctos*) dhe ujku (*Canis lupus*). Thundrakët, nga ana tjetër, përfaqësohen në numër të vogël nga derri i egër (*Sus scrofa*) dhe dhia e egër (*Rupicapra rupicapra balcanica*). Gjitarë të tjerë të shumtë në numër brenda parkut janë: dhelpra (*Vulpes vulpes*), kunadhja (*Martes foina*), baldosa (*Meles meles*), lepuri i egër (*Lepus europea*), ketri (*Sciurus vulgaris*), iriqi (*Erinaceus concolor*) dhe nuselalja (*Mustela nivalis*). Ndërsa lakuriqët e natës të cilët janë të pranishëm në territorin e parkut përfaqësohen nga *Rhinolophus hipposideros*, *Miniopterus schreibersi* dhe *Myotis capaccini*.

Parku kombëtar “Mali i Tomorrit” menaxhohet nga AKZM-ja. Parku ka një projektplan menaxhimi që është hartuar në vitin 2014 nga Ministria e Mjedisit.<sup>109</sup> Aktualisht nuk ka informacion nëse ky plan menaxhimi është miratuar. Sipas AKZM-së, parku kombëtar “Mali i Tomorrit” ka vëmendjen e vazhdueshme të autoriteteve lokale, AdZM-ve Elbasan dhe Berat, të cilat mbrojnë parkun dhe kontrollojnë veprimtaritë brenda tij. AdZM –ja Elbasan ka përcaktuar një punonjës për mbikqyrjen e pjesës së parkut brenda territorit të qarkut Elbasan, ndërsa AdZM-ja Berat ka aktivizuar 5 punonjës për mbikqyrjen e parkut kombëtar “Mali i Tomorrit” dhe 4 specialistë për monumentet e natyrës.<sup>110</sup>

#### ○ Monumente Natyre (Kategoria III)

Monument Natyre përfaqëson një formacion natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacion i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat të një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike.<sup>111</sup> Në territorin e Bashkisë Gramsh ndodhe 21 të tilla, të cilat do të trajtohen në vijim:

**Shpella e kabashit:**<sup>112</sup> Ndodhet në afërsi të fshatit Kabash, në lartësinë 900 m mbi nivelin e detit. E formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë të kretës së sipërme, është e gjatë rreth 120 m. Ende nuk është eksploruar. Pjesa e njohur formon një labirinth të vërtetë dhe është e mbushur me konkrecione të shumta stalaktite dhe stalagmite me bukuri të rrallë. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), kulturore, didaktike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin Gramsh ose Elbasan – Kabash.

**Karsti i Tërvolit:**<sup>113</sup> Ndodhet në malin e Tërvolit, i cili është i përbërë nga gëlqerorët e kretës së sipërme. Në kreshtën e tij të sheshtë është i zhvilluar fuqimisht procesi i karstit, i cili ka formuar një peizazh të mbushur me një mori formash karstike, që u ngjajnë hojeve të bletëve. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin – Gramsh – Tërvol – Monumenti.

**Gurrët e Krushqëve**<sup>114</sup>: Ndodhen në afërsi të fshatit Lisec të bashkisë të Gramshit. Përbëjnë grupe gurësh gëlqerorë me forma të çudiçme, të formuara nga procesi i karstit dhe veprimtaria gërryrese e erës. Legjenda i lidh ata me "ngrirjen e krushqëve, që kishin shkuar për të marrë nusen". Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin Gramsh – Lisec.

**Kanioni i Sinecit ose Saraselit**<sup>115</sup>: Ndodhet pranë fshatit të Saraselit të NJA-së së Sultit, bashkia Gramsh. Përfaqëson një kanion të madh të formuar në gëlqerorët e kretës së sipërme nga veprimtaria karstike dhe erozive e përroit të Seraselit. Është i gjatë rreth 1,5 km, i thellë rreth 300 m dhe i gjerë rreth 20-30 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin Gramsh - Sinec.

**Shkëmbi (kanioni) i Kopaçit**<sup>116</sup>: Ndodhet në afërsi të Grabovës së Sipërme dhe është i formuar në shkëmbinjtë gëlqerorë nga erozioni dhe karsti i ujrave të lumit homonim, degë e Devollit. Është rreth 500 m i thellë, i gjatë rreth 1,5 km dhe i gjerë rreth 10-15 m. Ka shpate të thepisura. Në të njëjtën kohë përbën edhe një ekosistem interesant karstik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin Gramsh – Lenie – Grabovë e Sipërme.

**Tarraca e Ballores (Qytezës)**<sup>117</sup>: Ndodhet në krahun e majtë të lumit të Devollit, në afërsi të fshatit të Ballores. Përfaqëson një fragment të nivelit të parë të tarracës lumore të formuar nga lumi i Devollit dhe lumi i Tomorricës, degë e tij. Është e gjatë rreth 800 m dhe e gjerë rreth 200 m. Ka shpinë të sheshtë dhe front të thepisur, 15 m të lartë. Në shpinën e saj ka mbetje arkeologjike, pra përbën një vendbanim prehistorik. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, arkeologjike), didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen duke ndjekur itinerarin Gramsh – Skënderbegas.

**Liqeni i Dushkut:**<sup>118</sup> Ndodhet në afërsi të fshatit Lenie, në rrëzën veriperëndomore të malit të Komianit, në lartësinë 1105 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një liqen akullnajor me gjatësi rreth 800 m dhe gjerësi rreth 400 m. Ka botë të pasur të gjallë, në të cilën dallohen sidomos zambakët e mëdhenj të ujit. Rrethohet nga një pyll i dendur pishash me sipërfaqe rreth 12 ha. Së bashku me pyllin rrethues formon një ekosistem tepër interesant liqenor e pyjor. Ka vlera shkencore

(gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike e biologjike), didaktike, kulturore, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Kodovjat – liqeni i Dushkut.

**Liqenet e Valamarës:**<sup>119</sup> Ndodhen në malin e Valamarës, të vendosura në një cirk të madh kompleks akullnajor, në lartësinë rreth 2200 m mbi nivelin e detit, prane fshatit Lenie të rrethit të Gramshit. Përbëjnë një grup prej tre liqenesh akullnajore, me gjatësi dhe gjerësi mesatare 300 m e 200 m, të veçuara nga njeri tjetri prej depozitimesh morenike. Liqeni më i madh ka përmasa mesatare 600 m gjatësi dhe 200 m gjerësi. Kanë ujë të pastër si kristali dhe të ftohtë. Gjatë dimrit ngrijnë në sipërfaqe. Janë të pasura me një botë të gjallë dhe formojnë një ekosistem interesant të liqeneve alpinë. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe kulturore. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Lenie dhe prej këtej vazhdohet rruga kembesore drejt qafes së Mushkes për shpatin lindor të malit të Valamarës.

**Liqeni i Zi – Lenie:**<sup>120</sup> Gjendet në lartësinë 1634 m, në afërsi të fshatit Lenie, NJA-ja me të njëjtin emër të bashkisë së Gramshit. Përfaqëson një liqen me origjinë akullnajore. Në të ka faunë dhe përreth ka bimësi drurore të ahut, rrobullit dhe asaj barishtore në livadhe. Forma e liqenit është e përzgatur, rreth 1000 – 1200 m, e gjerë rreth 200 – 300 m. Drurët e pyllit kanë lartësi 25 – 30 m, trashësi të trungut 20 – 35 cm e perimetër të tij 60 – 100 cm. Janë drurë me moshë shekullore. Ujërat e liqenit përdoren edhe për kurim sëmundjesh si reumatizma, por ende nuk ka studime të këtij lloji. Monumenti ka vlera shkencore (hidrologjike), didaktike, turistike e kurative. Vizitohet duke ndjekur itinerarin: Gramsh – fshati Lenie – Biaj, e më pas në Liqenin e Zi.

**Moçalet e Grabovës:**<sup>121</sup> Gjendet në shpatin e malit të Valamarës, në lartësinë 1550 m mbi nivelin e detit. Nga ana administrative i përket fshatit Grabovë e Sipërme, NJA Lenie e bashkisë të Gramshit. Njihet edhe me emrat Moçalet, Gropa e Kryqit dhe Prishtakoll. Përfaqëson grupe drurësh të rrobullit. Ka formën e një shumëkëndëshi të çrregullt, me gjatësi 800 – 1000 m, gjerësi 400 – 450 m e sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungut 25 – 35 cm, perimetri trungjeve 80 – 100 cm, ndërsa mosha është 150 vjeçare. Pylli është përreth një livadhi, ku derdhen mjaft burime nga ana lindore e tij. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike. Gjëndja e tij është e mirë. Vizitohet sipas itinerarit Gramsh – Kodovjat – Grabovë e Sipërme – Moçalet.

**Burimet e Kërpicës:**<sup>122</sup> Ndodhet në afërsi të fshatit Kërpicë të bashkisë Gramsh. Janë burime karstike që dalin në kontaktin midis gëlqerorëve të kretës së sipërme dhe flishit të luginës së Tomoricës. Dallohen për regjim të rregullt të prurjes, ujin e pastër dhe të ftohtë. Krijojnë një pamje me bukuri mahnitëse. Kanë vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Kërpicë – monumenti.

**Ujëvara e Sotirës:**<sup>123</sup> Ndodhet në shpatin lindor të malit të Tomorrit, në afërsi të fshatit të Sotirës. Uji del nga një e çarë e madhe gjatësore në shkëmbin e thepisur gëlqeror, duke formuar kështu një burim të madh karstik dhe krijon ujëvarën e famshme me lartësi 10 m dhe të shtrirë në një gjerësi prej rreth 3 m. Zhurma e ujit dëgjohet në një distancë mjaft të madhe. Krijon një pamje me bukuri mahnitëse. Ka vlera shkencore (gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrologjike, biologjike), estetike, didaktike, ekologjike dhe turistike. Vizitohen sipas itinerarit Gramsh – Sotirë – Monumenti.

**Robulli i Valamarës**<sup>124</sup>: Gjëndet në malin e Valamarës, 1500 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 10 ha. Lartësia e drurëve është rreth 30 m, diametri i trungjeve është mbi 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 70 – 100 cm. Mosha e tyre është 150 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike e turistike. Për ta vizituar duhet ndjekur itinerari: fshati Grabovë e Sipërme – përroi i Sharrës – Valamarë.

**Rrobulli i Grabovës**<sup>125</sup> Gjëndet në afërsi të malit të Valamarës, ndaj nga banorët njihet edhe me emrin Valamara e Vogël. I përket fshatit Grabovë e Sipërme, NjA Lenie e Bashkisë Gramsh. Përfaqëson një sipërfaqe pyjore prej 8 ha. Pylli i rrobullit ka formë drejtkëndëshe me gjatësi 400 – 500 m, e gjerësi 150 – 200. Lartësia mbi nivelin e detit është 1500 m. Lartësia e drurëve është 25 – 30 m, diametri i trungjeve është 25 – 35 cm, ndërsa perimetri i tyre është 60 – 100 cm. Mosha e tyre është 100 vjeçare. Gjëndja e tyre është shumë e mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, ekonomike e turistike. Për ta vizituar duhet ndjekur itinerari: fshati Grabovë e Sipërme – përroi i Sharrës – Vërtoq.

**Dushku i Bulçarit**<sup>126</sup> Ndodhet në fshatin Sojnik, NjA Kukër e Bashkisë Gramsh, në lartësinë 1100 mbi nivelin e detit. Përfaqëson një grupë drurësh dushku. Ka formë të përzgatur me gjatësi 2000 – 3000 m, gjerësi 200 – 300 m. Drurët përfaqësohen nga pisha e zezë dhe dushk, përreth liqenit të Dushkut rreth 12 ha. Në afërsi të liqenit ka livadhe me bimësi barishtore, bimësi ujore e gjallesa të tjera. Lartësia e drurëve është 15 – 25 m, diametri trungjeve është 15 – 35 cm, perimetri tyre është 50 – 110 cm. Mosha e drurëve të pishës është 150 vjeçare. Janë të ruajtur mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike, ekonomike e turistike. Vizitohet sipas itinerarit: Gramsh – Kodovjat – Bulçar – liqeni i Dushkut.

**Dushkaja e Katër Lisave**<sup>127</sup> Gjëndet në fshatin Katërlis, NjA Tunjë të Bashkisë Gramsh, në lartësinë 850 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll dushku, me sipërfaqe rreth 1 ha. Grupi i drurëve ka formë drejtkëndëshi me gjatësi 200 – 250 m e gjerësi 40 – 50 cm. Lartësia e drurëve është 15 – 18 m, diametri i trungjeve është 30 – 40 cm, ndërsa perimetri i tyre arrin deri 120 cm. Mosha e drurëve është 80 – 100 vjeçare. Pas vitit 1990 ka patur dëmtim të pjesshëm të drurëve. Është në pronësi shtetërore. Kanë vlera shkencore (biologjike), estetike e turistike. Vizitohen sipas itinerarit; Gramsh – fshati Tunjë – mali Katërlisës.

**Ahishtia e Rovjes**<sup>128</sup> Gjëndet në afërsi të fshatit Kukër (Rovë) të NjA-së me të njëjtin emër të Bashkisë Gramsh, 1400 m mbi nivelin e detit. Përfaqëson një pyll ahu. Pylli ka formën e një amfiteatri në shpatin malor me sipërfaqe rreth 50 ha. Lartësia e drurëve është 15 – 35 m, diametri i trungut është 50 – 70 cm, perimetri trungjeve është 100 – 200 cm, ndërsa mosha e tyre është 80 vjeçare. Ende ruhet në gjëndje të mirë. Ka vlera shkencore (biologjike), didaktike, estetike e turistike. Vizitohet sipas itinerarit: Gramsh – fshati Kukër – Rovje.

- Problematikat kryesore të ZM-ve Gramsh

AKZM-ja dhe AdZM-ja janë duke bërë përpjekje serioze në drejtim të manaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në Bashkinë e Gramsh. Megjithatë, problematikat mbeten ende të shumta, ndër të cilat përmendim:

*Rreziku i përhapjes së zjarreve është i pranishëm pothuajse gjatë gjithë sezonit të nxehtë, kryesisht në zonën e Malit të Tomorrit, apo dhe në zona të largëta, të cilat paraqesin vështirësi për t'u*



kontrolluar.<sup>129</sup> Kryesisht, zjarret kanë qenë të qëllimshme nga praktika të gabuara që përdoren për hapjen e kullotave dhe tokave bujqësore.

*Gjuetia e paligjshme* është një problem aktual në territorin e bashkisë dhe në afërsi të PK Mali i Tomorrit dhe në zona të tjera të thella që është vështirë të kontrollohen. Gjuetia ndikon direkt në uljen e numrit të shpendëve e kafshëve dhe shqetësimin e tyre.

*Manaxhimi joefektiv i aktiviteteve* turistike që kryhen në të gjitha zonat e mbrojtura, edhe pse në nivele të ulëta, lënë pas mbetje të ngurta, të cilat shpërndahen, theksi duhet vendosur tek Ujëvara e Sotirës dhe tek Kanioni i Holtës, aty ku fluksi i vizitorëve është më i madh.

*Ndërtimi i HEC-eve*, të cilët shfrytëzojnë ujin, duke e devijuar atë, ka sjellë probleme të shumta në habitatet e zonave të mbrojtura. Disa zona janë prekur nga ndërtimi i HEC-eve të vegjël, duke sjellë reduktime të ndjeshme në sasinë e ujit që rrjedh në gjëndje të lirë dhe furnizon ekosistemet natyrore në këto zona. Shembull konkret i devijimit të ujit nga HEC-et është ai i Tervolit, në hyrje të Kanionit të Holtës

*Kullotja* është prezente pothuaj në të gjithë Zonat e Mbrojtura të Bashkisë Gramsh. Ende nuk ka një studim se sa është kapaciteti i lejuar i këtyre zonave, kështuqë është një problem i pastudiuar dhe i pazgjidhur.

*Erozioni* është një fenomen i pranishëm në zonat kodrinore malore, kryesisht erozioni i shpateve të zhveshura, apo në brigjet e përrenjve apo lumenjve, që kalojnë në zonat e mbrojtura.

Ndikimi që kanë patur, si prishja e rregjimit të ujërave në lumenj, gjithashtu edhe shpyllëzimet intensive, kanë rezultuar në një rritje të ndjeshme të aktivitetit eroziv kudo në Shqipëri, dhe ende nuk ka një adresim të saktë të këtij problemi ndaj edhe zgjidhja e këtij fenomeni mbetet të realizohet në një të ardhme ndoshta të largët.

- Përfundime dhe rekomandime

Bashkia Gramsh është e pasur me rezervate natyrore dhe monumente natyre të shumëllojshme, të cilat përbëjnë një pasuri të konsiderueshme për zhvillimin e turizmit në Bashki. Për më tepër, në Bashki gjenden edhe ujëra termale apo me veti kuruese (ujrat termal në hyrje të kanionit të Holtës dhe Ujrat me veti kuruese të Liqenit të Zi), të cilat nëse ruhen dhe mirëmbahen, mund të shndërrohen në motorrin kryesor të zhvillimit ekonomik të zonave përreth. Megjithatë, këto zona kanë pësuar dëmtime të ndryshme në vitet e shkuara, si prerje abuzive të pyjeve në territorin e tyre, zjarre, ndërtime të ndryshme, mbikullotja dhe fenomene të tjera natyrore si erozioni dhe shembjet e ndryshme të dherave.

Duke patur parasysh që zonat e mbrojtura janë të rëndësishme, jo vetëm sepse shërbejnë si habitate të një biodiversiteti të larmishëm, por edhe sepse mund të favorizojnë zhvillimin e ekonomisë në Bashki nëpërmjet turizmit, rekomandohet që organet kompetente në Bashki të tregojnë një kujdes të veçantë, përpara se ato të humbin vlerat biologjike dhe peizazhstike që mbartin. Më konkretisht, rekomandohet bashkëpunimi i Bashkisë Gramsh me AdZM-në Elbasan për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave të mbrojtura nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të planeve të manaxhimit për çdo zonë të mbrojtur dhe monument natyre, hartimin e planit të emergjencave për zjarre dhe rreziqe të tjera si dhe bashkëpunimin me universitetet të ndryshme me qëllim promovimin e vlerave shkencore, biologjike, faunistike dhe floristike të zonave të mbrojtura dhe

zhvillimin e eko-turizmit dhe aktiviteteve të tjera, që mundësojnë mbledhjen e të ardhurave financiare për manaxhimin e tyre.

Zonat e mbrojtura përfaqësojnë territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat manaxhohen në rrugë ligjore dhe nëpërmjet metodave shkencore bashkëkohore<sup>130</sup>.

Zonat e mbrojtura natyrore dhe turistike në vendin tonë janë konsideruar si pjesë tokësore dhe ujore të mbrojtura për shkak të shumëllojshmërisë biologjike të pasurive natyrore dhe kulturore që ofrojnë. Këto zona mbrohen me ligj<sup>131</sup> dhe zënë rreth 16%<sup>132</sup> të territorit të vendit.

Një territor i caktuar duhet të plotësojë të paktën një nga këto kriteret:<sup>133</sup> i) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve, ii) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve, iii) të ketë përfaqësueshmëri, iv) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit, v) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet, vi) të ketë vlera shkencore; vii) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme, viii) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike, ix) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore, dhe x) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Në vendin tonë, zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë përshkruar shkurtimisht në tabelën e mëposhtme.

Tabela 20 Kategoritë e zonave të mbrojtura sipas karakteristikave

Kategoria	Emërtimi	Karakteristikat
Kategoria I	Rezervë strikte natyrore/rezervat shkencor	Territore jo më të vogla se 50 ha, me vlera natyrore të veçanta, të formuara nga ekosisteme natyrore ose lehtësisht të ndryshueshme, që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi kombëtare dhe rajonale, shpallen rezervë strikte natyrore.
Kategoria II	Park kombëtar	Territoret e gjera, zakonisht jo më të vogla se 1000 ha, unike për nga vlerat kombëtare dhe ndërkombëtare, një pjesë e madhe e të cilave janë ekosisteme natyrore, të ndikuara pak nga veprimtaria e njeriut, ku bimët, kafshët dhe mjedisi natyror, fizik janë të një rëndësie të veçantë shkencore dhe edukative, shpallen park kombëtar.
Kategoria III	Monument natyror	Monumenti Natyror përfaqëson një formacioni natyror (përfshirë edhe dru të veçantë), me sipërfaqe deri 50 ha, formacioni i veçantë gjeologjik dhe gjeomorfologjik, një depozitë minerale ose një habitat i një lloji të rrallë e të kërcënuar ose me rëndësi e vlerë të veçantë shkencore dhe estetike, shpallet monument natyror <sup>134</sup> .
Kategoria IV	Rezervat natyror i manaxhuar/Park Natyror	Territoret që përfaqësojnë bioqendra dhe biokorridore me rëndësi rajonale e vendore ose zonat me bimë, kafshë, minerale e gjetje paleontologjike, veçanërisht të mbrojtura ose zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore shpallen rezervat natyror i manaxhuar (zonë e manaxhimit të habitateve dhe llojeve).
Kategoria V	Rezervat natyror i manaxhuar/Peizazh i mbrojtur	Territoret më të mëdha se 1000 ha, me peizazh harmonik e të formuar mirë, me relief të zhvilluar karakteristik, me larmi ekosistemesh, detare ose tokësore, me monumente historike, shpallen peizazh i mbrojtur.

Kategoria VI	Zonë e mbrojtur e burimeve të manaxhuara /zonë e mbrojtur me përdorim të shumëfishtë	Zonat që përfshijnë territore të gjëra e relativisht, të izoluar dhe të pabanuara, ku hyhet me vështirësi ose rajone që janë ende pak të populluara dhe që mund të jenë nën presion të vazhdueshëm për t'u populluar dhe përdorur më gjerësisht dhe kthimi i tyre për përdorim intensiv është i paqartë ose i papërshtatshëm, shpallen zona të mbrojtura të burimeve të menaxhuara.
--------------	--	---

Burimi: Ligji Nr .81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”

#### 6.6.4 Biodiversiteti

Sipas Ligjit nr. 9587/2006 “Për Mbrojtjen e Biodiversitetit i ndryshuar”, me biodiversitet ose larmi biologjike nënkuptojmë shumëllojshmërinë e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë<sup>135</sup>. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.

Shqipëria është një vend i vogël. Megjithatë, ajo dallohet për larmi të peizazheve dhe larmi biologjike<sup>136</sup>, duke u radhitur në vendet e Europës që shquhen për biodiversitet të lartë. Pjesa e Ultësirës Perëndimore është më e rëndësishme nga pikëpamja e biodiversitetit dhe larmishmërisë së tij, e cila shtrihet përgjatë zonës bregdetare nga qyteti i Vlorës në jug e deri tek liqeni i Shkodrës në veri. Përveç faktit që kjo është një zonë bregdetare, Ultësira përshkohet nga lumenjtë kryesorë të vendit, të cilët rrjedhin nga lindja në perëndim. Vija bregdetare arrin gjatësinë 476km.<sup>137</sup> Zona veriore e vendit ka një relief malor, i cili karakterizohet nga diversitet i formacioneve shkëmborë që nga koha e Paleozoikut. Klima në Shqipëri përbëhet nga katër zona klimatike dhe 13 nënzona, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti në biodiversitetin e pasur që ka vendi.<sup>138</sup>

Shqipëria ka një shumëllojshmëri të ekosistemeve dhe habitateve. Në territorin e vendit gjenden ekosistemet detare, zonat bregdetare, lumenjtë, liqenet, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje halore dhe fletore, kullota alpine dhe subalpine, si dhe ekosistemet e larta malore. Larmia e ekosistemeve dhe habitateve në Shqipëri mundëson një larmi të lartë të llojeve të kafshëve dhe të bimëve që rriten në to. Në Shqipëri gjenden rreth **7,233 taksonë bimore**<sup>139</sup> (bashkë me fiernat, likenet, kërpudhat, myshqet dhe algat) dhe **5,438 lloje kafshësh**<sup>140</sup> (përfshirë shpendë gjitarët, zvarranikët, insektet, peshqit etj.). Bimët me lule dhe algat mikroskopike janë grupi përfaqësues më i larmishëm dhe i pasur i llojeve të rradha, relike dhe endemike. Kjo për shkak të elementeve floristike të rajoneve.

Pyjet zënë rreth 33% të territorit, ose 1,041,000 ha, ndërsa *kullotat* zënë rreth 15% të sipërfaqes së territorit (400,000 ha). Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve dhe komuniteteve shtazore dhe atyre bimore.<sup>141</sup> Pyjet e larta strehojnë kryesisht gjitarët e mëdhenj si ujku, rrëqebulli, ariu, dhia e egër, si dhe shpendë të ndryshëm të cilët janë të lidhur me jetesën në pyjet e virgjëra. *Liqenet* e mëdha të vendit dhe lagunat bregdetare janë vendbanimet më të rëndësishme për shpendët, veçanërisht për dimërimin e atyre migratore. Në këto hapësira, prej vitesh numërohen rreth 70 lloje shpendësh uji, të cilët përbëjnë një popullsi që arrin deri në 180,000 individë gjatë dimrit.<sup>142</sup> Shqipëria është edhe një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për shpendët migratore dhe insektet.<sup>143</sup>

- Speciet e rrezikuara në Shqipëri


Në territorin e vendit gjenden rreth 91 lloje të kërcënuara specielisht në nivel global. Në këtë listë përfshihen Pelikani kaçurrel (*Crispus crispus*), Breshka Shqiptare e Ujit (*Pelophylax shqipericus*) dhe Blini (*Acipenser sturio*), për të cilat Shqipëria është një vend i rëndësishëm.<sup>144</sup> Sipas IUCN-it,<sup>145</sup> 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Lista e llojeve të bimëve të kërcënuara në vendin tonë e kalon atë të kafshëve, duke arritur shifrën 319 nga të cilat 76 janë të kërcënuara në formë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik, dhe 120 lloje të përkeqësuar.

Tabela 21 Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në Shqipëri

Kategoritë IUCN	Numri i llojeve të florës	Numri i llojeve të shpendëve
EX – Të zhdukura	0	5
CR – Të rrezikuara në mënyrë kritike	76	43
EN – Të rrezikuara	123	56
VU – Të pambrojtura	120	154
LR – Rrezik i ulët	59	238
DD – Mungojnë të dhëna	30	72
NE – Të pavlerësuar	3	7

Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016<sup>146</sup>; Përgatitip: Co-PLAN, 2016

Figura 34 Numri i llojeve të florës dhe shpendëve të rrezikuar në shkallë vendi



Burimi: Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit, 2016<sup>147</sup>; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

Lista e Kuqe e faunës dhe florës së egër është miratuar në dhjetor 2013, me Urdhër të Ministrit Nr. 1280, datë 20.11.2013. Llojet e mbrojtura të florës janë 402 nga 361 që ishin në Listën e Kuqe paraprake të vitit 2007. Llojet e mbrojtura të faunës janë 575, i njëjti numër me listën e vitit 2007.

- Biodiversiteti në Bashkinë Gramsh

Bashkia Gramsh bën pjesë në zonën klimatike mesdhetare kodrinore, nënzona jug-perëndimore që shtrihet deri në 800-1000 metra mbi nivelin e detit dhe në atë mesdhetare malore, nënzona juglindore, pjesa që arrinë lartësinë 2,373 metra mbi nivelin e detit. Territori i Bashkisë është i larmishëm, me terren fushor, kodrinor e malor dhe me lumenj e përrenj të shumtë. Gramshi përshkohet nga rrjedha e lumit Devoll dhe degët e tij. Larmia e formave të relievit dhe shtrirja gjeografike e kësaj nënzona ndikojnë në regjimin e elementëve klimatike dhe në biodiversitetin e pasur të zonës.

Bashkia Gramsh ka një sipërfaqë natyrore rreth 5,909.6 ha. Në bashki gjenden edhe shumë monumente natyrore (20 Monumente Natyre ku 11 Gjeo Monument dhe 9 Bio Monumente), si dhe zona të mbrojtura si Parku Kombëtar i Tomorrit (zonat e mbrojtura janë trajtuar në një seksion më vete). Në territorin e Gramshit dhe rrethinat, haset një numër i konsiderueshëm i llojeve të kafshëve dhe shpendëve, kryesisht gjitarët e medhenj dhe familja e rosave dhe thëllëza edhe pse numri total i specieve floristike dhe faunistike në bashki nuk njihet. Gjithashtu, territori i bashkisë shquhet për pasuri floristike, kryesisht në drurë të lartë, shkurre dhe bimë të kultivuara. Në brendësi të territorit hasen një sërë llojesh, duke filluar nga shkurret shqopa, shkoza, dhe deri tek dushqet, ahishtat, dhe kullotat alpine.

Numri i specieve floristike dhe faunistike, që gjenden në Bashki dhe habitatet e tyre, nuk njihet mirë. Megjithatë, njihet numri i specieve të rrezikuara (Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqiptare, 2007) i cili shkon në 100 specie (rreth 15% e specieve të rrezikuara në vend). Këto i përkasin kryesisht specieve të florës, insekteve dhe shpendëve.

Tabela 22 Flora dhe Fauna e rrezikuar në Shqipëri dhe në Bashkinë Gramsh

Flora dhe Fauna e Rrezikuar në Shqipëri dhe Bashkinë Gramsh <sup>148</sup>				
Kategoritë Taksonomike	Nr. Total i Specieve në vend	Nr. Specieve të rrezikuara në vend	Nr. Specieve të Rrezikuara në B. Gramsh	% Specieve të Rrezikuara në B. Gramsh
Kërpudha	800	16	2	12
Bimësi	3,228	363	42	11
Insekte	680	108	15	14
Zvarranikë	37	37	4	11
Shpendë	330	120	31	29
Gjitarë	91	46	6	13
<b>Totali</b>	<b>5,166</b>	<b>690</b>	<b>100</b>	<b>14.5</b>

Burimi: Libri i Kuq i Florës dhe Faunës Shqipëtare; Përgatiti: Co-PLAN, 2016

○ Fauna në Bashkinë Gramsh

Territori i Bashkisë Gramsh karakterizohet nga një faunë e pasur ujore dhe kafshë e shpendë të ndryshme. Ndër vite, në territorin e bashkisë është ushtruar presion i vazhdueshëm mbi faunën, kryesisht në formën e gjetisë së pa kontrolluar dhe dëmtimit të habitatit nga aktivitetet e ndryshme njerëzore, si rrjedhojë është ulur ndjeshëm numri i specieve faunistike dhe disa prej tyre rezultojnë të rrezikuara.

Nuk ka një numër të saktë mbi speciet që mund të gjenden në territorin e Bashkisë Gramsh. Nga të dhëna të siguruara nga studime pjesore, vëzhgime në terren, diskutime me banorët e zonës dhe specialistët pranë zyrave të Bashkisë mund të thuhet se në brendësi të territorit ka një numër të lartë specimesh faunistike.

Në territorin e Gramshit janë të pranishëm rreth 23 lloje gjitarësh të vegjël dhe lakuriqë nate, 11 lloje mishngrënësish, ndër të cilët përmendet Ariu i murrmë, Ujku, Çakalli, Macia e egër, Baldosa, etj. Rreth 63 lloje shpendësh strehohen kryesisht në zonat pyjore dhe shkurreta, 48 lloje

të tjerë ndodhen në habitatin që ofrojnë kullotat alpine dhe zonat e hapura. Në sipërfaqet shkëmbore strehohen rreth 14 lloje shpendësh kryesisht rrëmbenjës, ndërsa pranë zonave të banuara vërehet prania e 7 lloje shpendësh. Disa nga shpendët tipikë të cilët gjenden në zonë janë: Thëllëza e malit, Thëllëza e fushës, Shkurta, Shapka, Turtulli, Lauresha, Mëllenja, Cërloi, Harabeli i shtëpisë, etj.<sup>149</sup>

Në rrjedhat ujore në territorin e bashkisë janë identifikuar 10 lloje peshqish<sup>150</sup> dhe një lloj ngjale e cila nuk është hasur më pas ndërtimit të digës së hidrocentralit të Bënjës. Gjithashtu përgjatë gjithë Lumit Devoll dhe degëve kryesore të tij është e pranishme Lundërza, ndërsa gjëndja e makrozoobentik (kryesisht larva insektesh ujore) ndryshon në të cilësisë së ujit të lumit.<sup>151</sup>

Zonat ripariane të lumit Devoll (kryesisht ato të pa dëmtuara) strehojnë rreth 24 llojë insektesh, 6 prej të cilëve janë më status mbrojtës, specie të rrezikuara cilësohen *Flutura e hershme*, *Fshikendësja filodesmë*, *Antenagjati cerdo*, *Osmoderme eremitë* dhe *Rosalia*.

Gjithashtu, territori i Gramshit strehon një numër të konsiderueshmë reptilësh, dy prej të cilëve janë të rrezikuara sipas Librit të Kuq të Faunës Shqiptare, këto specie janë Bullari (*Ophisarurus apodus*) dhe Bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*).

Nga takimet e shpeshta me banorë të zonës dhe specialistë pranë Bashkisë theksohet që fauna ka pësuar ulje të numrit të specieve në territorin e bashkisë, pasi disa lloje nuk janë vëzhguar prej disa vitesh, ndër të tjera përmbenden Rriqebulli (*Linx linx*) dhe Ujku i bardhë, ky i fundit mendohet se është parë një individ kohet e fundit në NJA-në Tunjë, pranë zonës së quajtur “Varri i Djalit”

Shkaqet kryesore, që rrezikojnë zhdukjen e specieve të faunës në territorin e Bashkisë Gramsh, janë tregëtimi i specieve të ndryshme, koleksionimi i disa lloje speciesh, kryesisht fluturave, prishja e habitatit, ndotja e habitatit, zhvillimi i bujqësisë dhe përdorimi i plehrave dhe kimikateve në masë të madhe, zhvillimi i turizmit, shqetësimi i habitatit, zgjerimi i zonave urbane, gjuetia e paligjshme, pakësimi i ushqimit, shqetësimi i vendit të folezimit, trafikimi i specieve të rralla, fragmentimi i habitateve, degradimi i pyjeve etj. Në vijim, shkaqet do të trajtohen më gjerësisht duke i analizuar specifikisht.

#### o Flora në Bashkinë Gramsh

Territori i Bashkisë Gramsh dhe zonat përreth shquhen për larmishmëri floristike. Territori i bashkisë shquhet për pasuri të shumta natyrore, ku përfshihen trupat ujqorë, kodrat dhe malet e larta, shkurretat mesdhetare, pyjet gjethe gjerë dhe halorë, kullotat dhe shumë bimë të tjera barishtore. Në zonën e Gramshit numërohen rreth 9 monumente natyrore dhe një pjesë e parkut Kombëtar të Tomorrit, këto elementë përforcojnë edhe më tepër rëndësinë e pasurive natyrore në territorin e bashkisë. Në brendësi të territorit të bashkisë (sipas Librit të Kuq të Florës Shqiptare) gjenden rreth 44 specie të rrezikuara, kryesisht bime barishtore dhe me pak shkurre dhe pemë. Ndër të tjera specie të rrezikuara përmendim Tisi (*Taxus bacata*), Zonja e bukur (*Atropa bella-donna*), Lot zoje (*Convallaria majalis*), Lulebasani (*Hypericum perforatum*), Arra (*Juglans regia*), Dëllënja e zezë (*Juniperus communis*), Ilqe (*Quercus ilex*), etj. Ndarja e bimësisë dhe gjëndja e florës në territorin e bashkisë do të analizohet sipas NJA-ve në vijim:

**NJA Pishaj:** Bimësia përfaqësohet nga rreth 882 ha trungishte dhe 531 ha shkurre. Sipërfaqja e trungishtave përbëhet nga 481 ha pishë e egër dhe pishë deti, 8 ha akacie, 420 ha ahishte, shpardh dhe panjë, 1 ha arrë dhe rreth 34 ha qarri dhe shkozë. Ndërsa shkurretet përfaqësohen nga shkoza,

dëllënja, mareja, ilqe, qarr, frash dhe dell<sup>152</sup>. Gjithashtu në zonë janë të pranishme një sërë bimësh barishtore dhe bimë të kultivuara, të cilat pasurojnë edhe më tepër diversitetin floristik të zonës. Gjëndja e pyjeve dhe shkurreve në këtë zonë paraqitet në gjëndje relativisht të mirë, duke theksuar që vitet e fundit sipërfaqet kanë njohur zvogëlimë të konsiderueshme.

**NjA Poroçan:** Krahas të tjerave, në zonën e Poroçanit ndodhen rreth 1078 ha trungishte dhe 872 ha shkurre. Trungishtet përbëhen nga rreth 334 ha pyllë ahu, 43 ha gështenjë, 13 ha pylla akacie, 551 Qarr dhe 136 ha pyllë më pisha . Ndërsa shkurret përfaqësohen nga Dëllënja, Shkoza, Lisi, Frashëri dhe Murrizi<sup>153</sup>. Krahas specieve të përmendura, në Poroçan ka një numër të lartë të bimëve barishtore dhe atyre të kultivuara, të cilat shtojnë larmishmërinë floristike të zonës. Problematike në këtë zonë mbetet dëmtimi i pyjeve dhe bimëve si pasojë e prerjeve dhe kullotjes.

**NjA Kukur:** Speciet floristike lehtësisht të identifikueshme në zonën e Kukurit, shkurret dhe trungishtet, ku përkatësisht formojnë një sipërfaqe prej 2113 ha shkurre dhe rreth 857 ha cungishte dhe trungishte<sup>154</sup>. Shkurret përfaqësohen nga Shkoza, ndërsa cungishtet dhe trungishtet nga Pisha e egër, Pisha e zezë, Ahu dhe Akacia. Në këtë zonë gjenden dhe shumë bimë të tjera barishtore dhe të kultivuara, të cilat kanë një kontribut të rëndësishëm në diversitetin floristik të zonës. Ndër problematikat kryesore në këtë zonë paraqitet mbikullotja dhe prerja e pyjeve.

**NjA Skënderbegas:** Në zonën e Skënderbegasit dallohen lehtë speciet floristike, kryesisht të shkurreve dhe drurëve, pa lënë mbas dhe speciet barishtore dhe të kultivuara. Në Skënderbegas ndër të tjera gjendet 1591 ha trungisht dhe 1310 shkurre. Trungishtet përfaqësohen nga Pisha e zezë e cila shtrihet në një sipërfaqe prej 1339 ha, ndërsa shkurretat përfaqësohen nga makja, shkoza dhe lajthia<sup>155</sup>. Në këtë zonë ka një numër të lartë specimesh barishtore dhe të kultivuara, të cilat pasurojnë më tepër diversitetin floristik të zonës.

**NjA Lenie:** Në zonën e Lenies ka një sipërfaqe të konsiderueshme natyrore, e cila dominohet nga pyje dhe shkurre e ndjekur nga bimësi barishtore dhe ajo e kultivuar. Ndër speciet më tipike të zonës veçojmë pishën e egër dhe atë të zezë, Lisin, Dëllënjën, Shkozën, Frashërin, Mareja, Shkoza, etj<sup>156</sup>. Në këtë zonë ka një tendecë të dëmtimit të sipërfaqeve pyjore dhe dëmtimin e pyjeve dhe shkurretave e cila vjen nga prerjet abuzive dhe mbikullotja.

**NjA Kushovë:** Në zonën e Kushovës gjenden sipërfaqe të konsiderueshme më pyje, shkurre dhe bimë barishtore. Trungishtet zënë 671 hektarën, ndërsa shkurret 2830 ha<sup>157</sup>. Trungishtet përfaqësohen nga pisha e zezë dhe shpardi, ndërsa shkurret nga makie dhe shkozë. Problemet kryesore në këtë zonë shkaktohen nga prerja e jashtëligjshme e pyjeve dhe mbi kullotja.

**NjA Tunjë:** Në Tunjë ka larmishmëri të lartë të specieve floristike, ku haset një numër i madh i specieve pyjore, shkurre dhe barishtore e ato të kultivuara. Në territorin administrativ të Tunjës ndodhet 402 ha trungishte e cungishte dhe 2318 ha shkurre<sup>158</sup>. Shkurret në Tunjë përfaqësohen nga Shkoza, Marea, Dëllënja dhe Cermedelli, ndërsa pyjet përfaqësohen nga pisha e egër, lisi, akacia dhe Arra. Kohët e fundit ka një dëmtim të ndjeshëm të sipërfaqeve pyjore dhe bimeve të tjera, kjo si pasojë e mbi shfrytëzimit dhe mbi kullotjes.

**NjA Sult:** Sulti ka një sipërfaqe të konsiderueshme natyrore, ku pjesa dominuese është e mbuluar nga pyje dhe shkurre. Trungishtet dhe cungishtet zënë rreth 555 ha, të përfaqësuara nga pisha e Egër, Lisi dhe Akacia. Shkurrët zënë rreth 2984 ha, të cilat përfaqësohen nga Mare, Mrete, Dëllënja

dhe Shkoza<sup>159</sup>. Në këtë zonë ka edhe shumë specie barishtore dhe të kultivuara të cilat kanë kontribut të rëndësishëm në rritjen e diversitetit floristik të zonës. Kohët e fundit ka pasur jo pak probleme në këtë zonë, kryesisht prerje të paligjshme të pyjeve dhe mbikullotje.

**NJA Kodovjat:** Në këtë zonë ka një sipërfaqë të konsiderueshme më pyje dhe shkurre, të pasura me bimësi të ulët dhe barishtore. Trungishte dhe cungishte zënë 725<sup>160</sup> ha, të përfaqësuara nga Pisha e zezë, pisha e egër, Shpardhi dhe Qarri. Ndërsa shkurret zënë një sipërfaqë prej 2859 ha, e cila përfaqësohet nga Shkoza, Dëllënja, Mareja, Frashëri, etj. Kohët e fundit është venë re një ulje e sipërfaqeve pyjore dhe shkurretave, e cila mendohet që rrjedh si pasoje e prerjeve të paligjshme dhe mbikullotjen.

Sipas Librit të Kuq të Florës së Shqipërisë, në territorin e bashkisë gjenden 44 lloje të rezikuara floristike, ku pjesa më e madhe e tyre u përkasin llojeve barishtore, të ndjekura nga shkurre dhe më llojet e pemëve. Ndër speciet e rrezikuara që takohen në territorin e Gramshit, ndër të tjera janë: Çaji i malit (*Sideritis raeseri*), Rigoni i rëndomtë (*Origanum vulgare*), Foje (*Juniperus excelsa*), Lepushtera (*Caltha palustris*), Asteri shqiptar (*Aster albanicus*), Vidhi malit (*Ulmus glabra*), Ilqe (*Quercus ilex*), Arne (*Pinus peuce*), Dëllënja e zezë (*Juniperus communis*), etj.

o Problematikat kryesore të biodiversitetit në Bashki:

Gjëndja e florës dhe faunës në zonën e Gramshit paraqet problematika të ndryshme, kryesisht për shkak të zhvillimit të aktivitetit njerëzor në territorin e Bashkisë. Ndërhyrjet kryesor dhe ato të cilat kanë ndikim më të theksuar në biodiversitetin e zonës janë të renditura në vijim:

- Zhvillimi industrial dhe pasojat e ish-aktiviteteve industriale, kanë qënë kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit dhe ujit. Aktualisht, gjëndja paraqitet më e stabilizuar, pasi industrinë në territorin e bashkisë kanë ulur ndjeshëm kapacitetin e tyre prodhues.
- Urbanizimi: Kërkesa gjithnjë e në rritje për zona banimi, ku në dy dekadat e fundit kjo kërkesë është reflektuar në shtimin e zonave urbane informale dhe në shpërhapje, duke zënë sipërfaqe të zonave natyrore e bujqësore, kryesisht përreth qytetit të Gramshit.
- Fragmentimi i habitateve nga ndërtimi i infrastrukturës rrugore apo i veprave të ndryshme ka çuar në fragmentimin e habitateve ose ndërprerjen e vazhdueshmërisë së zonave natyrore i cili vjen si rrjedhojë e ndërtimit të infrastrukturës në toka bujqësore e natyrore, pa marrë parasysh parimet e mbrojtjes së mjedisit. Kjo vihet re edhe nga një analizë e thjeshtë e përdorimit të tokës në Territorin e Bashkisë. Fragmentimi në vetvete sjell zvogëlimin e sipërfaqes së habitatit të florës e faunës dhe izolimin e tyre në njësi të vogla habitati duke penguar lëvizjen e lirë të kafshëve të ndryshme.
- Gjuetia e paligjshme ka pasur një ndikim të ndjeshëm në biodiversitet, gjë që ndihet edhe sot, pas dy viteve të ndalimit të saj (moratoriumi i gjuetisë). Për fat të mirë, moratoriumi është zgjatur edhe për 5 vite të tjera.
- HEC-et: Prodhimi i energjisë në territorin e Gramshit nga HEC-et ka një ndikim jo të vogël në ndryshimin e rrjedhave të përrrenjëve të vegjël dhe krijimin e rezervuarëve të mëdhenj (HEC-i i Banjës).



- Zhvillimi i bujqësisë së shkallës: Zhvillimi i bujqësisë, ka qenë kërcënimi kryesor ndaj biodiversitetit gjatë sistemit të shkuar (periudha e regjimit komunist), hapja e tokave të reja bujqësore, shpyllëzimi për këtë qëllim dhe përdorimi i kimikateve bujqësore. Aktualisht, ky mbetet një problem i trashëguar, edhe pse disa nga tokat bujqësore të përfutuara nga tarracimet masive të viteve 1980-90, të cilat nuk u përdorën më për funksione bujqësore, po rikthehen në gjëndjen e mëparshme natyrore. Sot, bujqësia ndikon ndjeshëm në biodiversitet, kryesisht nëpërmjet përdorimit të pesticideve dhe plehërave kimike në mënyrë të pakontrolluar, duke u kthyer në sektor ndotës, kryesisht për rrjedhat ujore.
- Shpyllëzimi ka qenë dhe mbetet një problem kryesor i prishjes së habitateve. Në dy dekadat e shkuara, krahas prerjeve për lëndë drusore dhe djegëse, shpyllëzime masive ndodhnin për hapjen e tokave bujqësore. Aktualisht, qeveria shqiptare ka vendosur një moratorium 10-vjeçar me qëllim ripërtëritjen e fondit pyjor në vend.
- Kullotja e bagëtisë, në përgjithësi ka një ndikim negativ në zhvillimin e bimësisë, kryesisht në bimët dhe shkurret e ulëta, të cilat shërbejnë si ushqim për bagëtinë. Në territorin e Gramshit nuk ka një studim të mirëfilltë mbi kapacitetin mbajtës të kullotave. Si rrjedhojë, nuk dihet ndikimi i kullotjes në këtë zonë.
- Zhvillimi i turizmit, kryesisht në formën e vizitave ditore, në zonat natyrore të territorit të Gramshit, ka një ndikim jo të vogël në ndotjen e këtyre zonave dhe shqetësimin e kafshëve apo shpendëve. Kjo ndodh kryesisht në ato zona ku guidat nuk zbatojnë standardet e mbrojtjes së natyrës dhe nuk kanë informacion për zonat e caktuara, të cilat nuk duhen shqetësuar
- Peshkimi i pakontrolluar, kryesisht përgjatë lumit Devoll, ka ndikuar në uljen e numrit të popullatës së peshqve pa lënë pas edhe peshkimin në liqene apo rezervuarë, të cilët kanë tashmë një jetë natyrore të zhvilluar.

Në territorin e Bashkisë Gramsh mund të ketë edhe aktivitete të tjera, të cilat kanë ndikime më të vogla në biodiversitet ndër të cilat mund të përmendim mbledhjen e nënprodukteve të pyllit siç janë bimët mjekësore etj.


Shpallja e moratoriumit 5-vjeçar të gjuetisë dhe moratoriumit 10-vjeçar të pyjeve mendohet se do të mbrojë biodiversitetin në përgjithësi dhe do të shtojë numrin e specieve floristike dhe faunistike në territorin e Bashkisë.

## 6.4 Toka

Sipërfaqja totale e Bashkisë Gramsh është 739.98 km<sup>2</sup>. Sipas analizës territoriale, sistemi natyror zë rreth 79.87% të territorit (591.05 km<sup>2</sup>). **Sistemi natyror** është i përqëndruar në skajet e territorit të bashkisë, duke qenë se këto zona përshkruhen nga sisteme kodrinore dhe malore. **Sistemi bujqësor** renditet i dyti, duke zënë afërsisht 13.7% të territorit (101.39 km<sup>2</sup>) dhe ndodhet përgjatë shtratit të Lumit Devoll, në pjesën më të ulët të qytetit të Gramshit, zonë në të cilën janë përqëndruar zhvillimet urbane, industriale dhe ekonomike. Në pjesën qendrore të territorit, **sistemi urban** ndërthuret me sistemin natyror dhe me sistemin infrastrukturor. Sistemi urban, i cili zë 6.05%, është përqëndruar kryesisht në qytetin e Gramshit. Ky sistem shtrihet edhe përgjatë akseve kryesore rrugore, siç është segmenti Gramsh-Cërrik-Elbasan dhe segmentet rrugore që lidhin qendrën e bashkisë me njësitë administrative, që kanë distancë të vogël me qytetin e Gramshit. Në pjesën tjetër të Bashkisë Gramsh, sistemi urban është pikësor dhe ndërthuret me sistemin natyror

dhe sistemin bujqësor. Në territorin e Gramshit ka edhe sipërfaqe të konsiderueshme *ujore* që në total zënë një sipërfaqe prej 36.59 km<sup>2</sup>. Kategoria e përdorimit *banim*, zë një sipërfaqe totale 5.14 km<sup>2</sup> dhe është e përqendruar kryesisht në pjesën e qytetit ndërsa në fshatra zë më pak sipërfaqe dhe ka shpërhapje më të madhe, ndërsa kategoria *industri* dhe *ekonomi* zë 0.45 km<sup>2</sup> të gjithë sipërfaqes së Gramshit.

Figura 35 Sistemet territoriale në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 23 Sistemet territoriale, Bashkia Gramsh

Nr	Sistemet territoriale	Sipërfaqja në km <sup>2</sup>	Sipërfaqja në %
1	Bujqësor	101,39	13,70%
2	Infrastrukturor	4,90	0,66%
3	Natyror	591,05	79,87%
4	Ujor	36,59	4,94%
5	Urban	6,05	0,82%
	<b>TOTAL</b>	<b>739,98</b>	<b>100,00%</b>

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 24 Kategoritë bazë të përdorimit të tokës (km<sup>2</sup>)

Nr	Kategoritë bazë	Sipërfaqja (km <sup>2</sup> )	Sipërfaqja (%)
1	Aktivitete Shoqërore dhe Argëtim	0,053	0,007%

2	Arsim	0,106	0,014%
3	Banim	5,136	0,694%
4	Bujqësi	101,453	13,710%
5	Industri Ekonomi	0,447	0,060%
6	Infrastrukturë Bujqësore	0,062	0,008%
7	Infrastrukturë Energjitike	0,018	0,002%
8	Infrastrukturë Telekomunikacioni	0,002	0,000%
9	Infrastrukturë Transporti	4,751	0,642%
10	Infrastrukturë Ujësjiellës-Kanalizime	0,013	0,002%
11	Institucione	0,026	0,004%
12	Monumente Kulture	0,001	0,000%
13	Shëndetësi	0,028	0,004%
14	Shërbime	0,141	0,019%
15	Tokë Natyrore	591,054	79,874%
16	Ujëra	36,575	4,943%
17	Varreza	0,084	0,011%
18	Zonë ushtarake	0,03	0,004%
	<b>TOTAL</b>	<b>739,98</b>	<b>100,000%</b>

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

#### 6.4.1 Toka Bujqësore

Sipas klasifikimit të *Census* 2011, Bashkia e Gramshit ka 2 njësi vendore bujqësore mikse malore (Pishaj e Kukur) dhe 7 njësi vendore bujqësore malore (Kodovjat, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult e Tunjë). Sipas PPK ( Planit të Përgjithshëm Kombëtarë) Gramshi është klasifikuar si Qendër Terciare

Tabela 25 Ndarja e bashkive sipas sektorit ekonomik

Kodi	Bashkia	Tipologjia	Sip. km <sup>2</sup>	Banorë
14	Gramsh	Qendër lokale	2.48	14413
42	Pishaj, Kukur	Njësi vendore bujqësore mikse malore	192.6	5439
44	Kodovjat, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult, Tunjë	Njësi vendore bujqësore malore	544.14	8325
<b>Totali</b>			739.22	24231

Burimi: CENSUS, 2011; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Sipas tabelës së mësipërme, të paktën 30.8% e popullsisë ka si aktivitet bazë bujqësinë mikse malore, ndërsa rreth 34.4 % e popullsisë së bashkisë merret me bujqësi malore. Shifrat mund të jenë edhe më të larta, nëse llogaritjet kryhen sipas deklarimeve të punësimit, e jo klasifikimit tipologjik të bashkisë.

Bashkia e Gramshit nuk ka sipërfaqe të mëdha tokash bujqësore, që mund të shërbejnë për kultivimin intensiv të bimëve. Megjithatë, Bashkia përfshin një larmi të gjerë tokash në territorin

e saj (fushore, kodrinore dhe malore), të cilat përdoren për prodhimin e *drithërave* (grurit, misrit, tagjirës), pemtarisë, vreshtave, perimeve dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët, derri dhe dhentë). Bashkia dallohet edhe për *drurët frutorë*. Sipërfaqet bujqësore në Bashkinë e Gramshit janë të vendosura në tokat përgjatë lumit të Devollit dhe përrenjëve që përshkojnë bashkinë.

#### 6.4.2 Problematikat e tokave në Gramsh

**Erozioni i tokave bujqësore, shkarjet, shembjet:** Bashkia e Gramshit shtrihet në një zonë me relief të larmishëm fushor, kodrinor dhe malor, ku zonat fushore janë të kufizuara përgjatë luginës së lumit Devoll dhe përgjatë përrenjëve. Si rrjedhojë, duke qenë se një pjesë e mirë e tokave bujqësore shtrihen në relief jofushor, ato janë të prirura ndaj erozionit, shkarjeve dhe shembjeve. Për sa i përket *erozionit* në tokat bujqësore, ndërsa në vendin tonë rreziku potencial i erozionit konsiderohet mesatar dhe i lartë, në zonën e Gramshit ky potencial është vlerësuar si *i lartë*.

Tabela 26 Vlerësim teorik për nivelin e erozionit potencial në tokat bujqësore të Shqipërisë

Rrethet	Sip (Ha)	Indeksi i erodibilitetit		Indeksi i erozionit të tokës	Indeksi i pjerrësisë	Indeksi i rrezikut potencial të tokës		Vlerësimi
		Abso l.	Rel.			Absol .	Rel.	
Korçë	58973	6.3	3	2	1.68	10.1	2	Mesatar
Gramsh	7518	7.3	3	2	2.37	14.2	3	I lartë
Elbasan	40450	6.9	3	2	2.25	13.5	3	I lartë

Burimi: AKM 2013; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2016

Bashkia ka shumë fshatra të ndodhura në terren kodrinor e malor, sidomos në zonën e NjA-ve Kukur, Skënderbegas, Tunjë, Gramsh dhe Pishaj të cilat janë të ndjeshme ndaj erozionit. Shkaqet e erozionit në tokat bujqësore të kultivuara në Bashkinë e Gramshit janë natyrore dhe të shkaktuara nga ndërhyrjet e njeriut me mënyra të papërshtatshme gjatë përdorimit të saj (keq-manaxhimi). Disa nga ndërhyrjet mund të lidhen kryesisht me: i) kultivimin e tokave me pjerrësi të mesme e të theksuar, që rezultojnë në rrëshqitje, ndihmuar kjo dhe nga fenomene atmosferike; ii) mënyra e kultivimit të tokës bujqësore kodrinore në të njëjtin drejtim me pjerrësinë dhe me zhveshje totale të tokës gjatë plugimit; iii) djegia e mbetjeve të bimëve të kultivuara në sezonin e mëparshëm, si praktikë e thjeshtë për pastrimin e saj, por që shkatërron plehun organik dhe zhvesh tërësisht tokën nga bimësia që shërben si mbrojtëse; iv) tarracimi i papërshtatshëm i zonave kodrinore-malore me zhveshje të tokës etj. Në fakt, gjatë gjithë zonës fushore dhe kodrinore brenda territorit të bashkisë, në kohën e punimit të tokës, vihen re ngastra toke të punuar thellë dhe të zhveshura tërësisht nga bimësia. Kjo sepse në tokat bujqësore në Bashkinë Gramsh dhe pothuajse në gjithë vendin tonë, bujqërit ose fermerët vazhdojnë të përdorin praktika bujqësore të papërshtatshme si zhveshja e tokës nga bimësia e stinëve të mëparshme gjatë plugimit, pa marrë parasysh se një gjë e tillë e varfëron tokën dhe e shndërron atë në tokë të ndjeshme ndaj erozionit, në rastin më të parë të reshjeve me intensitet të lartë apo të stuhive të erës.

Tokat e rajonit të Gramshit janë të rrezikuara edhe nga mundësitë e *shkarjeve* dhe *shembjeve*<sup>161</sup>, një formë e rrezikut gjeologjik. Disa nga shkaqet e shkarjes së tokës që indentifikon AKM-ja në


Bashki janë relievi i thyer, sasi të mëdha të reshjeve, dëmtimi i bimësisë natyrore, mbikullotja në zonat me bimësi livadhore, braktisja e tokave bujqësore, etj. Për shkak të reshjeve dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë<sup>162</sup>.

Fatkeqësisht, ndërkohë që vendet e tjera kanë futur tashmë praktika të përshtatshme kultivimi për të shmangur ose zvogëluar rrezikun e erozionit në tokat bujqësore (si punimi i tokës duke e trazuar atë sa më pak, ruajtja e masës bimë të mbjellave të mëparshme gjatë kultivimit, përdorimi i mbulesave bimë ndërmjet stinëve të kultivimit ose mbjellja e foragjereve apo e bimësisë që ushqen dhe forcon tokën ndërmjet bimëve të kultivuara me rreshta si pemtaria, vreshtaria ose ullishtet etj.), në vendin tonë mbetemi ende mbrapa. Si rrjedhojë, për shkak të arsyeve të ndryshme në territorin e bashkisë vihet re degradimi i tokës, kjo si pasojë e erozionit, mungesës së njohurisë së thelluar për tokën dhe praktikave të keqmanaxhimit, apo braktisjes. Shifrat lokale në lidhje me erozionin lokal mungojnë por në rang vendi degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të brendshëm bruto në vitin 2014<sup>163</sup>.

**Gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve:** Gjatë viteve të fundit, në Gramsh rreziku i gërryerjes së tokës në lumin Devoll mbetet i lartë, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta<sup>164</sup>. Dëmtimet në brigjet e lumenjeve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjeve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë shtratit dhe mbushjes së shtratit të tyre me mbetje urbane. Nga studimet e kryera në nivel kombëtar është konstatuar një gjëndje serioze e shtretërve të lumenjve duke humbur një nivel të lartë të tokave në brigjet e lumenjve, si pasojë e një mungese menaxhimi dhe mirëmbajtjeje të lumenjve<sup>165</sup>.

**Përdorimi konfliktual i tokës:** Duke iu referuar hartës së mësipërme, në Bashkinë e Gramshit përdorimi i tokës është i llojeve të ndryshme. Karakteristikat e të gjitha bashkive, por që e gjejmë edhe në Bashkinë e Gramshit është fakti që përdorimi i tokës nuk është i zonuar sipas parimit të përdorimit të lejuar, ndaluar dhe kushtëzuar. Kjo vihet re dukshëm në rastet kur tokat bujqësore nuk kanë asnjë ndasi apo brez mbrojtës ndaj zonave që përdoren për banim apo ndaj aktiviteteve të tjera ndotëse, pa marr parasysh asnjë masë mbrojtëse.

Figura 36 Mbivendosje e përdorimit të tokës



Punoi : Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Siç shihet dhe nga harta e mësipërme, në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh gjejmë mbivendosje të përdorimit të tokës<sup>166</sup>. Mbivendosjet më të shpeshta janë ndërmjet kategorive **bujqësi-ujëra**, **banim-ujëra** dhe **industri-bujqësi**, përdorime të veçanta (zona e varrezave) me banim. Mbivendosja e banimit me ujërat dhe e banimit me ujërat është e pranishme përgjatë lumit Devoll. Në NjA-të Tunjë, Kushovë, Lenie dhe Poroçan ka kryesisht mbivendosje të zonave të banimit me atë të varreza. Njësitë administrative përgjatë lumit Devoll shtrihen në terren fushor dhe kanë sipërfaqe me toka bujqësore. Në këto njësi mbivendosen banimet me tokat bujqësore. Zonat industriale dhe ekonomike mbivendosen me ato të banimit. Ish Uzina mekanike dhe ajo e prodhimit të baterive në qytetin e Gramshit është e vendosur pranë banimit dhe pranë trupit ujqor (lumi Devoll). Zona që ka pasur presion më të madh zhvillimi është përgjatë lumit Devoll, për arsye të karakterit fushor që ka kjo zonë. Pranë Lumit Devoll janë vendosur zona me karakter ekonomik duke krijuar mbivendosje të zonave industriale me bujqësore dhe atyre bujqësore me zonat ujore.

**Ulja e rendimentit të tokave bujqësore për shkak të përdorimit intensiv të saj:** Sot, bujqësia në vendin tonë përballlet me ndryshime të mëdha, gjë e cila nënkupton: kultivimin e tokës bujqësore përgjatë gjithë vitit me përdorimin e makinerive moderne e inputeve bujqësore të panjohura më parë, shtimin e kulturave bujqësore të reja si dhe përdorimin e plehrave të ndryshëm kimik.

Në vend është vënë re shtimi i sasisë së plehrave kimike të përdorur, ndërkohë që një fenomen i ri që vihet re vitet e fundit është edhe ndryshimi i llojit të plehrave kimike të përdorura (kalimi nga plehu organik në diamond superfosfat), për të cilin nuk njihet arsyeja.

Tabela 27 Sasia e plehrave kimik të përdorur në Bashkinë Gramsh, 2016

Nr	Kultura bujqësore	DAP	Nitrat	Ure	Pleh organik
		Sasia e përdorur (ton)	Sasia e përdorur (ton)	Sasia e përdorur (ton)	Sasia e përdorur (ton)
1	Misër	249	172,5	301	18540
2	Grurë	290	208,5	371	
3	Tagji	76,1	81,5	70,5	2590
4	Perime	55	104,5	13,9	7670
5	Patate	43	75,4	7,3	4420
6	Fasule	38,9	77,9	2,7	600
7	Foragjerë	369,9	424,9	225,9	16950
8	Pemë frutore	47,1	5	51,4	1760
9	Ullishte	22,9	4,8	25,8	880
10	Vreshta	34,1	5	36,7	1260
<b>TOTALI</b>		<b>1226</b>	<b>1160</b>	<b>1106,2</b>	<b>54670</b>

Burimi: Bashkia Gramsh, Përpunoi: MetroPOLIS, 2017

Zhvillimi i bujqësisë ka ardhur për shkak se në këtë mënyrë garantohet rritja e prodhimit dhe e përfitimeve ekonomike. Megjithatë, duhet theksuar se bujqësia intensive kërkon njohje të vetive fiziko-kimike të tokës të cilat ndihmojnë në përdorimin efiçient të saj (përdorimin e inputeve bujqësore, llogaritjen e përmbajtjes së metaleve të rënda, depërtimit të ndotjes nga toka në shtresat ujore nëntokësore, llogaritjes së sasisë së ujit të përdorur për ujitje, kohën e përdorimit etj.). Mungesa e njohjeve të tilla me kalimin e viteve çon në degradimin e tokës dhe në ndotjen e mjedisit, e sigurisht në rënien e prodhimit bujqësor dhe të zhvillimit ekonomik.

**Ndotja e tokës:** Në Bashkinë e Gramshit ndotja e tokës ka ndodhur në seksione të caktuara të territorit, kryesisht në zonat bujqësore, industriale, në zonat e depozitimit të mbetjeve si dhe në zona të tjera. Si zona të ndotura, në Bashkinë e Gramshit dallohet ish-Uzina e prodhimit të baterive, ish-Uzina e mekanike/ushtarake e Çekinit, venddepozitimi i mbetjeve pranë qytetit të Gramshit, në pjesën jugore të qytetit, si dhe venddepozitimet e mbetjeve në të gjitha NjA-të, pranë perrenjve, jashtë kushteve teknike dhe higjeno-sanitare.

#### 6.4.3 Përfundime e rekomandime

Bashkia e Gramshit ka një larmi të gjerë tokash, si: fushore, kodrinore dhe malore, të cilat përdoren për prodhimin e *drithërave* (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët dhe dhentë). Megjithatë, bashkia përballet çdo ditë e më tepër me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës**, që në Gramsh është fenomen i zakonshëm për shkak të shkëmbinjëve me fortësi mesatare dhe pjerrësisë të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi, duke e thelluar dhe më shumë fenomenet, si: erozioni, shkarjet dhe shembjet e tokës. Për shkak të shirave dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë<sup>167</sup>. Gjatë viteve të fundit, në Gramsh mbetet i lartë edhe rreziku i erozionit të tokës, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë periudhave me shi<sup>168</sup>. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë

rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë bregut të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndërkohë që mirëmbajtja e lumit lë për të dëshiruar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme<sup>169</sup>. Njëkohësisht, në zona të caktuara, në të cilën ka qenë e zhvilluar industria, si zona përreth Ish-Uzinës mekanike të Çekinit, nuk mungon ndotja.

Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore, duke u ofruar informacionin e duhur bujqërve. Ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Gramshit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së<sup>170</sup>.

Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

## 6.5 Ndryshimet klimatike dhe rreziqet

Në vendet e Europës Juglindore, përfshirë Shqipërinë, pasojat e ndryshimeve klimatike do të shprehen në forma të ndryshme si:

- Një rritje e temperaturës me 1.7 – 3.5°C deri në vitin 2100,
- Një ulje e sasisë së reshjeve dhe ndryshim të regjimit të tyre (-3.84 deri në -18.13% deri në vitin 2100)<sup>171</sup>.

Këto fenomene parashikohet të kenë pasoja të theksuara në zhvillimin e rajonit, sepse kanë mundësi të shkaktojnë ngritjen e nivelit të detit duke krijuar erozion detar, përmytje, pakësim të ujërave nëpër lumenj e liqene gjatë vitit dhe përmytje në periudha të caktuara për shkak të shtimit të reshjeve me intensitet të lartë, ndryshimeve në stinën e kultivimit në bujqësi, ndryshim të habitateve, pakësim në numër dhe lloj të specieve, shtimit të llojeve të huaja invazive së bashku me rritjen e sëmundjeve infektive.<sup>172</sup>

Gjithashtu, probleme të shumta do të hasen në komunitetet lokale dhe ato rajonale që varen nga shërbimet që ofron ekosistemi, uji i pijshëm, karburanti, materialet për ndërtim dhe të korrat. Të gjitha së bashku do të kenë një ndikim të madh në mbajtjen e kushteve optimale të jetesës. Është fakt i rëndësishëm, që disa rajone të Europës Juglindore shtrihen në fushën e Europës e cila është zonë më e ndryshme nga ndryshimet klimatike. Ndër pasojat më të theksuara të ndryshimeve klimatike, që parashikohet të ndodhin në rajon, renditen më poshtë:<sup>173</sup>



- Mungesa e ujit të pastër për shkak të uljes të sasisë së reshjeve dhe rritjes së temperaturave.
- Në zonat malore ku rritja e temperaturës do të shkaktojë shkrirjen e shpejtë të akujve dhe dëborës parashikohet fryrja e rrjedhave të lumit dhe ndikimet zinxhir që rrjedhin nga kjo.
- Zonat bregdetare do të përballen me pasojat që vijnë nga rritja e nivelit të detit kombinuar me rritjen e rrezikut nga fenomene klimatike si stuhitë apo reshjet intensive.

### 6.5.1 Ndryshimet klimatike në Shqipëri

Siç u tha me lart, Shqipëria, duke qënë se shtrihet në Europën Juglindore, do të ketë pasoja të ndjeshme nga ndryshimet klimatike. Ndryshime kryesore që parashikohen janë<sup>174</sup>:

- Rritja e temperaturave
- Ulja e sasisë së reshjeve,
- Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit
- Rritja e nivelit të detit<sup>175</sup>.

**Rritja e temperaturave:** Bazuar në të dhënat e paraqitura në komunikimin e tretë që Shqipëria ka bërë për ndryshimet klimatike në tre skenare të përgatitur, tregohet një rritje e mundshme e temperaturës mesatare vjetore përgjatë viteve 2030, 2050, 2080 dhe 2100. Si temperaturë referencë është marrë temperatura mesatare e vitit 1990 (Tabela 67)

Tabela 28 Skenaret e parashikimit të rritjes së temperaturës (Referuar Tem. Mes. 1990)


Stinët	Vitet			
	2030	2050	2080	2100
Vjetor	1.0 (0.7 to 1.2)	1.7 (1.3 to 2.2)	2.8 (2.0 to 3.5)	3.2 (2.4 to 4.1)
Dimër	0.8 (0.7 to 0.9)	1.2 (1.1 to 1.4)	2.0 (1.7 to 2.3)	2.4 (1.9 to 2.7)
Pranverë	1.0 (0.8 to 1.12)	1.5 (1.3 to 1.8)	2.6 (2.2 to 3.0)	3.1 (2.6 to 3.6)
Verë	1.6 (0.5 to 1.8)	2.5 (2.1 to 2.8)	4.3 (3.8 to 4.9)	5.3 (4.6 to 6.0)
Vjeshtë	1.0 (1.0 to 1.1)	1.6 (1.5 to 1.8)	2.8 (2.7 to 3.0)	3.5 (3.2 to 3.7)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016<sup>176</sup>; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Në skenaret e rritjes së temperaturës, në vitin 2050 parashikohet një rritje mesatare e temperaturës me 1.7°C dhe skenari maksimal 2.2°C. Ndërsa në vitin 2080, temperatura mund të rritet me 2.8°C, ndërsa vlera maksimale e vlerësuar arrin shifrën 3.5°C. Në vitin 2100, temperatura mesatare vjetore parashikohet të rritet me 2.4-4.1°C.

Duke vëzhguar vlerën e rritjes së temperaturës sipas stinëve të vitit, shqetësues është fakti që rritja më e madhe e temperaturës parashikohet të ndodhë në stinën e verës, duke e kthyer atë në një stinë akoma më të nxehtë e të thatë. Temperaturat mesatare vjetore për skenaret e përgatitur mund të rriten me 2.1-2.8°C në vitin 2050, dhe një rritje me 4.6-6.0°C në vitin 2100, referuar temperaturavetë vitit 1990. Temperaturat mesatare vjetore, sipas skenareve të hartuara, pritet të arrijnë në 25°C në vitet 2050, dhe në 30°C në vitin 2100.

Tabela 29 Skenarët e parashikimit të rritjes së temperaturës



Burimi: Ministria e Mjedisit 2016<sup>177</sup>; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Përveç rritjes së temperaturave në përgjithësi, parashikohet edhe shtimi i fenomeneve ekstreme të motit siç janë numri i ditëve me temperaturë >35°C pa ndërprerje, numri i ditëve me valë të nxehta dhe numri i ditëve me temperaturë të ftohtë pa ndërprerje.

Tabela 30 Numri i fenomeneve ekstreme të parashikuara deri në vitin 2100 në rajonet bregdetare në vend

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 1961-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Nr. ditëve me Tmaks >35° C	Veri	1.7-5.8	5-10	7-14	8-20	10.0-24.0
	Qendër	6 - 4.9	2-9	2-12	3-18	4.0-21.0
	Jug	1.3	4	5	7	8
Nr. ditëve me valë të nxehta	Veri	19-27	56-60	72-80	95-98	115-120
	Qendër	16	29	36	52	60
	Jug	7	13	16	20	25
Numri i ditëve me temperaturë të ftohtë	Veri	360	550	670	840	930
	Qendër	686	780	870	980	1100
	Jug	757	860	950	1050	1160

Burimi:Ministria e Mjedisit 2016<sup>178</sup>; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Duke iu referuar të dhënave të mësipërme (Tabel 94), përgjatë gjithë viteve të ardhshme deri në vitin 2100 do të kemi një rritje të ditëve me temperatura maksimale mbi 35°C, ku nga 1.7-5.8 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 do të arrijnë 10-24 ditë me temperatura mbi 35°C në veri, nërsa në pjesën qendrore dhe jugore kjo vlerë është më e ulët. Gjithashtu, ditët me valë të nxehta do të rriten përgjatë viteve të ardhshme, nga 19-27 ditë në periudhën 61-1990, në 115-120 në vitin 2100 në pjesën veriore, ndërsa në atë qendrore dhe jugore vlerat paraqiten më të ulëta. Përsa i përket ditëve me temperaturë me të ulët se 0°C të paraqitura në tabelën e mësipërme, parashikohet një rënie drastike deri në vitin 2100, krahasuar me vitin 1990, nga 10-27 ditë në periudhën 61-1990, në vitin 2100 këto ditë nuk do të jenë aspak të pranishme në të gjithë zonën bregdetare. Gjithashtu, edhe ditët me valët e të ftohtit nuk do të jenë të pranishme në vitet 2100.

Tabela 31 Numri i ditëve me fenomene ekstreme të motit në vit: Parashikime

Fenomeneve ekstreme të motit	Rajon	Vitet 61-1990	Vitet			
			2030	2050	2080	2100
Ditë me Tmin < 0°C	Veri	10-27	4-15	0-10	0-3	0
	Qendër	7-32	3-18	0-11	0-5	0
	Jug	3	0	0	0	0
Ditë me valë të ftohta	Veri	30-48	10-15	6-7	0-6	0
	Qendër	32-46	20-32	12-23	6-8	0
	Jug	7	0	0	0	0
Ditë me valë të ngrohta	Veri	1450	1410	1390	1350	1335
	Qendër	1530	1495	1460	1420	1390
	Jug	1168	1130	1110	1090	10702

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016<sup>179</sup>; Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Si pasojë e rritjes së temperaturës, dhe rritjes së numrit të ditëve me valë të nxehta, vendi do të përballlet me thatësi të konsiderueshme dhe mot të nxehtë. Ndikim të menjëhershëm do të ketë në rritjen e mesatares vjetore të vdekshmërisë, kryesisht për moshat e treta; në kërkesën në rritje për ujë të pastër; dhe probleme me përshtatjen e kulturave bujqësore me klimën.

**Ulja e sasisë së reshjeve:** Një problem i rëndësishëm, që pritet të vijë bashkë me ndryshimet klimatike, tashmë të vërtetuara shkencërisht, është ulja e sasisë së reshjeve vjetore dhe shpërndarja e tyre përgjatë vitit (Tabela 69).

Tabela 32 Parashikimet e ndryshimit të regjimit të reshjeve (në %) për periudha të ndryshme në lidhje me vitin 1990

Vitet	2030	2050	2080	2100
Vjetor	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Dimër	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Pranverë	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3 to 10.75)	-14.26 (-45.1 to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Verë	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7 (-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Vjeshtë	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Burimi: Ministria e Mjedisit 2016<sup>180</sup>; Përgatiti: Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe Metropolis, 2017

Në vitet e ardhshme pritet që sasia e reshjeve të ulet rreth 14.37% në vitin 2080, dhe deri në mbi 18% në vitin 2100. Në vitet e ardhshme parashikohet që periudhat e thatësisë të shtohen së tepërmi, si pasojë e uljes së sasisë mesatare të reshjeve vjetore dhe shpërndarjes së tyre përgjatë vitit. Nga të dhënat e skenareve të parashikuara të shpërndarjes së reshjeve vjetore, vihet re që stina

e verës do të jetë mbi 50% më e thatë. Mungesa e reshjeve do të çojë në një verë shumë më të nxehtë dhe të thatë, duke u kthyer në problem serioz për zhvillimin e bujqësisë dhe shumë probleme të tjera në sektorë të ndryshëm ekonomik.

Rritja e temperaturave në territorin e Bashkisë Gramsh do të ketë një sërë problemesh kryesisht në zhvillimin e bujqësisë dhe në biodiversitet. Zhvillimi bujqësor në territorin e bashkisë do të përballet me kushte klimatike më të thata, si pasojë do të ketë një rritje të kërkesës për ujë për vaditje, dhe nga ana tjetër, një ulje të sasisë së reshjeve dhe rezervave ujore të përdorshme për bujqësinë. Shtimi i dëmtuesve (parazitë, mikroba, insekte), do të jetë një problem i qenësishëm me rritjen e temperaturës mesatare vjetore. Biodiversiteti do të preket ndjeshëm nga kohëzgjatja e periudhave të nxehta gjatë vitit dhe mungesës së reshjeve, si pasojë dhe intensifikimi i zjarreve, të cilët dëmtojnë specie dhe habitate në tërësi. Për zhvillimin sa më të qëndrueshëm të biodiversitetit duhen marrë masa në kohë sa më të hershme, për përshtatjen e bujqësisë dhe gjetjen e mënyrave për plotësimin e nevojës me ujë për vaditje.

**Shtimi i fenomeneve ekstreme të motit:** Përgjatë viteve, fenomenet ekstreme të motit si përmbytjet, valët e të nxehtëtit etj. kanë qënë të pranishme në vendin tonë. Përmbytjet kanë një ndikim të madh në aspektin e jetës së njerëzve, ekonomisë, bujqësisë dhe mjedisit. Pika kulminante e përmbytjes në vitin e fundit është regjistruar në vitin 2010, në të cilën humbjet arritën në rreth 0.15% të PBB-së së vendit. Në vitet që vijnë, fenomeni i përmbytjeve, i ndihmuar nga shirat intensive, që pritet të shtohen, parashikohet të shpeshtohet. Stina e verës do të pësojë ndryshime të theksuara, duke krijuar kushte ekstreme si temperatura të larta dhe periudha të zgjatura të thata. Ndërsa në zonat bregdetare, me rritjen e temperaturave dhe intensifikimin e reshjeve, parashikohet të formohen stuhi, të cilat do të kenë një ndikim jo të vogël në ato zona.

Në të shkuarën, pjesë të territorit të Bashkisë Gramsh janë bërë pre e përmbytjeve të vazhdueshme nga Lumi Devoll, kryesisht tokat bujqësore pranë brigjeve. Në vitet e fundit, ky fenomen po kthehet i përvitshëm edhe pse në shkallë të ndryshme. Në skenarët e parashikimit të ndryshimit të klimës, theksohet shtimi i fenomeneve ekstreme të motit, kryesisht shtimi i shirave intensive, të cilët janë tepër problematike në fryrjen e menjëhershme të lumenjve dhe si pasojë përmbytjet do të jenë më të mëdha. Zonat breglumore, apo dhe zona përreth, do të jenë tepër të prekura nga përmbytjet që parashikohen në të ardhmen, ndaj duhen marrë masa të menjëhershme për përbalimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e tokës bujqësore dhe të zonave urbane.

### **6.5.2 Sektorët ekonomikë më të prekur nga ndryshime klimatike**

**Bujqësia<sup>181</sup>:** Sektori i bujqësisë është një nga drejtuesit kryesorë të ekonomisë shqiptare. Në vitin 2011 sektori i bujqësisë numëronte 54.6% të punësuarve, dhe kontribuonte në 20% të PBB-së. Bujqësia është shumë e ndjeshme ndaj ndryshimeve afatshkurtra të motit, luhatjeve sezonale dhe vjetore. Ndryshimi i klimës dhe rritja e temperaturës kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në uljen e prodhimit, shtimin e dëmtuesve në bujqësi (insekteve, parazitëve) etj. Gjithashtu, ndryshimi i klimës do të sjellë ulje të sasisë së reshjeve, sidomos në periudhën e verës duke çuar në rritjetë kërkesës për ujë dhe uljen e mundësisë për të pasur ujë të mjaftueshëm për të plotësuar nevojat gjithnjë e në rritje që ka bujqësia për ujë. Me rritjen e temperaturës, kulturat bujqësore do të hasin probleme me përshtatshmërinë e tyre rajonale. Kjo nënkupton që përgjatë dhjetëvjeçarëve të ardhshëm nevojitet të përshtatim llojin e të mbjellave me lloje më rezistente ndaj thatësisë dhe varietete që kërkojnë më pak ujë. Frutat dhe perimet do të jenë më të prekura nga ndryshimet

klimatike, pasi rritja e temperatures shton stresin tek këto bimë, duke ulur prodhimtarine ose duke vështirësuar rritjen e tyre.

Në territorin e Bashkisë Gramsh do të hasen jo pak ndryshime. Ndryshimet kryesore në lidhje me zhvillimin bujqësor janë rritja e temperaturës, shtimi i kohës së kultivimit, valët e të nxehtit, zgjatja e periudhës së thatë, shtimi i dëmtuesve të bujqësisë dhe mundësia e mungesës së ujit vaditës në disa zona. Rritja e temperaturës mesatare vjetore ka ndikim direkt në zhvillimin e bujqësisë, pasi kulturat aktuale, të cilat përdoren në tokat bujqësore, nuk do të përshtaten maksimalisht me temperaturat në rritje, apo disa prej tyre do ta kenë të pamundur të përshtaten, e për pasojë do të kemi të korra më të ulëta nga bujqësia. Intensifikimi i valëve të të nxehtit dhe ulja e reshjeve në periudhen e kultivimit të bujqësisë pritet të ketë një ndikim të madh në zhvillimin e bujqësisë, pasi do të kërkojë sasi të mëdha uji për vaditje, ndërsa zona të cilat nuk kanë akses në kanalet vaditës do të reduktojnë maksimalisht sasinë e të korrave. Rritja e temperaturës dhe zvogëlimi i valëve të ftohta në dimër do të ketë një ndikim direkt në shtimin e dëmtuesve të të mbjellave bujqësore, pasi shumë prej këtyre dëmtuesve (duke mos pasur temperature të ulta në dimër) do të mund të shtohen duke rritur periudhën e riprodhimit të tyre. Kjo situatë do të çojë në rritjen e kostos së prodhimit, në sajë të përdorimit të pesticideve, në ulje të cilësisë së prodhimit dhe në rënie të rendimentit.

**Burimet ujore** (Energjitika, HEC-et dhe burimet ujore)<sup>182</sup>: Përbërësit kryesorë të ciklit hidrologjik janë avullimi, transpirimi dhe reshjet. Ndryshimi i parametrave klimatikë, rrezatimi diellor, shpejtesia e erës, temperatura dhe lagështia ndikojnë drejtpërdrejt në fenomenin e avullimit. Ndryshimi i avullimit dhe reshjeve do të ndikojë në bilancin ujqor në vend. Reshjet mesatare vjetore në dekadat e ardhshme priten të ulen rreth 18%, ndërsa rastet e shirave intensive parashikohen të jenë më të shpeshta duke rritur shpeshtësinë e përmbytjeve. Duke patur parasysh që energjia elektrike në vend të plotësohet nga HEC-et, rritja e temperaturës do ta shtojë mungesën e ujit, i cili do të duhet për të plotësuar nevojat përgjatë gjithë vitit për energji dhe bujqësinë. Zgjatimi i periudhës së thatë në stinën e verës, shkrirja e dëborës në male, dhe mungesa e reshjeve në periudha të caktuara të vitit do të jetë një problem madhor në plotësimin e nevojave me ujë për sektorë të ndryshëm si energji, bujqësi etj. Prodhimi i energjisë pritet të ketë vështirësi në manaxhimin e situatave, duke qënë së ndarja e sasisë së reshjeve përgjatë vitit do të ketë diferenca të konsiderueshme. Rezervuarët e HEC-eve parashikohet të tejmbushen në periudha të caktuara dhe të vuajnë mungesën e sasisë së ujit në periudhën e verës. Megjithatë, edhe në rastin më të keq, diferenca midis prodhimit dhe nevojës për ujë mund të zbutet me çështje teknike dhe të politikave.

Përmbytjet nga rrjedhat e lumenjve do të jenë një problem serioz dhe me i shpeshtë në dekadat e ardhshme. Shirat e rrëmbyeshme që sjellin vërshimin maksimal të lumenjve në kohë të shkurtër parashikohet të jenë problemi kryesor i përmbytjeve në pjesën fushore të vendit. Periudha nëntor-mars kur sasia e reshjeve është më e madhe (80-85% e sasisë vjetore) parashikohet periudha më problematike për përmbytjet.

Vlen të theksohet se rritja e temperaturës sjell edhe zgjatjen e harkut kohor brenda të cilit mund të kultivohet përgjatë vitit, gjë që mund të ketë ndikime pozitive në bujqësi. Mundësia e kultivimit në një periudhë më të gjatë kohore dhe mundësia e futjes së kulturave të reja në bujqësi mund të çojë në rritjen e prodhimtarisë.

**Popullsia:** Ndryshimi i klimës parashikohet të ndikojë në shëndetin e banorëve në zonën bregdetare dhe veprimtarinë e tyre ekonomike kryesore si turizmi dhe bujqësia. Krahas kësaj, do të ketë rreziqe kërcënuese të cilat do të ndikojnë në sigurinë e jetës (përmbytjet, zjarri, rritja e mikrobeve dhe insekteve që transmetojnë sëmundje ngjitëse, ulja e rezervave të ujit të pijshëm, ushqimi, energjia, cilësia e mjedisit dhe peizazhit).

Lagështia e tepërt dhe përmbytjet do të kenë një ndikim të madh në popullsi pasi shumica e kateve të para të banesave nuk kanë hidro-izolim. Në vitet e ardhshme priten përmbytje (si ato të 2010) dhe stuhi të cilat, krahas dëmeve materiale, mund të shkaktojnë dhe humbje në njerëz, ashtu si në shumë vende europiane dhe fqinje. Në zonat bregdetare, nga rritja e frekuencës së përmbytjeve, pritet që ndikim të madh të ketë në infrastrukturë sipërfaqësore dhe nëntokësore si kanalizime, rrjet energjie, telefoni, interte etj.<sup>183</sup>

- Përfundime dhe rekomandime

Ndryshimet klimatike tashmë janë një realitet. Ky ndryshim i klimës ka ndikim të madh në shumë fusha të zhvillimit të vendit, sidomos në atë bujqësor dhe energjistik. Vetëm sektori i bujqësisë ka rreth 50% të punësuarve në Shqipëri. Gjithashtu, kontributi i këtij sektori në PPB arrin në 24%.<sup>184</sup> Në këtë kontekst, shihet më se e rëndësishme të merren masa të rëndësishme për planifikimin e zhvillimit të sektorit të bujqësisë dhe industrisë duke patur parasysh ndryshimet klimatike. Disa nga këto masa në bujqësi përfshijnë përshtatjen e kulturave bujqësore me ndryshimet e klimës, manaxhimin e duhur të burimeve ujore, rritjen e kapaciteteve kulluese dhe ato ujitëse, masa për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve, mbrojtja ndaj erozionit të tokës etj.

Edhe për Bashkinë Gramsh, sektorët që do të preken më shumë nga ndryshimet klimatike janë bujqësia, biodiversiteti, toka dhe ekosistemet ujore<sup>185</sup>. Në territorin e Bashkisë Gramsh kalojnë ujërat e lumit Devoll, të cilat në kushtet e rritjes së nivelit do të dëmtojnë tokat bujqësore pranë rrjedhës së tij apo edhe vendbanimet e ndryshme. Për këtë arsye, duhen marrë masa për fortifikimin e barrierave të brigjeve të lumenjve, kryesisht në zonat më problematike, të cilat janë të prekura edhe nga erozioni lumor. Gjithashtu duhen marrë masa për përmbushjen e nevojave ushqimore në raste ekstreme, ku kulturat bujqësore dëmtohen nga përmbytjet masive dhe nga periudhat e gjata të thatësirës.

## **6.6 Zonat e nxehta (problematike) mjedisore**

Gjatë kohës së sistemit komunist në Republikën e Shqipërisë ndotjet më të mëdha janë trashëguar nga aktiviteti industrial. Të gjitha industritë të cilat funksionuan gjatë asaj periudhe prodhuan mjaftueshëm mbetje, të cilat në vitet që pasuan u magazinuan pa asnjë masë minimale të sigurisë teknike. Në vitin 1990, industria kontribuonte në më shumë se 37% të GDP-së në vend. Ky tregues u ul në 12% në vitet 1999 ku edhe sot karakterizohet nga ulje-ngritje, të cilat janë kryesisht produkt i politikave të paqëndrueshme miratuar e shfuqizuar në vendin tonë.

Problematikat lidhur me këto zona filluan të dilnin në pah dhe e vështirësuan më tepër situatën si pasojë e mbylljes së industrive dhe lënien në mënyrë të pakontrolluar të depozitave me kimikate dhe elementëve ndotës në mjedis, zhvillimi i zonave urbane pranë zonave industriale, si dhe papërgjegjshmëria e individit.

Sot, numurohen të paktën 9-10 vatra të nxehta mjedisore (*prioritare*) në të gjithë vendin, por lista mund të zgjatet nëse tregohemi të matur dhe realistë kur marrim në konsideratë ndotjet e

vazhdueshme të prodhuara nga ujërat e ndotura të zonave urbane dhe industriale si dhe vlerësojmë gjëndjen e venddepozitimeve në të gjithë vendin e veçanërisht në venddepozitimet që ndodhen në brigjet e lumenjve apo në zona totalisht të papërshtatshme nga ana mjedisore.

Në Bashkinë Gramsh, industria ka qenë sektori kryesor i zhvillimit të kësaj Bashkie, e fokusuar në sektorin e prodhimit të baterive dhe prodhimin e armëve.

Referuar raportit të UNECE-s mbi hotspotet në vendin tonë, të hartuar në vitin 2012<sup>186</sup>, Bashkia e Gramshit nuk ka asnjë veprimtari ose ish-veprimtari të cilësuar si vatër e nxehtë mjedisore, por në territorin e Bashkisë së Gramshit shtrihen zona të ndotura nga: veprimtaria industriale, mbetjet urbane, ujërat e ndotura etj, veprimtari të cilat kanë shkaktuar një ndotje të akumuluar në territor.

**Uzina e prodhimit të baterive (jug-lindje të qytetit)** në Gramsh nuk është identifikuar si zonë e nxehtë mjedisore, por mendohet se mbetjet dhe ndotja që ka shkaktuar gjatë kohës që ka funksionuar është e madhe. Në zonën industrial, e cila është jashtë funksionit, mendohet se vazhdojnë të jenë të depozituara sasi të mëdha të cianurit të pluhurit të zhivës<sup>187</sup>.

Në këtë sipërfaqe janë të depozituara ndër vite sasi të mëdha baterish. Bateritë kanë në ndërtimin e tyre element ndotës, si: plumbi dhe zhiva, të cilat njihen për efektin e tyre shkatërrues për mjedisin, por sidomos dhe për jetën e njerëzve.

Plumbi mund të hyjë në trupin tonë nëpërmjet ushqimit ose ujit që përmban këtë element, i cili mund të shkaktojë shumë probleme shëndetësore. Plumbi mund të ndikojë pothuajse në çdo organ dhe sistem në trupin tuaj. Tek të rriturit, plumbi mund të rrisë presionin e gjakut dhe të shkaktojë fertilitet, çrregullime nervore dhe të muskujve, etj. Prani e plumbit mund të shkaktojë nervozizëm dhe mund të ndikojë në aftësinë për t'u përqëndruar<sup>188</sup>.

Plumbi është veçanërisht i rrezikshme për fëmijët sepse mund të shkaktojë anemi, dhimbje stomaku, dobësi të muskujve dhe dëmtim të trurit. Edhe në nivele të ulëta, plumbi mund të ndikojë në rritjen mendore dhe fizike të fëmijës<sup>189</sup>.

Në rastet kur njerëzit kanë kontakt me merkurin shkaktohen probleme me fjetjen, anoreksinë, ankthin, probleme me dëgjimin e shikimin<sup>190</sup>. Gjithashtu, nën efektin e shkurtër të merkurit shkaktohet probleme në frymëmarrje, irritim i syve, dhimbje koke, shije metalike në gjuhë, etj<sup>191</sup>. Gjëndja duhet parë si problematike sepse godinat e Uzinës janë kthyer në apartamente për të jetuar familjet.

**Uzina mekanike Gramsh (Çekin)**, siguron prodhimin e makinerive me precision të lartë, trajtime në të nxehtë dhe riparime për industrinë e mbrojtjes<sup>192</sup>. Që prej vitit 2009, nëpërmjet Urdhrit Nr.997, datë 07.07.2008, në Uzinë bëhet dhe demontimi i armatimeve të tepërta dhe riparimi i armëve ekzistuese.

Për prodhimin e armëve ushtarake përdoren element me potencial të lartë rrezikshmërie. Përbërësit metalor, që përdoren zakonisht në prodhimin e municioneve dhe të armëve përfshijnë plumbin (Pb), bakrin (Cu), merkurin (Hg), etj, për shembull plumbi (Pb) përbën 95-97 % të komponentëve metalike të municioneve ushtarake<sup>193</sup>.

**Mbetjet e ngurta industriale:** Bashkia e Gramshit është ndeshur edhe me problemin e depozitimit të mbetjeve të ngurta industriale gjatë kohës që Uzina mekanike dhe ajo e prodhimit të baterive kanë ushtruar aktivitetin e tyre në bashki. Si pasojë e aktivitetit të tyre ndër vite, sot në Bashki nuk ka një plan se ku të depozitohen këto mbetje, ndaj dhe nuk dihet ku përfundojnë ato. Ndotja ë

shkaktohet nga këto mbetje nuk mund të përcaktohet, për aq kohë sa nuk dihet se sa është sasia e prodhuar<sup>194</sup>.

Ndikimi i ndotjes me metale të rënda nga burimi ndotës (zona industriale) shtrihet deri në zonën e lumit Devoll, sepse afërsia me të është afërsisht 400-450m. Kjo veprimtari industriale ka ndikuar edhe në ndotjen e tokave bujqësore përreth.

**Shkarkimet e lëngshme industriale:** Gjatë gjithë kohës së funksionimit të zonës industriale, ndotjet e lëngshme janë shkarkuar dhe shkarkohen në lumin Devoll. Krahas aktiviteteve madhore industriale, në territorin e Bashkisë Gramsh janë identifikuar disa aktivitete më të kufizuara, të cilat ndotjen dhe mbetjet e gjeneruara i shkarkojnë në ujërat e lumit Devoll apo përrenjëve më të afërt. Ndër to mund të përmëdim mbetjet nga furra e gëlqereve, mbetjet nga aktiviteti i përpunimit të inerteve, mbetje urbane dhe inerte të depozituara në brigje dhe shtratin e trupit uJOR.

#### **6.6.1 Zona/aktivitete potenciale me ndotje të pavlerësuar**

Në këtë seksion, krahas zonave të nxehta mjedisore, të cilat janë të identifikuar dhe ndotja e tyre është adresuar dhe monitoruar, po pasqyrojmë edhe disa zona të cilat nevojitet të monitorohen me qëllim identifikimin e ndotjes së tyre në mjedis.

**Venddepozitimi i vjetër i mbetjeve:** Së pari, vend-depozitimi i vjetër i mbetjeve në Bashkinë e Gramshit ka qënë i vendosur në dalje të qytetit. Ai ka qënë i vendosur thujse në trupin e lumit Devoll, pranë fshatit Cërrujë. Por me ndërtimin e digës së hidrocentralit të Banjës kërkohet zhvendosja e këtij venddepozitimi, sepse paraqiste probleme për krijimin e liqenit. Për ndotjen e shkaktuar nga vend-depozitimi i vjetër nuk është identifikuar sasia e shllameve të depozituara në shtresat nëntokësore. Njëkohësisht nuk është vlerësuar sasia e gazeve metan CH<sub>4</sub> i grumbulluar ndër vite, në formë jastikësh, në nënshtresat e këtij vend-depozitimi dhe gazi i formuar nga procesi i kompostimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Gramsh.

Afërsia me shtratin e lumit Devoll dhe pozicionimi i tij mbi akuiferin ndërkokrrizor me ujëpërcjellshmëri mesatare në lumin Devoll krijonë dhe përbën një problem me shkarkimet dhe infiltrimet e shllamve të çliruara nga dekompozimi i mbetjeve.



Figura 37 Vendepozitimi i vjetër i mbetjeve, Cërrujë, Bashkia Gramsh



Burimi: Ministria e Zhvillimit Urban, Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

### **6.6.2 Përfundime dhe rekomandime**

Duke patur parasysh rreziqet që i kanosen shëndetit të njeriut dhe mjedisit, rekomandohet që Bashkia të marr masa për pastrimin dhe rehabilitimin e zonave të ndotura dhe kontrollin e ndotjes nga industria, venddepozitimit të vjetër dhe të ri të mbetjeve dhe shkarkimet e ujërave të ndotura.

Monitorimi i shkarkimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura industriale dhe urbane duhet të përfshihet në axhendën e Inspektoriatit Mjedisor Rajonal, duke referuar kështu në mënyrë dinamike cilësinë e ujërave sipërfaqësor të Bashkisë Gramsh, si dhe të adresohet secili shkelës nëpërmjet parimit ndotësi-paguan.

## **7. Shërbimet publike**

### **7.1 Furnizimi me ujë**

Aktualisht, sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane operon nëpërmjet shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Gramsh, e cila ofron shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe gjithashtu siguron largimin e ujërave të ndotura.

Bashkia e Gramsh siguron furnizimin e popullatës me ujë për konsum publik në pjesën më të madhe nga burimi i Kërpicës në malin e Tomorrit në jug-lindje të qytetit të Gramshit në një lartësi prej 390m mbi nivelin e detit. Prurja maksimale e këtij burimi  $1\text{m}^3/\text{s}$ , me një regjim të qëndrueshëm.

Klorinimi ndodh në depon kryesore në vendburim, i cili injektohet direkt në rrjetin e transmetimit. Burimi i Kërpicës i plotëson kërkesa e qytetit të Gramshit për furnizimin me ujë të pijshëm.

Cilësia e ujit nga burimi Kërpicës që përdoret për furnizimin e popullatës paraqitet mjaft i mirë, kjo sepse burimi del në shkëmbinjtë dhe nga akuiferi me porozitet çarje-karst.

Këto ujëra janë të një cilësie të mirë si rrjedhojë e një sërë faktorëve, ndër më të rëndësishmit mund të përmendim i) mungesën e infiltrimeve të ujërave të ndotura në akuiferin nga i cili furnizohet ky burim dhe ii) respektimin e zonave higjeno-sanitare.

Kapaciteti stokues i ujit të pijshëm për popullatën e Bashkisë Gramsh përfaqësohet nga 35 rezervuarë, të mëdhënj e të vegjel, që u shërbejnë komuniteteve në territor, volumi i përgjithshëm prej 1670 m<sup>3</sup> paraqitet nga tabela e mëposhtme:

Tabela 33. Volumi i depozitimit dhe furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm

N r	NJËSIA ADMINISTRATIVE	Ujësjellesi	Burim nga funizohet	Fshati që funizohet	Banoret	Depo Uji
1	<b>B A S H K I A G R A M S H</b>	Ujës.Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	Qyteti	14396	400 m3
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Pishaj</i>	905	Nga qyteti
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Cekin</i>	855	200 m3
		<b>Ujësjellesi</b>	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Qerret</i>	286	20 m3
	<b>P</b>	<b>Kerpice</b>	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Shemriz</i>	563	50 m3
	<b>I</b>		<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Trashovic</i>	367	50 m3
2	<b>S</b>		<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Fshati Balloll</i>	279	nga Llalla
	<b>H</b>		<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Fshati Llalle</i>	246	50 m3
	<b>A</b>	<b>Ujësjellesi</b>	<i>St.pompave Holte</i>	<i>Fshati Kotorr</i>	435	20 m3
	<b>J</b>	<b>Kotorr</b>	<i>St.pompave Holte</i>	<i>Fshati Gjorgjovin</i>	248	20 m3
		<b>Ujësjellesi</b>	<i>St.pomp. Gjorgjovine.</i>	<i>Fshati Ceruje</i>	650	80 m3
		<b>Gjorgjovin</b>	<i>St.pomp. Gjorgjovine.</i>	<i>Fshati Drize</i>	508	30 m3
		<b>Ujës.Galigat</b>	<i>Burimi Proshoves</i>	<i>Fshati Galigat</i>	479	40 m3
		<b>Ujës.Stror</b>	<i>Burimi Duzha</i>	<i>Fshati Stror</i>	263	30 m3
					<b>6084</b>	
		<b>Ujësjellesi</b>	<i>Burimi Bulcar</i>	<i>Fshati Kodovjat</i>	423	30 m3
3	<b>K O D O V J A T</b>	<b>Kodovjat</b>	<i>Burimi Bulcar</i>	<i>Fshati Bersnik</i>	513	20 m3

		Ujës.Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Mashan</i>	622	50 m <sup>3</sup>
		Ujës.Zamash	<i>Burimi =</i>	<i>Fshati Zamsh</i>	162	20 m <sup>3</sup>
					<b>1720</b>	
4	<b>TUNJE</b>	Ujës.Kerpice	<i>St.pompave Shemrize</i>	<i>Fshati Lubinje</i>	517	30 m <sup>3</sup>
					<b>517</b>	
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Sotire</i>	238	50 m <sup>3</sup>
			<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Paktos</i>	53	20 m <sup>3</sup>
5	<b>KUSHOVE</b>	Ujës.jellesi	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Kushov</i>	276	30 m <sup>3</sup>
		Kerpice	<i>Burimi Kerpice</i>	<i>Fshati Bregas</i>	142	50 m <sup>3</sup>
			<i>St.pompave Bregas</i>	<i>Fshati Gjeraqine</i>	88	20 m <sup>3</sup>
					<b>797</b>	
6	<b>LENIE</b>	Ujës.Taragjin	<i>Burimi Komjanit</i>	<i>Fshati Taragjin</i>	57	20 m <sup>3</sup>
		Ujës.Lenie	<i>Burimi Komjanit</i>	<i>Fshati Q.Lenie</i>	120	15 m <sup>3</sup>
					<b>177</b>	
7	<b>POROCAN</b>	Ujës.Porocan	<i>Burimi Carciaj</i>	<i>F. Porocan Qënder</i>	lokale	12 m <sup>3</sup>
	<b>S</b>		<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Skenderbegas</i>	440	50 m <sup>3</sup>
	<b>K</b>	Ujës.jellesi	<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Narte</i>	323	30 m <sup>3</sup>
	<b>E</b>	Skenderbegas	<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Harunas</i>	153	20 m <sup>3</sup>
	<b>N</b>		<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Zenalas</i>	140	10 m <sup>3</sup>
	<b>E</b>		<i>Burimi Shkozës</i>	<i>Fshati Shima</i>	221	20 m <sup>3</sup>
8	<b>R</b>	Ujës.Vidhan	<i>Burimi Beges</i>	<i>Fshati Vidhan</i>	141	20 m <sup>3</sup>
	<b>B</b>	Ujës.Siman	<i>Burimi Vashes</i>	<i>Fshati Siman</i>	138	20 m <sup>3</sup>
	<b>E</b>	Ujës.Siman	<i>Burimi Kroi Bardhe</i>	<i>Fshati Kotke</i>	220	20 m <sup>3</sup>
	<b>G</b>	Ujës.Ermenje	<i>Burimi Shkuriqit</i>	<i>Fshati Ermenje</i>	216	20 m <sup>3</sup>

	<b>A</b>	<b>Ujës.Menkoll are</b>	<b>Burimi Sekes</b>	<b>Fshati Fushez</b>	119	20 m3
	<b>S</b>	<b>Ujës.Bletes</b>	<b>Burimi Gurres</b>	<b>Fshati Bletes</b>	147	20 m3
					<b>2258</b>	

Burimi: Ujësjiellës-Kanalizime Gramsh; Përgatiti: MetroPolis, 2016

Duke qënë gjithnjë në gjëndje pune, rezervuarët, klorifikatori dhe vetë sistemi i tubacioneve nuk iu janë nënshtruar rregullisht proceseve mirëmbajtëse si pastrim-shpëlarje dhe dezinfektim.


Gjithashtu agjentët atmosferikë si edhe në disa raste vegjetacioni kanë ndikuar negativisht në higjenën e këtyre elementëve. Siguria e tyre është një aspekt tjetër i cili nuk shfaq besueshmëri duke marrë parasysh faktin se në këto elementë mund të kenë akses edhe persona të paautorizuar.

VKM-ja nr. 102, datë 16.03.1992, “Për normat e përdorimit dhe çmimin e ujit të pijshëm në qytet dhe në fshat” përcakton që normat e përdorimit të ujit të pijshëm për efekt pagese për përdoruesit familjarë, të cilët nuk kanë matës, të jetë 150 litra ujë në ditë për frymë.

Norma e konsumit për popullatën ndryshon nga 90-120 litra ujë në ditë për frymë sipas kategorive (Banesa, Institucione, Biznese).

Gjatë kësaj llogaritjeje janë marrë parasysh humbjet në rrjet, të cilat për qytetin e Gramshit përlllogaritet të jenë në masën deri në 30-40%. Disa prej NjA-ve në Bashkinë Gramsh nuk kanë infrastrukturën minimale ndaj zgjidhja e tyre është me puse në oborret e shtëpive, apo marrja nga burime sipërfaqësore.

Figura 38 Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm, Bashkia Gramsh



Burimi : Ujësjiellës-Kanalizime, Bashkia Gramsh; Punoi: MetroPOLIS, 2017

### **7.1.1 Pus-shpimet**

Popullsia banuese në zonat e pashërbyera ka ndërmarrë në mënyrë të organizuar, ose individuale iniciativën për të realizuar pus-shpime, për të përmbushur nevojat e përditshme, për ujë të pijshëm dhe konsum sekondar.

Bashkia Gramsh dhe ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, mbështetet kryesisht tek prurjet që vijnë nga burimi Kërpicës Në të njëjtën linjë operojnë edhe NjA-të e tjera të cilat e kanë mbështetur shërbimin e furnizimit duke shfrytëzuar pus-shpime apo burime sipërfaqësore brenda territorit të tyre dhe afër qendrave të banuara.

Masa që duhen ndërmarrë për rritjen e efikasitetit të këtij sistemi kanë të bëjnë kryesisht me kontrollin dhe monitorimin e vazhdueshëm të sasisë së ujit të pijshëm të prodhuar dhe të faturuar.

Masa të tjera që mund të parashikohen që të ketë rehabilitim të sistemit dytësor dhe kryesor të furnizimit me ujë dhe të lidhjeve me shtëpitë janë : i) rehabilitim i rrjetit të brendshëm të furnizimit me ujë, ii) instalimi i sahatëve matës në shkallë të gjerë si edhe pajisje të tjera.

Në vlerësimin tonë nevojitet që për të qënë sa më miqësorë me mjedisin, të kontrollohen në mënyrë dinamike sasi të ujit të prodhuar nga pus-shpimet në varësi të kërkesës për konsum. Kjo realizohet me anë të sistemit SCADA<sup>195</sup> i cili në mënyrë automatike do të monitorojë nivelin e ujit të stokuar në depozitat e lartpërmendura të ujit të pijshëm e më pas po në mënyrë automatike do të udhëzojë pompat në lidhje me sasinë e nevojshme të ujit për t'u pompuar nga thellësia.

Ky sistem mbështetës kërkon një investim fillestar, por kontributi që ai jep në ruajtjen e ujërave natyrale është mjaft i rëndësishëm, duke ulur në të njëjtën kohë edhe humbjen e ujit që shkarkohet në tepërplotësat e depozitave, pasi ato janë mbushur, por nuk janë komanduar për t'u mbyllur.

Gjithashtu, një masë tjetër ka të bëjë me monitorimin e të gjithë linjës magjistrale si edhe nivelet kryesore e dytësore të rrjetit të shpërndarjes për konstatimin dhe shkëputjen e të gjitha lidhjeve të paligjshme.

Kjo masë do të ndikonte duke reduktuar ndjeshëm humbjet prej dëmtimeve në rrjet, si edhe do të ndihmojë që sasia e faturuar e ujit të jetë sa më pranë sasisë së prodhuar, duke rritur kështu edhe rentabilitetin e ndërmarrjes e duke i ulur humbjet sa më pranë nivelit të humbjeve të llogaritura në projektim.

### **7.1.2 Problematikat në sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm**

Për sa i përket problematikave që hasen në sektorin e furnizimit me ujë, ato janë të llojeve të ndryshme dhe përfshijnë kryesisht:

- Mungesa e shtrirjes të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh.
- Gjëndjen jo të mirë të sistemit aktual për shkak të tubacione të vjetëruara, ose të bllokuara.
- Humbjet në sistem: aktualisht humbjet vlerësohen të jenë midis 30-40%. Këto humbje në bazë të strategjisë kombëtare të furnizimit me ujë të popullatës duhet të reduktohen deri në masën 30%.


## 7.2 Ujërat e ndotura

Shërbimi i grumbullimit të ujërave të ndotura urbane ofrohet në qytetin e Gramshit dhe pjesërisht në Kodovjat dhe Çekin nëpërmjet sistemit të kanalizimeve. Sa i përket qytetit të Gramshit shërbimi i ofruar është në nivele të pakënaqshme, kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhe i bllokuar, i dëmtuar si pasojë e vjetërsisë së tij. Vitet e fundit janë bërë ndërhyrje duke rikonstruktuar vetëm problematikat kryesore të sistemit të kanalizimeve në Gramsh.

Ky sistem është i kombinuar, mbledh si shkarkimet e ujërave të ndotura urbane, industriale dhe ujërat shiut. Ujrat e përdorura trajtohen në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura, i cili u ndërtua në vitin 2016.

Në të gjithë fshatrat e NjA-se përdoren gropa septike jashtë kushteve higjieno-sanitare për largimin e ujërave të ndotura urbane nga shtëpitë, shpesh hasen raste ku ujrat e ndotura derdhen direkt në trupat ujorë sipërfaqësor, përrenj dhe lumenj.

Figura 39 Mbulimi me sistemin e kanalizimeve, Bashkia Gramsh



Punoi: MetroPOLIS, 2016

Aktualisht janë të identifikuara disa pika të shkarkimeve të ujërave të ndotura urbane në lumin e Devollit, kryesisht të zonave rurale, të cilët bëjnë shkarkimin direkt në ujrat sipërfaqësor.

Diametri i tubave variojn nga 200 deri në 800mm. Kanalet janë kryesisht tuba betoni pa bazament dhe me bashkime me llaç. Pothuaj 70-80% e rrjetit është shtrire para vitit 1980.

**Zonat Urbane:** Sot, Bashkia Gramsh mbulon me shërbimin e kanalizimit të ujërave të ndotura rreth 80-90% të popullsisë së NjA-së të Gramsh. Aktualisht ujrë e përdorura trajtohen në impiantin e trajtimit të ujrave të ndotura në pjesën veri-perëndimore të qytetit.

**Zonat Rurale:** Në zonën rurale të Bashkisë Gramsh nuk ekziston asnjë sistem i organizuar inxhinierik i mbledhjes dhe largimit të ujërave të ndotura (pjesërisht Kodovjat dhe Çekin, por që nuk janë plotësisht funksional). Ujërë e ndotura të çdo shtëpie largohen në gropa individuale në oborret e shtëpive, të cilat nuk respektojnë standardet higjeno-sanitare të gropave septike me ose pa filtrim. Në mjaft raste largimi i ujërave të ndotura nga këto gropa bëhet në kanale të hapura kulluese që kalojnë pranë shtëpive të tyre dhe janë në kundërshtim me kushtet teknike e sanitare të largimit të tyre.

Shkarkimi dhe trajtimi i ujërave urbane dhe industriale është një ndër problemet kryesore që haset sot në zonat rurale të bashkisë Gramsh. Përzjerja e lëndëve ndotëse organike dhe inorganike (ujërë e ndotur urban e ato industrial) si edhe largimi i tyre deri në grykëderdhje përbën një shqetësim të madh mjedisor e shoqëror për të gjithë banorët e zonave rurale.

o Problematikat

Sikurse u pa më sipër, rrjeti i kanalizimeve në Bashki është relativisht i amortizuar dhe nuk përmbush me efikasitet funksionin bazë. Përveç Qytetit të Gramshit, pjesa tjetër e Bashkisë nuk mbulohet me rrjet kanalizimesh. Për më tepër, edhe në zonat ku ky rrjet shtrihet, hasen shumë probleme. Kjo për shkak se sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është i vjetëruar, duke shkaktuar kështu ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe kanaleve kulluese e vaditës, si pasojë e derdhjes së ujërave të ndotura të patrajuara në mjedis.

Si përfundim mund të thuhet se në Bashkinë Gramsh:

- Kanalizimi i ujërave të ndotura është i pjesshëm dhe ofrohet vetëm në zonën urbane.
- Shërbimi i orfuar është në nivele të pakënaqshme, pasi sistemi i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në pjesën më të madhë i bllokuar, i dëmtuar.
- Ujërë e ndotura urbane vazhdojnë të ndosin pjesën më të madhe të ujërave sipërfaqësore si pasojë e shkarkimit të patrajuar të tyre drejtpërdrejtë në trupat ujore (kryesisht zonat rurale).
- Zonat Rurale nuk kanë rrjet kanalizimesh të ujërave të ndotura (largimi i ujërave bëhet nëpërmjet gropave septike, jashtë standardeve higjeno-sanitare).
- Nevojitet që sistemi i grumbullimit të ujërave të ndotura të projekohet i ndarë nga sistemi i cili pret ujërë e larta, kjo për arsye të shmangies së mbingarkesës e cila shpesh rezulton në përmytje dhe daljen në sipërfaqe të ujërave të ndotura.
- Nevojiten të gjenden zgjidhje për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave në zonat rurale, për të eliminuar përdorimin e gropave septikë jashtë kushteve higjeno-sanitare. Vazhdimisht praktikohen mënyra të ndryshme të cilat janë mjaft efektive sa i përket eliminimit të ndotjes duke minimizuar kështu ndotjen që shkarkohet nga gropat septike.

## 7.3 Menaxhimi i mbetjeve

### 7.3.1 Menxhimi I mbetjeve të ngurta urbane në Bashkinë Gramsh

Me manaxhim të mbetjeve nënkuptohet grumbullimi i mbetjeve të ngurta nga pikat e grumbullimit të mbetjeve, shpërndarë në funksion të dëndësisë së popullatës dhe aktiviteteve private e shtetërore dhe, transportimi dhe trajtimi i tyre, si edhe depozitimi i tyre përfundimtar.

Bashkia Gramsh aktualisht mbulon me shërbim të menaxhimit të mbetjeve urbane NjA-në e Gramshit dhe NjA-në Pishaj dhe Kodovjat, dy të fundit në masën 30%. Në NjA-në Gramsh grumbullimi dhe largimi i mbetjeve kryet nëpërmjet sipërmarrjes private “Kurora” Shpk, ndërsa NjA Pishaj dhe Kodovjat bashkia e kryen vetë këtë shërbim. Përveç NjA-së Gramsh dhe pjesërisht Pishaj dhe Kodovjat, në të gjitha NjA-të e tjera nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane. Menaxhimi i mbetjeve në NjA-në Gramsh , Pishaj dhe Kodovjat bëhet me skemë tepër bazike, ku proceset e mbetjeve kalojnë nga gjeneruesi në pika grumbullimi, mbledhja dhe depozitimi në fushën e depozitimit të mbetjeve, e cila nuk plotëson standartet e një landfilli sanitar. .

Sot, Bashkia Gramsh mbulon me shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve të ngurta urbane (MNU) 50% të popullsisë, e cila është e përafërt me numrin e popullsisë të NjA-së Gramsh dhe të fshatrave Pishaj dhe Kodovjat. NjA-të në të cilat nuk ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe largimit të MNU-së, janë gjetur zgjidhje individuale nga banorët, të cilët i depozitojnë ato në pika të pa autorizuara dhe shpesh herë përgjat rrjedhave të përrenjëve dhe lumenjëve.

Si në të gjitha qendrat urbane të vendit, edhe në Bashkinë Gramsh, mbledhja e mbetjeve urbane bëhet me metodat tradicionale. Nga zyra e urbanistikës është përcaktuar skema e shpërndarjes në terren të pikave mbledhëse të mbetjeve të ngurta urbane. Në qytetin e Gramshit funksionojnë 101 pika të tilla, 90 prej të cilave janë vendosur kazanë prej llamarine me vëllim 1100L, ndërsa 11 pika të tjera janë platforma prej betoni. Personeli përkatës i subjektit “KURORA” shpk evadon çdo ditë, mbetjet urbane, duke i dërguar ato në fushën e depozitimit të përkohshëm të tyre. Transporti i mbetjeve urbane bëhet nga makina teknologjike me kapacitet 7 ton. Distanca mesatare e transportit nga vëndet e mbledhjes së mbetjeve urbane, në fushën e re të depozitimit të përkohshëm të tyre është rreth 5 km.

Gjëndja e rrugëve ku lëviz mjeti i transportit të mbetjeve urbane është përgjithësisht i mirë. Trafiku në rrugën që shkon në venddepozitimin e mbetjeve mund të vlerësohet disi intensiv sepse ky është një aks rrugor që lidh qytetin e Gramshit me Njësitë Administrative Kodovjat dhe Kukur dhe më tej deri në Qytetin e Korçës.

### 7.3.2 Vend-Depozitimi i mbetjeve urbane

**Venddepozitimi i ri i mbetjeve:** Përveç vend-depozitimit të vjetër, në Gramsh është ndërtuar vend-depozitimi i ri i mbetjeve në Çkrezë, i cili ndodhet afërsisht 3.4 km<sup>196</sup> larg nga qendrës së qytetit dhe vetëm 300 m nga Lumi Devoll. Ky venddepozitim është vënë në funksion në vitin 2016. Në një moment të mëvonshëm, mendohet të bëhet seleksionimi i mbetjeve dhe në landfillin rajonal të depozitohen vetëm mbetjet e pariciklueshme.



Deri atëherë, rekomandohet që Bashkia të marrë masa parandaluese që sigurojnë se elementët ndotës në përbërjen e shllamit të mos përfundojnë në ujërat sipërfaqësore të Devollit, dhe më tej në ujërat nëntokësore, që përkon me rrjedhën e Devollit në zonën e akuiferit me porozitet ndërkokrrizor.

Figura 40 Vend-depozitimi i ri i mbetjeve urbane, Bashkia Gramsh



Burimi: Google Earth, Punoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Venddepozitimi i ri dhe ai i vjetër i mbetjeve grumbullon mbetjet urbane vetëm për qytetin e Gramshit. Sa i përket mbetjeve urbane, për NjA e tjera të bashkisë, përrrenjtë dhe proskat janë vend depozitimi final i mbetjeve.

Venddepozitimet e mbetjeve, duke u kufizuar nga rrjedha sipërfaqësore, pranë lumit Devoll, kombinuar kjo edhe me elementët e sigurisë të cilët mungojnë në këtë sit, përbënë pikërisht një vatër të nxehtë mjedisore për Bashkinë Gramsh.

Problematikë emergjente paraqitet situata mbi: shkarkimet e gazrave CH<sub>4</sub> në atmosferë, NO, NH<sub>4</sub> si dhe dioksinat nga djegiet e ndryshme, shkarkimet e mbetjeve të ngurta mbi rrjedhën e ujërave sipërfaqësore, infiltrimin e shllameve nga dekompozimi i mbetjeve në ujërat nëntokësore.

### 7.3.3 Gjenerimi i mbetjeve të ngurta urbane

Gjatë vitit të shkuar Bashkia Gramsh ka gjeneruar rreth 8,810t/vit<sup>197</sup>, thënë ndryshe, afërsisht 24.1 t/ditë (gjenerim për të gjithë territorin e bashkisë). Norma mesatare e prodhimit të mbetjeve në territorin e bashkisë është 0.7 kg/ditë/banor. Norma e gjenerimit për bizneset është 10 kg/ditë, kjo për bizneset e vogla dhe të mëdha, ndërsa për institucionet është 12 kg/ditë. NjA-ja Burrel prodhon rreth 9.5 t/ditë mbetje urbane, ose rreth 39.4% të mbetjeve të gjeneruara në territorin e bashkisë.

Sasia më e madhe e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë vijnë nga sektori familjar, e ndjekur nga biznesi i vogël, biznesi i madh dhe me sasinë më të vogël të gjeneruar renditen institucionet. Nga sasia totale e mbetjeve të prodhuara në territorin e bashkisë rreth 72% e tyre

prodhohet nga sektori familjar, rreth 22% nga biznesi i vogel dhe i madh, rreth 6% nga institucionet.

Figura 41 Gjenerimi i mbetjeve sipas grupeve të prodhuesve në Bashkinë Gramsh,

Bashkia Gramsh						
Nr.	Emertimi	Njësia	Nr.	Norma kg	kg/dite	Ton/vit
1	Nr. Banore	fryme	24,484	0.7	17,138	6,255
2	Biznes i vogel	cop	493	10	4,930	1,799
3	Biznes i madh	cop	57	10	570	208
4	Institucione	cop	125	12	1,500	547
	<b>Shuma</b>				<b>24,138</b>	<b>8,810</b>

Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

Mbetjet e prodhuara nga NjA-të varet kryesisht nga numri i popullsisë në to, pasi sasia më e madhe e prodhuar e mbetjeve vjen nga prodhimet familjare, që do të thotë, që sektori i biznesit, apo sektorë të tjera kanë sasi më të ulët prodhimi mbetjesh sesa sektori familjar. Siç edhe është përmendur më lartë, NjA Gramsh ka sasinë më të madhe të gjenerimit të mbetjeve.

#### Vend-Depozitimi i mbetjeve urbane

Vend depozitimi i mbetjeve ndodhet rreth 5 km larg nga qendra e qytetit të Gramshit, në Fshatin Çekrezë. Vend depozitimi ndodhet shumë pranë nga Lumi Devoll. Ky vend-depozitim është vënë në funksion në vitin 2016. Në një moment të mëvonshëm, mendohet të bëhet seleksionimi i mbetjeve dhe në landfillin rajonal të depozitohen vetëm mbetjet e pariciklueshme. Deri atëherë, rekomandohet që Bashkia të marrë masa parandaluese që sigurojnë se elementët ndotës në përbërjen e shllamit të mos përfundojnë në ujërat sipërfaqësore të Devollit, dhe më tej në ujërat nëntokëse, që përkon me rrjedhën e Devollit në zonën e akuiferit me porozitet ndërkokrrizor.

NjA-të e tjera të Bashkisë Gramsh, nuk kanë vend-depozitime të përcaktuara duke rritur hapsirat e shpërndarjes së mbetjeve në pika më të vogla dhe vështirësuar mbledhjen dhe pastrimin e tyre.

#### **Metodat e depozitimit.**

Njihen dy metoda kryesore të depozitimit të mbetjeve urbane që janë:

- a) Depozitim i thjeshtë
- b) Depozitim i kontrolluar.

**Depozitim i thjeshtë** konsiston në shkarkimin/grumbullimin e mbetjeve urbane në terrene apo gropa të ndryshme, pa marrë masa të veçanta. Në shumicën e rasteve këto depozitime bëhen vatra të grumbullimit të insekteve, kafshëve dhe shpendëve parazitar që tërhiqen dhe ushqehen nga lëndët organike që përmbajnë këto mbetje. Kjo lloj metode sjell impakte serioze negative mbi mjedis, prishin pejsazhin, përhapin erëra të këqija, emetojnë gaze dhe lëngje që ndotin mjedisin dhe sjellin pasoja të vlerësueshme në shëndetin e popullatës në përgjithësi.

**Depozitimi i kontrolluar** konsiston në sistemimin e mbetjeve urbane në terrene të ndërtuara paraprakisht, duke i përshtatur ato për mbajtjen e mbetjeve urbane për kohë relativisht të gjata. Prgatitja konsiston në vendosjen e shtresave natyrore apo artificiale të cilat nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve që dalin nga dekompozim i mbetjeve në shteresat e tokës dhe kështu

eliminohet ndotja e tokës dhe e ujrave nëntoksore. Gjithashtu mënyra e sistemimit të mbetjeve në këto terrene bëhet e tillë që mund të mblidhet dhe administrohet biogazi që del gjatë dekompozimit të mbetjeve dhe, të përdoret ai për qëllime komunale.

#### **7.3.4 Mbetjet nga sektori i bujqësisë**

Kimikatet e përdorura në këtë sektor (pesticidet, plehurat kimike etj.) prodhojnë një nivel të konsiderueshëm ndotjeje e cila shkakton shqetësime në florë dhe faunë si pasojë e elementëve kimikë që shpërbëhen në këto ujëra. Ndotja shtohet në rast rreshjesh, të cilat shpërlajnë tokën bujqësore dhe përfundojnë në burime ujore sipërfaqësore. Duke parë shtimin e sasisë së përdorur të pesticideve në bujqësi, me futjen e bujqësisë në një sipërfaqe të vogël të fushave të Gramshit, mendohet se bujqësia është shndërruar edhe në burim ndotës për lumin Devoll.

#### **7.3.5 Mbetjet spitalore**

Mbetjet spitalore manaxhohen nga subjekti privat Medi-Tel, i cili i tërheq mbetjet periodikisht sipas kontratës së lidhur me subjektet përkatëse. Kompania MediTele ofron shërbimin e sterilizimit dhe grirjes së mbetjeve spitalore. Kjo mënyrë e trajtimit të këtyre mbetjeve zvogëlon vëllimin e tyre me anë të shpërbërjes mekanike, për t'i administruar më pas mbetjetet si urbane, jo të rrezikshme për komunitetin dhe mjedisin.

Mbetjet spitalore të gjeneruara në spitalin e Gramshit arrijnë në rreth 400 kg/ditë, ndërsa mbetje të tjera që mund të gjenerohen nga qendrat shëndetësore dhe nga subjekte të tjera nuk njihen.

Problematike mbeten edhe mbetjet farmaceutike. Rezulton se asnjëra nga farmacitë nuk ka marrëdhënie kontraktuale me ndonjë nga subjektet e licënuara në fushën e trajtimit të mbetjeve spitalore. Farmacitë i manaxhojnë vetë mbetjet, thjesht duke i depozituar në kazanët e mbetjeve urbane ose drejtpërdrejt në vend-depozitimin kryesor të mbetjeve. Siç mund të shihet, për sa i takon manaxhimin e mbetjeve, farmacitë kryejnë aktivitetin e tyre jashtë të gjithave kushteve ligjore.

#### **7.3.5 Mbetjet Elektronike**

Rregullat për trajtimin dhe klasifikimin e mbetjeve elektronike nuk e parashikojnë depozitimin e tyre në landfill. Pra, aktualisht Bashkisë Gramsh, duke qënë se të gjitha objektet apo materialet e klasifikuara si mbetje i manaxhon duke i transportuar dhe depozituar në vend-depozitimin e Gramshit apo pikave të tjera, i lind nevoja që të ndërtojë një qendër për trajtimin e diferencuar të kësaj rryme.

Gjenerues të këtyre mbetjeve janë si familjarët ashtu edhe bizneset private, që operojnë në Bashkinë Gramsh. E vetmja mënyrë për të arritur manaxhimin e mbetjeve tek ata dhe jo mbetja tek konteineri është nëpërmjet realizimit të një plani specifik të manaxhimit për këtë rrymë dhe aktivizimi i fushatave sensibilizuese.

**Ndotja nga shkarkimet industriale:** Në Gramsh ushtrojnë aktivitetin e tyre biznese të ndryshme në fushën e ndërtimit, agro-ushqimore, industri përpunuese etj. Sipas legjislacionit në fuqi për manaxhimin e mbetjeve industriale, bizneset duhet të mbajnë regjistrin e mbetjeve të prodhuara.

Megjithatë, situata lidhur me mbetjet industriale në Bashkinë Gramsh mbetet ende e paqartë dhe informacioni rreth këtij fluski mbetjesh nuk është lehtësisht i gjindshëm. Vlerësohet se Bashkia

Gramsh prodhon në total rreth 7 ton<sup>198</sup> mbetje në ditë, por nuk është saktësisht e përcaktuar se sa është sasia e mbetjeve industriale nga totali i prodhuar.

Një aspekt problematik për ndotjen deri në ditët tona ka qënë mënyra e trajtimit të mbetjeve industriale dhe ndotjes nga shkarkimet në ujë dhe tokë nga Uzina e montimit të armëve në Çekin dhe Uzina e prodhimit të baterive. Shpeshherë, kushtet teknike të trajtimit të mbetjeve industriale, si edhe kushtet e lejes mjedisore, nuk zbatoheshin duke stokuar mbetjet industriale në afërsi të lumit. Kjo Uzinë tashmë shërben si Fabrikë e demontimit të armëve. Mbetjet ushtarake industriale që dalin nga procesi i demontimit ruhen brenda territorit të godinës, në pritje të depozitimit të tyre në vend-depozitime të përshtatshme që deri më tani mungojnë në vendin tonë. Si rrjedhojë, për aq kohë sa Shqipëria nuk ka një venddepozitim të tillë, këto mbetje do të vazhdojnë të ruhen në territorin e uzinës.

Probleme të ndotjes së burimeve ujore përbën dhe venddepozitimi i kimikateve në qytetin e Gramshit. Në këtë venddepozitim janë akumuluar mbetje gjatë viteve. Sa i takon këtyre mbetjeve Bashkia nuk ka informacion rreth sasisë që është depozituar aty. Për momentin nuk ka asnjë plan për mënyrën se si do të trajtohen këto mbetje apo nëse ka një plan për transferimin apo trajtimin e tyre.

Një burim tjetër i ndotjes industriale janë edhe *ndërrimi apo grumbullimi i vajrave të makinave*, të cilat mund të përdoren si lëndë djegëse. Ato lehtësisht mund të derdhen në tokë dhe në sipërfaqe e më pas të përfundojnë në lumë duke dëmtuar ekosistemin

### **7.3.6 Përfundime dhe rekomandime**

Fillimisht, Bashkia Gramsh ka nevojë për të hartuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë.

Vend-depozitimi aktual duhet ti nënshtrohet rehabilitimit mjedisor të tij, dhe të mendohet për të gjetur një zgjidhje për vend depozitimin e ri të mbetjeve, i cili duhet të jetë në standartet e një landfilli sanitar të manaxhuar.

Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë kopetencë e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në zonat ish industriale të Çekinit dhe Gramshit

Aktualisht nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në territorin e bashkisë, riciklimi ndodh në mënyrë joformale, ndaj shikohet e arsyeshme që bashkë me hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve të formalizohet sektori i riciklimit.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, në Çekin dhe Gramsh përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re, që duhet të përvetësojë Bashkia e Gramshit për manaxhimin e integruar të mbetjeve.

Shërbimi i grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve urbane nevojitet të shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh.

## **7.4 Furnizimi me energji elektrike, telekomunikacion dhe ndriçimi publik**

### **7.4.1 Ndriçimi publik**

Në këtë seksion do të analizohet ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik në bashkinë Gramsh. Në fillim do të bëhet një analizë e kompetencave ligjore të pushtetit vendor mbi ofrimin e këtij shërbimi. Do të kryhet një analizë statistikore e ofrimit të shërbimit të ndriçimit publik, do të vihen në dukje zonat që kanë sistem të amortizuar të ndriçimit publik, si dhe zonat në të cilat nuk ofrohet ky shërbim. Në pjesën e fundit do të nxirren konkluzionet përkatëse mbi analizën.

*Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2014-2020 në lidhje me ofrimin e shërbimeve publike (shërbimi i ndriçimit publik)*

Me reformën administrativo – territorial u krijuan 61 bashki nga 374 komuna dhe bashki, si rezultat i bashkimit të disa NJQV-ve. Jo të gjitha NjQV-të e vjetra i ofronin shërbimet publike të përcaktuara në ligj për banorët e tyre, dhe kjo si shkak i pamundësive të ndryshme. Me reformën administrative-territoriale bashkive të reja u lind nevoja të ofrojnë shërbimet publike në të gjithë territorin e tyre. Kjo gjë do të ndodhë dhe me Bashkinë Gramsh, e cila duhet të ofrojë shërbimin e ndriçimit publik në të gjitha NjA-të e Bashkisë. Për momentin Bashkia Gramsh ofron shërbimin e ndriçimit publik në NjA-të, Gramsh, Lenie, Pishaj, Kodovjat dhe Tunjë, kurse në NjA Sult, Kushovë, Skënderbegas, Kukur dhe Poroçan nuk e ofron.

Përsa i përket strategjisë së decentralizimit, ofrimi i shërbimeve publike, ku bën pjesë dhe ndriçimi publik, i përket funksioneve të veta të pushtetit vendor, të cilat Bashkia duhet t'i ofrojë në mënyrë ekskluzive në territorin që administron.

Kuadri ligjor mbi shërbimin e ndriçimit publik nga pushteti vendor:

- **Ligji nr. 139/ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore"**

Në këtë ligj, në nenin 23, pika 5, thuhet se pjesë e funksioneve të veta të bashkive është dhe ndriçimi i mjediseve publike, pra ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik. Gjithashtu, në nenin 35, pika 5a, thuhet se Bashkia krijon të ardhura nga tarifatat vendore për shërbimet publike që ofrohen. Një ndër këto shërbime publike është edhe ofrimi i shërbimit të ndriçimit publik.

- **Ligji nr, 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar"**

Në këtë ligj, në kreun VII për tarifatat vendore dhe administrimin e tyre, në pikën 2, thuhet që tarifatat vendore vendosen dhe administrohen në përputhje me ligjin nr.139\ 2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Këshilli Bashkiak vendos për llojet e tarifave, nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e tyre, si dhe vendos nëse këto tarifa mbledhen nga vetë strukturat bashkiake apo nga agjentët.

- **Ligji nr. 125/ 2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat".**

Në këtë ligj, në nenin 4, thuhet se zbatimi i koncesioneve ose i partneriteteve publike private lejohet në shërbime publike të tilla si ndriçimi publik në territorin e njësisve vendore (kjo pikë është shtuar me ligjin nr. 88/ 2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat").

**Pronësia dhe administrimi i shërbimit të ndriçimit publik në Bashkinë Gramsh:** Sipas strukturës organizative të Bashkisë Gramsh të vitit 2017, shërbimi i ndriçimit publik administrohet nga Drejtoria e Shërbimeve Komunale, e cila ndahet në dy sektorë: sektori i shërbimeve komunale dhe sektori i gjelbërimit. Pjesë e sektorit të shërbimeve komunale është edhe shërbimi i ndriçimit publik. Për menaxhimin e këtij shërbimi nuk ka punonjës të dedikuar vetëm për këtë shërbim. Gjithashtu ky institucion nuk disponon një mjet teknologjik të posatshtëm për mirëmbajtjen e këtij rrjeti. Drejtoria e shërbimeve komunale që merret me administrimin e shërbimit të ndriçimit publik minimalisht 1 herë në vit duhet të bëjë inventarizimin e infrastrukturës së ndriçimit publik në tërësi. Stafi i shërbimit të ndriçimit publik menaxhon mirëmbajtjen e rrjetit, ndërrimin e llambave të djegura, riparimin e shtyllave dhe kabllove të dëmtuara, si dhe riparimin e pajisjeve të tjera elektrike në funksion të ndriçimit publik.

Vendimet mbi buxhetin, strukturën e personelit apo ndryshimet e nevojshme për administrimin e shërbimit të ndriçimit publik miratohen nga Bashkia dhe Këshilli Bashkiak Gramsh.

Deri më sot në Shqipëri kanë munguar standardet e ndriçimit, përfshi këtu dhe ato të ndriçimit publik apo rrugor. Një nga të metat kryesore të ofrimit të shërbimit publik në sistemet e mëparshme vjen dhe si pasojë e mungesës së standardeve të ndriçimit rrugor. Propozimi dhe miratimi i standardeve është një element i rëndësishëm jo vetëm për përzgjedhjen e llambave të nevojshme që mundësojnë ndriçimin brenda këtij standardi të kërkuar por gjithashtu për të mundësuar kursimin dhe shmangjen e kostove të tepërta nga mbindriçimi i rrugëve dhe hapësirave publike.

Duke ju referuar Standardit European për ndriçimin publik, kriteret për ndriçimin përzgjidhen sipas klasave të rrugës e cila duhet të ndriçohet. Çdo klasë vlerësohet në bazë të një sërë kriteresh ndër të cilat mund të përmendim: sasinë e përdoruesve të rrugës, shpejtësinë e lëvizjes së automjeteve, volumnin e trafikut dhe zonat me rrezik.

Objekt i ndriçimit publik në Bashkinë e Gramshit janë akset rrugore automobilistike, rrugët e këmbësorve, sheshet urbane, lulishtet si dhe ndërtesat e institucioneve të ndryshme si (shkollat, ndërtesa e bashkisë etj.)

Pjesa më e madhe e sistemit të ndriçimit publik është operativ prej 15-18 vitesh duke bërë që amortizimi të ndikojë drejtëpërdrejtë në cilësinë e ofrimit të shërbimit në këto akse/ hapësira si dhe në performancën e dobët energjitike të këtij sistemi në tërësi.

Aktualisht Bashkia Gramsh ofron shërbimin e ndriçimit duke menaxhuar në total një sistem i cili shtrihet përgjatë 14 km linear rrjeti rrugor, dhe i shpërndarë në 16 akse rrugore.

Investimet e reja apo edhe ndërhyrjet për rinovimin e rrjetit ekzistues të ndriçimit publik janë kryer përgjithësisht gjatë ndërtimit të rrugëve të reja në qytet, rehabilitimit të akseve ekzistuese, si pjesë e masave për sistemin e infrastrukturës në kuadër të rehabilitimit të lagjeve, si dhe rehabilitimit të shëtitores qëndrore të qytetit.

Infrastruktura aktuale e ndriçimit vuan shumë nga djegja e shpeshtë e llambave, dëmtimi i shtyllave, djegja e pajisjeve të brendshme si droseli, injektori, kondensatori etj. Aktualisht numri i kokave të shtyllave që nuk funksionon arrin në 58 copë. Për më tepër, një pjesë e madhe e llambave nuk ofrojnë një performancë të mjaftueshme ndriçimi për shkak të humbjes së rendimentit të ndriçimit pas një periudhe 3 vjeçare dhe mos zëvendësimit të tyre.

Nga vizitat në terren është vërejtur se performanca e ndriçimit në shumë rrugë të qytetit është e ulët, ku lagjet janë përgjithësisht të pambuluara me shërbim dhe akset rrugore apo sheshet, shpesh nuk janë të ndriçuara në mënyrë uniforme. Në qytetin e Gramshit, rreth 15% e sistemit të ndriçimit është i amortizuar dhe jashtë funksionimit të tij. Ky qytet, ofron shërbimin e ndriçimit publik në 5 sheshe kryesore dhe në 1 lulishte. Në total në këtë qytet numërohen 330 shtylla të ndriçimit publik, nga të cilat 70 janë Shtylla me ndriçim LED.

Shërbimi i ndriçimit publik ofrohet edhe në NjA-të Pishaj, Kodovjat, Lenie dhe Tunjë por në këto zona ky rrjet ka probleme të shumta me amortizimin dhe dëmtimin e tij.

#### 7.4.2 Furnizimi me energji elektrike

Sistemi i Transmetimit të energjisë elektrike të territorit të Bashkisë Gramsh përfshin të gjitha linjat me tension të mesëm dhe të ulët, 10 dhe 6 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre, që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë:

- Linjat e transmetimit 10 kV.....166.6 km
- Linjat e transmetimit 6 kV .....21.3 km

Numri i kabinave sipas nivelit të tensionit janë:

- Kabina 10 kV.....104
- Kabina 6 kV .....41

Territori i Bashkisë Gramsh (zonat e banuara) mbulohet totalisht nga rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike. Kryesisht zonat kryesore të banuara në territorin e bashkisë nuk shfaqin probleme me infrastrukturën e energjisë elektrike.

Tabela 34 Rrjeti i tensionit të mesëm dhe të ulët në territorin e Bashkisë Gramsh

Emertimi i Nënstacionit	Tensioni në kV	Emertimi i Fiderit	Kabllore	Ajrore	Total kabinat
Gramsh	6	Fideri Nr 1	0.095	2.325	1
	6	Fideri Nr 2	0.855	1.150	7
	6	Fideri Nr 4	0.734	6.556	9
	6	Fideri Nr 5	4.039	5.590	24
	10	Fideri Nr 6	0.533	84.357	50
<b>Total</b>			<b>6.841</b>	<b>175.379</b>	<b>137</b>
Ceruqe	10	Fideri Nr 1	0.16	5.733	11
	10	Fideri Nr 3	0.04	31.083	13
	10	Fideri Nr 4	0.04	37.273	23
	10	Fideri Nr 5	0.04	7.38	7
<b>Total</b>			<b>0.28</b>	<b>81.469</b>	<b>54</b>


Burimi: OST 2017, Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS

Ndërtimi i Linjave 220 dhe 110 kV që përbëjnë edhe pjesën kryesore të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike ka filluar që para 30-60 vjetësh. Si pasojë e kohës së gjatë të shërbimit, e

terreneve të vështira nga kalojnë këto linja, si dhe e punës në kushte të rënduara të ngarkesave elektrike, konstatohen amortizime të shtyllave, përcjellësve, morseterive, etj.

Në hartën në vijim shikohen linjat e trasmetimit të mesëm dhe të ulët të energjisë elektrike në territorin e Bashkisë Gramsh, ekzaktësisht linjat 10 dhe 6 kV. Gjithashtu në hatë paraqiten dhe kabinat kryesore të instaluar në territorin e bashkisë.

Figura 42 Harta e rrjetit energjitik dhe kabinave të telekomunikacionit Bashkia Gramsh



Burimi: OST 2017, Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS

### 7.4.3 Telekomunikacioni

ALBTELEKOM-i është e vetmja kompani e rrjetit kabllor në qytetin e Gramshit. Rrjeti urban kabllor i qytetit të Gramshit përbëhet nga dy rrjete të ndara sipas kohëe: rrjeti i vjetër dhe rrjeti i ri me kapacitete përdorimi respektive 1300 dhe 1200.

Rrjeti kabllor ajror i vjetër me kapacitet 1300 kopje në rrjet të parë dhe 1350 kopje në rrjet të dytë. Rrjeti kabllor, nëntokësorë i ri i ndërtuar nga firma ALKATEL me 1350 kopje në rrjet të parë dhe 1800 kopje në rrjet të dytë.

Në Bashkinë Gramsh ndodhen 5 kabina të telekomunikacionit ku 4 ndodhen në qytetin e Gramshit dhe 1 në fshatin Pishaj. Në total këto kabina kanë 2500 porta abonentësh.

Sqarojmë së rrjeti i parë përfshin kabllot që dalin nga permutatori (Telekom) deri në kabinetin më të afert sipas drejtimeve përkatëse ndërsa rrjeti i dytë përfshin kabllot në vazhdim nga kabineti deri në DP ose kasetën më fundore prej nga del linja individuale e secilit abonent. Tërësia e linjave individuale përbën atë që quhet rrjet i tretë. Shuma e linjave që hyjnë dhe dalin nga një kabinet përbëjnë kapacitetin e kabinetit. Rrjeti i ri ka 8 kabinate që numërohen 01,02,...,08 që lidhen me permutatorin me kabllot të vendosura në tubacione që kalojnë nëpërmjet pusetave të cilat shtrihen



në tre drejtime kryesore A, B dhe C. Pusetat janë dy tipe: a – Manhole (250x140x100 cm) dhe b- Handhole (213x75x100cm). Në terren të dy tipet e pusetave dallohen nga njera tjetra sepse të parat e kanë kapakun në formë rrethore ndërsa të dytat në forme drejtkëndore. Rrjeti i vjeter kabllor është ndërtuar në vitet 1970 -2000 dhe gjendja e tij është e kënaqshme ndërsa rrjeti i ri është ndërtuar në 2001dhe është në gjendje të mirë. Rrjeti kabllor mbulon pothuajse të gjithë qytetin e Gramshit dhe ka aktualisht në shfrytëzim në total 1533 kapacitete për rrjetin e parë dhe 1835 kapacitete për rrjetin e dytë, ndërkohë që ka respektivisht 665 dhe 1217 kapacitete të lira. Deri në vitin 2007 ALTELEKOMI Gramsh numerohen 1800 abonentë.

## 8. Demografia

Ndryshimet politike në Shqipëri në vitet 90, u shoqëruan me një emigrim masiv të popullatës që ishte dhe faktori kryesor në ndryshimin rrënjësor demografik të saj. Popullata shqiptare e pas viteve 90” pësoi një rritje negative (-0.3% në vit) në periudhën 1989-2001, nga një rritje vjetore positive prej 2% në periudhën 1979-1989.

Megjithëse pas censusit të vitit 2001, emigrimi pritej të reduktohej në mënyrë të konsiderueshme, censusi i vitit 2011 tregoi se emigrimi vazhdoi në një shkallë masive, duke mbetur sërisht faktori më i rëndësishëm në humbjen neto të popullsisë me rreth 270 mijë persona në periudhën ndërmjet censuseve të viteve 2001-2011.

Tabela 35 Popullsia shqiptare në vite

Treguesit e popullsisë në vite	1979	1989	2001	2011
Numri i popullsisë (në mijë)	2.59	3.18	3.069	2.8
Ndryshimi ndërmjet censuseve (në mijë)		590	-111	-269
Ndryshimi ndërmjet censuseve (në %)		22,8	-3,5	-8,8
Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censuseve (në mijë)		58	-11	-26
Ndryshimi vjetor mesatar ndërmjet censuseve (në %)		2,0	-0,3	-0,9

Burimi: Instat, census data 2011

*Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë, si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë, jo vetëm në nivel kombëtar por sidomos në shpërndarjen rajonale të saj.*

Popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2016 arriti në 2,886,026 banorë duke pësuar një rënie prej 0.2% krahasuar me vitin e kaluar, ose rreth (- 6%) krahasuar me vitin 2001. Ndryshimet në rënie të popullsisë i “dedikohen” pakësimit të shtesës natyrore vjetore të popullsisë dhe fenomenit të migracionit neto i cili vazhdon të vlerësohet si vlerë negative.

Nga kjo popullsi, 1,46 milion janë meshkuj dhe 1.42 milion janë femra dhe për rjedhojë koeficienti gjinor është 103 meshkuj për çdo 100 femra. Ky tregues po ti referohemi analizës 15 vjeçare të tij për periudhën 2000-2015, pas vlerës prej 100, për periudhën 2002-2011 (100 meshkuj për cdo 100 femra) në vitin 2012 e në vazhdim, vlerat në rritje të treguesit gjinor, flasin për një dominancë të lehtë të popullsisë së meshkujve ndaj femrave.

Zhvillimet e fundit demografike tregojnë se popullsia e Shqipërisë po zvogëlohet, ndërkohë që struktura e saj tregon se popullsia po shkon drejt plakjes. Kjo si pasojë e rritjes së jetëgjatësisë, dhe nga ana tjetër e lindshmërisë e cila edhe pse po rritet lehtësisht, vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit.


*Mosha mesatare e popullsisë së Shqipërisë në 1 Janar 2016 është 37.5 vjeç.*

Gjatë periudhës 2001-2016, popullsia shqiptare ka pësuar një rënie mesatare vjetore prej -0.4%. Ndërkohë që vlen për t'u përmenduar ndryshimi strukturor që ka pësuar popullata në lidhje me raportin urban/ rural të popullsisë, ku viti 2008 shënon vitin e "kthesës" së këtij raporti në favor të popullatës urbane, dhe aktualisht në vitin 2016, popullsia urbane përfaqëson rreth 58% të popullsisë gjithsej.

Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës. Njohja e strukturës moshore dhe gjinisë së popullatës si në nivel kombëtar por sidomos në nivel rajonal (qark/bashki) është e rëndësishme për të llogaritur, parashikuar dhe plotësuar nevojat e saj në drejtim të shërbimeve sociale, përfshirë këtu arsimimin, sistemin shëndetësor, infrastrukturën, etj.

Gjithashtu analiza sipas grupmoshave tregon rëndësinë relative që kanë grupet e ndryshme të popullatës dhe sidomos kategoria në moshë pune dhe sa më të larta të jenë vlerat numerike të këtyre grupmoshave, aq më e lartë është potencialisht përfshirja e tyre në tregun e punës, dhe për rrjedhojë aq më e lartë do të jetë e ardhura kombëtare. Nëpërmjet paraqitjes grafike duke përdorur si instrument analizë, piramidën e popullsisë, lehtësisht konstatohen ndryshimet e strukturës moshore të popullatës qoftë edhe për një periudhë të shkurtër kohore, 2011-2015, gjatë të cilës në mënyrë të dukshme evidentohet se ka filluar plakja e popullsisë, për shkak të tendencave në rritje të grupmoshës (15-64) dhe rritjes së jetëgjatësisë së popullsisë.

Tabela 36 Piramida e popullsisë për vitet 2011; 2015.



Burimi: Instat, 2016

Nëse grupmoshat e tjera të popullsisë joaktive të rinjte (0-14) dhe mosha e 3-te, ( 65+) kanë një peshë të ulët në strukturën moshore të popullatës, atëherë të ardhurat e gjeneruara mund të rifuten në ekonomi/prodhim duke shumfishur potencialisht mirëqënien e përgjithshme, pra ***vendimarrja për zhvillimin socio-ekonomik të vendit varet shumë nga situata dhe zhvillimet demografike të popullatës.***

Tabela 37 Struktura moshore, Shqipëria në censuset e popullsisë.

Grupmoshat në %	1979	1989	2001	2011	2016
(0-14)vjeç	37	33.1	29.3	20.7	18
(15-64)vjeç	57.8	61.6	63.2	68	69
65+ vjeç	5.3	5.3	7.5	11.3	13
Gjithsej	100	100	100	100	100

Burimi: Instat, 2016

Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe moshë mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Por në referencë të analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmoshës (+ 65vjeç), edhe popullsia shqiptare ka hyrë në “rrugën” e plakjes së saj, treguesit për vitin 2016 vërtetojnë më së miri këtë tendencë të popullsisë, sipas të cilës grup-mosha (65+) është rritur me (+2) pikë përqindje krahasuar me vitin 2011.

Projeksionet e popullsisë janë një tjetër tregues i rëndësishëm, sepse nëpërmjet tyre ofrohet informacion i detajuar për numrin, shpërndarjen dhe strukturën demografike të popullatës në periudhat e ardhshme.

Sipas projeksioneve , popullsia shqiptare parashikohet të pësojë rënie në 2 skenaret e saj ( rritje e ulët e popullsisë dhe rritje e mesme) dhe me një rritje të lehtë me skenarin e rritjes së lartë të popullsisë. (tab.3)

*Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse, ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti.*

Tabela 38 Popullsia shqiptare sipas 3 skenarëve të projeksioneve, 2016 - 2031.

Viti	Skenari i rritjes së ulët	Skenari i rritjes së mesme	Skenari i rritjes së lartë
2016	<b>2.866.653</b>	<b>2.888.995</b>	<b>2.906.871</b>
2017	<b>2.851.251</b>	<b>2.884.624</b>	<b>2.911.407</b>
2018	<b>2.833.433</b>	<b>2.879.941</b>	<b>2.917.409</b>
2019	<b>2.813.176</b>	<b>2.874.873</b>	<b>2.924.807</b>
2020	<b>2.790.463</b>	<b>2.869.350</b>	<b>2.933.530</b>
2021	<b>2.765.292</b>	<b>2.863.311</b>	<b>2.943.520</b>
2022	<b>2.737.646</b>	<b>2.856.674</b>	<b>2.955.010</b>
2023	<b>2.710.245</b>	<b>2.849.846</b>	<b>2.966.197</b>
2024	<b>2.683.043</b>	<b>2.842.753</b>	<b>2.976.953</b>
2025	<b>2.656.007</b>	<b>2.835.342</b>	<b>2.987.173</b>
2026	<b>2.629.114</b>	<b>2.827.569</b>	<b>2.996.766</b>
2027	<b>2.602.354</b>	<b>2.819.401</b>	<b>3.005.655</b>
2028	<b>2.576.491</b>	<b>2.810.804</b>	<b>3.013.768</b>
2029	<b>2.551.481</b>	<b>2.801.764</b>	<b>3.021.054</b>
2030	<b>2.527.254</b>	<b>2.792.264</b>	<b>3.027.473</b>
2031	<b>2.503.751</b>	<b>2.782.310</b>	<b>3.033.017</b>

Burimi: Instat, 2014

**8.1 Popullsia dhe treguesit demografike sipas qarqeve.** Mbështetur në të dhënat e fundit të publikuara nga INSTAT, popullsia sipas qarqeve për periudhën 2001-2016, paraqitet sipas tabelës në vijim, (tab.1). Në referencë të këtyre të dhënave, vërejmë se numri total i popullsisë për qarqet, Elbasan dhe Diber, ka pësuar rënie nga viti në vit, sikundër rënia e popullsisë totale por edhe rënia e popullsisë në pjesën më të madhe të qarqeve të tjera të vendit (me përjashtim të qarqeve, Tiranë dhe Durrës).

Ndryshimi i numrit të popullsisë në nivel qarku është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Nga 12 qarqe, jo më pak se 10 prej tyre shënuan një rënie të popullsisë ndërmjet censuseve të viteve 2001 dhe 2011, me përjashtim të Tiranës dhe Durrësit. Për më tepër, të gjitha qarqet me rritje negative pësuan rënie që ishin të paktën rreth dyfish krahasuar me rënien e popullsisë kombëtare me 8,8 përqind dhe rëniet më të mëdha të popullsisë u identifikuan në qarqet më të skajshme të vendit si Kukës e Gjirokastrë. Nga këndvështrimi i procesit demografik, popullsia e qarkut Elbasan ndjek të njëjtin model zhvillimi demografik sikundër edhe popullsia në nivel kombëtar, që do të thotë se shkaqet e ndryshimeve demografike në nivel qarku janë të njëjta me shkaqet e ndryshimeve të popullatës në nivel kombëtar, emigracion i lartë, lindshmëri e vdekshmëri e ulët. *Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm (INSTAT,2014), duke treguar se përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonet e Shqipërisë.*

Tabela 39 Popullsia në 1 janar për periudhën, 2001-2016

Viti	Shqipëria	Qarku
		Elbasan
1/1/2001	3,063,320	361,980
1/1/2002	3,057,018	357,044
1/1/2003	3,044,993	350,862
1/1/2004	3,034,231	345,762
1/1/2005	3,019,634	339,461
1/1/2006	3,003,329	333,636
1/1/2007	2,981,755	327,189
1/1/2008	2,958,266	321,098
1/1/2009	2,936,355	314,757
1/1/2010	2,918,674	309,657
1/1/2011	2,907,361	306,939
1/1/2012	2,902,190	305,140
1/1/2013	2,898,293	303,069

<b>1/1/2014</b>	2,895,000	302,728
<b>1/1/2015</b>	2,892,302	301,324
<b>1/1/2016</b>	2,886,026	298,913

Burimi: Instat,2016

Popullsia e këtij qarku, në vite ka pësuar rënie e cila vlerësohet në ritme të larta nëse krahasohet me vitin 200, respektivisht me (-17.4%), ndërkohë që rënia mesatare vjetore e popullsisë së këtyre zonave, pas vitit 2001, vlerësohet të jetë rreth (-1.2%). Rënia më e madhe në numrin e popullsisë, identifikohet në qarkun e Diberës me rreth (-29%), qark i cili gjithashtu ka dhe rënien më të madhe mesatare vjetore të vlerësuar në (-2%). Gjithashtu vlen të theksohet se pas vitit 2010, ritmi mesatar i ndryshimit të popullsisë ka shënuar ritme të lehta në rënie, ndërkohë që në vitin 2016, ritmi i rënies së numrit të popullsisë ka shënuar vlerën e tij më të lartë të periudhës 2010- 2016, 0.8% për qarkun e Elbasanit.

Tabela 40 Ndryshimi vjetor i popullsisë sipas indekseve me vit bazë dhe zinxhir,Elbasan

	Elbasan		Shqipëria	
	I.2001	Iz	I.2001	Iz
<b>1/1/2001</b>				
<b>1/1/2002</b>	-1.4%	-1.4%	-0.2%	-0.2%
<b>1/1/2003</b>	-3.1%	-1.7%	-0.6%	-0.4%
<b>1/1/2004</b>	-4.5%	-1.5%	-0.9%	-0.4%
<b>1/1/2005</b>	-6.2%	-1.8%	-1.4%	-0.5%
<b>1/1/2006</b>	-7.8%	-1.7%	-2.0%	-0.5%
<b>1/1/2007</b>	-9.6%	-1.9%	-2.7%	-0.7%
<b>1/1/2008</b>	-11.3%	-1.9%	-3.4%	-0.8%
<b>1/1/2009</b>	-13.0%	-2.0%	-4.1%	-0.7%
<b>1/1/2010</b>	-14.5%	-1.6%	-4.7%	-0.6%
<b>1/1/2011</b>	-15.2%	-0.9%	-5.1%	-0.4%
<b>1/1/2012</b>	-15.7%	-0.6%	-5.3%	-0.2%
<b>1/1/2013</b>	-16.3%	-0.7%	-5.4%	-0.1%
<b>1/1/2014</b>	-16.4%	-0.1%	-5.5%	-0.1%
<b>1/1/2015</b>	-16.8%	-0.5%	-5.6%	-0.1%
<b>1/1/2016</b>	-17.4%	-0.8%	-5.8%	-0.2%

Burimi: INSTAT 2016, llogaritjet autori

**Treguesi demografik lidhur me raportin e shpërndarjes urban/rurale** të popullatës në nivel qarku, paraqitet me një pamje të ndryshme nga treguesi në nivel kombëtar, nëse në nivel kombëtar raporti është në favor të popullsisë urbane, në këto qarqe ndodh e kundërta, pra raporti i shpërndarjes urban/rurale të popullatës tregon mbizotërimin e popullsisë rurale ndaj asaj urbane. Më konkretisht, Shqipëria pas vitit 2008, ka një raport të popullsisë urban/rural, në favor të popullsisë urbane dhe në vitin 2016, rreth 58% e popullatës klasifikohet si popullsi urbane, ndërkohë që në qarqet e mësipërme, ky tregues paraqitet i ndryshëm dhe në favor të popullsisë rurale. Megjithatë në vite diferenca ndërmjet popullatës rurale dhe asaj urbane, ka ardhur duke u ngushtuar edhe në këto qarqe, sërisht deri në fund të vitit 2015, ky raport tregon mbizotërim të popullatës rurale ndaj popullsisë urbane.

Tabela 41 Struktura urban/rurale e popullsisë gjithsej dhe për qarqet, Elbasan, 2001-2016

Popullsia në vite	Elbasan		Shqipëria	
	Urban	Rural	Urban	Rural
1/1/2001	34%	66%	42%	58%
1/1/2002	35%	65%	43%	57%
1/1/2003	36%	64%	45%	55%
1/1/2004	36%	64%	46%	54%
1/1/2005	37%	63%	47%	53%
1/1/2006	37%	63%	48%	52%
1/1/2007	38%	62%	49%	51%
1/1/2008	38%	62%	50%	50%
1/1/2009	39%	61%	51%	49%
1/1/2010	39%	61%	52%	48%
1/1/2011	39%	61%	53%	47%
1/1/2012	39%	61%	54%	46%
1/1/2013	39%	61%	56%	44%
1/1/2014	39%	61%	57%	43%
1/1/2015	39%	61%	57%	43%
1/1/2016	40%	60%	58%	42%

Burimi: INSTAT2016, llogaritjet autori

Eshtë e rëndësishme të vemë në dukje sidomos në nivel qarku /bashkie, se krahas faktorëve të tjerë të përmenduar me sipër, si emigracioni masiv dhe eventet demografike, lindshmëria, vdekshmëria, shtesa natyrore e popullsisë, **një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës së qarqeve është edhe migrimi i brëndshëm i popullsisë**, pra lëvizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.

*Modeli i ndryshimit të popullsisë në nivel qarku përputhet shumë me modelin e migrimit të brendshëm duke treguar së përveç emigrimit dhe rritjes natyrore të ndryshme, migrimi i brendshëm është një proces me domethënie të madhe në ndryshimet e popullsisë në rajonët e Shqipërisë, (Instat,2014).*

Analiza e lëvizjeve migratore të popullsisë së qarqeve në studim, sipas të dhënave nga censusi i përgjithshëm i popullsisë të vitit 2011, evidenton lëvizjet, hyrje/dalje të popullsisë për këto qarqe duke demonstruar qartazi se bilanci neto i lëvizjeve të popullsisë në këto qarqe, është një bilanc negativ, që tregon se largimet e popullatës nga këto qarqe janë shumëfish më të larta se sa hyrjet e popullates.

Tabela 42 Levizjet migratore të brëndshme, 2001-2016

Qarku	Popullsia në hyrje	Popullsia në dalje	Bilanci i levizjeve migratore	Popullsia 2001	Popullsia 2016	Dif.2001-2016	Impakti i levizjes migratore të brendshme
ELBASAN	9,357	24,381	(15,024)	357,044	298,913	(58,131)	-26%

Burimi: INSTAT2014, llogaritjet autori

Për më tepër nëpërmjet këtyre të dhënave mund të vlerësojmë statistikiisht edhe impaktin që faktori “migracioni i brëndshëm” ka sjell në përcaktimin e madhësisë totale të popullatës së këtyre qarqeve, duke ndikuar në pakësimin e saj. Më konkretisht vetëm për efekt të migrimit të brëndshëm, popullsia e këtyre qarqeve është pakësuar respektivisht me (-26%), (-65%) gjatë periudhës 2001-2016.

**Treguesi demografik në lidhje me raportin gjinor.** Procesi i vazhdueshëm i emigrimit në shkallë të gjerë si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë patën një ndikim shumë të madh në strukturën demografike të popullsisë në Shqipëri dhe sipas qarqeve. Duke qënë se migracioni është një proces i lidhur me gjininë, ai prek në mënyra të ndryshme meshkujt dhe femrat.

Ecuria në vite e raportit gjinor, (meshkuj ndaj 100 femra) dëshmon së gjatë periudhës (1990-2000), migrimi ndërkombëtar dominohej nga meshkujt, duke “krijuar” një raport gjinor më të ulët, pra në favor të popullatës femërore. Por megjithëse emigrimi filloi si një fenomen tipik për meshkujt, ai është kthyer në një proces të balancuar nga ana gjinore në dekadën e fundit duke rezultuar në një raport gjinor pak më të rritur në vitin 2011.

Krahas emigrimit ndërkombëtar, migrimi i brëndshëm është një tjetër faktor i rëndësishëm që luan rol në përcaktimin e raportit gjinor. Analiza e këtij fenomeni tregoi se migrimi i brendshëm ka një impakt të konsiderueshëm mbi diferencat gjinore ndërmjet qarqeve, raporti i migrantëve të brendshëm është mjaft i ndryshëm për meshkujt dhe femrat duke evidentuar faktin që *femrat kanë tendencë të migrojnë brënda vendit më shumë se sa meshkujt.*

Shkaqet e ndryshimit cilësor të raportit gjinor në vitet e fundit, në një raport gjinor me gjini të balancuara sipas studimeve demografike, rezultojnë të jenë, ribashkimet familjare, si dhe rritja emigrimit të femrave për arsye studimi dhe punësimi, duke “kompensuar” kështu tepricën e meshkujve në grupmoshën 20-29 vjeç të emigruar në dekadën e parë pas viteve 90”.

Treguesi demografik lidhur me raportin gjinor të popullatës për qarkun Elbasan, paraqitet me vlerë më të lartë se vlera mesatare e këtij raporti në nivel kombëtar, duke demonstruar në këtë mënyrë një përparësi në rritje të popullatës së meshkujve ndaj asaj të femrave për këto qarqe. Analiza në vite e këtij treguesi, sidomos duke e krahasuar edhe me koeficientin gjinor në nivel kombëtar tregon për një mbizotërim sistematik të popullatës së meshkujve ndaj popullatës së femrave, në këto qarqe. Koeficienti gjinor në këtë qark shënon vlerat e tij më të larta në vitin 2016 respektivisht në qarkun Elbasan (104.7). Shkaqet e mbizotërimit të popullatës së meshkujve ndaj femrave në këto qarqe përveç faktorëve të sipërpërmendur, lidhen gjithashtu edhe dominancën e popullsisë rurale në strukturën rural/urbane të popullatës si dhe me praninë e abortit selektiv sipas gjinisë, duke preferuar fëmijët meshkuj të lindur. (UNFPA 2012).

Tabela 43 Koeficienti gjinor sipas qarqeve për periudhën 2001-2016

Vitet	Elbasan	Shqipëria
1/1/2001	102.6	99.5
1/1/2002	102.9	99.5
1/1/2003	102.8	99.5
1/1/2004	102.5	99.6
1/1/2005	102.4	99.6
1/1/2006	102.1	99.7
1/1/2007	102.2	99.8
1/1/2008	101.9	99.8

1/1/2009	101.9	99.9
1/1/2010	101.8	100.0
1/1/2011	101.3	100.3
1/1/2012	101.3	100.5
1/1/2013	101.9	101.1
1/1/2014	102.5	101.7
1/1/2015	103.6	102.1
1/1/2016	104.7	102.6

Burimi: Instat 2016, Ilogaritjet autori

### Një tjetër tregues shumë i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.

Analiza e strukturës moshore të popullatës shqiptare si dhe moshë mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata shqiptare vazhdon të jetë akoma një popullsi e re. Analiza e strukturës moshore e popullatës së qarkut paraqitet e ndryshme krahasuar kjo me strukturën moshore të popullatës në nivel kombëtar. Me ndryshime më të lehta krahasimisht me strukturën në nivel kombëtar paraqitet qarku i Elbasanit i cili ka një popullsi të re më të lartë se mesatarja kombëtare. Ndërkohë popullsia në moshë pune në qarkun është 66% ndaj mesatarja kombëtare. Për rrjedhojë grupmosha e 3-te (+65) rezulton, respektivisht 10%, në qarkun e Elbasanit, por ndërkohë më e ulët se mesatarja kombëtare me rreth 4 pikë përqindje. Gjithashtu në reference të analizës së serive kohore të popullatës në grupmosha, për shkak të zvogëlimit të grup-moshës së re (+15vjeç) dhe rritjes së grupmoshës (+ 65vjeç), edhe popullsia e këtij qarku sikundër popullsia shqiptare në tërësi ka hyrë në “rrugën” e mplakjes së saj.

Tabela 44 Struktura moshore në Qarkun, Elbasan

Popullsia, qarku, sipas grup-moshave	Viti 2016			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+
Qarku Elbasan	298,913	63,062	205,370	30,481
	Struktura në %			
<i>Shqipëria</i>	100	18%	69%	13%
Qarku Elbasan	100	21%	69%	10%

Burimi: Instat 2017, Ilogaritjet autori

Analiza e strukturës moshore të popullsisë na ndihmon gjithashtu në përlogaritjen e treguesve tjerë demografike sikundër janë treguesit e varësisë totale, (raporti i grupmoshave (0-14) + (+65) ndaj popullsisë në moshë pune/(15-65)) treguesi varësisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës (0-14)/(15-65) dhe varësisë së të moshuarve(raporti i grupmoshës (+65)/(15-65)). Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme dhe një baze e dobishme informacioni për të vlerësuar burimet potenciale njerëzore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të vendit në tërësi dhe zonave në studim. Koeficienti I varësisë totale shpreh raportin e popullsisë inaktive (në moshë jopune) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jopune, “mbulohen” nga 100 individë në moshë pune. Ky koeficient detajohet më tej edhe në: (a)koeficientin e varësisë së të rinjve dhe (b) koeficientin e varësisë së të moshuarve, të cilët përfaqësojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave (0-14) vjeç dhe (65+) vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën (15-64) vjeç. Nga analiza e këtyre treguesve për periudhën 1979-2011, identifikojmë se Shqipëria, për vitin 2011 ka koeficientin e saj me të ulët të varësisë totale prej 47 përqind, që do të thotë se çdo 100 individë në moshë pune kanë “në



ngarkim” 47 individë në moshë jopune. Vlera e këtij treguesi (varesia totale) tregon se vendi ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividendit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) vjeç përkundrajt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar(+65).

Tabela 45 Treguesit e varesisë moshore, për popullatën Gjithsej dhe qarkun Elbasan

Treguesit e varesisë ,2011	Shqipëria	Elbasan
Raporti i varësisë totale $\{(0-14)+ (+65)\}/(15-65)$	<b>44.3</b>	46
Raporti i varësisë së të rinjve $(0-14)/(15-65)$	<b>26.1</b>	31
Raporti i varësisë së të moshuarve $(+65)/(15-65)$	<b>18.2</b>	15
Indeksi i zëvendësimit $(0-14)/\text{popullsia Gjithsej}$	<b>0.18</b>	0.21
Indeksi i moshës së vjetër $(+\text{pop } 65)/\text{popullsia Gjithsej}$	<b>0.12</b>	0.10

Burimi: Instat 2016 ,Ilogaritjet autori

Fenomeni i “dividendit demografik” është gjithashtu i pranishëm edhe në qarkun Elbasan, me vlera pothuajse të njëjta me vlerat mesatare të këtyre treguesve në nivel kombëtar.

*Nëse Shqipëria edhe qarqet do të përfitojnë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social dhe ekonomike të ndërmarra nga politikbërësit, përfshirë këtu edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë puntore për të mundur integrimin e saj në punë produktive të cilat me pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e performancës ekonomike por edhe në rritjen e mirëqenies së popullatës.*

Ndërkohë që koeficienti varësisë totale në nivel kombëtar dhe qarku, flet për egzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varësisë në harkun kohor (1979-2011) tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, ( nga 9% në 17%) dhe një rënie e grup-moshës së re, (nga 60% në 30%) duke demonstruar qartazi për “hyrjen” në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të “plakjes”.

*Ndryshimet thelbësore në aspektin demografik të popullatës (sëbashku në nivel kombëtar dhe në nivel qarku), jo vetem nënkuptojnë një ndryshim rrënjësor të shoqërisë pas viteve 90’, por ato shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajoneve në veçanti, prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik me qëllim hartimin e politikave socio-ekonomike-mjedisore që t’u paraprijnë këtyre ndryshimeve.*

*Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projeksionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio- ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.*

**Shenim metodik:**

Instat mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në “trendin” që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmerisë, vdekshmerisë, emigracioni dhe migracioni, ka ndërtuar skenaret e projeksioneve të popullsisë. Sipas këtyre përlogaritjeve janë ndërtuar 3 skenare të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatesisht skenari i rritjes ulët, (lindje të ulta, vdekshmeri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmeri, vdekshmeri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmeri e lartë, vdekshmeri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor,) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë.

**Gjithashtu vlen të theksohet së Projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përlogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjecare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel bashkie ose komune.**

Tabela 46 Popullsia e Shqipërisë dhe qarqeve sipas skenarit të rritjes së mesme 2015-2031

Popullsia, qarku,	2011	2015	2016	2021	2026	2031
SHQIPËRIA	2,902,190	2,893,005	2,886,026	2,863,311	2,827,569	2,782,310
QARKU ELBASAN	306,939	301,324	298,913	276,326	263,059	250,275

Burimi: Instat 2014 dhe 2016,

Sipas projeksioneve të popullsisë, (skenari i rritjes së mesme), popullsia e vendit, pëson rënie, e cila si mesatare vjetore 15 vjecare, vlerësohet të jetë 0.3%. Sikundër popullsia shqiptare edhe popullsia e qarkut në studim, parashikohet me rënie, e cila mesatarisht në vit vlerësohet të jetë respektivisht (-1%) për qarkun Elbasan.

Një nga faktorët që mendohet se do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, e të cilit për periudhën 2015-2031, argumentohet me perspektivën e një largimi të vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

## 8.1 Popullsia dhe treguesit demografik sipas bashkisë Gramsh

Zbatimi i ligjit 115/2014 për ndarjen e re administrative, sipas të cilit kemi një rikompozim të ri të bashkive, nuk implikon ndryshime në totalin e popullsisë në nivel qarku, por është shoqëruar me ndryshime drastike të numrit të popullsisë të njësive vendore në nivel bashkie e komunash.

*Ndërkohë që popullsia në nivel kombëtar dhe rajonal ka pësuar rënie, popullsia në “bashkitë e reja” përgjithësisht është më shumë se dyfishuar për shkak të bashkimit të ish njësive vendore duke sjellë në këtë mënyrë apriori shumfishimin e problematikave që lidhen me mirëmenaxhimin e burimeve natyrore, pasurore dhe njerëzore të këtyre njësive vendore.*

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, si dhe në përputhje me ndarjen e re administrative, popullsia e bashkive ka pësuar ndryshimet në vijim:

Tabela 47 Popullsia sipas ndarjes së re administrative për bashkinë Gramsh

Popullsia sipas qarqeve	Viti 2011*		(01/01/2016)	Dendësia e popullsisë
	ishte	behet		

<b>Qarku ELBASAN</b>	<b>295,827</b>	<b>306,939</b>	<b>298,913</b>	92
Bashkia Gramsh	24,231	25,141	24,484	

Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

\* shifrat 2011 të korrigjuara sipas publikimit të Instat, 2016

### • Bashkia Gramsh

Bashkia Gramsh, është një ndër 7 bashkitë e qarkut Elbasan e cila për nga numri i popullsisë renditet e 6-ta, ose e parafundit me rreth 8.2 përqind të popullsisë totale të qarkut Elbasan. Me ndarjen e re administrative, Bashkia Gramsh përfshin brënda juridiksionit të saj administrativ, qytetin e Gramshit dhe 9 komunat, Pishaj, Sult, Porocan, Tunje, Kushove, Skenderbegas, Kodovjat, Kukur e Lenie.


Nga këndvështrimi i shpërndarjes strukturore të popullsisë, në bashkinë Gramsh banojnë rreth 8.2% e popullatës rezidente të qarkut Elbasan, ndërkohë që pjesa tjetër e popullatës së qarkut rreth 92% është e shpërndarë në bashkitë e tjera, Elbasan, Peqin, Belsh, Cërrik, Prrenjas, Librazhd, respektivisht me 48%, 8.8%, 6.6%, 9.3%, 8.4%, 10.8% të popullatës gjithsej të qarkut.

Popullata rezidente e bashkisë Gramsh si rrjedhojë e ndarjes së re administrative është rritur me rreth 65% duke shënuar një numër popullsie rezidente stok në fillim të vitit 2016, prej 24,5 mijë banorë\* ose me një rënie prej 2.6 përqind krahasuar me vitin e kaluar.

Popullsia rezidente e kësaj bashkie është e përqëndruar kryesisht në qytetin e Gramshit, me rreth 35%, që klasifikohet edhe si popullsi urbane, ndërkohë që pjesa tjetër e saj prej rreth 65% është e shpërndarë në 9 komuna dhe klasifikohet si popullsi rurale.

Tabela 48 Popullsia sipas ndarjes së re administrative, 2011-2016

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	2011	2016
<b>Bashkia Gramsh</b>	<b>25,141</b>	<b>24,484</b>
Gramsh	8,757	8,528
Pishaj	5,090	4,957
Sult	655	638
Porocan	1,317	1,282
Tunje	1,445	1,408
Kushove	684	666
Skenderbegas	1,286	1,252
Kodovjat	2,443	2,380
Kukur	2,656	2,587
Lenie	808	787
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>306,939</b>	<b>298,913</b>



Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Nga këto komuna, veçohet komuna Pishaj me rreth 20% të popullatës së bashkisë, e ndjekur pas nga komunat Kodovjat e Kukur respektivisht me 10% e 11% të totalit të popullatës së bashkisë

Gramsh. Ndërkohë që shpërndarja e popullsisë në pjesën e mbetur të komunave “lëviz” në intervalin (3-6)% të popullatës gjithsej të bashkisë.

**Popullsia e bashkisë Gramsh, krahasuar me vitin 2011, ka pësuar rënie** me rreth 700 banorë<sup>199</sup>, ose me 2,6% me pak, rënie e cila si fenomen tashmë është prezent pothuaj në të gjitha njësitë vendore të vendit (përfshirë këtu qarkun Tiranë dhe Durrës) pas viteve “90”.

Shkaqet e pakësimit të popullsisë në bashkinë Gramsh, lidhen me faktorët e emigrimit, uljes së ritmeve të shtesës natyrore të popullsisë si dhe ritmeve të larta të migrimit të brëndshëm, duke ndjekur të njëjtin model –profil të zhvillimit demografik të popullsisë, sikundër në njësitë e tjera vendore të vendit.

Tabela 49 Popullsia sipas gjinisë Bashkia Gramsh, për vitet 2011-2016,

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	Viti 2011			Viti 2016		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
Bashkia Gramsh	25,141	12,845	12,296	24,484	12,509	11,975
Gramsh	8,757	4,445	4,312	8,528	4,329	4,199
Pishaj	5,090	2,597	2,493	4,957	2,529	2,428
Sult	655	346	309	638	336	301
Porocan	1,317	654	663	1,282	637	646
Tunje	1,445	742	703	1,408	722	685
Kushove	684	371	312	666	362	304
Skenderbegas	1,286	647	638	1,252	631	621
Kodovjat	2,443	1,251	1,192	2,380	1,219	1,161
Kukur	2,656	1,373	1,283	2,587	1,337	1,250
Lenie	808	419	389	787	408	379
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>306,939</b>	154,426	152,513	298,913	152,875	146,038

Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

**Popullsia e bashkisë Gramsh, nga këndvështrimi i raportit gjinor**, ruan një diferencë të lehtë përse i përket ndarjes së popullsisë sipas gjinisë në meshkuj e femra. Rrjedhimisht, mbështetur dhe në të dhënat e popullsisë për dy vitet 2011-2016, treguesi demografik i raportit gjinor (meshkuj /femra100) tregon se edhe për vitin 2016, raporti gjinor vazhdon të jetë në favor të popullatës së meshkujve, ashtu sikundër paraqitet koeficienti gjinor për vitin 2011,(104 meshkuj për cdo 100 femra për vitin 2011/2016).

Tabela 50 Raporti gjinor për bashkinë Gramsh, 2011-2016

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	Koeficienti gjinor në %	
	2011	2016
<b>Bashkia Gramsh</b>	<b>104</b>	<b>104</b>
Gramsh	103	103
Pishaj	104	104
Sult	112	112

Porocan	99	99
Tunje	105	105
Kushove	119	119
Skenderbegas	101	101
Kodovjat	105	105
Kukur	107	107
Lenie	108	108
<b>Qarku Elbasan</b>	101	105

Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Nëse krahasojmë raportin gjinor të popullatës së bashkisë me atë të qarkut, identifikojmë vlera të ndryshme të raportit gjinor, gjithnjë në favor të popullatës së meshkujve (104) dhe kjo situatë është akoma më e theksuar në nivel komunash ku ky tregues arrin vlerën maksimale në 119 (119 meshkuj për çdo 100 femra), si në rastin e komunës Kushove e ndjekur pas nga komuna Sult me një koeficient gjinor prej 112. Këto përmasa të raportit gjinor veçanërisht të larta në komunat si pjesë përbërëse të bashkisë, mund të shpjegohen me dominancën e popullsisë rurale ndaj asaj urbane në qarkun e Elbasanit. Aktualisht, për vitin 2016, struktura urban/rurale e qarkut vlerësohet në raportin 40%:60%, ndërkohë që vendi që prej vitit 2008 ka një strukturë urban/rurale në favor të zonave urbane dhe për vitin 2016, rreth 58% e popullatës kombëtare klasifikohet si popullatë urbane. Një tjetër faktor mund të konsiderohet edhe shfaqja e fenomenit të abortit selektiv, duke favorizuar femijët meshkuj.

**Një tjetër tregues i rëndësishëm demografik është struktura moshore e popullatës.** Analiza e strukturës moshore të popullatës si dhe moshat mesatare e re e saj, tregojnë se aktualisht popullata e bashkisë Gramsh, vazhdon të jetë akoma një popullsi e re sikundër edhe popullata aktuale shqiptare në tërësi. Për vitin 2016 struktura moshore e popullatës së bashkisë, tregon se 68% e saj i takon grupmoshës (15-64) vjeç, dhe 22% grupmosha (0-14) vjeç të dhëna këto shumë optimiste dhe që evidentojnë se bashkia/qarku ka një potencial të lartë të popullsisë në moshë pune ekonomikisht aktive, por se sa e angazhuar është ajo realisht në performancën ekonomike të zonës, kjo duhet analizuar së bashku edhe me të dhënat për punësimin.


Tabela 51 Popullsia rezidente, sipas grup-moshave

Popullsia, qarku, bashkia, komunat	Viti 2011				Viti 2016			
	Gjithsej	0-14	15-64	65+	Gjithsej	0-14	15-64	65+
<b>Bashkia Gramsh</b>	<b>25,141</b>	<b>5,504</b>	<b>17,076</b>	<b>2,561</b>	<b>24,484</b>	<b>5,360</b>	<b>16,630</b>	<b>2,494</b>
Gramsh	8,757	1,824	6,013	920	8,528	1,776	5,855	896
Pishaj	5,090	1,134	3,408	548	4,957	1,104	3,319	534
Sult	655	118	467	70	638	115	455	68
Porocan	1,317	357	828	132	1,282	348	806	128
Tunje	1,445	302	1,014	130	1,408	294	987	126
Kushove	684	132	488	64	666	128	475	63

Skenderbegas	1,286	243	891	151	1,252	236	868	148
Kodovjat	2,443	555	1,657	231	2,380	541	1,614	225
Kukur	2,656	655	1,764	238	2,587	638	1,718	231
Lenie	808	185	547	77	787	180	532	75
<b>Qarku Elbasan</b>	<b>306,939</b>	<b>64,755</b>	<b>210,88</b>	<b>5</b>	<b>31,299</b>	<b>3</b>	<b>63,062</b>	<b>205,370</b>
								<b>1</b>

Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Tabela 52 Struktura moshore e popullatës, bashkia Gramsh



Burimi: te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Analiza e strukturës moshore të popullatës edhe në nivel komunash që përfshihen brenda bashkisë, tregon se popullata e kësaj grupmoshe është e pranishme me të njëjtat nivele (66-71%) edhe në komuna. Gjithsesi, ndërmjet tyre, ka edhe ndryshime nga të cilat veçojme komunat Skenderbegas dhe Pishaj të cilat kanë nivelin me të lartë të grupmoshës së të moshuarve (+65 vjec) me 12% dhe 11% dhe komunat Porocan e Kukur me nivelin me të lartë të grupmoshës së re (0-14), respektivisht me 27% dhe 25%.

Nëpërmjet të dhënave të ndarjes së popullsisë sipas grupmoshave, mundësohet gjithashtu edhe llogaritja e treguesve të varesisë, tregues këta shumë të rëndësishëm në analizën socio-ekonomike.

*Analiza e këtyre treguesve është e rëndësishme për të vlerësuar burimet potenciale njerezore që mund të përfshihen në tregun e punës dhe rrjedhimisht të ndikojnë në përmirësimin e performancës ekonomike të zonës në studim.*

**Treguesit e varesisë** klasifikohen në, treguesit e varesisë totale, (raporti i grupmoshave  $[(0-14) + (+65)] / (15-65)$  ndaj popullsisë në moshë punë, treguesi varesisë së të rinjve ( raporti i grupmoshës  $(0-14) / (15-65)$  dhe treguesi i varesisë së të moshuarve (raporti i grupmoshës  $(+65) / (15-65)$ ).

Koeficienti i varësisë totale shpreh raportin e popullsisë joaktive (në moshë jo punë) ndaj popullsisë në moshë pune, duke treguar se sa individë në moshë jopune, “mbulohen”/përballohen nga 100 individë në moshë punë. Sa më e vogël të jetë vlera e këtij treguesi, aq më shumë mund të rritet potencialisht performanca ekonomike, ndërkohë koeficienti i varësisë së të rinjve dhe i varësisë së të moshuarve, tregojnë respektivisht raportin e popullsisë së grupmoshave 0-14 vjeç dhe 65 vjeç e lart kundrejt popullsisë në moshën 15-64 vjeç. Gjithashtu interpretimi ekonomik i treguesit të varesisë së të rinjve, është i ngjashëm me treguesin e varësisë totale, pra një tregues i lartë shpreh optimizëm në drejtim të rritjes së numrit të popullsisë aktive në një periudhë të ardhshme, ndërkohë që rritja e treguesit të varësisë së të moshuarve, është “sinjal” për alokim fondesh-investimesh për të lehtësuar e përmisuar jetësën dhe mirëqënien e kësaj kategori të popullsisë. Konkretisht, për bashkinë Gramsh, treguesit e varesisë moshore totale, e varesisë së të rinjve dhe varesisë së të moshuarve paraqiten si në tabelen në vijim:

Tabela 53 Koeficientët e varësisë

Koeficientet e varesisë, qarku, bashkia, komunat	KOEFIICIENTET E VARESISË,2016		
	Varesia totale	varesia e të rinjve	varesia e të moshuarve
<b>Bashkia Gramsh</b>	47	32	15
Gramsh	46	30	15
Pishaj	49	33	16
Sult	40	25	15
Porocan	59	43	16
Tunje	43	30	13
Kushove	40	27	13
Skenderbegas	44	27	17
Kodovjat	47	34	14
Kukur	51	37	13
Lenie	48	34	14
<b>Qarku Elbasan</b>	46	31	15

Burimi: Te dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

Mbështetur në këta tregues konstatohet se treguesi i varesisë totale për bashkinë e Gramshit shënon vlerën 47 ( 47 banorë tq moshës joaktive ( 0-14 vjec dhe +65vjec) “përballohen” nga 100 banorë të moshës aktive për punë(15-64 vjec), ndërkohë që edhe vlera e ketij treguesi në nivel kombëtar është 47. Viti 2011 është viti në të cilën ky tregues ka shënuar vlerën e tij me të ulët për gjithë periudhën (1979-2011) si në nivel kombëtar ashtu dhe në nivel njësie vendore, duke treguar në këtë mënyrë se bashkia ndodhet në të ashtuquajturën episod i “dividentit demografik” dhe kjo si rezultat i një numri të lartë popullsie potencialisht ekonomikisht aktive (15-65) përkundrajt një numri të ulët popullsie të re (0-14) dhe të moshuar (+65). Edhe për vitin 2016, treguesit e varësisë për bashkinë Gramsh vazhdojnë të performojnë një nivel relativisht të ulët duke demonstruar në këtë mënyrë akoma vazhdimësinë e fenomenit të “dividentit demografik”. Këto vlera janë të përafërta me vlerat mesatare në nivel qarku ndërkohë që krahasuar me vlerat mesatare në nivel kombëtar, treguesit në nivel bashkie janë më të favorizuar, për shkak të pranisë më të madhe të grupmoshës së re dhe pranisë më të ulët të grupmoshës së të moshuarve.

*Nëse Bashkia/qarku do të përfutojë nga ky “dividend demografik” kjo varet nga efektiviteti i politikave social ekonomike të politikbërësit, përfshirë këtu në mënyrë të vecante edhe arsimimin dhe kualifikimin e mjaftueshëm të fuqisë puntore për të mundësuar integrimin e saj në punë produktive të cilat pastaj do të ndikojnë jo vetëm në përmirësimin e përformancës ekonomike, por edhe në rritjen e mirëqënies së popullatës.* Ndërkohë që koeficienti varësisë totale, flet për egzistencën e “dividendit demografik”, analiza e treguesve të tjerë të varesisë tregojnë një rritje të konsiderueshme në numrin e personave të moshuar 65 vjeç e lart, (nga 9% në 15%) dhe një rënie të grup-moshave të reja, (nga 60% në 29%) duke demonstruar qartazi për “shenjat” në hyrjen në një fazë të re demografike të popullsisë, në atë të “plakjes”. Rritja e grupmoshës (+65), shoqërohet dhe me nevojën e rritjes së investimeve për të lehtësuar e përmirësuar aspektin socio-ekonomik të kësaj kategorie të popullsisë. Këta tregues në nivel bashkie vlerësohen afërsisht të njëjtë me treguesit në nivel qarku, ndërkohë që konstatohen ndryshime të konsiderueshme në vlerat e tyre sipas komunave... **Prandaj analizat demografike të popullatës janë shumë të nevojshme për të kuptuar në kohë ndryshimet thelbësore në aspektin demografik sepse këto ndryshime shoqërohen me implikime madhore në çështjet e zhvillimit ekonomik, social, urban e mjedisor të vendit në tërësi e rajonëve në vecanti.**

Një tjetër aspekt i rëndësishëm në studimet demografike është edhe përgatitja e projeksioneve të popullsisë, për të paktën 2 dekada. Projektionet e popullsisë ofrojnë informacion në lidhje me numrin e ardhshëm, strukturën demografike dhe shpërndarjen territoriale të banorëve sipas hipotezave më të mundshme të prirjeve në sjelljen demografike. Ato janë me interes për shoqërinë në përgjithësi dhe shërbejnë si bazë për planifikimin e zhvillimit socio - ekonomik të vendit/zonave, përfshirë këtu edhe studimin e tregut.

**Shënim metodik:**

Instat mbështetur në të dhënat e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë si dhe në “trendin” që kanë pësuar treguesit demografik të lindshmërisë, vdekshmërisë, emigracioni dhe migracion, i ka ndërtuar skenarët e projeksioneve të popullsisë. Sipas këtyre përllogaritjeve janë ndërtuar 3 skenarë të numrit të popullsisë shqiptare deri në vitin 2031, përkatësisht skenari i rritjes ulët, (lindje të ulta, vdekshmëri e lartë, migracion i lartë) skenari i rritjes së mesme (lindshmëri, vdekshmëri dhe migracion me rritje të mesme) dhe skenari i rritjes së lartë (lindshmëri e lartë, vdekshmëri e ulët dhe migracion i ulët). Për efekt planifikimi (demografik, financiar-buxhetor) rekomandohet përdorimi i të dhënave që rezultojnë nga skenari i rritjes së mesme të popullsisë. Gjithashtu vlen të theksohet së projektionet e popullsisë për rastin e qarqeve, janë përllogaritur duke shfrytëzuar skenarin e rritjes së mesme, në periudha 5 vjeçare dhe vetëm në nivel qarku, pra nuk ka llogaritje në nivel bashkie ose komunë.

***Mbështetur në të dhënat e popullsisë për komunat, bashkitë dhe peshën e tyre respektive ndaj qarkut për vitin 2011, janë përgatitur “projeksionet e popullsisë në nivel bashkie dhe komunash për periudhën 2016-2031.***

Në vijim po paraqesim tabelat me numrat e popullsisë për periudhën, 2011-2031, gjithmon sipas totalit të popullsisë në nivel qarku, të përllogaritur me variantin e skenarit të rritjes së mesme.

Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se popullsia e bashkisë Gramsh, sikundër edhe ajo e qarkut, do të pësojë rënie të konsiderueshme e cila si mesatare vjetore përgjatë periudhës 2015-2031, llogaritet të jetë rreth 1.3%, ndërkohë që rënia e popullsisë në 2031, e krahasuar me vitin 2015, vlerësohet të jetë akoma më e madhe në rreth 17%. Parashikimi në rënie i numrit të popullsisë rezidente përgjatë periudhës 2015-2031, është i pranishëm në të gjitha njësitë vendore të qarkut/bashkisë, duke ruajtur të njëjtin ritëm mesatar rënie sikundër edhe bashkia. Një nga faktorët që mendohet së do të vazhdojë të ndikojë në përcaktimin e stokut të numrit të popullsisë rezidente edhe në vitet e ardhshme, është faktori migrim, vazhdueshmëria, të cilit për periudhën 2011-2031, argumentohet me përspektivën e një largimi të



vazhdueshëm të të rinjve nga sektori bujqësor, në migrimet e studentëve që transformohen në një qëndrim afatgjatë përtej studimeve, si dhe në rëndësinë e normave patriarkale në krijimin e familjeve, që do të ruajë një migrim të lartë të femrave në moshë të re.

Tabela 54 Projektionet e popullsisë, bashkia Gramsh 2011-2031

Popullsia, qarku, bashkia, komunat, 2011-2031	2011	2015	2016	2021	2026	2031
<b>Bashkia Gramsh</b>	25,141	24,681	24,484	22,634	21,547	20,500
Gramsh	8,757	8,597	8,528	7,884	7,505	7,140
Pishaj	5,090	4,997	4,957	4,583	4,363	4,151
Sult	655	643	638	589	561	534
Porocan	1,317	1,293	1,282	1,185	1,128	1,074
Tunje	1,445	1,419	1,408	1,301	1,239	1,179
Kushove	684	671	666	616	586	558
Skenderbegas	1,286	1,262	1,252	1,157	1,102	1,048
Kodovjat	2,443	2,399	2,380	2,200	2,094	1,992
Kukur	2,656	2,608	2,587	2,391	2,276	2,166
Lenie	808	793	787	728	693	659
<b>Qarku Elbasan</b>	306,939	301,324	298,913	276,326	263,059	250,275

Burimi: Të dhënat për qarqet Instat, në nivel bashkie, komunash-llogaritje të autorit

## 8.2 Përfundime

- Bashkia e Gramshit në 1 janar 2016, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 24,484 banorë, prej të cilëve 12,5 mijë meshkuj dhe 11,9 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 35% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 65% si popullsi rurale. Ndërkohë sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjec dhe 22% grupmoshës (0-14) vjec, tregues këta që demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomike aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqënien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.
- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë dhe vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënien e numrit të popullsisë, por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës së qarqeve/bashkive është edhe migrimi i brëndshëm i popullsisë, pra levizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë-skenari i rritjes së mesme- popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rënie me rreth 1.3% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brëndshëm

- Popullsia rezidente e bashkisë Gramsh deri në vitin 2021, do të performojë tregues të varesisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuquajturin fenomenin e “dividentit demografik”. Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategorie të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqënies së saj dhe komunitetit në tërësi.

## 9. Zhvillimi dhe përfshirja sociale

### 9.1 Arsimi

#### 9.1.1 Niveli i përgjithshëm arsimor

Në bashkinë Gramsh, rreth 59.5% e popullsisë është me arsim bazik përfundimtar (fillor, dhe 8 ose 9-vjeçar), pothuajse në të njëjtat nivele me mesataren në rang qarku, por relativisht më i lartë nëse krahasohet me popullsisë në nivel kombëtar (52.1) %<sup>200</sup>. Shkalla e analfabetizmit në qark (3.65 %) dhe veçanërisht në bashkinë Gramsh (3.5%), edhe pse krahasueshmërisht e ngjashme me bashkitë e tjera të qarkut, është më e lartë se mesatarja në rang vendi (2.8%). Përsa i përket arsimit të mesëm, 27.8% e popullsisë është me arsim të mesëm, në krahasim me 31.4% popullsisë me arsim të mesëm në rang kombëtar (figura X). E njëjta gjë mund të thuhet dhe për arsimin universitar/pas universitar. Në bashkinë Gramsh, vetëm 7.7 % e popullsisë zotëron arsim të lartë universitar/pasuniversitar në krahasim me 11.8 % të popullsisë në rang kombëtar.<sup>201</sup> Këto të dhëna, edhe pse krahasueshmërisht të ngjashme me mesataren e qarkut Elbasan, janë më të ulta se mesatarja kombëtare, dhe më të ulta se bashki të tjera si Durrësi, Tirana, Vlora, Fieri, Berat, etj. Kjo do të thotë që popullsia që përbën forcën e punës në këtë bashki është relativisht më pak e kualifikuar, gjë që ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në punësimin e tyre dhe nivelin e jetesës. Arsimimi është ngushtësisht i lidhur me zhvillimin ekonomik, sidomos në zonat me popullsi rurale<sup>202</sup>. Nivelet e ulta të arsimimit të njëjësive administrative në bashki, i bëjnë këto komunitete lehtësisht të prekshme nga varfëria. Njësitë administrative rurale vuajnë nga mungesa e dijeve profesionale dhe teknike, sidomos në lidhje me agrikulturën.


Tabela 55 Niveli Arsimor

	Njësia administrative	Niveli Arsimor i Përfunduar			Shkalla e analfabetizmit
		8/9 vjeçar	i mesëm	i lartë	
1	Gramsh	41.39	39.94	14.85	2.6
2	Pishaj	66.4	23.39	4.51	3.5
3	Kodovjat	69.45	21.48	4.34	3.4
4	Kukur	69.83	20.74	3.73	4.2
5	Kushovë	76.32	17.67	1.13	2.9
6	Lenie	63.73	27.45	2.83	4.9
7	Poroçan	74.59	16.43	1.73	5.3
8	Skënderbegas	65.07	24.58	4.18	5.1
9	Sult	77.37	15.28	2.32	5.3

10	Tunjë	73.59	15.97	4.45	4.2
	Bashkia Gramsh	59.5	27.8	7.7	3.5
	Qarku Elbasan	59.6	26.63	8	3.65
	Shqipëria	52.1	31.4	11.8	2.8


Burimi: Instat, Census, 2011



Tabela 56 Niveli arsimor përfundimtar, Bashkia Gramsh i krahasuar



Burimi: Instat, Census 2011; Përpunoi Co-PLAN, 2016


Figura 43 Shpërndarja e nivelit arsimor të përfunduar sipas NjA-ve; Shkollimi fillor dhe 9-vjeçar, analfabetizimi, shkollimi i mesëm, shkollimi universitar.





Vitet mesatare të shkollimit janë një tregues i rëndësishëm, për të vlerësuar edukimin e moshës aktive për punë, duke qënë se ato tregojnë raportin e numrit të viteve të shkollës të kryera me sukses prej personave të moshës 15 vjeç e lart, ndaj numrit gjithsej të personave 15 vjeç e lart. Në krahasim me mesataren kombëtare, popullsia në bashkinë Gramsh ka 9.7 vite mesatare shkollimi, ngjashëm me mesataren në rang qarku, përkundrajt 10.2 viteve mesatare të shkollimit në nivel kombëtar.

Tabela 57 Vitet e Shkollimit



Burimi: Instat, Census 2011; Përpunoi Co-PLAN, 2016

### 9.1.2 Shkalla e Analfabetizmit

Tabela 58 Përqindja e shkallës së analfabetizmit sipas NjA-ve në Bashkinë Gramsh

NjA	Përqindja e shkallës së analfabetizmit
Gramsh	2.60%
Kushovë	2.90%
Tunje	4.20%
Sult	5.30%
Poroçan	5.30%

<b>Skenderbegas</b>	<b>5.10%</b>
<b>Lenie</b>	<b>4.90%</b>
<b>Kukur</b>	<b>4.20%</b>
<b>Pishaj</b>	<b>3.50%</b>
<b>Kodovjat</b>	<b>3.40%</b>

Burimi: INSTAT; Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS; 2017

Në tabelën e mësipërme paraqitet përqindja e shkallës së analfabetizimit sipas NjA-ve në bashkinë Gramsh. Në nivel kombëtar shkalla e analfabetizimit vlerësohet të jetë 2.8%. Në bashkinë Gramsh vërehet se vetëm NjA Gramsh është nën nivelin kombëtar ndërsa gjëndja më problematike vërehet të jetë në NjA-të Poroçan, Skënderbegas, Lenie dhe Sult.


## 9.2 Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Gramsh

Në bashkinë Gramsh janë 8 gjimnaze, 25 shkolla 9-vjeçare, 34 shkolla fillore dhe 43 kopshte dhe çerdhe<sup>203</sup>, shpërndarja e të cilave sipas secilës njësi administrative mund të shihet si më poshtë<sup>204</sup>.

Tabela 59 Shpërndarja e institucioneve arsimore në territorin e Bashkisë Gramsh

Njësia administrative	Kopshte	Shkolla fillore dhe 9 vjeçare	Shkolla të mesme
Gramsh	3	3	1
Pishaj	16	13	1
Kodovjat	5	9	1
Kukur	5	5	1
Kushovë	2	3	0
Lenie	2	4	1
Poroçan	2	4	1
Skënderbegas	3	7	1
Sult	1	7	0
Tunjë	4	4	1
Gjithsej	43	59	8

Tabela 60 Diagrama e institucioneve arsimore




Për të kuptuar më shumë mbi situatën në sektorin e arsimit në bashkinë Gramsh, është analizuar cilësia e shërbimit të ofruar duke marrë parasysh dy indikatorë: rrezen e shërbimit të institucioneve arsimore dhe raportin mësues/nxënës.

Qyteti i Gramshit, edhe pse është njësi me numrin më të madh të popullsisë dhe dendësisë së vendbanimeve, (ish-bashkia e vjetër para reformës territoriale), zotëron 1 shkollë të mesme, 3 shkolla 9-vjeçare dhe 3 kopshte. Në njësitë administrative Kushovë dhe Sult nuk gjendet asnjë shkollë e mesme, dhe fëmijët e këtyre zonave për të ndjekur arsimin e mesëm duhet të shkojnë në qytetin e Gramshit, ose në njësitë administrative më të afërta, në një distance që shpesh shkon edhe 10-15 km larg. Në njësitë e tjera administrative ekziston një shkollë e mesme për njësi, por zakonisht ato janë të bashkuara me shkollat 9-vjeçare dhe veprojnë në të njëjtin objekt. Megjithatë, për të analizuar aksesin e nxënësve në arsim, dhe për të vlerësuar infrastrukturën është e domosdoshme të konsiderohet *rrezja e shërbimit*, krahasuar me standartet e përcaktuar në rregulloren e planifikimit<sup>205</sup>, si dhe *raportet nxënës-mësues* në krahasim me standartet e mesatares kombëtare dhe Bashkimit Europian.

**Kopshte.** Sipas standarteve të planifikimit në Republikën e Shqipërisë, llogaritet një kopsht për çdo 1500 banorë me rreze të shërbimit të kopshtit 250-350 metra në zona urbane dhe 500-600 metra në zona rurale<sup>206</sup>. Në qytetin e Gramshit dhe në të gjitha njësitë e tjera administrative, ku dendësia e vendbanimeve është më e vogël, shihet se ka një mbulim të pjesshëm me shërbimin. Problematika kryesore në lidhje me kopshtet shihet veçanërisht në qytetin e Gramshit, ku një popullsi me 8440 banorë, shërbeht vetëm nga 3 kopshte. Për mbulimin optimal, në mënyrë që 1 kopësht ti shërbejë 1500 banorëve, nevojitet ndërtimi i një kopshti të ri. Nga ana tjetër, rrezja e shërbimit për Bashkinë Gramsh shihet se mbulon relativisht mirë qendrën e qytetit, por lë zbuluar periferinë dhe zonat më skajore. Njësitë administrative shihet të kenë edhe problematikat kryesore me shtrirjen e rrezes së shërbimit.

Edhe pse numri ekzistues i kopshteve i përgjigjet relativisht mirë popullsisë ekzistuese në njësitë administrative, për shkak të dendësisë së vogël dhe shpërhapjes së madhe të vendbanimeve në territor, një pjesë e madhe e popullsisë nuk përfiton nga shërbimi. Kjo problematike nuk është veçori vetëm e bashkisë Gramsh, por paraqet një trend në gjithë republikën e Shqipërisë, për shkak të fenomenit të dendësisë së vogël të vendbanimeve në zonat rurale. Përgjithësiht, rrezet e shërbimit të kopshteve nuk e mbulojnë mjaftueshëm të gjithë territorin<sup>207</sup>. Zgjidhja më optimale në këto raste lidhet me përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese dhe përmirësimin e transportit publik, veçanërisht për qëllime edukuese dhe shëndetësore. Për më tepër, shumica e kopshteve nuk i plotësojnë standartet minimale të sipërfaqes së objektit/fëmijë dhe sheshit funksional (oborrit), siç rekomandohet në bazë të legjislacionit përkatës<sup>208</sup>. Rekomandohet që të gjitha ndërhyrjet strategjike të Bashkisë në vitet e ardhshme të marrin parasysh këto mangësi në mënyrë që të ketë një rritje të aksesit të fëmijëve në kopshte.


Figura 44 Rreze shërbimi për kopshtet dhe çerdhe



Burimi: Instat, Census 2011; Përpunoi Co-PLAN, 2016

**Shkollat fillore dhe 9 vjeçare.** Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat 9-vjeçare duhet të jetë 500-600m në zonat urbane dhe 1000-1500m në zonat rurale dhe duhet të llogaritet një godinë për 6 000 banorë<sup>209</sup>. Siç vërehet nga harta e mëposhtme, rrezet e shërbimit të këtyre institucioneve mbulojnë relativisht mirë pothuajse të gjithë territorin e banuar, me përjashtime të caktuara. Disi problematik është mbulimi në qytetin e Gramshit, ku pjesa periferike më jugore nuk mbulohet plotësisht nga rrezja e shërbimit. Megjithatë, duke qënë se infrastruktura brenda qytetit është relativisht e mirë, vështirësia për të aksesuar shkollat ekzistuese është e vogël. Ndërkohë në njësitë administrative rurale, infrastruktura është shumë e dobët dhe aksesimi në shkollat 9-vjeçare është i vështirë. Fëmijëve në disa nga fshatrat e Gramshit, si Gjeraqinë, Duzhë, Harunas, Kokël, Vreshtas, Poroçan i Sipërm, Kotorr, Grekan, Irmanjë, etj. u duhet të përshkruajnë 3-5 km rrugë të vështirë në këmbë për të shkuar në shkollë. Edhe në rastet kur shkollat fillore dhe 9-vjeçare janë të shpërndara relativisht mirë në territorin e bashkisë dhe ofrojnë shërbim lehtësisht të arritshëm nga fëmijët frekuentues, shumica e tyre nuk i plotësojnë standardet minimale të sipërfaqjes së objektit dhe sheshit funksional (oborrit), siç rekomandohen në bazë të legjislacionit përkatës. Madje, siç është përmendur dhe më sipër, shumë nga këto shkolla 9-vjeçare janë të bashkuara me shkollat e mesme dhe gjëndja fizike e godinës është e rrënuar. Me përjashtim të 5-6 shkollavë, të gjendura në qytetin e Gramshit, në njësinë administrative Pishaj dhe në fshatin Sotirë, shumica e objekteve ku gjenden shkolla fillore dhe 9-vjeçare janë të keqpajisura me pajisje dhe kanë infrastrukturë të dobët.

Figura 45 Rreze shërbimi për arsimin fillor dhe 9-vjeçarë




Burimi: Instat, Census 2011; Përpunoi Co-PLAN, 2016

**Shkolla të mesme.** Sipas standarteve të planifikimit, rrezja e shërbimit për shkollat e mesme duhet të jetë 1000-1500m në zonat urbane dhe 2000-4500m në zonat rurale, llogaritur 1 objekt për 9000 banorë<sup>210</sup>. Në hartën e mëposhtme shihet se i gjithë territori i Bashkisë Gramsh nuk mbulohet mjaftueshëm nga shkolla të mesme. Rrezet e shërbimit të shkollave të mesme lënë zbuluar njësi të tëra administrative të banuara. Situata shfaqet veçanërisht problematike në njësitë si Sult, Pishaj, Kushovë. Në këto njësi administrative jo vetëm që nuk ekziston asnjë shkollë e mesme, por rrezet e mbulimit të shkollave të mesme të njësive ngjitur mbulojnë pak ose aspak këtë pjesë të territorit. Shumica e nxënësve që duan të vazhdojnë shkollën e mesme në këto zona duhet të udhëtojnë më shumë se 15 km, në një terren dhe infrastrukturë të vështirë. Në mungesë të konvikteve fjetës, transportit publik eficient, mundësive financiare, dhe infrastrukturës të përshtatshme, shumë nga nxënësit e zonave rurale vendosin të mos frekuentojnë shkollat e mesme. Djemtë zakonisht preferojnë të mërgojnë jashtë vendit, në kërkim të punës. Kurse vajzat përgjithësisht martohen në moshë të re dhe i dedikohen punëve të ndryshme në bujqësi. Këto dukuri shpjegojnë edhe nivelin e ulët të arsimit të mesëm në këto njësi administrative. Edhe në njësitë e tjera, ku ekziston një shkollë e mesme, rrezja e shërbimit nuk e mbulon tërësisht zonën. Në bashkinë e Gramshit nuk ekziston asnjë shkollë e mesme profesionale dhe të rinjtë duhet të shkojnë në qytetin e Elbasanit, në rast se dëshirojnë të ndjekin studimet e mesme profesionale. Bashkia duhet të ndjekë politika sociale më favorizuese për këtë kategori, duke ofruar bursa sipas meritës dhe nevojës, ose mundësi transporti. Në Gramsh ka shumë nevojë për forcë punëtore të kualifikuar me dije teknike.



Figura 46 Rreze shërbimi shkollë e mesme




Burimi: Instat, Census 2011; Përpunoi Co-PLAN, 2016

### 9.2.1 Raporti nxënës/mësues

**Kopshte.** Raporti fëmijë/edukatorë në nivel kombëtar është 18.25 sipas strategjisë kombëtare të zhvillimit të arsimit parauniversitar në Shqipëri dhe synimi është të ulët ky raport në 18 për vitin 2017 dhe 2020<sup>211</sup>. Në bashkinë Gramsh, 1 edukator kujdeset për 15 fëmijë mesatarisht, raport më i ulët se ai në nivel kombëtar <sup>212</sup>. Pothuajse në të gjitha njësitë administrative raporti edukatorë/fëmijë është më i lartë se mesatarja kombëtare, duke dëshmuar për një cilësi relativisht më të mirë të ofrimit të shërbimit të kopshtit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Arsimit, vetëm në njësitë administrative Gramsh dhe Kukur, raporti i fëmijëve për edukatorë është disi më i lartë se mesatarja kombëtare.

Figura 47 Raporti fëmijë-edukator, Bashkia Gramsh



Burimi: Ministria e Arsimit, 2015, Përpunoi : METRO\_POLIS 2017

Tabela 61 Raporti nxënës-mësues në kopshte, Bashkia Gramsh


Kopshte			
Njësia administrative	Nr. i edukatorëve	Nr. i fëmijëve	Raporti fëmijë/edukatorë
Gramsh	25	350	14
Kodovjat	7	105	15
Kukur	6	100	17
Kushovë	2	30	15
Lenie	2	29	15
Pishaj	21	249	12
Poroçan	2	32	16
Skënderbegas	3	46	15
Sult	1	17	17
Tunjë	4	57	14

Burimi: Bashkia Gramsh, Tetor 2016

**Shkolla 9-vjeçare.** Sipas të dhënave të Bankës Botërore 2013, mesterja e Bashkimit Europian (BE) e raportit nxënës/mësues për shkollat fillore është afërsisht 13.4, kurse e Shqipërisë në rang kombëtar është afërsisht 19<sup>213</sup>. Nga të dhënat e publikuara nga Ministria Arsimit 2015, pothuajse në të gjithë bashkinë e Gramshit ka një raport nxënës/mësues të ngjashëm me standardet Europiane

dhe përgjithësisht më mirë se mesatarja kombëtare. Nga tab. 3 dhe nga harta e shpërndarjes vërehet se shumë nga njësitë administrative kanë një raport nxënës/mësues rreth 3-7, që rezulton të jetë më i ulët se mesatarja në BE, gjë që mund të ketë implikimet e veta në uljen e cilësisë së këtij shërbimi. Njësia më problematike e bashkisë ngelet qyteti i Gramshit, ku në disa shkolla raporti nxënës/mësues rezulton të jetë relativisht i madh, për shkak të popullimit të dendur dhe frekuentimit më të madh të shkollave në zonën urbane.


Figura 48 Raporti mësues-shkollë 9-vjeçare, Bashkia Gramsh



Burimi: Ministria e Arsimit, 2015, Përpunoi : METRO\_POLIS 2017

**Shkollat e mesme.** Për edukimin e mesëm Shqipëria në rang kombëtar ka një raport mësues/nxënës 14, kurse niveli mesatar në Bashkimin Europian është 11.8<sup>214</sup>. Në këtë drejtim, raporti nxënës/mësues për shkollat e mesme në Bashkinë Gramsh (17 nxënës/mësues) është afërsisht i ngjashëm me standardet kombëtare.

Figura 49 Raporti mësues-shkollë e mesme, Bashkia Gramsh



Burimi: Ministria e Arsimit, 2015, Përpunoi : METRO\_POLIS 2017

### 9.2.2 Gjendja e infrastrukturës së institucioneve arsimore

Nga vlerësimi i gjëndjes infrastrukturore të të gjitha institucioneve arsimore (kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) rezulton se ato kanë nevoja të mëdha për investime, që shkon nga rikonstruksion i plotë deri të nevojat prioritare për mirëmbajtje. Përveç institucioneve arsimore në qytetin e Gramshit, kopshtet dhe shkollat në njësitë e tjera administrative shfaqin të paktën një kusht në rrezik. (këtu duhet të futet lista e investimeve për shkolla që duhet ti dorëzojë Bashkia). Për më tepër, rezulton se shumica e shkollave nuk janë të pajisura me laboratorë apo pajisje të tjera didaktike, duke e vështirësuar kështu procesin e mësimdhënies. Duke marrë parasysh të gjithë faktorët e tjerë të sipërpërmëndur, propozohet ndërmarrja e investimeve të menjëhershme për përmisimin e kushteve të institucioneve arsimore nga ana e institucioneve vendore dhe qendrore.

### 9.3 Punësimi

Numri i banorëve në moshë pune, që i përket grupmoshës 15-64 vjeç përbën rreth 67.9 % të popullsisë së Bashkisë së Gramshit. Rreth 34 % e popullsisë totale të bashkisë është banuese në qytetin e Gramshit, kurse pjesa tjetër është e shpërndarë në njësitë e tjera, përqëndruar më tepër në Pishaj, Kukur, Kodovjat dhe më pak në njësitë administrative të Lenies, Sultit, Kushovës, etj.




Tabela 62 Përbërja e popullsisë në Bashkinë Gramsh

Këto të dhëna janë optimiste pasi evidentojnë që bashkia Gramsh ka një potencial të lartë, për shkak të numrit të lartë të popullsisë në moshë punë aktive. (Këtu duhet parë për numrin e popullsisë në moshë pune në fshat, për të zgjeruar analizën-mbas analizës së Godivës).

#### 9.3.1 Punësimi sipas degëve të ekonomisë

Për të kuptuar dinamikën në tregun e punës në Bashkinë Gramsh është e nevojshme të analizohen sektorët ekonomikë me numrin më të madh të të punësuarëve. Në zonën urbane të bashkësisë, që përbehet kryesisht nga qyteti i Gramshit, numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin e shërbimeve me 78.7% (tab. X) Në degën e industrisë është punësuar 17.2 % e popullsisë, kurse në bujqësi punon vetëm 4.1 % e popullsisë<sup>215</sup>. Si mund të shihet në tabelën më poshtë, pjesa e popullsisë që ndodhet në pjesën më rurale të bashkisë, është punësuar kryesisht në bujqësi. Në njësitë si Kushovë, Lenie, Tult, Tunjë, etj., rreth 90% e popullsisë është punësuar në bujqësi. Një pjesë shumë e vogël e popullsisë merret me tregti me shumicë dhe pakicë apo industri. Në fakt, këto njësi kanë karakter bujqësor dhe shumica e të punësuarëve fokusohen në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit.


Tabela 63 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (%)

Të dhënat e punësimit sipas sektorëve ekonomik për të gjithë bashkinë Gramsh konfirmojnë një trend të përgjithshëm me qarkun. Numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin ekonomik bujqësor me 57.4 %, më pas vjen ai i shërbimeve me 34.4 % dhe në fund ai i industrisë me 8.2 %.

	Punësimi sipas degëve të ekonomisë (%)		
	Bujqësi	industri	shërbime
Gramsh	4.1	17.2	78.7
Pishaj	70.9	7.2	21.8
Kodovjat	71.4	8.4	20.3
Kukur	80.9	1.4	17.7
Kushovë	89	4	7
Lenie	88.9	1.5	9.6
Poroçan	78.7	3.7	17.7
Skënderbegas	85.9	4	10.1
Sult	87.2	2.1	10.7
Tunjë	87.3	2.2	10.6
Bashkia Gramsh	57.4	8.2	34.4

Në nivel kombëtar nuk ndodh i njejtë fenomen. Numri më i madh i të punësuarëve është në sektorin e shërbime me 55.5 %, në sektorin bujqësor me 26.1 % dhe më pas në industri me 20.4 %. Këto të dhëna konfirmojnë rënien e dukshme të sektorit industrial në bashkinë Gramsh, i cili deri para viteve 1990 ka patur një sektor industrial më të zhvilluar. Megjithatë, të dhënat e mësipërme janë të vjetra dhe me investimet në sektorin energjitik, numri i të punësuarëve në industri ka ardhur duke u rritur në vitet e fundit. (Këtu mund të vendosim shifra mbi numrin e të punësuarëve në HEC-et).

Tabela 64 Punësimi sipas degëve të ekonomisë (%)



### 9.3.2 Paga mesatare mujore sipas degëve të ekonomisë

Ndërsa të dhënat rreth pagës mesatare mujore sipas sektorëve ekonomik në nivel bashkie mungojnë, është e vlefshme analiza e tyre duke iu referuar sistemit kombëtar të pagave mujore për sektor, për të përfituar një tablo të përgjithshme të situatës ekonomike të të punësuarëve në Bashkinë e Gramshit.

Tabela 65 Aktiviteti ekonomik (2000-2013)

Aktiviteti ekonomik (2000-2013)	lek
Industri	37 646.42
Ndërtim	35 113.32
Transport e komunikacion	51 638.21
Tregti	31 733.86
Shërbime	34 447.18
Gjithsej	36 331.86

Paga mesatare mujore për një të punësuar në rang kombëtar (sektori privat dhe shtetëror), 2000-2013<sup>216</sup>


Paga mesatare mujore në Shqipëri në sektorin privat dhe atë shtetëror është më e ulta në rajon<sup>217</sup>. Sektorë të tillë si tregtia, industria dhe shërbimet ofrojnë një pagë mesatare bruto rreth 30 000-35 000 lekë/muaj<sup>218</sup>. Nuk ka të dhëna mbi nivelin mesatar të pagës për sektorin e bujqësisë, por paga minimale mujore, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të kujdesit shëndetësor sipas Drejtorisë së Përgjithsme të Tatimeve, për personat e vetëpunësuar në bujqësi, është 4 620 lekë<sup>219</sup>. Mungojnë të dhënat nëse të punësuarit/vetëpunësuarit në bujqësi sigurojnë pagë minimale apo mesatare mujore dhe sa është vlera e tyre nivel njësie administrative apo qarku. Megjithatë në bashkinë Gramsh, ku punësimi në bujqësi zë 57.4% të punësimit të përgjithshëm, më shumë se gjysma ndaj punësimit total, dhe nëse do të përlllogariten të ardhurat minimale mujore që meren nga sektori bujqësisë, do të rezultonin më të ulëta se të ardhurat që përdoren për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të varfërisë.<sup>1</sup>

### 9.3.3 Punësimi sipas nivelit arsimor

Punësimi sipas nivelit arsimor kategorizon të punësuarit sipas raportit të të punësuarëve me arsimit specifik (bazik, të mesëm apo të lartë) mbi numrin e përgjithshëm të të punësuarëve në bashkinë Gramsh (tab. 8). Këto të dhëna na shërbejnë për të kuptuar nivelin e edukimit të forcës aktive të punës së bashkisë Gramsh Kështu, 53.6% e të punësuarëve janë më arsim bazik 8-9 vjeçar në bashkinë Gramsh dhe në qarkun e Elbasanit, përkundrajt 38.1 % të të punësuarëve në rang kombëtar me të njejtin nivel arsimor.

<sup>1</sup> Shënim: Në Shqipëri nuk është ende i përcaktuar niveli i minimumit jetik, por sipas Instat "Një individ cilësohet i varfër nëse shpenzimet mesatare mujore për frymë të tij janë nën 4891 lekë"

Tabela 66 Diagrama e punësimit sipas nivelit arsimor



Në të njëjtin drejtim, numri i të punësuarëve në Bashkinë Gramsh dhe në qark me arsim të mesëm, profesional dhe të lartë është më i vogël se ai në rang kombëtar. Këto të dhëna dëshmojnë se forca punëtore e punësuar në bashkinë Gramsh është më pak e kualifikuar se ajo në nivel kombëtar. Tabela më sipër pasqyron një trend domethënës për nivelin arsimor të të punësuarëve në zonat me karakter urban dhe rural në Bashki. Kështu prsh. në qytetin e Gramshit, numri i të punësuarëve me arsim të mesëm/profesional dhe universitar/pas universitar është shumë herë më i lartë se në të gjitha njësitë e tjera. Kjo shpjegohet me faktin se njësitë administrative rurale punësojnë një numër të madh banorësh në sektorin bujqësor, i cili nuk kërkon kualifikime të mëdha. Gjithashtu aksesit në shkollat të mesme në njësitë e tjera administrative të bashkisë Gramsh është i vogël. Për më tepër, në bashki nuk operon asnjë shkollë e mesme profesionale dhe sipas të dhënave të vitit 2013, numri i nxënësve në shkollat profesionale të qarkut nga Gramshi është 0.

Duke qënë se Shqipëria është një vend me shkallë të lartë mobiliteti sidomos nga zonat rurale në ato më urbane, forca punëtore duhet të kualifikohet më tepër nëse do të jetë konkurruese në treg në rast lëvizjesh brënda bashkisë Gramsh, apo më gjërë në rajon. Ndërtimi i shkollave të mesme të profilizuara dhe nxitja e të rinjëve të ndjekin arsim të mesëm profesional shihen të domosdoshme për kualifikimin e mëtejshëm të fuqisë punëtore.

Tabela 67 Punësimi sipas nivelit arismor

	Me arsim fillor, 8 ose 9- vjeçar	Me arsim të mesëm dhe profesional	Me arsim të lartë
Bashkia Gramsh	53.6	30.8	14.4
Qarku Elbasan	53.6	31	14.3
Shqipëria	38.1	38	23
Gramsh	14.58	48.77	36.5
Pishaj	65.47	24.55	8
Kodovjat	62.33	29.74	6.4




Kukur	72.03	20.15	5.4
Kushovë	76.19	22.34	1.1
Lenie	61.99	32.47	3.3
Poroçan	76.67	18.67	3.7
Skënderbegas	66.09	27.97	5
Sult	86.10	11.76	2.1
Tunjë	76.7	19.18	3.4

### 9.3.4 Shkalla e Papunësisë

Në bazë të të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, niveli i papunësisë në bashkinë Gramsh është 31.5 %, relativisht më i lartë se ai në rang kombëtar (29.3%).

Tabela 68 Diagrama e papunësisë



Në Bashkinë Gramsh, femrat janë ato që e vuajnë më shumë papunësinë me 37.2 %, në krahasim me 27.9 % të meshkujve të papunë. Ky trend konfirmohet dhe në nivel qarku, edhe në nivel kombëtar. Niveli i papunësisë tek të rinjtë e moshës 15-24 vjeç është 49.4 %, që tregon se rreth gjysma e të rinjëve në bashkinë Gramsh janë të papunë.


Trendi i papunësisë në bashkinë Gramsh nuk është i njejtë për çdo njësi administrative. Njësia administrative Gramsh (qyteti) është njësia me karakterin më urban në bashki dhe si rrjedhojë ka një treg pune më dinamik dhe të lëvizshëm. Kurse njësitë e tjera administrative, me një nivel shumë të lartë të punësuarëve në sektorin bujqësor, me një treg të akomoduar pune dhe pothuaj të pandryshueshëm, karakterizohen nga një nivel shumë i ulët i papunësisë.

Tabela 69 Shkalla e papunësisë sipas gjinive

	Shkalla e papunësisë	Femra	Meshkuj	Të rinj (15-24 vjeç)
Gramsh	51.8	54.3	49.7	82.9
Pishaj	24.3	29.1	21.4	49.5
Kodovjat	34.8	38.3	33.4	57.3
Kukur	9.2	12	7.9	21.7
Kushovë	10.5	7	12.6	19.2
Lenie	4.6	5.3	4.3	10.8
Poroçan	9.9	26.3	5.1	28
Skënderbegas	5.2	8.1	3.8	18.3
Sult	11	21.3	6.7	41.5
Tunjë	9.1	7.8	10	23.9
Bashkia Gramsh	31.5	37.2	27.9	49.4
Qarku Elbasan	27.1	29.5	25.6	48.3
Shqipëria	29.3	31.4	27.9	52.9

Niveli më i madh i papunësisë në bashkinë Gramsh është në qytetin e Gramshit me 51.8 %. Disa nga njësitë administrative me nivelin më të ulët të papunësisë janë Lenie me 4.6 % të papunësië, Skënderbegasi me 5.2 %, Tunja me 9.1 %, Kukuri me 9.2% dhe Poroçani me 9.9 %. Të gjitha njësitë e tjera kanë nivel papunësie më të madh se 10 %, sidomos Kodovjat, që arrin nivelin e papunësisë 34.8% (tab. 9). Shifrat reflektojnë një dukuri alarmante për punësimin e të rinjëve në bashki. Në qytetin e Gramshit, 82.9 % e të rinjve të moshës 15-24 vjeç janë deklaruar si të papunë gjatë Censurit të 2011-tës. Përveç Lenies (10.8 %), të gjitha njësitë e tjera administrative kanë një nivel të lartë të papunësisë së grupmoshës rinore.

Tabela 70 Diagrama e shkallës së papunësisë sipas Nj.A



Të dhënat e mësipërme janë të dhëna të marra në bazë të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2011, të cilat në shifra të plota numërojnë rreth 5190 të papunë<sup>220</sup>. Megjithatë papunësia llogaritet edhe sipas të dhënave administrative për numrin e të papunëve, të cilat marrin për bazë punëkërkesit e papunë të regjistruar në zyrat e punës, dhe popullsinë e përgjithshme aktive, e cila përfshin zonën urbane dhe rurale. Sipas të dhënave të bashkisë, numri i personave të papunë në Gramsh për vitin 2016, llogaritet në rreth 1303. Zakonisht kjo papunësi është më e ulët se ajo me bazë censusin e popullsisë, pasi jo të gjithë të papunët i drejtohen administratës shtetërore për të kërkuar ndihmë që të punësohen. Gjithashtu, të dhënat e censusit të fundit datojnë në vitin 2011. Në vitet e fundit, bashkia Gramsh ka njohur një rritje të numrit të popullsisë së punësuar, për shkak të investimeve të fundit në fushën e energjitikës, të lidhura kryesisht me ndërtimin e një sërë hidrocentralesh.

Tabela 71 Tabelë e papunësisë në nivel Bashkie

Numri i të punësuarve në sektorin shtetëror	Numri i të punësuarve në sektorin privat	Numri të papunëve	
		1303	
		Femra	Meshkuj
1190	828	633	670

Burimi: Bashkia Gramsh

Në nivel bashkie të dhënat mbi punëkërkesit aktiv mungojnë, por në nivel qarku ato pasqyrohen në tabelën më poshtë. Rreth 16, 308 persona, banues në qarkun e Elbasanit janë rregjistruar në Zyrat e Punës si punëkërkes, prej të cilëve 2,797 janë të rinj dhe 7,774 janë femra. Shumica e punëkërkesve janë me arsim 8 ose 9-vjeçar ose me arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional. Ndihet nevoja për rikualifikim të forcës punëtore, në mënyrë që ti përshtatet tregut të punës. Nga ana tjetër, qeverisja vendore, në bashkëpunim me atë qëndrore duhet të stimulojë hapjen e vendeve të punës në të gjithë sektorët e ekonomisë.

Tabela 72 Tabela e papunësisë në nivel Qarku.

Papunësia, Qarku Elbasan						
Gjithësej	Femra	Të rinj	Arsim 8 ose 9-vjeçar	Arsimi të mesëm të përgjithshëm	Arsimi të mesëm profesional	Me arsim të lartë
16.308	7.774	2.797	9.032	5.263	1.773	241

Burimi: Punëkërkes aktivë në nivel qarku Elbasan, Vjetari statistikor, Instat 2015

#### 9.4 Shëndetësia

Sektori i shërbimit shëndetësor në Bashkinë Gramsh përbëhet nga 1 spital dhe 10 qendra shëndetësore. Shqipëria është një nga vendet e rajonit me numrin më të vogël të stafit mjekësor, me 1.14 mjekë për 1000 banorë (ËHO, 2014) ose 1 mjek për 887 banorë<sup>221</sup>. Kurse, mesatarja në BE është 3.4 mjekë për 1000 banorë ose **1 mjek për 295 banorë**<sup>222</sup>. Ndërkohë, në bashkinë e

Gramshit, ky raport është mesatarisht 4-6 herë më i vogël, ku një mjek i shërben mesatarisht 1900 banorëve<sup>223</sup>. Mungesa e stafit mjekësor është e theksuar në të gjitha njësitë administrative (ish-komunat para reformës territoriale) me përjashtim të Sultit, Lenies dhe Kushovës, të cilat kanë raportin mjek/banorë të ngjashëm me mesataren kombëtare, por sërish larg standardeve Europiane. Në njësinë administrative Kukur, një mjek i vetëm i shërben më shumë se 2500 banorëve, një raport pothuaj 8 herë më i vogël se mesatarja e BE-së. Duke qënë se e gjithë bashkia e Gramshit është një zonë e thyer malore me densitet të ulët popullsie, vështirësitë e personelit mjekësor për ti shërbyer banorëve është e madhe. Megjithatë, personeli i infermierëve luan një rol shumë të rëndësishëm në ofrimin e kujdesit shëndetësor, jo vetëm në mjedise tradicionale të tilla si spitalet dhe institucionet e kujdesit afatgjatë, por gjithnjë e më shumë në kujdesin parësor (sidomos në ofrimin e kujdesit për të sëmurët kronik) dhe në mjediset e kujdesit në shtëpi. Në bashkinë Gramsh, ka pothuaj të paktën një infermier për çdo fshat dhe në rang bashkie veprojnë mesatarisht 7 infermierë për 1000 banorë. Mesatarja kombëtare e numrit të infermierëve në Shqipëri është vetëm 3.8 infermierë për 1000 banorë, kurse ajo në BE është rreth 16.7 infermierë për 1000 banorë<sup>224</sup>.

Tabela 73 Raportet staf mjekësor/banorë në Bashkinë Gramsh

<b>Spitali dhe qendrat shëndetsore</b>	<b>Numri i mjekeve</b>	<b>Numri i infermierëve</b>	<b>Numri i popullsisë (Instat, census 2011)</b>	<b>Infermiere/ 1000 banorë</b>	<b>Mjekë për 1000 banorë</b>
Spitali Gramshit	13	88	2,4231	7	0.5
Qendra Shëndetsore Sult	1	9	631	14	1.5
Qendra Shëndetsore Tunjë	1	10	1,393	7	0.7
Qendra Shëndetsore Kushovë	1	9	659	13	1.5
Qendra Shëndetsore Skënderbegas	1	10	1,239	8	0.8
Qendra Shëndetsore Kodovjat	2	12	2,355	5	0.8
Qendra Shëndetsore Lenie	1	5	779	6	1.2
Qendra Shëndetsore Kukur	1	10	2,560	4	0.3
Qendra Shëndetsore Porocan	1	7	1,269	6	0.7


Qendra Shëndetsore Pishaj	3	22	4,906	5	0.6
Qendra Shëndetsore e Qytetit Gramsh	7	14	8,440	2	0.8

Burimi: Bashkia Gramsh 2016; Përpunoi: Co-PLAN

Në përgjigje të mungesës së mjekëve dhe për të siguruar aksesin e duhur në kujdesin mjekësor, shumë vende në botë i japin prioritet numrit dhe cilësisë së infermierëve. Eksperienca nga praktikatat në Shtetet e Bashkuara, Kanada dhe Mbretërinë e Bashkuar tregojnë se infermierët e avancuar përmirësojnë ndjeshëm shërbimin mjekësor, duke zvogëluar kohën e pritjes, ndërsa ofrojnë të njëjtën cilësi kujdesi njëllor si mjekët për shumë nga pacientët, sidomos për ata me shqetësime të vogla që përgjithësisht kërkojnë rutinë ndjekje<sup>225</sup>.

Sipas VKM nr. 671 një qendër shëndetësore duhet planifikuar për çdo 250 – 1500 banorë, dhe ambulancat/konsultore duhen planifikuar 1 për 1500-2000 banorë<sup>226</sup>. Në qytetin e Gramshit janë 7 qendra shëndetësore, për një popullsi prej 8440 banorë. Njësitë e tjera administrative kanë të paktën një qendër shëndetësore për njësi, në mbulim të mirë të popullsisë, pa marrë parasysh dëndësinë e vendbanimeve. Të dhënat e llogaritura për secilën nga njësitë administrative të Gramshit, tregojnë se qendrat shëndetësore mbulojnë mesatarisht mirë qytetin e Gramshit dhe njësitë e tjera, më përjashtim të njësisë administrative Kukur, në të cilën ekziston vetëm një qendër shëndetsore për rreth 2,560 banorë (tab.). Megjithatë, edhe pse pothuaj në gjithë territorin janë zbatuar standardet e planifikimit, të të paturit një qendër shëndetësore për 250-1200 banorë, shpërndarja dhe infrastruktura e varfër e vështirësojnë aksesin në shërbimin shëndetësor cilësor. Përgjithësisht, të gjitha qendrat shëndetësore shfaqin një infrastrukturë fizike të dobët; janë të keqpajisura dhe të vështira për tu aksesuar. Nevojitet ndërhyrja e menjëherëshme për rikonstruksionin e spitalit qendror të Gramshit.

Figura 50 Shpërndarja e shëndetësisë




#### 9.4.1 Personat me aftësi të kufizuar

Numri i personave me aftësi të kufizuar në bashkinë Gramsh është relativisht më i lartë se ai në nivel kombëtar. Rreth 8.3 % e popullsisë banuese në bashkinë e Gramshit, ose rreth 2039 persona kanë deklaruar se kanë të paktën një aftësi të kufizuar<sup>227</sup>. Numri më i madh i personave me aftësi të kufizuar i përket atyre që vuajnë nga kufizimet në lëvizje me 4.8 % të popullsisë. Në disa njësi administrative si Sulti (16.25%), Tunja (11.8), Skëndërbegas (10.25%), ka një numër të madh personash me të paktën një aftësi të kufizuar. Këto janë të dhëna shumë të rëndësishme statistikore, pasi është i domosdoshëm planifikimi i ndërtimeve të reja publike dhe private në mënyrë të tillë që të lehtësohen barrierat fizike për personat me aftësi të kufizuara.

Tabela 74 Personat me aftësi të kufizuar, Bashkia Gramsh

Personat me aftësi të kufizuara:	Bashkia Gramsh	Shqipëria
Në shikim	3.1 %	2.3 %
Në dëgjim	2.3 %	1.7 %
Në kujtesë	2.8 %	1.8 %
Në kujdesin e përditshëm	2.5 %	1.8 %
Në komunikim	2.03 %	1.5 %
Në lëvizje	4.8 %	3.7 %
Personat me të paktën një aftësi të kufizuar	8.3 %	6.2 %

Burimi: Instat, Cencus 2011



Pavarësisht një numri të konsiderueshëm personash me aftësi të kufizuara, nuk ekziston asnjë institucion publik ose privat që të ofrojë shërbime sociale për këtë kategori. Në fakt, në nivel qarku shihet se ekziston vetëm 1 institucion publik që ofron shërbim social dhe ky është kryesisht për të moshuarit. Nga ana tjetër, 10 institucione jo-publike ofrojnë shërbime sociale për fëmijët dhe familjet dhe komunitetet dhe zakonisht janë të përqendruar në bashkinë Elbasan. Kategori si gratë dhe vajzat, të rinj me probleme sociale dhe persona me aftëzi të kufizuar nuk marrin shërbim social në nivel qarku. Kuptohet që edhe në nivel bashkie, këto grupe nuk asistohen nga shërbimet sociale. Nga të dhënat e bashkisë Gramsh, evidentohet që problemet sociale në bashki janë të shumta, por shpesh herë për shkak të vështirësive të terrenit kodrinor-malor nuk arrijnë të raportohen siç duhet. Bashkia ka të regjistruar 7 raste për vitin 2016, si pjesë të skemës ekonomike, si raste të dhunës në familje. Me gjithë dinamikën e zhvillimeve socio-ekonomike në qark, por sidomos në bashkinë Gramsh këshillohet ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve ekzistuese për ofrimin e shërbimit përkatës social dhe ndërtimi i institucioneve për të ofruar këto shërbime.

Tabela 75 Shërbimet sociale në Qarkun e Elbasanit (\*Ky shërbim është iniciuar nga Këshilli Rajonal)

Qarku Elbasan	Publike	Jo publike
Shërbime sociale për të moshuar	1	1
Shërbime sociale për gra dhe vajza	0	0
Shërbime sociale për për fëmijët	1*	7
Shërbime sociale për për familjet dhe komunitetet	0	2
Shërbime sociale për PAK	0	0
Shërbime sociale për të rinj me probleme sociale	0	0
Gjithsej	1	10

## 9.4.2 Lindshmëria dhe Vdekshmëria

*Vdekshmëria Foshnjore* <sup>228</sup>

Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria renditet si vendi i parafundit me tregues për vdekshmërinë foshnjore më negative në Balkan, me 7.9 foshnja të vdekura/1000 lindje krahasuar me mesataren e BE-së, e cila është 3.7/1000 lindje.<sup>229</sup>

## 9.5 Mirëqënia ekonomike

### 9.5.1 Burimi i të ardhurave të Njësi Ekonomike Familjare (NjEF)


Në bashkinë e Gramshit rreth 22.7 % të familjeve marrin ndihmë sociale dhe përfitime (transferta të tjera) nga shteti në krahasim me 11.7 % të familjeve në rang vendi dhe 15.16% të familjeve në qarkun e Elbasanit<sup>230</sup>. Burimi i të ardhurave të NjEF-së nga puna e paguar ose vetëpunësimi është më i ulët në nivel bashkie dhe qarku, përkatësisht 54.2 % dhe 54.60 % krahasuar me nivelin kombëtar me 56.4 %. Burimi i të ardhurave nga të gjitha llojet e pensioneve për bashkinë e Gramshit është 31.8 %, pothuaj në të njëjtat nivele si ato kombëtare.

Tabela 76 Burimi i të ardhurave të NjEF

	Punë e paguar/vetëpunësim	Të gjitha llojet e pensioneve	Ndihmë sociale dhe përfitime	Para të dërguara nga jashtë shtetit
Bashkia Gramsh	54.2	31.8	22.7	6.2
Qarku Elbasan	54.4	30.98	15.16	11.7
Shqipëria	56.4	32	11.7	8.6

Gjithashtu, 6.2 % të familjeve të Bashkisë Gramsh kanë si burim të ardhurash dërgesat nga jashtë shtetit përkundrajt 8.6 % të familjeve në rang kombëtar. Ky nivel është më i ulët edhe se mesatarja e qarkut, ku rreth 12.98 % të familjeve që jetojnë në qarkun Elbasan kanë si burim të ardhurash para të dërguara nga jashtë shtetit. Ky tregues është përgjithësisht pozitiv, pasi tregon se të ardhurat e familjeve në bashkinë Gramsh varen pak nga të ardhurat nga jashtë vendit, dhe si rrjedhojë ndikohen pak nga krizat e ndryshme financiare, si për shembull ajo e viteve të fundit në Europë.

Tabela 77 Diagrama e burimit të ardhura për NjEF






Në përgjithësi, të gjitha të dhënat e mësipërme tregojnë se afërsisht gjysma e popullsisë siguron të ardhurat jo nga puna e paguar ose vetëpunësimi, por nga shteti në formën e ndihmave sociale dhe pensioneve dhe nga para të dërguara nga jashtë shtetit. Megjithatë të dhënat janë relativisht të vjetra (Census 2011) dhe bashkia Gramsh ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në vitet e fundit, për shkak të investimeve të shumta në fushën e energjisë. Një numër i madh i popullsisë është punësuar në sektorët e rinj energjitikë, duke e rritur në mënyrë të konsiderueshme numrin e familjeve që kanë burim kryesor të ardhurash punën e paguar.

Tabela 78 Burimi i të ardhurave për NjEF sipas Njësive administrative

Njësia administrative	Punë e paguar/vetëpunësim	Të gjitha llojet e pensioneve	Ndihmë sociale dhe përfitime	Para të dërguara nga jashtë shtetit
Gramsh	48.95	37.23	18.64	6.74
Pishaj	60.53	35.53	13.86	5.88
Kodovjat	42.29	29.52	<b>24.76</b>	11.43
Kukur	47.61	18.95	<b>52.06</b>	3.29
Kushovë	74.7	13.86	4.22	3.01
Lenie	62.42	30.3	<b>46.67</b>	6.67
Poroçan	65.02	14.83	<b>36.12</b>	2.28
Skënderbegas	64.6	32.65	15.12	6.87
Sult	37.76	29.37	7.69	4.2
Tunjë	74.77	31.91	<b>23.71</b>	4.56
Bashkia Gramsh	54.2	31.8	22.7	6.2

Në disa nga njësitë administrative në bashkinë Gramsh, burimi i të ardhurave të NJEF-ve nga ndihma ekonomike sociale dhe përfitime të tjera është disa herë më i lartë se mesatarja kombëtare. Kështu për shembull, numri i familjeve që kanë deklaruar si një nga burimet e të ardhurave në 12 muajt e fundit ndihmën sociale në disa njësi si Kukuri (52.06 %), Lenie (46.67%), Poroçan (36.12%), Kodovjat (24.76%), Tunjë (23.71%) është mesatarisht 5-8 herë më i lartë se në disa njësi të tjera të bashkisë. Në njësitë Kushovë (4.22%), Sult (7.69%), Pishaj (13.86%), numri i familjeve që përfitojnë të ardhura nëpërmjet ndihmës sociale dhe remitancave të dërguara nga jashtë është i vogël. Në këto njësi, burimi kryesor i të ardhurave duket të jetë puna e paguar ose vetëpunësimi, zakonisht në sektorin e bujqësisë. Me përjashtim të Sultit, në të gjitha njësitë e tjera administrative, më shumë se gjysma e familjeve ka deklaruar si burim të ardhurash për 12 muajt e fundit punën e paguar dhe vetëpunësimin.

Tabela 79 Diagrama e burimit të ardhurave për NjEF sipas Njësive administrative



### 9.5.2 Varfëria

Bashkia Gramsh (ish rrethi i vjetër i Gramshit sipas ndarjes së vjetër territoriale), ka qënë historikisht e izoluar, pa rrugë e korridore lëvizëse për njerëzit e bizneset, me mungesa të theksuara në investime, mungesë të shërbimit shëndetsor cilësor, mjekëve të specializuar, qendra për rehabilitimin e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me një normë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Ndonëse, të dhënat aktuale mbi normën e varfërisë në nivel bashkie mungojnë, bashkia Gramsh (ish-rrethi Gramsh) bën pjesë në rajonin Malor, të vlerësimeve që bën Instituti Shqiptar i Statistikave mbi varfërinë. Sipas të dhënave më të fundit, vlerësuar në vitin 2012, niveli i varfërisë në rajonin Malor të Shqipërisë është rreth 15.3%, në krahasim me 14.3 % në nivel kombëtar. Të dhënat për qarkun e Elbasanit tregojnë se përqindja e varfërisë është 10.7 %<sup>231</sup>. Qarku Elbasanit (ku përfshihen bashkitë Peqin, Belsh, Cërrik, Gramsh, Prrenjas, dhe Librazhd), konsiderohet si një nga qarqet me shkallën më të ulët të varfërisë në vend, pas Gjirokastrës. Qarku Elbasanit ka një hendek varfërie 2.3 %, krahasimisht më i ulët se ai kombëtar me 2.9%. Hendeku i varfërisë tregon se sa larg janë individët nga linja e varfërisë. Ky hendek varfërie prej 2, 3 % do të thotë se shuma e përgjithshme që do t'u duhej të varfërve për të arritur nivelin e linjës së varfërisë është e barabartë me popullsinë shumëzuar me 2.3 % të linjës së varfërisë<sup>232</sup>. Tregues tjetër është ashpërsia e varfërisë, që tregon pabarazisë midis të varfërve. Qarku Elbasan me 0.8 % nivel ashpërsie shfaqet relativisht më mirë se niveli kombëtar me nivelin 1%. Megjithatë, pavarësisht treguesëve pozitiv në nivel qarku, bashkia Gramsh, një zonë e thyer malore me densitet të ulët popullsie, ka patur një nivel të lartë varfërie ndër vite. Vetëm në vitët e fundit, falë investimeve energjitike të një sërë hidrocentralesh në kaskadën e Devollit dhe nëndegëve të tij, me punësimin e një numri të madh të popullsisë, varfëria ka ardhur duke u ulur. Përgjithësisht, zonat Malore në Shqipëri kanë patur ulje të varfërisë në vitet e fundit. Në këto zona, varfëria është ulur nga 26.6% në 2008 në 15.3% në vitin 2012<sup>233</sup>. Megjithatë, kjo ulje përveç se mund të jetë ndikuar nga zhvillimet e fundit, mund të vijë edhe si pasojë e zhvendosjes së popullsisë nga zonat Malore drejt rajoneve të tjera. Përgjithësisht vihet re një rritje e nivelit të varfërisë në rajonin Bregdetar dhe bashkinë e Tiranës, gjë që mund të konfirmojë hipotezën e mësipërme.

Tabela 80 Treguesit e varfërisë

Treguesit e Varfërisë			
	Përqindja	Hendeku (%)	Ashpërsia (%)
Qarku Elbasan	10.7	2.3	0.8
Rajoni Malor (ku futet ish-rrethi Gramsh, 2012)	15.3	2.5	0.7
Shqipëria	14.3	2.9	1.0

Burimi: INSTAT, Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, AMNJ 2002, 2005\*, 2008\*, 2012\*

### 9.5.2 Kohezioni Social dhe Gjithëpërfshirja

Në një studim të kryer nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Ministria e Çështjeve Sociale, mbi grupet vulnerabël në qarkun e Elbasanit, rezulton se vajzat, nxënësit Romë dhe nxënësit me aftësi të kufizuara janë të privuar pothuajse plotësisht nga arsimi dhe formimi profesional në rrethin e Gramshit (territori i bashkisë së sotme). Arsimi dhe formimi profesional mungon plotësisht në zonën rurale. Për sa i përket të ardhurave të pakta, të cilat lidhen në shumicën e rasteve me përfshirjen e ulët në tregun e punës, njësitë administrative përfaqësojnë karakteristika shumë të ndryshme: rrethi i Gramshit bën pjesë e grupimit si njësitë vendore më vulnerabël për sa i përket numrit të personave që përfitojnë ndihmë ekonomike. Përqindja më e madhe e familjeve vulnerabël konfirmohet të jetë në zonat rurale dhe në disa komuna ky është edhe burimi i vetëm i të ardhurave për më shumë se 35% të familjeve<sup>234</sup>.

## 1. Analiza e nevojave për strehim

Kapitulli mbi strehimin, synon të përcaktojë objektivat afatmesëm dhe afatgjatë të Bashkisë Gramsh për t'iu përgjigjur efektivisht nevojave të strehimit të përballeshëm për të gjithë popullsinë. Gjatë analizës të përgjithshme të stehimit janë marrë në konsideratë aspekte si demografia dhe projeksionet e ardhshme të popullsisë, inventari i banesave dhe truallit, njohja dhe zbatimi i paketave ligjore dhe strategjike në lidhje me nevojat e përgjithshme për strehim, intesitetet e ndërtimit, etj. Në lidhje me strehimin social, janë konsideruar disa aspekte të tjera si prsh, oferta dhe kërkesa për strehim social, fondi i banesave sociale, cilësia e përgjithshme dhe kushtet e banesave, fondi lokal për banesa sociale, etj.

Sipas Ligjit

*"Programe sociale strehimi"* janë programe, të cilat shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve, që nuk janë në gjëndje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore.

Parimi kryesor i politikave të strehimit social garanton strehimin nga shteti, për ato familje pa të ardhura, të cilat nuk arrijnë të përballojnë shpenzimet e strehimit.

## 10.1 Vështrim i përgjithshëm i ndryshimit të popullsisë, dhe tregut të banesave në nivel vendor

Në lidhje me numrin zyrtar të personave të pastrehë apo grupeve vulnerabël, bashkia Gramsh nuk zotëron një listë të përditësuar, që pasqyron numrin real të personave dhe familjeve të pastreha. Momentalisht, Bashkia mbështetet në listat e ndihmës ekonomike, kërkesave për strehim apo evidentimit ad-hoc të rasteve të personave dhe familjeve të pastreha. Megjithatë, sipas të dhënave të vitit 2013, numri total i aplikimeve për strehim social në Bashkinë Gramsh është 410. Gjithashtu, janë evidentuar rreth 54 të pastrehë, të cilët nuk kanë paraqitur kërkesë për strehim. Në tabelën e mëposhtme, mund të shihen kërkesat sipas kategorive të ndryshme sociale:

Tabela 81 Numri i aplikimeve për strehim social në Bashkinë Gramsh

Kategoritë	Numri i aplikimeve
Gratë kryefamiljare:	2
Familjet me një prind	4
Familjet me shumë fëmijë	17
Të moshuarit:	16
Personat me aftësi të kufizuara(PAK)	27
Çiftet e reja	0
Familjet që kanë ndryshuar vendbanim	4
Jetimët	0
Emigrantët e rikthyer	2
Punëtorët emigrant	0
Azil-kërkuesit	0
Familjet e policëve të rënë në detyrë	0
Viktima të dhunës në familje	0
Familje Rome	1
Familjet Egjiptiane	53
Përfituesit e ndihmës ekonomike	181
Grupe të tjera(specifiko)	0

Pjesa më e madhe e aplikantëve për strehim social në Bashkinë Gramsh, nuk kanë një banesë në pronësi dhe shumica (n= 181) prej tyre janë përfitues të ndihmës ekonomike, që do të thotë se nuk kanë asnjë të ardhur tjetër, përveç ndihmës që marrin nga shteti. Rreth 53 familje aplikante i përkasin komunitetit Egjiptian, kurse vetëm 1 aplikim është nga familjet Rome. Ky është një problem që ka nevojë të adresohet në të ardhmen, duke qënë se kushtet e jetesës dhe banesave për komunitetin Rom, janë përgjithësisht shumë të këqija. Në vitet 2010-2013 programi social i strehimit në Bashkinë Gramsh ka qënë ai i kredive të lehtësuara dhe nuk ka patur forma të tjera programesh. Nga viti 2016-të është duke u zbatuar programi i bonusit të strehimit, ku Bashkia është financuese në masën 50% të qirasë minimale. Për vitin 2016 kanë përfituar vetëm 3 familje bonusin e strehimit (Bashkia Gramsh, 2016).


Në total, 12 familje kanë përfituar strehim nëpërmjet kredive të lehtësuara nga viti 2010 der në vitin 2013, duke përfituar nga programi i **kredisë me interes të ulët** në masën **3%**. Pas viteve 2013, programi është ndërprerë dhe në vitet e fundit nuk ka patur asnjë përfitues të programeve sociale. Sipas viteve, në

mbështetjen e Bashkisë Gramsh, janë lidhur kontrata dhe janë paraqitur pranë një banke të nivelit të II-të, familjet, si me poshte:

Tabela 82 Numri i familjeve përfituese (2010-2013)

Viti	2010	2011	2012	2013
Nr. i familjeve përfituese	2	4	3	3

Në total për Bashkinë Gramsh janë planifikuar 78 kredi të buta për blerje banese në tregun e lirë, nga të cilët janë lidhur vetëm 12, duke mbetur 66 të tilla në rast se do të vazhdojë ky program. Nuk ka informacion mbi profilin e familjeve përfituese nga strehimi social, se cilit grup vulnerabël i përkasin, apo rreth përbërjes familjare, apo kushteve të tjera socio-ekonomike, në të cilat jetojnë. Problemi kryesor që lidhet me aplikimet për banesat me kosto të ulët kredie është se vendimin përfundimtar e marrin punonjësit e bankës, në vlerësim të riskut të kredisë. Vendimmarrja e tyre bazohet në qendrueshmërinë financiare të aplikantit dhe jo nga nevojat imediate për strehim.



Në nivel qendror është hartuar Strategjia Kombëtare e Strehimit 2016-2025, si dhe është draftuar projektligji Për Programet Sociale të Strehimit, i cili pritet të kalojë në parlament, në fundin e vitit 2016, fillim viti 2017.

Pesë problemet kryesore që hasen në sigurimin e strehimit në Gramsh.

- Mungesa e fondeve për ndërtimin e banesave për të pastrehët mendojmë se është problemi më kryesor
- Bashkia nuk ka ambiente të tjera të cilat mund ti kthejë në fond banese e të përdoren për strehim.
- Mungesa e të ardhurave të mjaftueshme për familjet të cilat kërkojnë të aplikojnë për kredi me interes të ulët. Sikurse dihet për të marrë 1+1,2+1,3+1 familjes u kërkohet të kenë një sasi të

ardhurash mujore,ku theksojmë se shumica e tyre që kanë aplikuar nuk kanë fare të ardhura ose janë në nivele shumë të ulëta,të cilat nuk pranohen nga Banka kur kërkohet lidhja e kontratës.

- Ka shumë familje të cilat mendojnë se kur lidhet kontrata për blerje banese në treg,u kërkohet dhe nuk u lejohet që edhe pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore,ku familja ka mundësi të shlyejë kredinë për pjesën e mbetur të kontratës,nga entet nuk lejohet asnjë ndryshim,pra do të respektohet kontrata mbi 20 vjet. Kjo e bën qytetarin (për atë që ka mundësi të paguajë)të pavendosur dhe largohet nga aplikimi i këtyre programeve.

## 10.2 Problematika

Shpesh, shërbimi social i strehimit është i ndarë nga shërbimet e tjera sociale. Kështu, edhe në rastet kur grupeve më në nevojë i sigurohet banesë (me qira apo me forma të kredis së butë), për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, në shumë raste familjet e kanë të pamundur të paguajnë për elektricitet, ujë apo ngrohje. Programet sociale të strehimit kanë nevojë që të shoqërohen, sipas rastit, me programe të tjera të shërbimeve sociale si, ato të punësimit, arsimimit, kujdesit shëndetësor, etj.

Tabela 83 Banesat e pazëna dhe bosh për Njësitë Administrative

	Banesat	
	E pazëna	Bosh
Gramsh	16.64	13.02
Pishaj	21.55	15.4
Kodovjat	42.4	41.29
Kukur	32.81	25.28
Kushovë	53.76	52.37
Lenie	41.07	8.93
Poroçan	30.61	30.61
Skënderbegas	47.03	40.52
Sult	36.61	13.84
Tunjë	45.32	34.32
	Banesat	
	E pazëna	E pazëna
Bashkia Gramsh	29.6	22.9
Qarku Elbasan	22.48	17.11
Shqipëria	29.81	21.6

Tabela 84 Vlerat mesatare të banesave

	Sip. shfrytëzimi lekë/m <sup>2</sup>	Sip. ndërtimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlerat mesatare të shit-blerjeve të banesave në tregun e lirë (lekë/m <sup>2</sup> sipërfaqe shfrytëzimi)
Gramsh	39,464	32,335	43,023

Politika e strehimit social në Shqipëri, në nivel kombëtar, por edhe vendor nuk është tërësisht funksionale, dhe arrin të plotësojë vetëm pjesërisht nevojat në këtë drejtim.

Grupet në pozita të pafavorizuara (romët, egjiptianët, jetimët, personat me aftësi të kufizuara, gratë që janë viktime të dhunës në familje, etj) janë vlerësuar të jenë edhe grupet më të përjashtuara nga politika e strehimit social (UNDP, 2014)<sup>235</sup>

## Popullsia

Tabela 85 Rënia e popullsisë në zonën urbane

	Ndryshimi i popullsisë 2001-2011
Gramsh	-19.87
Pishaj	-22.75
Kodovjat	-34.22
Kukur	-36.54
Kushovë	-51.26
Lenie	-50.91
Poroçan	-37.92
Skënderbegas	-44.06
Sult	-54.38
Tunjë	-47.57

Burimi: Census, 2011

Rënie të popullsisë në zonën urbane (qyteti i Gramshit) dhe në zonën rurale të bashkisë (të gjitha njësitë administrative). Shihet se në zonën rurale popullsia ka rënë me ritme të shpejta, duke u përgjysmuar në shumë nga njësitë administrative.

Raporti i numrit të ndërtesave për qëllime banimi të ndërtuara prej vitit 2001, ndaj numrit gjithsej të ndërtesave për qëllime banimi është 13.2 % në Bashkinë Gramsh, krahasuar me 38.5% të banesave në rang kombëtar<sup>236</sup>.

Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, në shkallë Republike, për vitin 2015, e cila të jetë 39.587 (tridhjetë e nëntë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë/m<sup>2</sup>, për sipërfaqe shfrytëzimi.

**Zgjerimi i instrumenteve financiare** është objektivi kryesor në nivelet qendrore dhe vendore të qeverisjes në Shqipëri, përcaktuar qartë në Strategjinë Kombëtare të Strehimit (2016-2025).

### Problematika:

Mungesa e të dhënave ose ekzistenca e të dhënave të varfra rreth nevojave për strehim të grupeve në pozita të pafavorizuara në nivel vendor; kapacitete të dobta vendore në sektorin e strehimit social.

### 10.3 Objektiva

- 1) Ngritje dhe forcim i kapaciteteve ekzistuese për sigurimin e njohurive rreth kërkesës dhe ofertës për strehim social në mënyrë periodike;
- 2) Për plotësimin e nevojave reale për strehim të popullatës së synuar dhe grupeve në pozita të pafavorizuara në veçanti, si p.sh. komunitetet rome dhe egjiptiane, jetimët, personat me aftësi të kufizuara, gratë që janë viktima të dhunës në familje, etj., është e domosdoshme kuptimi dhe sigurimi i njohurive për kërkesën dhe ofertën për strehim në mënyrë periodike në të gjitha njësitë vendore.
- 3) Krijimi i sistemit për mbledhjen e të dhënave dhe numrin e aplikimeve për strehim- një sistem i standartizuar mes të 61 NJQV-ve
- 4) Një nga objektivat e Strategjisë së Strehimit Social fokusohet në ngritjet e një sistemi i cili do të shërbejë për grumbullimin e të dhënave rreth strehimit social në çdo njësi vendore. Kjo përfshin të dhëna rreth aplikantëve dhe përfituesve të programeve të strehimit social, rreth karakteristikave të grupeve të përjashtuara dhe nevojave të tyre për strehim social, si dhe rreth burimeve të njërive vendore të cilat mund të mobilizohen me qëllim ofrimin e strehimit. Ky informacion i cili do të grumbullohet në nivel vendor do të komunikohet Drejtorisë së Shërbimeve Urbane dhe Strehimit nga secila njësi vendore. Informacioni do të grumbullohet dhe më tej analizohet për të matur ndryshimin në kohë.
- 5) Monitorimi dhe vlerësimi i programeve të strehimit të zbatuara dhe familjeve që kanë përfituar nga këto programe
- 6) Sigurimi i marrëveshjeve të mundshme të Partneritetit Publik-Privat (PPP) për përmirësimin e alternativave të strehimit social
- 7) Nxitja e përdorimit të ndërtesave të pashfrytëzuara dhe trojeve në njësinë vendore të Gramshit
- 8) Ministria e Zhvillimit Urban, bazuar në ligj, ka autoritetin për të garantuar politika nxitëse dhe është përgjegjëse mbi planifikimin e buxhetit për zhvillimin e strehimit social. Bashkia Gramsh, në të njëjtat kushte si 60 bashkitë e tjera në vend, duhet të angazhohet jo vetëm në zbatimin e aktiviteteve të strategjisë kombëtare të strehimit, por duhet gjithashtu të luajë një rol aktiv dhe ndikues.

## 2. Zhvillimi ekonomik

Analiza e zhvillimit ekonomik trajton prirjet kryesore të zhvillimi të Bashkisë Gramsh në aspektin ekonomik, duke u mbështetur në të dhëna si Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB), Vlera e Shtuar Bruto (VSHB), ndërmarrjen ekonomike që operojnë në territorin e bashkisë, punësimin sipas sektorëve, etj.

Ndryshimi i kufirit administrativ, me reformën administrative në maj 2014, edhe prirjet e zhvillimit ekonomik kanë ndryshuar. Fakti që territori i Elbasanit është rritur disa herë dhe territoret të cilat janë përfshirë kanë karakter rural, ka sjell gjithashtu ndryshime në vendosjen e prioriteteve për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të Bashkisë Gramsh.



## 11.1 Kuadri Makroekonomik<sup>237</sup>

### 11.1.1 Produkti I Brëndshëm Bruto(PBB)

*Produkti i Brëndshëm Bruto është një tregues i vlerës së tregut të të gjithë të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuar në një vend. PBB përfshin prodhimet dhe shërbimet aktuale, të destinuara për treg dhe ato të prodhuara për konsum vetjak nga të gjitha njësitë rezidente, që veprojnë territorin e një shteti.*

Referuar të dhënave të INSTAT, PPB për frymë në nivel kombëtarë është 460 mijë lekë, ndërsa në qarkun e Elbasanit 346 mijë lekë, pra rreth 25% më i ulët në raport me PPB për frymë në nivel kombëtar. Pësha që zë PBB e qarkut Elbasan në vlerën e përgjithshme të PBB-s kombëtare vlerësohet 7.9%, çka tregon për rëndësinë e Qarkut të Elbasanit në ekonominë kombëtare, i renditur qarku i katërt për nga rëndësia ekonomike.

Duke u mbështetur në të dhënat e mëposhtme PBB për frymë në Qarkun e Elbasanit ka ardhur duke u rritur në mënyrë graduale nga viti 2000 deri në 2008, ku në vitin 2009 kemi një rritje prej 1.5%, rritja me e madhe e PBB dhe në vitin 2010 është shënuar rritja më e madhe me 6.6% për periudhën 2000-2010.

Këto vlera në rritje tregojnë për një angazhim dhe performancë të mirë të të gjithë sektorëve ekonomikë në qarkun e Elbasanit.

Megjithatë, si pasojë e krizës ndërkombëtare ekonomike, PBB për frymë, në vitin 2012 ka pësuar një rënie me 1.9%.

Tabela 1 PBB për frymë e Qarkut të Elbasanit në raport me nivelin kombëtar

Vendi	Struktura e PBB	PBB për frymë në lekë	Struktura e indeksit për frymë ndaj PBB-së (%)
Shqipëria	100%	460436	100
Qarku Elbasan	7.9%	346054	75.2

Burimi: INSTAT 2012

Tabela 2. Struktura e PBB ndër vite

Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005
PBB për frymë në lekë	128,307	143,553	150,502	169,194	188,137	211,835
Viti	2006	2007	2008	2009	2010	2012
PBB për Frymë në lekë	230,213	243,640	278,698	286,865	352,000	346,054

Burimi: INSTAT 2012

### 11.1.2 Vlera e Shtuar Bruto (VSHB) dhe produktiviteti i sektorëve

*Vlera e shtuar bruto përfaqëson kontributin e aktiviteteve të ndryshme në PBB, dhe llogaritet si diference midis prodhimit dhe konsumit të ndërmjetëm.*

Vlerën e Shtuar Bruto më të lartë, në qarkun e Elbasanit, e ka **sektori i shërbimeve me 43.50%**, ku 23.60% e zënë shërbimet e tjera dhe 16.30% tregti, hotele, restorante.

Sektori i dytë me VSHB-në më të lartë është **bujqësia me 34.10%**, më pas renditet industria me 14.20% dhe e fundit renditet ndërtimi me 8.20%. Pavarësisht karakterit kryesisht bujqësor të Bashkisë së Gramshit, duket se vitet e fundit një hov të madh ka marrë dhe sektori i shërbimeve, kryesisht ai i hotelierisë dhe turizmit, si një nga fushat prioritare të kësaj bashkie.

Tabela 3 VSHB sipas degëve të ekonomisë në Qarkun Elbasan

	Bujqësi & Peshkimi	Industri total	Industri nxjerrëse	Industri përpunuese	Ndërtim	Shërbime total	Tregti, hotele, restorante	Transport	Postë dhe telekomunikacion	Shërbime të tjera
<b>VSHB</b>	<b>34.10%</b>	14.20%	1.60%	12.60%	8.20%	43.50%	16.30%	2%	1.50%	23.60%

Burimi: INSTAT 2012

Megjithëse sa i përket Vlerës së shtuar Bruto, sektori i shërbimeve renditet i pari në këtë qark, sa i përket numrit të të punësuarve (i llogaritur më poshtë si produktiviteti i një sektori) qarku i Elbasanit rendit sektorin Industrial të parin në listë. Megjithatë e parë në kuadrin Lokal, duket se ky sektor dominohet nga Bashkia Elbasan e cila ofron dhe numrin më të madh të popullsisë në qark, ndërkohë që Bashkia Gramsh do të reflektojë një produktivitet më të lartë në sektorin Bujqësor, i cili renditet i dyti sektor me numrin më të madh të të punësuarve në Qarkun e Elbasanit.

*Vlera e produktivitetit llogaritet si raport i vlerës së VSHB-së të sektorit me numrin e punonjësve në atë sektor.*

Nga Tabela mëposhtë, produktivitetin më të lartë e ka sektori i industrial me 3.72, më pas është **bujqësia me produktivitet 2.8** dhe në të fundit për nga produktiviteti renditen shërbimet me 1.68.

Tabela 4. Produktiviteti në sektorin e Industrisë dhe të Shërbimeve, qarku Elbasan

Sektori	VSHB sipas sektorit	Numri i punonjësve për sektor	Produktiviteti
<b>Industria</b>	59818	16067	3.72
<b>Shërbimet</b>	68135	40328	1.68
<b>Bujqësia</b>	144037	51436	2.8

Burimi INSTAT 2012

### 11.1.3 Prirjet e ndërmarrjeve ekonomike

Referuar INSTAT, bizneset sipas llojit të aktivitetit ndahen në prodhues të mirash dhe shërbimesh<sup>238</sup>.

Referuar të dhënave të Vjetorit Statistikor të 2015, ndërmarrjet aktive në Qarkun e Elbasanit që prodhojnë të mira përbëjnë 14% dhe prodhuesit e shërbimeve 86%. Sigurisht që kontribuesi më i madh i kësaj shifre është qyteti i Elbasanit, i cili alokon dhe numrin më të madh të bizneseve në Qark.

Nga viti 2013 deri në vitin 2014 ka pasur një ndryshim me 0.2 % tkurrje të prodhuesve të të mirave kundrejt prodhuesve dhe shërbimeve

Prodhuesit e të mirave ndahen në 3 kategori: a) bujqësia, b) pyjet dhe peshkimi, c) industria dhe ndërtimi. Bujqësia pyjet dhe peshkimi, që vlerësohen 1.4 %, në vitin 2014 ka pësuar një rritje me 0.2% krahasuar me vitin 2013. ***Këto shifra është e rëndësishme të merren në konsideratë për Bashkinë Gramsh, si një nga kontribueset kryesore të rritjes së prodhimit bujqësor në Qarkun e Elbasanit.*** Ndërkohë Sektori i Industrisë dhe i ndërtimit kanë pësuar ulje me 0.2% nga vitit 2013 në vitin 2014 kryesisht si pasojë e uljes së aktivitetit ndërtimor, fenomen ky i vërejtur në të gjithë Shqipërinë.

Prodhuesit e shërbimeve ndahen në 5 kategori: a) tregtia, b) transport, magazinim, c) akomodim, shërbime sociale, d) informacion komunikim dhe e) shërbime të tjera. Sektori më i zhvilluar në kategorinë e shërbimeve është tregtia, i cili nga 42.6% në vitin 2013 është rritur në 42.7% në vitin 2014. Sektori i transportit dhe magazinimit ka pësuar tkurrje me 0.6%, nga 10.8% në vitin 2013 në 10.2% në vitin 2014. Akomodimi dhe shërbimet sociale janë rritur nga 15.5% në vitin 2013 në 15.9% në vitin 2014. Në Qarkun e Elbasanit sektori kryesor ekonomik është sektori bujqësor. Ky qark ka rreth 10.4 % të tokës bujqësore në rang kombëtar dhe 11.7 % të tokës pyjore dhe kullotave në rang kombëtarë çka dëshmon për potencialin bujqësor dhe natyror që ka.

Të ardhurat nga bujqësia në qark vlerësohen me 6.5% të të ardhurave totale të bujqësisë (në rang kombëtar) dhe të ardhurat nga blegtoaria vlerësohen 9.6% të të ardhurave totale blegtorale (në rang kombëtar). Gjithashtu, të ardhurat nga produktet e ndryshme bujqësore vlerësohen me 4.1 % të totalit dhe të ardhurat nga produktet të ndryshme blegtorale vlerësohen me 20.7% të totalit. Këto të dhëna na ndihmojnë të kuptojmë se Qarku i Elbasanit ka një potencial të madh bujqësor dhe kryesisht është i orientuar drejt sektorit blegtoral kundrejt atij bujqësor<sup>239</sup>.

Referuar shifrave të mësipërme, Bashkia Gramsh, duhet të synojë forcimin e rolit të saj në sektorin e turizmit në Qark dhe më gjerë në rajon, sikurse duhet të mundësojë dhe krijojë kushte të favorshme të zhvillimit bujqësor, blegtoral dhe të agropërpunimit si sektorë ekonomik mbështetës të kryefjalës turizëm të kësaj bashkie.

Tabelat më poshtë ilustronë gjetjet sa më sipër, duke bër një diferencim të gjetjeve për dy kategoritë kryesore të ndërmarrjeve

Tabela 5 Ndërmarrjet sipas aktiviteti ekonomik në Qarkun Elbasan

<b>Të mira</b>						
	<b>Prodhues të mirash total</b>	<b>Bujqësi, Pyje, Peshkim</b>			<b>Industria</b>	<b>Ndërtimi</b>
2013	1,057	90			768	199
2013	14.20%	1.20%			10.30%	2.70%
2014	1,094	107			794	193
2014	14%	1.40%			10.10%	2.50%
<b>Shërbime</b>						
	<b>Prodhues shërbimesh total</b>	<b>Tregtia</b>	<b>Transport, magazinim</b>	<b>Akomodim, shërbime</b>	<b>Informacioni, komunikacioni</b>	<b>Shërbime të tjera</b>
2013	6,385	3,172	806	1,156	156	1095
2013	85.80%	42.60%	10.80%	15.50%	2.10%	14.80%
2014	6,705	3,354	800	1,253	168	1,190
2014	86%	42.70%	10.20%	15.90%	2.10%	15.10%

Burimi: INSTAT Vjetari Statistikorë 2015

## 11.2 Klima e Biznesit


Bazuar në të dhënat e INSTAT sektorët kryesorë të ekonomisë në Bashkinë Gramsh janë: Bujqësia ku punësohet rreth 57.4% e forcës punëtore; Industria me 8.2% dhe Shërbimet me 34.4%.

Bashkia Gramsh, ka një përqindje të lartë të papunësisë, ku në total papunësia sipas të dhënave të INSTAT është 54.3% tek femrat, 49.7% tek meshkujt dhe 82.9% tek të rinjtë. Niveli më i lartë i papunësisë raportohet në Gramsh qendër (njësia administrative e Gramshit) dhe në njësinë administrative Kodovjat. Kjo gjë është e lidhur dhe me faktin se pjesa më e madhe e popullsisë është e punësuar në bujqësi, ndërkohë që sektorët e tjerë janë shumë të dobët nga pikëpamja ekonomike. 2 vitet e fundit, krahas hartimit të Strategjisë së Turizmit për Bashkinë Gramsh, janë vënë re disa nisma të rëndësishme për ekonominë vendase në sektorin e turizmit, i cili pritet të forcohet gjithnjë e më shumë në vitet në vijim.

Tregues tjetër i rëndësishëm i marrë në konsideratë gjatë kryerjes së kësaj analize është dhe shpërndarja e biznesit sipas llojit dhe madhësisë në territorin e Bashkisë Gramsh.


Të dhënat për vitin 2017<sup>240</sup>, referuar drejtorisë së Tatim Taksave në Bashkinë Gramsh, demonstron se në bashkinë Gramsh operojnë gjithsej 550 biznese, ndër të cilat 493 janë biznese të vogla dhe 57 biznese të mëdha.

Tabela 6 Kategorizimi i bizneseve sipas madhësisë, Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

Tabela 7 Kategorizimi i bizneseve sipas llojit të aktivitetit ekonomik, Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh, 2017

Sektori i shërbimeve është i përqëndruar kryesisht në qendrat e banuara, më së shumti në qytetin e Gramshit, dhe përbëhet kryesisht nga biznese të vogla të fokusuara në ofrimin e shërbimeve si:

- Tregëti (ushqimore, farmaci, prodhime bujqësore, pika karburanti etj.);
- Transport (udhëtarësh dhe produkte, në nivel lokal dhe rajonal);
- Materiale ndërtimi dhe ndërtim;
- Bare, lokale, restorante, hotele, agjensi turistike etj.

Përtej qytetit të Gramshit, vërehet prezenca e disa bizneseve të vogla, në formën e pikave të tregëtimit dhe përpunimit të produkteve, baxhove, apo kantinave edhe në qendrat e ish-komunave.

Në përgjithësi mund të themi se zhvillimi ekonomik në Bashkinë Gramsh është i përqëndruar në bujqësi dhe blegori, dhe mungon sofistikimi dhe fuqizimi i këtyre sektorëve, apo i sektorëve të tjerë, si turizmi, punimet artizanale, apo shërbimet, të cilat janë aktualisht potenciale të pashfrytëzuara plotësisht. Për këtë arsye është e nevojshme që të krijohen mundësitë për mbështetjen dhe hapjen e sipërmarrjeve të reja që shfrytëzojnë këto potenciale në dobi të zhvillimit ekonomik në Bashkinë Gramsh.

### 11.2.1 Bujqesia dhe Prodhimi

Bashkia e Gramshit ka toka të buta dhe mjaft pjellore, diellëzim të lartë, kullota në sipërfaqe të mëdha dhe burime të shumta ujore, ndaj dhe potencialet për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe frutikulturës janë të mëdha. Pjesa më e madhe e Bashkisë, me rreth  $\frac{3}{4}$  e saj ka karakter kodrinor-malor dhe zhvillim përgjithësisht rural. Këto zona janë mjaft të pasura me prodhime bujqësore, të cilat kultivohen thuajse në të tërë territorin. Mund të përmendim vreshtat dhe ullishtet që përbëjnë dy nga kulturat kryesore, si dhe frutikulturën që është gjithashtu mjaft e përhapur.

Gjithashtu në Bashki kultivohen edhe një numër i konsiderueshëm frutash, si rrushi, fiku, molla, dardha, kumbulla, qershia, pjeshka, hurma, arra, gështenja, shega, kajsia, ulliri, bajamja etj.; dhe rreth 20 lloje perimesh si patatja, fasulja, domatja, qepa, preshi, kastravec, speci, hudhra, bamja,

patëllxhani, bostani, shalqini, sallata, mashurka, panxhari i kuq, karrota, kungulli, lakra, spinaqi dhe erëza të ndryshme.

Ndër kulturat e drithërave gruri zë peshën më të madhe, me rreth 46% të sipërfaqes së mbjellë, me një produktivitet prej 72% të prodhimit të drithërave të bukës, ndërsa misri mbillet në rreth 21% të sipërfaqes, duke dhënë rreth 27% të prodhimit të drithërave.

Gramshi njihet edhe për prodhimin e duhanit, edhe pse sot sipërfaqja e mbjellë me duhan ka rënë, rrjedhimisht edhe rendimenti. Për më tepër, çmimi që ofrohet për blerjen e prodhimit të duhanit nuk i nxit fermerët të meren me kultivimin e tij. Një pjesë të rëndësishme të territorit të kultivuar e zënë edhe bimët medicinale, të cilat luajnë një rol shumë të rëndësishëm dhe mund të shfrytëzohen për t'u kthyer në një faktor kyç të zhvillimit ekonomik të zonës në të ardhme.

Falë kushteve natyrale të relievit në Bashkinë Gramsh ka kushte edhe për mbarështimin e blegtorisë, veçanërisht të deles e të dhisë, por edhe të gjedhit e të një-thundrakëve. Në Gramsh rriten edhe mjaft shpendë të butë si pula, rosa, pata e gjeli i detit; madje në fshatin Çekin ndodhet edhe një pulari për mbarështimin e pulave. Gramshi njihet edhe për mbarështimin e bletës, duke shfrytëzuar masive kullësore. Mjalti i prodhuar sidomos në zonën e Vërçës është i një cilësie të lartë me vlera kurative.

\*Duhet shtuar me informacione rreth pikave të grumbullimit, fabrikave të përpunimit, thertoreve etj.

## 1. Ekonomite Urbane dhe Agrare<sup>241</sup>

Nga pikëpamja e politikëbërjes, zhvillimi ekonomik mund të përkufizohet si përpjekje të cilat synojnë të përmirësojnë mirëqenien ekonomike dhe cilësinë e jetës për qytetarët duke krijuar dhe/ose mundësuar vende të reja pune dhe rritjen e të ardhurave të përgjithshme.

Me **zhvillim ekonomik rural** do të kuptojmë të gjitha ato njësi territoriale e rajone me përparësi ekonomitë agrare<sup>242</sup> të prodhimit dhe përpunimit, ku me rural kuptohet çdo njësi jo urbane. Ndryshe nga kjo, **ekonomitë urbane** janë ato ekonomi të orientuara kryesisht nga ofrimi i shërbimeve, administratës dhe shërbimeve tregtare.

Analizat e zhvillimit ekonomik dhe rural fokusohen në vlerësimin e karakteristikave të cilat mundësojnë dhe formësojnë ekonomitë aglomeruese dhe efektet përkatëse të tyre në qeverisjen rajonale dhe vendore.

Për evidentimin e ekonomive aglomeruese dhe rurale janë përdorur analiza ekonometrike, të cilat i referohen dy treguesve të rëndësishëm: *densitetit të punësimit*<sup>243</sup> dhe *produktivitetit*<sup>244</sup>. Mbështetur në këto dy të dhëna, siç mund të shihet edhe nga hartëzimi i gjetjeve në figurën më poshtë, bashkia Gramsh është e orientuar drejt ekonomisë agrare, ku përjashtim bën vetëm qyteti i Gramshit, me përqendrimin më të madh të të punësuarve në sektorin e shërbimeve, duke e cilësuar këtë njësi si njësi aglomeruese.

## 2. Nxitësit ekonomikë dhe potencialet për zhvillim të mëtejshëm

### **11.2.2 Turizmi**

Turizmi përbën një nga sektorët kryesorë potencial të zhvillimit ekonomik në Bashkinë Gramsh, por pavarësisht potencialit që ai përfaqëson, momentalisht nuk është adresuar ashtu siç duhet. Nëpër territorin e Bashkisë Gramsh ka një sërë atraksionesh turistike me karakter natyror, historik dhe kulturor, të cilat në mënyrë të paorganizuar dhe rastësore shfrytëzohen për turizëm nga turistë të huaj dhe vendas. Momentalisht janë zhvilluar 3 tipe turizmi:

- Turizmi i bardhë (Mali i Valamarës, Mali i Tomorrit);
- Turizmi Kurativ (Liqeni i Zi, Liqeni i Dushkut, Kanioni i Holtës);
- Turizmi Kulturor (Grabova e Sipërme, Kalaja e Irmajit).

Disa pika të tjera të rëndësishme për zhvillimin e turizmit janë: Ujëvara e Sotirës, Grabova (përmendet për bukurinë natyrore, kishat, urat, kalldrëmet e çezmat e vjetra), Liqeni i Zi, Kalaja e Irmajit, Mali i Tomorrit, dhe Kanioni i Holtës.

Mungesa e infrastrukturave lidhëse rrugore dhe shërbimeve e bën të vështirë aktivizimin e tyre të plotë. Nëse të tëra këto potenciale integrohen sëbashku dhe bëhen pjesë e guidave turistike të organizuara nga Bashkia, duke promovuar në të njëjtën kohë zhvillimin e qëndrueshëm mjedisor dhe eko-turizmin, atëherë turizmi mund të ketë një vlerë edhe më të madhe në zhvillimin ekonomik të zonës.

### **11.2.3 Industria**

Momentalisht në Bashkinë Gramsh zhvillojnë aktivitetin e tyre shumë pak industri. Gramshi trashëgoi industrinë ushtarake nga regjimi totalitar, por me kalimin e viteve shumë prej tyre u mbyllën dhe sot janë jashtë funksionit. Mund të përmendim Uzinën Mekanike të Çekinit dhe Uzinën e Prodhimit të Baterive, që momentalisht janë jashtë funksionit dhe një pjesë e godinave të së cilës janë përshtatur për banesa dhe janë privatizuar. Një godinë 4 katëshe e po këtij kompleksi industrial është dhënë me kontratë për disa vjet për t'u përdorur si qendër tregëtare, dhe momentalisht është në ndërtim e sipër.

Industria e përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale është shumë pak e zhvilluar dhe kufizohet vetëm me prezencën e disa baxhove nëpër fshatra për përpunimin e qumështit.

Një tjetër industri, dikur shumë e famshme në Gramsh, është edhe përpunimi i produkteve me thupra misri, të cilat më parë eksportoheshin edhe jashtë vendit. Momentalisht ky aktivitet zhvillohet në mënyrë mjaft sporadike dhe të pa-organizuar, por mund të përbëjë një fushë me mjaft interes për Bashkinë, falë kulturës dhe traditës që popullsia ka trashguar në vite, në përpunimin dhe krijimin e produkteve të ndryshme.


Momentalisht në Bashkinë Gramsh vihet re tërheqja dhe zhvillimi i industrisë tekstile, ku pak kohë më parë u hap një punishte rrobaqepsie, dhe shumë shpejt mendohet të hapet edhe një fabrikë këpucësh.

### **11.2.4 Hidro - energjika**

Burimet ujore përbëjnë një pasuri të madhe potenciale për zhvillimin e industrisë energjitike të rajonit, me kosto jo shumë të lartë. Studimi i bërë për shfrytëzimin e rrjedhjes së lumit Devoll ka nxjerrë si konkluzion se mbi të mund të ndërtohen tre hidrocentrale të mëdhenj. Njëri prej tyre, ai

i Banjës aktualisht është në punë e sipër. Aktualisht Gramshi ka dy hidrocentrale të vegjël, një mbi lumin Grabovë, në Lënie me kapacitet 400kË/h, dhe një në fshatin Kërpicë me kapacitet 200kË/h.

Figura 51 Zhvillimi ekonomik



Burimi : Bashkia Gramsh, Përpunoi MetroPOLIS2017

## 12. Analiza e bujqësisë

### 12.1 Kuadri Ligjor për bujqësinë dhe zhvillimin rural

Sipas ligjit nr. 9817 datë 22.10. 2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, objektivat e përgjithshme të qeverisë në lidhje me zbatimin e politikave bujqësore dhe zhvillimin rural lidhen me rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, rritjen e prodhimit të përgjithshëm kombëtar, duke garantuar cilësi dhe siguri ushqimore dhe në të njëjtën kohë duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin. Përsa i përket rolit dhe funksioneve të qeverive lokale në këtë drejtim, ligji nr139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, përmbledh funksionet e zgjeruara të bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave pas reformës administrative territoriale, duke përfshirë: administrimin e infrastrukturës vendore të ujitjes, kullimit të tokave, pyjeve dhe kullotave vendore si dhe manaxhimin e institucioneve në shërbim të këtyre funksioneve. Për më tepër, bashkitë kanë funksion krijimit dhe administrimin e skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimit rural, të financuara nga buxheti lokal dhe/ose me bashkëfinancim nga të tretët; dhe së fundmi,



bashkitë janë përgjegjëse për shërbimin veterinar vendor, informacionin statistikor bujqësor dhe administrimin e kadastrës së tokave bujqësore.

Përsa i përket aspektit të planifikimit, objektivat e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural janë të lidhura me rritjen e sipërfaqes së tokave bujqësore të shfrytëzuara, për të rritur madhësinë mesatare të fermave e në këtë mënyrë për të rritur prodhimtarinë e sektorit (**Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor, 2014-2020**). Sipas legjislacionit në fuqi dhe ligjit 9244 datë 17.06.2004 **“Për mbrojtjen e tokës bujqësore”**, i ndryshuar, specifikohet mbrojtja e tokës nga ndërtimet, mbrojtja e shtretërve dhe brigjeve të lumenjve për parandalimin e erozionit si dhe zbatimi i një praktike të mirë bujqësore. Sipas këtij ligji, kthimi i tokës bujqësore në tokë urbane, mund të propozohet vetëm përmes një dokumenti planifikimi, sipas legjislacionit të planifikimit. Ndërtimi është i ndaluar përveç ndërtimeve të përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën dhe që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral, të cilësuar në Vendimin e KM nr. 283, datë 1.4.2015 **“Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”**. Për të gjitha objektet për qëllime bujqësore duhet të respektohen distancat nga rrugët, çdo infrastrukturë tjetër publike, nga kanalet ujitëse e kulluese, si dhe brigjet e lumenjve, me sipërfaqe dhe kritere të veçanta të përcaktuar në pikat 1-12. Leja e ndërtimit lëshohet nga njëسيا e qeverisjes vendore në përputhje me dokumentin e planifikimit vendor.

Ndryshimi i tokës bujqësore në kategori të tjera burimesh si në tokë urbane, pyjore, kullotë, livadh dhe tokë e pafrytshme bëhet sipas përcaktimit në ligjin nr. 8752, datë 26.3.2001 **“Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”** i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu do të merret parasysh VKM 410, datë 27.6.2012 **“Për Përcaktimin e Rregullave dhe të Procedurave të Ndryshimit të Kategorive të Resurseve të Tokës”** Më specifikisht, ligji cilëson që në tokat bujqësore të kategorisë së parë, dytë, tretë dhe katërt të bonitetit mundësohet kalimi në sipërfaqe për ndërtime me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm për rastet e domosdoshme si infrastrukturë (rrugore, hekurudhore, arjore, detare), hidrocentrale, varreza, si dhe raste të tjera të cituara tek neni 11/1. Shtesa e sipërfaqes nuk mund të jetë më e madhe se 3 ha dhe kërkesa për shtesë bëhet vetëm një herë. Kalimi i tokës bujqësore (boniteti V deri në X) në kategori të tokës urbane (truall), si dhe për veprimtari minerare e gjeologjike, për gurore e kariera, bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave për sipërfaqe deri në 30 ha dhe me ligj të veçantë për sipërfaqe mbi 30 ha. Ndryshimi i kategorisë së resursit tokë bujqësore në kategoritë e resurseve pyll, kullotë dhe livadh bëhet vetëm me kërkesë të pronarit të saj apo organit të qeverisjes vendore, i cili i ka në përdorim këto toka dhe ndryshimi për sipërfaqet deri në 5 ha bëhet me urdhër të ministrit përkatës, kurse për sipërfaqet mbi 5 ha, me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërkohë miratimi i ndryshimit të kategorisë së resurseve pyll, tokë me bimësi pyjore, kullotë dhe livadh dhe kalimi i tyre në kategorinë e resursit tokë bujqësore bëhet nga komisioni që krijohet pranë bashkisë (me përfaqësues të drejtorive specifike në qark, kryetar in e bashkisë dhe juristin e bashkisë). Megjithatë, këto ndryshime qoftë në rast të pronësisë private, qoftë si pronë e bashkisë ndërmerret vetëm kur paraqiten projekte zhvillimi afatgjate të kulturave bujqësore, që përputhen me programet mbështetëse të qeverisë. Kurse, ndryshimi i tokës së pafrytshme në kategorinë e resursit tokë bujqësore miratohet nga Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për sipërfaqet deri në 5 ha, dhe me vendim të Këshillit të Ministrave

për sipërfaqet mbi 5 ha. Në tokat bujqësore, në të gjitha kategoritë e bonitetit, miratimi i kalimit të sipërfaqes për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe në asnjë rast nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të objektit ndërtimor. Sipas ligjit nr. 10 263, datë 8.4.2010 **“Për përdorimin dhe shfrytëzimin e tokave bujqësore të pakultivuara”**, toka bujqësore konsiderohet si e pakultivuar në rastet kur autoritetet vendore kanë vërtetuar se toka nuk është kultivuar për të paktën 2 vjet rradhazi. Në këto raste, kur pronari i tokës nuk ushrtun të drejtën për kultivimin e saj, bashkia ka të drejtë ta nxjerrë në ankand për ta ofruar me qira sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Akte të tjera nënligjore që i shërbejnë zhvillimit të përgjithshëm bujqësor dhe rural përfshijnë VKM nr. 52, datë 21.1.2015 **“Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2015 i ndryshuar”** dhe udhëzimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Financave nr. 4, datë 25.2.2015 **“Për procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”**, të cilat përcaktojnë mbështetjen financiare për vitin 2015, nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, i cili bazohet në rajonizimin e aktiviteteve sipas hartës bujqësore të miratuar nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave. Ligje të tjera që organizojnë veprimtarinë bujqësore përfshijnë ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 **“Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio" i ndryshuar”**, në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit, të kryera në përputhje me rregullat e përkrahura në këtë ligj, për prodhimin e produkteve organike dhe ligji nr.38, datë 5.4.2012 **“Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”**, ku shprehet përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe kushteve për themelimin e administrimit të shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, si dhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre.

## **12.2 Strategjitë dhe Planet Kombëtare për Bujqësinë dhe për Zhvillimin rural**

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, shkon në të njëjtin drejtim me perspektivën e vendit për antarësimin në BE dhe si rrjedhojë mbështetet në parimet dhe objektivat e Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP) dhe politikat (IPARD), duke patur në fokus kushtet dhe problemet specifike të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri. Objektivi i përgjithshëm i strategjisë është trajtimi i sfidave me të cilat përballet sektori i bujqësisë dhe agro-përpunimit në vend, si edhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Në lidhje me zhvillimin ekonomik, social dhe territorial, objektivi lidhet me rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit të bujqësisë, duke mbështetur sektorët prioritarë, rritjen e sipërfaqeve bujqësore të kultivuar, rritjen e madhësisë të fermave, infrastrukturën mbështetëse të bujqësisë, rendimentin për njësi të sipërfaqes dhe prodhimin e përgjithshëm.

Në Qarkun e Elbasanit, bujqësia mbetet sektor shumë i rëndësishëm ekonomik dhe kontribuon në ekonominë kombëtare me produktin e brendshëm bruto, në punësimin në zonën rurale dhe stabilitetin makroekonomik. Në Qarkun e Elbasanit sektori i bujqësisë jep rreth 18 % të PBB. Megjithatë, performanca ekonomike, kontributi i sektorit bujqësor në vend është ende i pamjaftueshme për shkak të fermave të vogla dhe të fragmentuara, aftësisë ujitëse të ulët, nivelit të ulët të teknologjisë dhe produktivitetit total të faktorëve të prodhimit, krahasuar me treguesit e

BE për njësi të sipërfaqes dhe të disa bashkive të zonave fushore me mesataren e vëndit dhe vëndeve të BE-së.

Në Bashkinë e Gramshit, me sipërfaqe të përgjithshme 737 km<sup>2</sup>, toka bujqësore zë 10338 Ha ose 14 % të sipërfaqes së përgjithshme të territorit. Sektori bujqësor është përqëndruar kryesisht në formën e fermave familjare, ferma të vogla dhe të fragmentuara. Në nivel kombëtar, 58 % e fermave bujqësore janë me madhësi deri në 1 ha tokë, ndërsa në Qarkun e Elbasanit madhësia mesatare e fermave varion mesatarisht në 1.2 ha.

Në bashkinë e Gramshit veprojnë 4700 ferma bujqësore e blegtorale me një sipërfaqe masatare prej 1.35 ha. Nga kjo janë:

- a) 625 ferma me 0.5 Ha
- b) 2070 ferma me 0.5-1 Ha
- c) 1338 ferma me 1-1.5 Ha
- d) 514 ferma me 1.5-2 Ha
- e) 240 ferma me 2 Ha

Fermat familjare janë kontribuesi më i rëndësish

ëm për sigurinë e ushqimit, duke prodhuar ushqimin për vetë-konsum si dhe pjesërisht për treg. Kontributi i tyre në punësim është i rëndësishme duke qënë se shumica e fermave individuale shërbejnë si burimi kryesor i të ardhurave për të vetëpunësuarit në këtë sektor. Rreth 57 % e numrit të përgjithshëm të fermave janë të madhësisë deri në 1 ha dhe të fragmentuara në 4-5 parcela të vogla dhe jo eficiente për organizimin e prodhimit.

Në përgjithësi, sektori bujqësor në të gjithë territorin e vëndit, karakterizohet nga niveli i lartë i fragmentimit të pronës në jo më pak nga 4 vënde të shpërndara në pika të ndryshme dhe të pa kufizuara me njëra – tjetrën. E njëjta dukuri ndodh edhe në Bashkinë e Gramshit. Me një sipërfaqe totale të tokës bujqësore prej rreth 10330 ha, madhësia mesatare e fermës brënda bashkisë konsiderohet të jetë 1.35 ha, krahasuar me madhësinë 1.20 ha në qarkun e Elbasanit dhe madhësinë 1.2 ha në rang kombëtar, ndërkohë që madhësia e parcelës është 0.27 ha në rang kombëtar, 0.23 ha në rang qarku. Këto të dhëna dëshmojnë se fermat në bashkinë e Gramshit, janë të vogla dhe sektori bujqësor vazhdon të ngelet mjaft i fragmentarizuar. Rritja e madhësisë së fermës konsiderohet si një faktor i rëndësishëm për të përmirësuar eficientë ekonomike në sektorin bujqësor dhe për ta bërë atë më konkurrues në treg. Aktualisht, nevojat për produkte blegtorale dhe bujqësore mbulohen nga importi i cili mbetet i lartë krahasuar me exportet. Megjithatë, në territorin e Bashkisë Gramsh, në raport me popullsinë, ekzistojnë potenciale të pa shfrytëzuara për rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, për shkak të burimeve të papërdorura tokësore dhe mundësisë për rritjen e numrit të krerëve dhe prodhimeve blegtorale.

### **12.2.1 Plani Kombëtar**

Plani kombëtar në sektorin e bujqësisë, përqendrohet në synimin për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, vlerësimin e potencialeve të burimeve natyrore dhe planifikimin e territorit. Një ndër objektivat më prioritare të Planit Kombëtar është ruajtja maksimale e fondit të tokës bujqësore dhe në veçanti tokat me potenciale të larta prodhuese, duke ndaluar çdo ndërtime që nuk i shërben sistemit bujqësor, plani gjithashtu synon vendosjen e një rrjeti të suksesshëm të zinxhirit ekonomik bujqësor: prodhim-grumbullim-përpunim-eksportim, si dhe investime në infrastrukturën e mirëmbajtjes, sistemin ujtitës e kullues.

Plani Kombëtar i Planifikimit të Territorit e vendos Bashkinë e Gramshit si pjesë e rajonit ekonomik të Qarkut të Elbasanit me një profil Bujqësi- Turizëm. Bashkia e Gramshit ka zona me karaktere të forta bujqësore, çdo zhvillim i ri në njësitë administrative duhet të ruajë karakterin ekzistues rural, vecanërisht në fshatrat në të dy anët e lumit Devoll. Një rëndësi e madhe këtu duhet t'u kushtohet strukturave dhe ngritjes së infrastrukturës strategjike të përshtatshme në funksion të zhvillimit bujqësor e blegtoral. Plani i trajton me prioritet rajonet me karakter të theksuar bujqësor dhe për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë rurale, thekson diversifikimin e aktivitetit të fermerëve dhe efikasitetin në sektorin e ushqimit dhe bujqësisë së bashku me peshkimin dhe pylltarinë, ku Bashkia e Gramshit i gjen mundësitë e zhvillimit në shtatë drejtimeve. Kështu në Bashkinë e Gramshit, sipërfaqja e mbuluar me pyje prej 31000 ha ose 42 % të territorit, është një burim i rëndësishëm ekonomik dhe për shërbime mjedisore.

Ne PPK janë parashikuar:

Ruajtje maksimale e fondit të tokës bujqësore, me zbatimin e politikave të densifikimit të zhvillimit urban. Me miratimin e Planit Kombëtar 2030 nuk lejohen ndërtimet e reja në tokë bujqësore që nuk i shërben sistemit Bujqësor. Krijimi i qëndrave/ poleve bujqësore dhe profilizimi i këtyre të fundit sipas karakteristikave të prodhimit bujqësor, krijimi i markave të produkteve karakteristike bujqësore të vendit. Specializim në prodhim dhe përpunim të prodhimeve dhe produkteve karakteristike shqipëtare. Bimët Mjekësore, pemë frutore arnore dhe vreshtarisë, perime karakteristike të zonës, Produkteve bujqësore të përpunuara bujqësore e blegtorale, janë produkte, të cilat mund të zgjerohen në territorin e Bashkisë Gramshit.

### **12.2.2 Rajonizimi i kulturave dhe skemat mbështetëse për bujqësinë**

Rajonet bujqësore zakonisht përcaktohen si zona me një homogjenitet të lartë në relief, llojin e tokës, kushtet klimatike, praktikat bujqësore, vendosjen e bimëve dhe kafshëve më të përshtatshme për klimën dhe tokën dhe rajonizimi i kulturave bujqësore në bazë të kushteve specifike, si relief, klimë e përshtatshme, lloji i tokës, traditë kultivuese, sipas përparësisë drejt disa kulturave të veçanta. Në kushtet e Bashkisë së Gramshit bimë të përshtatshme janë gruri, foragjeret, patate, perime, peme frutore, traditë që duhet rikthyer në kultivimin e duhanit, si një ndër bimët me përfitime për eksport.

Në përgjithësi, të gjitha rajonet, të cilat kanë kushte eko-klimatike të favorshme për kultivimin e perimeve, e shohin si të nevojshme skemën mbështetëse të qeverisë mbi shtimin e serave me ngrohje ose me plasmas. Aktualisht serat në bashkinë e Gramshit zënë vetëm 1.4 ha dhe prodhohen rreth 142 Ton perime (2015). Rendimenti i realizuar është 4.3 herë më i lartë se rendimenti i realizuar në kushte fushore. Shfrytëzimi i mikroklimeve zonale, krijon mundësitë e rritjes së sipërfaqes së serave, kultivimit, vecanërisht të perimeve.

Përparësitë kryesore të zhvillimit të bujqësisë për kushtet e Gramshit janë pemët frutore, vreshtaria, blegtoria e imtë, gruri, bimët medicinale, përparësi mesatare perimet, gjedhi, bleta, kulturat arnore ( arra, bajame, lajthi, gështenjë, shegë). Sipas një studimi të kryer, në territorin e Bashkisë së Gramshit, kulturat arnore gjenden të shpërndara në rreth 5000-6000 rrënjë. Por bazuar në sipërfaqet e lira dhe kushtet klimatiko tokësore, janë mundësitë e kultivimit të arorëve në 500-600 ha në vazhdimësi, duke rritur të ardhurat në zonën rurale dhe zhvillimin e qendrushëm bujqësor.

Pemëtaria mbetet një drejtim i rendësishëm në zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë e Gramshit dhe të peshës në sektorin e bujqësisë në saj të një tradite të kultivimit të drufrutorëve dhe kushteve të përshtatshme klimatike dhe tokësore në disa zona, duke i dhënë përparësi kryesore në këtë mënyrë rajonizmit të pemëve frutore. Peshën specifike më të lartë në këtë drejtim duhet ta zerë kultivimi i mollës, kumbullës, qershia, kajsia, dardha, vreshtaria në blloqe dhe pjergullat, më e kufizuar pjeshka, hurma, kushte të përshtatshme për fikun etj.

Prodhimet organike Në objektivat e PK , është parashikuar edhe zhvillimi i bujqësisë organike , për mundësitë që krijojnë kushtet klimatike e tokësore dhe njohurive tradicionale të fermerëve vendas që nga periudha e mungesës të plehrave kimike dhe pesticideve. Zhvillimi i bujqësisë organike bëhet më e domosdoshme edhe në kushtet e synimit të zhvillimit të turizmit dhe nevojës për produkte bio dhe të tendencës pozitive në konsumimin gjithmone e me tepër të produkteve bio-organike.

Kërkesa për produktet bio-organike është e lartë në tregjet mesdhetare apo Europiane. Kushtet klimatike e tokësore dhe prodhimi i shpërndarë në të gjithë territorin e Bashkisë Gramshit, e vendosin bujqësinë organike në avantazhe shumë të favorshme për tu zgjeruar si në bujqësi, blegtori, bimë medicinale. "Prodhime organike" janë të gjitha veprimet e përfshira për prodhimin e produkteve "Bio", në mbështetje të përdorimit harmonik të kushteve të mjedisit dhe të kryera në përputhje me rregullat e përshkruara në ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 "**Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve bio**". Një nga parimet kryesore për prodhimet organike, ndër shumë specifike të tjera, lidhet me sasinë totale të plehrave kimikë, të përdorura në një zonë bujqësore, zgjerimi i bimëve leguminoze si fasule, bizele etj, që grumbullojnë në tokë lendë ushqyese dhe kufizohet përdorimi i plehrave në mbjelljet pasardhëse, qarkullimi i bimëve bujqësore cdo vit në të njejtin vënd, jane faktorë që sigurojnë produkte bio. Sipas studimit të ndërmarrë nga Ministria e Bujqësisë<sup>245</sup> **produktet** relativisht më të lehta për t'u prodhuar **bio** jane: ulliri dhe vaji ullirit, bimët mjekësore; **perime** si qepa, domatja, speci, patllixhani, lakra, lulëlakra, sallatrat, brokoli, spinaqi, erëzat e guzhinës, patatja; **nga frutat**, hurma, shega dhe fiku; si **produkte blegtorale**, mishi i viçit, mishi qingjave dhe kecape në zonat kodrinore të bashkisë, djathi dhisë dhe mjalti. Mbështetja e prodhimeve organike duhet të orientohet në zonat kodrinore dhe malore ku përdoren më pak plehëra kimike dhe pesticide, ku ndotjet janë më të pakta dhe mjedisi ruhet më mirë. Në territorin e Bashkisë Gramsh, vlerësohet një potencial i lartë për prodhimin e produkteve bio, kryesisht të perimeve, prodhimet bio për pemtarinë (molla, kumbulla, aroret) sidomos në zonën kodrinore të saj. Një mundësi tjetër në Bashkinë e Gramshit është prodhimi bio i mishit të bagëtive të imta, të cilat rriten në kullotat natyrale, prodhimi i qumështit dhe nënprodukteve të tij.

Disa eksperiencia gjenden aktualisht në zonën rurale të Bashkisë. Kështu, në fshatin Cerruj është organizuar "**Shoqëria e bashkëpunimit bujqësor**", në të cilën përfshihen 20 familje dhe punojnë sëbashku 30 ha tokë për kultivimin e bimeve medicinal (lavandula) dhe vreshtari organike. Lavandula përveç vlerave medicinale, mbron tokën nga erozioni. Prodhimi i bimëve medicinal bio eksportohet në Austri. Shoqëria në fabrikën e përpunimit të rrushit prodhon verë të certifikuar që eksportohet. Bujqësia biologjike në bashkinë e Gramshit gjen mundësi të shtrihet gjërësisht në bagëtitë e imta në zonën kodrinore dhe malore me kullotje në natyrë dhe sigurimi i qumështit dhe mishit bio.

## 12.3 Klima

Klima është një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e bujqësisë. Territori Bashkisë Gramsh, përfshihet në zonën me klimë mesdhetare kodrinore dhe mesdhetare malore. Në zonën e parë përfshihen NJA dhe fshatrat që shtrihen në dy anët e lumit Devoll, kryesisht zona e Sulovës dhe zonës së Vërcës në lartësinë 600-700 m lartësi. Sasia vjetore e reshjeve varion në 950-1300 mm reshje, temperatura mesatare vjetore varion 14-15 gradë, ndërsa në pjesën malore 11-13 gradë. Temperatura mesatare e Janarit (muaj më i ftohtë), varion në 6 gradë dhe nga fundi i Marsit ngjitet në 10 gradë, 23-24 gradë në Korrik. Deri në fillim të muajt prill vazhdojnë ngricat.

Në zonën e dytë, mesdhetare malore, ku përfshihet zona e Porocanit, Kukurit, Sojnikut, Lenie dhe një pjesë e Drizës, Kodovjat, Vidhan dhe Skënderbegas, sasia e reshjeve arrin në 1200-1500 mm reshje, vera është e shkurtër, temperatura mesatare vjetore 8-12 gradë, temperatura me e ulët deri – 8 gradë. Një pjesë e reshjeve janë në formë dëbore. Ka diell të mjaftueshëm. Klima është e përshtatshme për zhvillimin e pemtarisë, grurit, foragjereve, perime-patate, vreshtarisë, bimëve medicinale, zgjerimit të prodhimit në sera në vendet e mbrojtura nga era etj.

## 12.4 Zhvillimi I bujqësisë në vite të Bashkisë Gramsh

### 12.4.1 Historiku i zhvillimit të bujqësisë

*Deri në vitin 1990*, NJA të Bashkisë Gramsh (2015) ishin të përfshira në rrethin e Gramshit me një sipërfaqe të përgjithshme prej 695 km<sup>2</sup>. Në një popullsi prej 43,8 mije banorë, 17 % jetonte në qytet dhe 83 % në fshat, bujqësia përbënte aktivitetin kryesor ekonomik.

Edhe para vitit 1990, bujqësia përbente aktivitetin kryesor ekonomik, duke qenë një rreth bujqësor dhe më pak industrial. Prodhimi përgjithshëm bujqësor në vitin 1990, ka qenë 2.5 herë më i lartë se prodhimi i përgjithshëm industrial. Nga ana tjetër, për shkak të disa faktorëve kufizues si cilësia e tokës, aftësia e ulët ujitëse, terreni pjerrtë, fragmantimimi i lartë i tokës, teknologjitë dhe praktikat bujqësore jo të avancuara, rendimentet dhe prodhimi për njësi të sipërfaqes është i ulët. Deri në vitin 1990, sipërfaqja e tokës bujqësore ishte e organizuar në 15 kooperativa dhe ferma shtetërore bujqësore (14 kooperativa dhe një fermë bujqësore shtetërore). Në atë periudhë, përdorimi i tokës varionte në këto raporte: nga 10.8 mije ha gjithsej dhe kultivimi 100 %. Nga kjo, 9.4 mijë ha (87 %) e kultivuar me bimët e arave, 1 000 ha me pemtore (9.3 %) , 300 ha vreshta (2.8%) dhe 100 ha ullishte (0.9 %). Rezultatet më të larta në prodhimin e drithërave, foragjereve, realizohen në luginën e Devollit.

Prodhimet kryesore bujqësore të periudhës ishin bimët e arave, që zinin 85-87 % të sipërfaqes të përgjithshme të tokës bujqësore, ndër to peshën kryesore e zinin drithërat (gruri, misëri), sipërfaqe të kufizuara perime, patate, fasule, duhani, lulediell, foragjere, pemëtari, vreshta, ullishte. Numri i pemëve frutore, përgjithësisht të shpërndara dhe pak në blloqe, rreth 300 mijë, në periudhën e tranzicionit u abandonuan dhe në vitin 2015 numri i rrënjëve zbriti në 105 mijë ose 3 herë më pak.

Blegtoria ishte një sektor i rëndësishëm. Rreth 14 mije krere gjedhe ( 40 % e numërit të krerëve lopë), 30 mije krere të leshta, 42 mije krerë të dhirta, 70 mije krerë shpendë, 2000 koshere bletë. Prodhimi i qumështit 7600 ton. Në krahasim me vitin 1990, treguesit bazë të bujqësisë në Bashkinë e Gramshit, kanë pësuar ndryshime drastike në nivelin e përdorimit të tokës, strukturën e prodhimit, rendimentet dhe prodhimin bujqësor diku në ngritje, diku në ulje.

*Pas vitit 1990, me privatizimin e tokës bujqësore u krijuan 4700 ferma bujqësore me sipërfaqe mesatare të fermave 1.35 ha. Privatizimi i tokës dhe krijimi i fermave familjare, në vitin 2015, në krahasim me vitin 1990 solli ndryshime thelbësore në përdorimin e tokës bujqësore, pasi është kultivuar vetëm 58 % e sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore dhe 42 % e lënë djerr. Në vitin 2015, gjithashtu sipërfaqja e kultivuar me bimët e arave, në krahasim me të njëjtën periudhë është ulur 3.4 herë (ose kultivuar 27 % ndaj vitit 1990), prodhimi i grurit ulur 26-43 %, sipërfaqja e pemtorëve 4-5 herë më e ulët, vreshtaria 10 herë më e ulët dhe prodhimi i rrushit rreth 500 Ton më pak.*

Tabela 86 Sipërfaqja e tokës bujqësore sipas përdorimit viti 2015

Sipërfaqe në Ha	Në hektare 1990	Në hektare 2015
Tokë bujqësore	10338	10338
Tokë Arë	87 %	9172
Tokë e kultivuar	100 %	5545
Pemtari	9.3 %	197
Vreshta	2.8 %	133
Ullishte	0.9 %	240
Tokë e pakultivuar)	0	4330

Burimi: Bashkia Gramsh, 2015

Duhani është një kulturë me leverdi ekonomike dhe me traditë të kultivimit në zonë. Në vitin 2015, janë prodhuar vetëm 6.8 Ton duhan, nga 2800 kv të prodhuar në vitin 1990. Pas 1990, është ulur ndjeshëm sipërfaqe e kultivuar, në uljen e prodhimit dhe rendimenteve të kulturave bujqësore, ulja e numrit të krerëve të gjedhit, numri krerëve të dhive, rritja e numrit të të leshtave, rritje e prodhimit të qumeshtit dhe rendimentit për krerë, rritja e shpendëve dhe prodhimit të vezëve, dy fishimi i numrit të koshereve të bletëve.

Me zbatimin e reformes administrative-territoriale (2015) Bashkia e Gramshit u organizua në 10 NJA, nga bashkimi i ish komunave me bashkine e qytetit. Bashkia aktualisht është përgjegjëse për zhvillimin e bujqësisë.

Bujqësia aktualisht, mbetet sektori kryesor ekonomik në Bashkinë e Gramshit. Bujqësia siguron 30 % të vlerës së shtuar bruto nëpërmjet aktiviteteve bujqësore, pyjeve dhe sektorëve të tjerë të saj. Popullsia rurale, vazhdon të jetë më e lartë nga popullsia urbane. Popullsia urbane(qyteti dhe dy njësi administrative përreth zene 16,4 mijë banorë, popullsia rurale 19.7 mije banore ( megjithëse shifrat e Census nuk përputhen me gjëndjen civile). Rreth 55-58 % e forcave të afta për punë vëtpunësohen në bujqësi.

Blegtoaria, është një sektor i rendësishëm për ekonominë rurale të Bashkisë Gramshit. Relievi në ¾ e territorit është kodrinor-malor, gjë që dikton nevojën e zhvillimit të bujqësisë mbi sistemet dhe parimet e bujqësisë kodrinore-malore. Bujqësia në bashkinë e Gramshit përshtatet me zhvillimin e pemtarisë tradicionale dhe zgjerimin e aroreve dhe ullirit, Sipas të dhënave të Bashkisë, në NJA, mbarshtrihen 5569 lope, por ka renë numri i gjedhit me 3000 krerë më pak, 53000 të leshta (dele 35000 krerë), (dhi 22500 krerë ose 2 herë më pak se në vitin 1990). NJA

Skenderbegas, Kukur dhe Lenie, zënë 64 % të numrit të krerëve të të leshtave të Bashkisë. Ndersa 3 NJA (Pishaj, Kodovjat dhe Sult) mbarshtrajne 52 % të numrit të krerëve të të dhive. Nga analiza jone, rezulton se kapaciteti mbajtës për cdo 100 ha është më i lartë nga numri aktual i gjedhit dhe në vecanti bagëtime të imta dhe se numri i të imtave duhet të rritet jo më pak nga 20-30 % nga numri aktual. Disponon rreth 10 mije ha kullota, nga të cilat 8500 ha kullota verore. Dominimi i kullotave verore ndaj atyre dimërore, dikton nevojën e përmirësimit të strukturës së prodhimit foragjer për të mbuluar këtë periudhë. Numri i të dhirtave është nën numrin e krerëve të vitit 1990. Prodhimet kryesore blegtorale janë qumështit.

Tabela 87 Prodhimet blegtorale 2015

1	Nga delet Ton	Nga dhia Ton	Nga Lopa Ton	Prodhimi Total Ton
2	3443	3508	15020	21971
%	15.6	15.9	68.6	100

Burimi: Bashkia Gramsh

Në zhvillimin e blegtorisë, shtimi i numrit të krerëve, rendimentit të qumështit për krerë dhe prodhimit të qumështit dhe mishit për cdo 100 ha tokë, ka rezerva të mëdha, të cilat duhen shfrytëzuar.

Nga analiza e treguesve të bujqësisë dhe kapaciteteve mbajtëse për blegtorinë, rezulton se në bujqësi ka rezerva të pa shfrytëzuara në përdorimin e tokës, përmirësimin e strukturës së prodhimit bujqësor, të rritjes së rendimentit dhe prodhimit, shtimit të sipërfaqes së pemtarisë, vreshtarisë dhe pjergullave, duhanit, bimëve medicinale, shtimit të numrit të krerëve të bagëtime të imta si numri i të leshtave për 100 ha tokë të punuar dhe të dhive për 100 ha pyje e shkurre. Duhet të rritet përdorimi tokës dhe kultivimit të gjithë sipërfaqes së tokës bujqësore, rritjes së madhësisë së fermave dhe bashkimit të pronës.

Rritja e aftësisë ujitëse që aktualisht është në masën 10 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore (1100 ha) ose 21 % e aftësisë ujitëse faktike të vitit 1990, e cila ishte 5380 ha.

## 12.5 Toka Bujqësore

Bashkia e Gramshit, shtrihet në të dy anët e lumit Devoll dhe në territor të gjërë kufizohet me Elbasanin, Pogradecin, Maliqin, Skraparin, Beratin, Kucovën, Cërrikun. Kjo shtrirje, krijon një larmi të theksuar të relievit .

### Relievi:

Karakterizohet nga një reliev kodrinor e malor me lartësi 100- 1400 m mbi nivelin e detit (Sojniku dhe Porocani) dhe pjesërisht në luginen e Devollit. Sipas pjerresise tokat bujqesore klasifikohen ne:

**Tokat me pjerresi 0-5 % 1400 ha ose 13.9 %**

**Tokat me pjerresi 6-25 % 50072 ha ose 50.7 %**

**Tokat me pjerresi 26-50 % 3128 ha ose 31.3 %**



## **Tokat me pjerrësi mbi 51 % 407 ha ose 4.1 %**

Në të gjithë territorin gjenden toka me pjerrësi e lartësi të ndryshme. Në lartësi më të ulët gjenden tokat e shtrira në dy anët e lumit Devoll në zonën e Suloves (Darzeze, Shemrize, Kushove, Tunje) dhe të zonës Verces, kryesisht deri në lartësinë 60-70 m (Drize, Mashan, Kodovjat, Skenderbegas e Vidhan). Ndërsa në lartësi dominojnë tokat në Porocan, Kukur, Sojnik, Lenie dhe pjesa malore e Drizes, Kodovjatit, Vidhan dhe Skenderbegas), në zonën Sulove (Darzeze, Shenrize, Kushove, Tunje).

### ***Tokat bujqësore përfshijnë një larmi të tipeve e nëntipeve si:***

- Tokat MP, që zënë rreth 380 ha (3.8 % të sipërfaqes) shtrihen në lartësine mbi 1000 m mbi nivelin e detit , kryesisht në Lenie, Sojnik, Kukur, Porocan)

-***Tokat e Kafajta Malore (KM)***, që zënë 2350 ha ose 23.5 % të sipërfaqes, janë të shpërndara pothuajse në shumicën e territorit të NJA, shtrihen në lartësinë 600-1000 m lartësi mbi nivelin e detit në Drize, Kodovjat, Tunje, Prenjas, Kushove, Vidhan, Sojnik, Lenie, Kukur e Porocan. Në këto toka zhvillohen gruri, misri, perime, patate, dru frutoret. Tokat kanë përmbajtje të ulët dhe mesatare në humus.

-Tokat e ***Hinjta Kafe (HK)*** dominojnë në 4554 ha ose 45.5 % e sipërfaqes totale të tokave bujqësore. Me përjashtim të Linie dhe Porocan, tokat e këtij tipi shtrihen në territorin e gjithë NjA-ve të Bashkisë Gramshit. Shtrihen në lartësine 200-700 m mbi nivelin e detit, kryesisht në Skenderbegas, Prenjas, Kodovjat, Drize dhe Shemerize. Shtrihen në pjerrësi 25-50 %. Zhvillohen të gjitha bimët e arave dhe drufrutoret, sipërfaqe të kufizuara me ullishte.

-***Te Hinjta Kafe Livadhore*** zënë 14.5 % të tokave bujqësore (1440 ha) shtrihen më tepër në Kushove, Tunje, Vidhan, Darzeze, Drizë). Siperfaqe të konsiderueshme shtrihen në Kushove, Darzeze, Drize, Tunje, Shemerize

- ***Tokat e Livadhore të Hinjta Kafe*** zënë 8 % të tokës bujqësore dhe shtrihen kryesisht në toka me pjerrësi 0-5 %, në luginën e lumit Devoll dhe degëve ëe tij në Darzeze, Kodovjat, Shemerize, Skenderbegas. Realizohen rendimente të larta të bimëve të kultivuara.

Katër tipet kryesore të tokës (KM, HK, HKL, LHK) në shkallë Bashkie, zënë rreth 91.5 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore). Ndërsa tipet e tjera zënë vetëm 8,5 % të sipërfaqes së përgjithshme.

Tokat Livadhore Aluvionale, të cilat shtrihen në të dy anët e rrjedhjes së lumit Devoll, në (Darzeze, Kushove, Kodovjat, dhe kanë vlera të larta bujqësore zënë vetëm 1 % të sipërfaqes së tokave bujqësore.

Në zbatimin e teknologjive dhe praktikave bujqësore, përcaktimit të strukturës së prodhimit bujqësor në territorin rural të Bashkisë Gramsh, duhet të mbahet parasysh se 16 % e sipërfaqes së tokës bujqësore ( 1621 ha) është thellësi nën 20 cm të horizontit aktiv, 44 % (4390 ha )në thellësi 20-40 cm dhe 40 % (3995 ha ) me thellësi mbi 40 cm. Zgjedhja e bimëve, drurëve frutore, vreshtarisë në përputhje me thellësinë, tipin dhe trashësinë e tokës, ndikon direkt në nivelin e prodhimit dhe rendimentin për njësi toke si dhe në plotësimin e kërkesave të bimëve në faktorët e rritjes dhe zhvillimit. Në të gjitha NJA gjenden të shpërndara tokat e tre kategorive. Por sipërfaqja

më e madhe e tokave me thelesi mbi 40 cm, shtrihen në Porocan, Skenderbegas, Kushove, tokat përreth qytetit të Gramshit, Sojnik. Ndërsa tokat e cekta dominojnë, Lenie, Kodovjat. Karakteristikat kimike dhe fizike të tokave ndikojnë gjithashtu në zgjedhjen e bimëve dhe llojeve të pemtarisë. Kështu në tokat e Murme Pyjore, që janë me reaksion acid mund të kultivohet patatja dhe thekra.

Tabela 88 Prodhimet blegtorale 2015

<b>Klasa</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>8</b>	<b>9</b>	<b>10</b>
% sipërfaqes	0	2	5	14	22	17	16	16	7.8	0.1


Bazuar në klasifikimin e tokave bujqësore të Bashkisë Gramsh, tokat e klasave I-IV zënë rreth 21% të sipërfaqes së përgjithshme të tokave bujqësore dhe 79% në klasat V-X-te. Duke analizuar këtë përbërje, për të rritur eficientësinë e tokës dhe prodhimin bujqësor, (i) ka nevojë të rajonizohen kulturat bujqësore dhe pemtaria në përputhje me kërkesat e bimëve dhe karakteristikat e tokës, (ii) të aplikohen teknologji të diferencuara sipas tipeve e karakteristikave të tokës dhe rendimentit e prodhimit bujqësor të parashikuar.

Në bashkinë e Gramshit, të paktën 58 % e popullsisë të aftë për punë ka si aktivitet bazë bujqësinë. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në Bashkinë e Gramshit. Zonat që kanë me shumë përparësi në zhvillimin bujqësorë janë njësitë administrative përgjatë luginës së Lumit Devoll, si pasojë e terreni me fushorë dhe cilësisë të tokës, në raport me njësitë e tjera që kanë një potencial me të moderuar për zhvillim bujqësor (terren kodrinor-malor). Blegtoria zë peshën kryesore të të ardhurave, kultivimi i pemëve frutore dhe vreshtarisë është akoma larg mundësive reale të zhvillimit. Gjithashtu blegtoria dhe përpunimi i produkteve të mishit dhe qumshtit janë me një zhvillim mesatar në raport me kapacitetin mbajtës të terrenit të kërësorë për cdo 100 ha tokë bujqësore dhe pyje.

Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Gramsh është 10338 ha. Shtimi i sipërfaqes së ullirit është një ndër mundësitë e bashkisë së Gramshit dhe një nga produktet bujqësore të rëndësishëm për plotësimin e nevojave të popullsisë për vaj dhe konsum të freskët. Në vitin 1990, në të njëjtin territor, sipërfaqja e kultivuar me ullinj, ka qënë shumë e kufizuar vetëm 100 ha ose rreth 1% e sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore dhe prodhimi rreth 50 kv. Në të njëjtën periudhë sipërfaqja e vreshtave 320 ha dhe prodhimi 1300 Ton.

Territori i bashkisë së Gramshit ka sipërfaqe të konsiderueshme tokësore natyrore të cilat kanë potencial për mbjelljen e drufrutorëve, bimëve medicinal, vreshtarisë, duke rritur kështu prodhimin e këtyre kulturave bujqësore dhe të ardhurat financiare.

Figura 52 Ullishtet ekzistuese Qarku Elbasan



Ullishtja në Gramsh shtrihet në terrene kodrinore deri në ato malore në Kodovjat, Kushovë, Pishaj, Lenie, në toka të varfra dhe pa mundësi mekanizimi, kultivarët kryesorë janë Leccino dhe Bianchera, në një sipërfaqe prej 520 ha ku përfshihen ullinjtë tradicionalë dhe mbjelljet e reja pas vitit 1990.

Tabela 89 Struktura e kultivarëve të ullirit sipas NJA Gramsh

	Komuna	Ha	Mixan	Koker Madh Elbasani	Ulli Bardhe Tiranes	Frantoio	Bianchera	Leccino
<b>GRAMSH</b>	KODOVJAT	70					25	45
	KUSHOVE	100					50	50
	LENIE	150					50	100
	PISHAJ	200					100	100
		<b>520</b>					<b>225</b>	<b>295</b>
<b>QARKU ELBASAN</b>		<b>7600</b>	<b>4360</b>	<b>167</b>	<b>660</b>	<b>833</b>	<b>320</b>	<b>1160</b>

Figura 53 Territoret e ullishteve të reja qarku Elbasan




Tabela 90 Sipërfaqet e kultivuara dhe Produkte Bujqësore dhe Blegtorale 2015

Nr.	Emertimi	Sipërfaqe (Ha)	Rend. (Kv/Ha)	Prodhimi në Ton	
				Kulture e I	I+II
<b>A</b>	<b>Drithera buke gjith</b>	<b>2670</b>	<b>45.7</b>	<b>12200</b>	<b>12460</b>
1	Grure	1270	42.25	5240	5240
2	Miser	1270	54.5	6540	6800
3	Tagjira	200	21	420	420
<b>B</b>	<b>Perime gjithsej</b>	<b>190.4</b>	<b>240</b>	<b>4571</b>	<b>4571</b>
<b>I</b>	<b>Perime fushe</b>	<b>189</b>	<b>234.3</b>	<b>4429</b>	<b>4429</b>
1	Perime të njoma	110	305.9	3365	3365
2	Perime të thata	75	120.5	904	904
3	Bostane	4	400	160	160
<b>II</b>	<b>Serra</b>	<b>1.4</b>	<b>1014</b>	<b>142</b>	<b>142</b>
<b>C</b>	<b>Patate</b>	<b>180</b>	<b>200</b>	<b>3600</b>	<b>3600</b>
<b>D</b>	<b>Fasule direkte</b>	<b>190</b>	<b>24</b>	<b>456</b>	<b>456</b>
<b>E</b>	<b>Kultura industriale duhan</b>	<b>4</b>	<b>17</b>	<b>6.8</b>	<b>6.8</b>
<b>F</b>	<b>Bime medicinale</b>	<b>110.4</b>	<b>20</b>	<b>220.4</b>	<b>220.4</b>
1	Sherebele	46.9	20	93.8	93.8
2	Te tjera (livando)	63.5	20	127	127
<b>G</b>	<b>Faragjer të njoma</b>	<b>2200</b>	<b>309</b>	<b>68000</b>	<b>68000</b>

1	Jonxhe	1680	327.4	55000	55000
2	Hasell	520	250	13000	13000
	<b>Siperfaqe kultivuar</b>	<b>5544.8</b>	-	-	-

Prodhimet kryesore janë drithërat, prodhimi 12460 Ton, perime gjithsej 4700 ton, patate 3600 Ton, fasule 456 Ton, prodhimi foragje në 68000 Ton dhe zë 40 % të sipërfaqes së kultivuar, bimët medicinale në 110 ha dhe prodhimi 220 Ton, është një aktivitet drejt zgjerimit, kultivimi i duhanit në 4 ha dhe prodhimi 6.8 Ton, përbën një mundësi për tu zgjeruar në saj të kushteve të përshtatshme në një pjesë të territorit dhe për rritjen e të ardhurave financiare të larta nga kjo bimë.

Përdorimi i tokës përbën një problem, pasi nga 9800 ha tokë bujqësore arë, është kultivuar vetëm 5544 ha ose 56 %, ndërsa 44 % e lënë djerr. Kjo sipërfaqe krahas mungesës të prodhimit, është e predispozuar edhe ndaj erozionit dhe degradimit masiv edhe për shkak të terrenit.

## 12.6 Infrastruktura Bujqësore

Përsa i përket pikave të grumbullimit të produkteve bujqësore, në Bashkinë Gramsh nuk ka shpërndarje magazinash për produktet bujqësore dhe depozitim të prodhimit, pasi produktet bujqësore që sigurohen nga fermerët, një pjesë e konsiderueshme përdoret për konsum vetjak dhe pjesa tjetër shitet në tregun e produkteve bujqësore të qytetit. Por megjithatë, me zgjerimin e prodhimit bujqësor, nevojitet të përcaktohen vendgrumbullimet e produkteve, në varësi të parashikimit të prodhimit.

### 12.6.1 Ujitja dhe kullimi

Aftësia ujitëse është e ulët dhe një faktor kufizues i prodhimit bujqësor. Në Qarkun e Elbasanit aftësia ujitëse aktuale varion në 29-30 % të sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore. Ndërsa në Bashkinë e Gramshit më e ulët në masën 1100 ha ose 11-13 % e sipërfaqes, nga 5200 Ha, ose 51 % e sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore në vitin 1990. Disa nga objektet kryesore të infrastrukturës së ujitjes janë:

**-Liçeni i Dushkut, sistemi ujitës** në Njësine Administrative Kukur me gjatesi të kanaleve 4.7 km i gjate dhe ujit rreth 200 Ha tokë në fshatrat Snosem dhe Lilaj është bërë rehabilitimi nga projekti i Bankes Boterore në vitin 2006, **Rezervuari Postnovisht 1 dhe 2**, Njësia Administrative Kodovjat me gjatesi të kanaleve gjithsej 24.7 km dhe ujit rreth 300 Ha tokë bujqësore kryesisht në fshatrat Bersnik, Kodovjat dhe Mashan. Rehabilitimi i sistemit është bërë në 2011, 2012 dhe 2016. Megjithatë, në këtë rrjet problem është degëzimi Posnovisht-Mashan pasi është totalisht i amortizuar. **Rezervuari Galigat**, Njësia Administrative Pishaj që siguronte ujitjen në rreth 80 Ha tokë bujqësore, por aktualisht nuk funksionojnë veprat vaditese, si dhe ka nevojë për meremetimin e të gjithë kanalit ujites.

**-Rezervuari Dardhe 1 dhe 2**, Njësia Administrative Kushove, vaditeshin 350 Ha tokë bujqësore. Ky rezervuar ekziston, por nuk funksionojnë veprat vaditëse dhe ka nevojë për meremetimin e të gjithë kanalit ujitës. **Veprat ujore Valamare**, Njësia Administrative Lenie. Aftësia e kësaj vepre është 470 Ha dhe sot vaditen rreth 180 Ha, ndërsa pjesa tjetër e sistemit të kanalizimeve është jashtë funksionit në rreth 40 km. Në përgjithësi mbetet problematikë kryesore mirëmbajtja e rrjetit të kanaleve vaditës.

## 12.7 Inovacionet në Bujqësi

Bashkia e Gramshit (aktualisht) nuk është e përfshirë në objektiva specifike në PPK. Niveli i investimeve në infrastrukturën mbështetëse të bujqësisë, qendrat e grumbullimit, shtimin e aftësisë ujitëse dhe në sektorin agro-ushqimor janë ende të ulët. Skemat mbështetëse në sektorin bujqësor mbeten në nivele të ulëta.

Të rendësishme mund të konsiderohen edhe mbështetje për aktivitete të reja të aktiviteteve të diversifikimit të ekonomisë rurale me aktivitete jashtë bujqësisë si prodhimi i bimëve mjekësore, erëzave, bimëve dekorative, kërpudhave, punimeve artistike, zhvillimit të turizmit malor, përpunimi i produkteve bujqësore e blegtorale, zhvillimi i agroturizmit dhe aktivitete shoqëruese.

## 12.8 Sfidat dhe Konkluzionet

Një nga vecoritë e Bashkisë së Gramshit për zhvillimin rural dhe bujqësor lidhet me terrenin e thyer kodrinoro-malor dhe me numrin e popullsisë, që sa vjen e po ulët në zonat rurale. Momentalisht, rreth 55-56 % e popullsisë totale është përqendruar në zonën rurale, me karakter të theksuar bujqësor. Të punësuarit në sektorin e bujqësisë përfshijnë më shumë se 55 % të numrit total të forcave të afta të punës në Bashki, duke e bërë kështu bujqësinë për zonat rurale sektorin primar të ekonomisë. Megjithatë sipas skenarëve vlerësues të projeksionit të popullsisë (2015-2031), mendohet se numri i banorëve në zonat rurale do të pësojë rënie të vazhdueshme. Shkaku kryesor i kësaj zhvendosje mendohet të vijë si pasojë e migrimit të brëndshëm dhe ndër të tjera, nga largimi i vazhdueshëm i të rinjve nga sektori bujqësor. Kjo prirje demografike ndikon negativisht në përballimin e proceseve të punimeve në bujqësi në zonat rurale dhe mbrojtjen e burimeve përbën një sfidë të rëndësishme për të ardhmen e zhvillimit bujqësor dhe rural si dhe nevojës të intensifikimit të procesit të mekanizimit. Ruajtja e tokës, kultivimi i tokës bujqësore, që aktualisht është jo më shumë se 50-55 % do të fuqizonte aktivitetin bujqësor përmes rritjes së rendimentit, për njësi të sipërfaqes, rajonizimit të kulturave sipas territorit, ndërtimit të tregjeve. Në kushtet e terrenit kodrinor malor dhe pjerrësisë të lartë, nevojitet të përmirësohen praktikat e përdorimit të tokës, me qëllim të mbrojtjes nga erozioni, që në zonën malore e kodrinore të Gramshit në tokat bujqësore, nga praktikat jo të mira të punimeve përpandikular me pjerrësinë, humbja e tokës nga erozioni rezulton jo më pak nga 30 Ton/ha/vit (kovaci V, Lushaj Sh, Laze P, 2005).

Prioritizimi i aktiviteteve bujqësore në Bashkinë e Gramshit është një rrugë kryesore për qëndrueshmërisë rurale, efikasitetin e kapacitetit prodhues të tokës, rentabilitetit të prodhimit dhe nivelit të prodhimit bujqësor. Në këtë kontekst, bazuar në karakteristikat e tokës, klimës, vecoritë e terrenit, pemëtaria e vreshtaria, janë drejtime të rëndësishme, duke pasur si bazë prodhimin tradicional të pemëve frutore, rrushit dhe pjergullave. Në lidhje me pemëtarinë, në shumë zona të Bashkisë mbizotërojnë qershia, kumbulla dhe lloje të tjera dhe sipërfaqja duhet rritur, por duke rritur edhe kapacitetet përpunuese për këto prodhime, pasi mungojnë. Kushtet janë të përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë, vecanërisht blegtorisë së imtë (dele dhe dhi), pasi ka kapacitete natyrale tokësore për shtimin e numrit të krerve për cdo 100 ha, numri i krerve të të dhirtave është nën atë të vitit 1990, po ashtu edhe numri i krerve të gjedhit. Gjithashtu në shumicën e NJA, të nxitet rritja e numrit të krerëve të bagëtive të imëta, kryesisht dheneve, dhe synimi për të krijuar tufa të mëdha me raca të përmirësuara, me prodhimtari të lartë qumështi.

Një sfidë e zhvillimit të bujqësisë mbetet zmadhimi dhe intensifikimi i fermave bujqësore shndërrimi nga familjare në intensive, futjen e teknologjive të reja, përdorimin efiçent të inputeve bujqësore, përmirësimin e pjellorisë tokës, bashkimin e pronës dhe rritja e aftësisë ujitëse, ngritja e njohurive për tipet e tokës, vecoritë dhe mbrojtja nga erozioni.

Mbrojtja e tokës nga erozioni, është një domosdoshmëri, pasi niveli i gërryerjes në zonën kodrinore dhe malore është e lartë i nxitur nga pjerrësia dhe praktikave të kultivimit. Shkaqet e erozionit lidhen me: (i) praktikave jo të mira të kultivimit të tokave me pjerrësi të lartë e të mesme (ii) mënyra e kultivimit të tokës, nëpërmjet punimeve në të njëjtin drejtim me pjerrësinë (iii) prerje të pyjeve përreth tokave bujqësore. Në nivel kombëtar, vetëm erozioni dhe degradimi i tokave kanë çuar në humbjen e 5% të prodhimit të bredshëm bruto në vitin 2014<sup>246</sup>. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të zbatojë masat e mbrojtjes së tokës si garanci për rritjen e prodhimit dhe zhvillimin e një bujqësie të qëndrueshme, nëpërmjet zbatimit të praktikave të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së<sup>247</sup>, kultivimin e tokës dhe zbatimin e praktikave të përshtatshme.

Problemet kryesore të cilat pengojnë zhvillimin e bujqësisë në Bashkinë e Gramshit janë:

- 1- Aftësia ujitëse e ulët 10-13 %
- 2- Konfliktet me titujt e pronësisë së tokë
- 3- Coptimi i tokës në shumë parcela
- 4- Fermat e vogla për vetëfurnizimin familjar
- 5- Parcelat e vogla dhe të shpërndara
- 6- Teknologjitë e prapambetura dhe shkalla e ulët e mekanizimit.
- 7- Mungesa e infrastrukturës mbështetëse ( qendrat e grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale, rrugët e brendëshme)
- 8- Cilësia e tokës (dominojnë toka të klasës 5-9)
- 9- Struktura e prodhimit bujqësor ka nevojë të përmirësohet në përputhje me vecoritë e tokës dhe klimës dhe efiçencën e kulturave .

## 12.8 Rekomandime

Territori i Bashkisë Gramsh është një territor kodrinor dhe malor. **Bujqësia zhvillohet në ferma të vogla familjare, si një bujqësi tradicionale** në zonat malore-kodrinore, për vetëushqyerjen e popullsisë. Për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë, në nivelin më të lartë që lejon kushtet klimatike, tokësore dhe territorit të zonës, nevojitet zmadhimi i fermave së paku deri në 1,5- 2 herë të madhësisë ekzistuese me zbatimin e tregut të tokës dhe bashkimi i pronës, kooperimi i fermerëve, rritja e aftësisë ujitëse, së paku në nivelin e aftësisë ujitëse dhe skemave ekzistuese të vitit 1990.

-Në bazë të kushteve konkrete në territorin e bashkisë duhet të zgjerohen sistemet bujqësore të diferencuara (i) për zonën kodrinore dhe (ii) sistemet malore për tokat me pjerrësi të lartë. Në zonën kodrinore prioritet duhet të mbetet zhvillimi i pemtarisë, vreshtarisë dhe në zona më të kufizuara ulliri, zgjerimi i mbarshimit të blegtorisë së imët, kurse në zonën e ulët, kultivimi i bimëve të arave, shtimi i gjedhit dhe deleve, serave të perimeve, etj. Në zonat kodrinore është e

leverdisshme të ngrihen dhe fermat e vogla të specializuara me pemëtore dhe vreshta edhe pse nuk i kalojnë madhësinë më shumë se 4 -8 dynym.

Në zonën kodrinore dhe malore, të zbatohet rotacioni i bimëve, me qëllim që të ruhet pjelloria e tokës.

- Të ndërtohet një qendër e grumbullimit të prodhimit, bazuar në kapacitetin prodhues të zonës dhe krijimin e zinxhirit; prodhim/grumbullim /përpunim/ tregëtim.
- Aktualisht përpunimi i prodhimeve blegtorale bazohet në disa baxho lokale të përpunimit të qumështit, por mungojnë linjat e përpunimit të produkteve, prandaj agropërpunimi duhet të zgjerohet edhe në funksion të agroturizmit, që përbën një mundësi në këtë bashki.
- Të rritet numri i blegtorisë së imtë për cdo 100 ha tokë, pasi mundësitë janë më të larta, veçanërisht të dhirtat, numri i të cilave ka renë.
- Shtimi i pularisë, pasi ekziston vetëm një e tillë
- Shtimi i bletarisë, sepse ka kushte të përshtatshme
- Duhet të nxitet krijimi i shoqatave të prodhimit dhe shërbimit në zonën rurale, për të forcuar bashkëpunimin e prodhuesve dhe rritur interesin e fermerëve nëpërmjet përmirësimeve të teknologjisë së prodhimit dhe rritjes së shkallës së mekanizmit bujqësor, të përshtatur me terrenin dhe madhësinë e fermës, të përmirësohet infrastruktura bujqësore, si konsolidimi i tregjeve të shumicës në afërsi të njësive administrative apo qytetit, për grumbullimin e prodhimeve të fermerëve privatë.
- Për ngritjen e punishteve të agropërpunimit të prodhimeve bujqësore e blegtorale mundësitë financiare për ngritjen e linjave të përpunimit, të cilat mungojnë si një pengesë në rritjen e të ardhurave, apo mundësive për eksport, por edhe si një frenim për rritjen e mëtejshme të prodhimit bujqësor e blegtoral, veçanërisht në zonat kodrinore-malore me dalje të kufizuar në treg.
- Për shtimin e kapaciteteve përpunuese partneriteti publik-privat do të ndihmonte në shtimin e kapaciteteve përpunuese të produkteve.
- Diversifikimi i ekonomisë rurale
- Ndërtimi i një qendre grumbullimi të produkteve dhe tregëtimit
- Ndërtimi i një thertore me standarte dhe zgjerimi edhe në zona të tjera
- Planifikimi dhe zbatimi i masave për mbrojtjen e tokës nga erozioni, nëpërmjet praktikave bujqësore.

### **13 Sistemi i kullimit dhe vaditjes**

Ky seksion analizon vlerësimin e gjëndjes ekzistuese të infrastrukturave të bujqësisë në Bashkinë Gramsh. Me infrastrukturë bujqësore kuptojmë tërësinë e rrjetit të kanaleve vaditëse dhe kulluese sipas kategorisë, si dhe të gjitha veprat inxhinierike në funksion të bujqësisë, dhe këtu mund të përmendim argjinaturat, rezervuaret ujitëse, digat, stacionet e pompimit dhe hidrovoret.

**Mënyra e funksionimit të infrastrukturave bujqësore:** Infrastruktura bujqësore kryesisht përbëhet nga rrjeti i kanaleve që ndahen në kanale vaditëse dhe kulluese. Kanalet vaditëse shërbejnë për të bërë shpërndarjen e ujit të domosdoshëm në parcelat bujqësore. Kanalet vaditëse i kemi të tri kategorive: kanale të para, të dyta dhe të treta me specifikat si më poshtë:



**Kanalet e para** janë kanalet kryesore të cilat çojnë ujin nga rezervuarët drejt tokave të cilat do të vaditen më pas. Shpërndarja e ujit kalon nga kanalet e para në të dyta dhe, në fund, në kanalet e treta.

**Kanalet kulluese** janë kanalet që bëjnë mbledhjen e ujit të tepërt të parcelave bujqësore dhe e çojnë atë drejt lumenjve, liqeneve ose detit. Këto kanale janë po aq të rëndësishme, sepse mbrojnë tokën bujqësore nga përmbytjet.

**Kanalet e treta kulluese** mbledhin ujin nga parcelat e vogla dhe e çojnë në kanalet sekondare ose të dyta e më pas në kanalet kryesore që e çojnë ujin në lumenj ose në dete.

**Argjinaturat** janë një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës bujqësore, sepse bëjnë mbrojtjen e tokave bujqësore nga vërshimet e lumenjve. Gjithashtu, rezervuarët janë venddepozitime të ujit të cilat janë të lidhura kryesisht me kanalet kryesore vaditëse dhe shërbejnë si ushqyes kryesorë të ujit me të cilin vaditen tokat bujqësore.

**Korniza ligjore mbi kullimin dhe vaditjen:** Korniza ligjore mbi administrimin dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore na ndihmon të kuptojmë kompetencat e institucioneve të ndryshme mbi administrimin e kësaj infrastrukture. Ligji kryesor mbi administrimin dhe menaxhimin institucional dhe përcakton të gjitha direktivat ligjore mbi infrastrukturën bujqësore është ligji nr. 8518, datë 30.7.1999, “Për kullimin dhe vaditjen”.

Më zhvillimin e reformës territoriale-administrative edhe menaxhimi institucional i një pjesë të infrastrukturës bujqësore ka ndryshuar. Këto ndryshime ligjore mbi kompetencat institucionale i paraqesin dy Vendimet të Këshillit të Ministrave: VKM-ja nr. 691, datë 29.07.2015, “Për miratimin e strategjisë për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020” dhe VKM-ja nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek Bashkitë e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”. Ligjet që sapo përmendëm tregojnë administrimin institucional dhe menaxhimin e infrastrukturës bujqësore si më poshtë:

- **Ligji Nr. 24/2017 Për administrimin e Ujitjes dhe të Kullimit**

Ky ligj përcakton Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave si organin kryesor përgjegjës për administrimin e ujitjes dhe kullimit. Menaxhimi i skemave të kullimit dhe të vaditjes bëhet nga njësi më të vogla që janë Bordet e Kullimit, të cilat ndodhen në çdo qark me përjashtim të Lushnjës, që ka bord kullimi të veçuar. Bordet e kullimit janë struktura teknike të specializuara në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Neni 46, pika 1. shkronja ç e ligjit nr. 24/2017: 1. Kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen si të tilla:ç) ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve më afër se 8 metra nga bordura e kanalit kryesor (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues ose vija e takimit të skarpatës së jashtme të bankinës së kanalit ujitës me sipërfaqen e tokës), ose e një sistemi kryesor kullimi, apo më afër se 4 metra nga bordura e çfarëdo kanali ujitjeje ose kullimi;

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 29.07. 2015, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020”.**

Për zbatimin e këtij vendimi legjislativ ngarkohen ministri i Çështjeve Vendore, ministritë, institucionet qëndrore dhe njësitë e pushtetit vendor të përmendura në tekstin e kësaj strategjie.

Në këtë strategji thuhet se në fushën e infrastrukturës së bujqësisë, Bashkive do t'u shtohet si **funksion i ri** administrimi dhe menaxhimi i rrjetit dytësor dhe tretësor.

- **Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 30.12.2015, “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave tek bashkitë të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit i ndryshuar”.**

Sipas këtij vendimi bashkive u transferohet e drejta e menaxhimit dhe e administrimit të infrastrukturës bujqësore dytësore dhe tretësore, aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe makinerive të rënda nga Bordet e Kullimit tek bashkitë në territorin e të cilave ndodhen këto infrastruktura.

## **14 Pronësia mbi tokën dhe pronat publike**

Në përcaktimin e qeverisë, zonë informale do të konsiderohet territori me sipërfaqe mbi 2 hektarë, i zënë nga ndërtime informale, procesi i legalizimit të të cilave nuk u nënshtrohet kushteve të instrumenteve të planifikimit të territorit. Sipas ALUIZNI-t, kriteret që merren parasysh për propozimin e këtyre zonave janë:

- Evidentimi i ndërtimeve informale në territorin përkatës,
- Vija kufizuese administrative e njësive administrative,
- Morfologjia dhe kushtet e terrenit,
- Gjëndja e pronësisë,
- Cilësitë juridike të territorit.

Sipas ligjit nr.9482, dat 3.4.2006 “Për urbanizimin, legalizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, për ndërtimet që gjenden brenda zonave informale aplikohen procedura më të lehta<sup>248</sup>.

Sipas të dhënave zyrtare të ALUIZNI-t, 29.5% e ndërtimeve në territorin shqiptar janë pa leje. Numri total i ndërtimeve në Shqipëri është 1,008,243 dhe 297,440 prej tyre rezultojnë objekte informale<sup>249</sup> në bazën e të dhënave të Agjencisë së Legalizimeve.

Referuar “Raportit përmbledhës të ecurisë së legalizimit të ndërtimeve pa leje 2013 – 2014” të ALUIZNI-t Drejtoria Rajonale Elbasan regjistron 3,316.8 km<sup>2</sup> sipërfaqe informale. Për 26084 numër aplikimesh. Gjatë periudhës 2005 – 2013 trendi i vetëdeklarimeve në Qarkun e Elbasanit ka ardhur duke u rritur (nga 6808 në 2005, 11920 në 2006 dhe 3756 në vitin 2013) duke rezultuar kështu me një numër total prej 22484 vetëdeklarimesh nga qytetarët për zonat informale. Qarku i Elbasanit, radhitet tek lista e zonave me një nivel mesatar të ndërtesave informale në nivel qarku (ndërtesa informale/ndërtesa totale për qark) me vetëm 8%. Ndërkohë që procesi i dhënave të lejeve për Qarkun e Elbasanit ka qënë në rritje. Referuar të njëjtit raport, për periudhën e 2006-2014 numri I lejeve ka ardhur në rritje (289 në periudhën 2006-2009, 253 në 2010, 361 në 2011, 548 në 2012, 620 në 2013 dhe deri në fund të nëntorit 2014 gjithsej 726) kështu numri total I lejeve rezulton 2797. Qarku I Elbasanit, shënon 28.48% të ndërtesave informale në nivel qarku (ndërtesa informale/ndërtesa totale për qark). Sipas raportit të ALUIZNI-t “Përmbledhje e zonave Informale të miratuara për Qarkun Elbasan” **nuk kemi zona informale** në Bashkinë e Gramshit, por vetëm ndërtesa informale. Nga viti 2016 e më tej kemi një rritje me 4.671% të numrit të lejeve.

Në këtë kuadër, Gramshi duket se bën pjesë në një nga zonat e cila ka patur aktivitet ndërtimor jo të kufizuar. Megjithatë vitet e fundit vihet re një lloj shpërhapje urbane drejt zonave periferike të qytetit, e karakterizuar nga zona me dëndësi të ulët, dhe banesa të tipit vila. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksojmë se më miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit, zhvillimi i ardhshëm të mos i lihet rastësisë, por të kontrollohet dhe orientohet saktë nga instrumentet e planifikimit dhe arkitektonikë të qartë.

#### 14.1 Pronat Publike<sup>250</sup>

Bashkia Gramsh është angazhuar në përmbledhjen dhe regjistrimin e të gjitha pronave publike në pronësi të kësaj njësie qeverisje vendore, me qëllim ripërdorimin e këtyre pronave si asete të rëndësishme për pasurimin e shërbimeve publike ndaj qytetarëve të Gramshit.

“E mirë publike” është pronë e paluajtshme publike e shtetit, sipas legjislacionit përkatës, si dhe të mira të tjera të natyrës publike, si: ajri, ujërat, burimet natyrore, mjedisi, në përgjithësi, trashëgimia kulturore, frekuenca, si dhe të tjera të kësaj natyre, sipas legjislacionit në fuqi.<sup>251</sup>

Bashkia e Gramshit ka raporte të mira për inventarizimin e pronave publike. Për këtë analizë ka ardhur në ndihmë “Plani I Menaxhimit të Pronave Vendore”. Sipas këtij procesi të regjistrimit nga Bashkia Gramsh në fund të vitit 2010 disponohet një numër prej 375 pronash vendore të ndara sipas kategorive më poshtë:

Tabela 91 Lista e provane publike për Njësinë Administrative Gramsh

Emërtimi	Sipërfaqe në m <sup>2</sup> /Gjatësia në ml
Objekte	86719.76
Vendstrehimet	800.2
Shërbime publike dhe ndriçimi (në ml)	992420
Infrastrukturë (në lagje)	37525.1
Infrastrukturë (në gjithë qytetin për ml)	47030
Troje dhe hapësira publike	36328.9
Troje që mund të përdoren për projekte partneriteti publiko-private	154369.4
Prona të dhëna me qera	5945.45

Sipas kësaj table sipërfaqja totale e pasurive vendore është 161374 m<sup>2</sup> të tipit objekte vendstrehim hapësira publike dhe 1039450 ml kryesisht të tipit infrastrukturë. Sipërfaqja totale e hapësirave që mund të përdoren për projekte të ndryshme është 154369.4 m<sup>2</sup>. Nga sipërfaqja totale vetëm 5945.45 m<sup>2</sup> janë të dhëna me qera.

Qyteti I Gramshit dhe qendra e Bashkisë Gramsh, mbart numrin më të madh të pronave publike me karakter ndërtimor, si ndërtesa të institucioneve dhe administrative, ish ndërtesa industrial, numrin më të madh të objekteve arsimore dhe shëndetësore dhe gjithashtu Pallatin e Kultures, Pallatin I Sportit, Muzeu I Gramshit, Stadiumi i qytetit. Megjithatë, kryesisht në vitet 2007-2011, një pjesë e ndërtesave me pronësi publike janë privatizuar duke u kthyer kështu në pika të rëndësishme ekonomike për qytetin si rasti Ish fabrikës së Qumështit në lagjen “Sporti” apo Ish Shtëpia e Ushtarakëve në lagjen “18 Gushti”.

Për njësitë e tjera administrative, informacioni i gjetur është vetëm për objektet publike.

Më poshtë është hartuar lista me sipërfaqet e objekteve publike sipas njësive administrative përkatëse të Bashkisë Gramsh.

Tabela 92 Lista e objekteve sipas njësive administrative

<b>Njësia Administrative</b>	<b>Sip.m<sup>2</sup></b>
Kodovjat	10149
Kukur	4362
Kushove	19514.1
Lenie	5168
Pishaj	7180
Poroçan	10601
Skënderbegas	5726
Sultë	5563
Tunjë	6488
<b>Totali</b>	<b>74751.1</b>


Tabela 93 Lista totale e objekteve për Bashkinë Gramsh

<b>Njësia Administrative</b>	<b>Sip.m<sup>2</sup></b>
Gramsh	10149
Njësitë e tjera	74751.1
<b>Totali</b>	<b>161470.76</b>

Objektet publike zënë 0.022% të territorit të Bashkisë Gramsh.


Bashkia Gramsh është ndër të paktat bashki në Shqipëri (ndoshta e vetmja) që ka përfunduar procesin e transferimit dhe është aktualisht duke përfunduar procesin e regjistrimit të pronave vendore të transferuara. Kjo gjë krijon mundësinë e realizimit me lehtësi të proceseve të shitjes, dhënies me qera apo vënien në përdorim të këtyre aseteve.

Figura 54 Harta e pronave të NjA Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Figura 55 Harta e pronave të NjA Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 15. Cilësia e hapësirave publike, strukturave dhe territoreve

Kjo analizë ka si qëllim vlerësimin e hapësirave publike, strukturave dhe territoreve. Nga e cila identifikohen pikat më problematike dhe për to me pas hartohen masa për rehabilitimin, rigjenerimin, rizhvillimin dhe mënyra të tjera të cilat do të propozohen në kapitullin e propozimeve të planit.

Burimet që janë përdorur për analizimin e gjëndjes fizike të këtyre objekteve janë harta të vjetra të Bashkisë Gramsh, hartat e zhvillimit ndër vite të bashkisë (google imagery), inventarizimi i cilësisë së strukturave nga vizitat në terren.

Baza ligjore të cilës i rreferohemi për hapsirat publike është **VKM nr. 1096 datë 28.12.2015 për miratimin e rregullave, kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike.**

**Hapësirat publike:** Për sa përket hapësirave publike në Bashkinë Gramsh janë një në numër të vogël krahasuar më sipërfaqen totale të territorit dhe numrin e banorëve që i përgjigjet. Këto hapësira janë të përqëndruara në qendrën e qytetit të Gramshit të cilat kanë formën e shesheve urbane, parqeve, lulishteve dhe këndeve sportive.

Qyteti I Gramshit ka tre hapësira të kategorizuara si sheshe publike më një sipërfaqe të përgjithshme 4270m<sup>2</sup>, dy prej të cilave janë të vendosura në pjesën jugore të qytetit me sipërfaqe njëra 1380m<sup>2</sup> dhe tjetra 1190m<sup>2</sup>, të tilla janë në inventarin e bashkisë, ndërsa e treta ndodhet përballë komisarariatit të policisë (ish këndi I lojrave për fëmijë) me sipërfaqe 1700m<sup>2</sup>.

Përveç këtyre ka edhe hapësira të tjera të gjelbërta të cilat nuk janë të klasifikuara si lulishte, por që përdoren si elemente gjelbërimi ose sheshe publike: rreth 1900m<sup>2</sup> në jug të spitalit civil, hapësira në grupin e banimit, hapësira e gjelbër përballë shkollës 9 vjeçare “Rilindja” në total 1490m<sup>2</sup> dhe sheshi I “Tribunës” në qendër 860m<sup>2</sup>.

Për sa i përket hapësirave të gjelbërta në zonat e banimit mund të klasifikohen në dy kategori të ndryshme:

- a) Zona veriore karakterizohet nga breza të gjelbër me gjërësi 7-10m të vendosura midis rrugës kryesore (unazës) dhe ndërtesave të banimit.
- b) Zona jugore e cila pothuajse të gjitha hapësirat e lira midis pallateve I ka tërësisht të pasistemuara më përjashtim të dy lulishteve të qytetit.

Sheshi kryesor I qytetit momentalisht është rikonstruktuar gjë që ka sjellë shndërrimin e saj në një hapësirë cilësore, e cila mirëpret aktivitete të ndryshme për të gjithë qytetarët.

Në zonat e banuara ruralë prezenca e hapësirave publike është më e vogël dhe gati fare inekzistente. Përsa i përket hapësirave dhe zonave sportive, sërish është qyteti i Gramshit ai që ka numrin më të madh të këtyre hapësirave. Mund të përmendim stadiumin e qytetit, pallatin e sportit, dhe disa hapësira më të vogla sportive të shpërndara në qytet dhe pranë institucioneve të ndryshme arsimore. Gjithsesi cilësia dhe kushtet e këtyre infrastrukturave janë jo të mira dhe kanë nevojë urgjente për ndërhyrje. Pallati i Sportit gjithashtu ka një programacion shumë të varfër aktivitetesh, duke mos i dhënë kuptim rolit që ai ka, dhe duke mos vënë në përdorim hapësirat e bollshme që ai ofron.

Në zonat rurale hapësirat sportive janë të përqëndruara pranë institucioneve arsimore, si shkollat 9-vjeçare, ose ato të mesme, duke u vënë në përdorim nga nxënësit në kuadër të orëve mësimore, ose në raste aktiviteteve të ndryshme.

Qyteti aktualisht nuk ka një zonë parku ose parku periferik.

Figura 56 Foto nga hapësirat publike në Gramsh



Burimi : MetroPOLIS 2017

*Sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit” në të nenit 84 normativave urbanistike sipërfaqja e gjelbëruar në qytet duhet të zërë një sipërfaqe prej 8 ha ndërkohë që aktualisht ajo zë një sipërfaqe prej 5 ha. Dukë pasur parasysh karakterin e qytetit dhe strukturën ndërtimore më ndërtime individuale e me oborre të gjelbëruara, normat e gjelbërimit mund të jenë më të vogla. Krijimi i sipërfaqeve të reja duhet të shikohet me prioritet duke menduar një sipërfaqe uniforme në të gjithë territorin e bashkisë.*

**Strukturat:** Zhvillimi në Bashkinë Gramsh, pati një *boom* të ndërtimeve të pas 90’ës dhe veçanërisht në periudhën 2000 – 2013 ky zhvillim është rritur më shumë. Zhvillimi i ndërtimeve kryesisht në qytetin e Gramshit karakterizohet sipas tre drejtimeve kryesore: përshtatjes me morfologjinë e terrenit, përshtatjen me asket e lëvizjes dhe respektimin e peshave gravitacionale të zonimit funksional.

Në këtë aspekt qyteti organizohet në katër zona që shtrihen në drejtimin lindje perëndim dhe ndahen nga njëra tjetra nga përrenjtë e qytetit. Të katër këto zona kanë ngjashmëri të terrenit dhe formohen nga pjesa kodrinore në lindje të Bulevardit “10 Korriku” dhe rrugës “Ali Koci” dhe nga terrenet e sheshta në perëndim të këtyre rrugëve.

Zona e parë në veri të qytetit e cila përbëhet nga një strukturë kompakte me banesa individuale në pjesën lindore dhe nga zona ekonomike dhe industriale në hyrje të qytetit në pjesën lindore.

Zona e dytë është bërthama e qytetit dhe përbëhet nga një strukturë e shtresëzuar e cila diktohet nga terreni. Në pjesën lindore ku terreni është relativisht i pjerrët (kodra e Llapushajve) janë pozicionuar banesat individuale. Në pjesën e poshtme të kodrës ndodhet qyteti i “vjetër” me banesa kolektive 2-4 kate. Në pjesën në lindje të Bulevardit “10 Korriku” ndodhet zona e qendrës me sheshin kryesor, godinat administrative, hotelin dhe muzeun.

Zona e tretë është zona në jug të qytetit ose “zona e re” e cila ka një strukturë mikse funksionesh. Kjo zonë në përdim përbëhet nga zona e banimit e cila përbëhet nga zona me banesa individuale në pjesën kodrinore dhe me banesa kolektive 5-6 kate në pjesën deri tek rruga “Ali Koci” dhe nga zona industrial (Ish SMT dhe Uzina 85). Në pjesën perëndimore të rrugës “Ali Koci” ku terreni është i sheshtë janë pozicionuar zona e banimit me banesa kolektive 4-6 kate, zona sportive, shkolla e mesme dhe tregu agro-ushqimor. Duke qenë se më parë kjo zonë ka qenë zonë periferike e qytetit këtu ndodhet edhe ish reparti ushtarak.

Zona e katërt është zona në jug të përroit të Kocajve dhe karakterizohet nga një terren relativisht i sheshtë. Kjo zonë është parashikuar si zona e re industriale në perspektiven e qytetit ku do të zhvendoseshin industritë e qytetit pas ndërtimit të hidrocentralit të Banjës. Aktualisht këtu sot ndodhen disa ambjente industrial ish frigoriferike, ish fabrika e qumshtit etj.

Si rezultat i kostove të larta të ndërtimit dhe individualizmit që karakterizon përgjithësisht ndërtimet në zonat informale, shpesh janë neglizhuar përmbushja e disa standardeve në ndërtimin e tyre. Mos respektimi i rregullave të planifikimit, kriterëve të diellëzimit, ajrosjes dhe respektimi i distancave së ndërtesave, ul jo vetëm cilësinë e strukturës së tyre, por edhe vlerës e pronës. Fasadat janë të rikonstruara (pjesërisht) vetëm në qendrën e qytetit të Gramshit ndërsa në vendbanimet e tjera dhe qendrat njëjive të tjera administrative ato mbeten të pa kuruara fizikisht dhe estikisht.

Sa i përket cilësisë fizike të tyre, dy faktorët që ndikojnë më së shumti në rënien e cilësisë së strukturave në përgjithësi në bashkinë e Gramshit janë: amortizimi për shkak të kohës, dhe mungesa e jetueshmërisë në këto banesa. Në pjesën më të madhe të tyre, banesat janë të braktisura nga pronarët e tyre, për arsye emigrimi, ose të banuara vetëm nga të moshuar të cilët nuk kanë mundësitë financiare të kryejnë përmirësime fizike në banesat e tyre.

**Territoret:** Bashkia e Gramshit karakterizohet nga një natyrë marramendëse, fond të konsiderueshëm pyjor dhe kullësor, dhe rrjet të pasur hidrik. Megjithatë, sic shpjegohet edhe në seksionin e Analizës së Mjedisit, për shkak të aktivitetëve industriale, keqmenaxhimit të mbetjeve, shfrytëzimit të inerteve, prerjes pa kriter të pyjeve etj. territoret në bashkinë e Gramshit kanë nevojë të menjëhershme për rehabilitim mjedisor. Nga kjo pikëpamje, cilësia e pyjeve është drejt degradimit për shkak të prerjes pa kriter të tyre. Evidentohen dy vatra të nxehta mjedisore, të cilat përkeqësojnë dhe mjedisin rrotull (Rasti i Venddepozitimi të mbetjeve në Gramsh I cili ndodhet rreth 3 km larg qendrës së qytetit pranë brigjeve të Lumit Devoll në pjesën lindore të territorit).



## 16. Sistemi rrugor dhe transporti publik


### 16.1 Sistemi rrugor dhe transporti publik

Bashkia e Gramshit bën pjesë në qarkun e Elbasanit, në të cilin kalojnë infrastrukturat e rëndësishme të vendit ku mund të përmendim korridorin VIII i cili është korridori i vetëm PAN-European që kalon në Shqipëri. Një nga nyjet kryesore të këtij korridori është në Papër, ku itinerari drejt jugut të con në Cërrik dhe me pas drejt Gramshit. Largësia nga Papëri drejt Gramshit është 35 km<sup>252</sup> ( afërsisht 40 minuta). Qyteti i Gramshit është i pozicionuar 90 min larg Tiranës infrastrukturën e re është ndërtuar ka bërë që aksesit drejt kësaj bashkie të jetë më i mirë dhe që kjo bashki të aksesohet më mirë duke parë që Gramshi është ure lidhese ndërmjet Elbasanit dhe Korcës, por që nuk ka frekuentshmëri për shkak të infrastrukturës së dobët nga Moglica deri në Maliq. Me ndërtimin e kësaj infrastrukture bashkia e Gramshit do të ketë akses më të madh.

Në bashkinë e Gramshit kalojnë rrugët shtetërore:

- **Rruga Shtetërore 59 (SH59)**<sup>253</sup>- fillon nga korridori VIII (*Route E852*), e cila është rruga shtetërore 7 dhe në kryqëzimin në Papër merr drejtimin e jugut ku fillon rruga shtetërore (**SH 59**), vazhdon drejt qytetit të Cërrikut ku degëzohet me rrugën shtetërore (**SH 70**) që vjen nga Elbasani.
- **Rruga Shtetërore 71 (SH71)**- nis në kryqëzimin e Shirgjanit ku në njërin degëzim shkohet në Cërrik, rruga shtetërore (**SH 70**) dhe degëzimin tjetër shkon në drejt Gramshit ku në Drizë rruga shtetërore (**SH 71**) bashkohet me rrugën shtetërore (**SH 89**) e cila vjen nga Cërriku, ku nga bashkimi i këtyre 2 rrugëve shtetërore vazhdohet drejt qytetit të Gramshit si rrugë shtetërore (**SH 71**).
- **Rruga Shtetërore 89 (SH89)**- nis nga bashkimi i rrugëve shtetërore (**SH 70**) dhe (**SH 59**), vazhdon më tej në drejtim të qytetit të Gramshit ku bashkohet me rrugën Shtetërore (**SH 71**) e cila vazhdon deri në Maliq ku bashkohet me rrugën shtetërore (**SH 3**), që kalon në pjesën jugore të qytetit të Elbasanit.

Figura 57 Gramshi në raport me infrastrukturën rajonale



Burimi: OpenStreetMap, ESRI, G.I.S Përgatiti: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS , 2017

### 16.1.1 Transporti ndërqtetas (Interurban)

Transporti publik ndërqtetas luan një rol të rëndësishëm për mënyrën e lëvizjes (bashkëveprimi) së bashkive me njëra - tjetrën. Transporti publik ndërqtetas është kompetencë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

Transporti ndërqtetar përkufizohet si:

Transporti i udhëtarëve me autobus, i cili kryhet në linjat kryesore paresore, linjat kryesore dytesore dhe linjat ushqyese, të parashikuara në rrjetin e linjave të miratuara nga Ministri. Linjat kryesore paresore shërbejnë për të plotësuar nevojat e lëvizjes së popullsisë që lidhin bashkitë, si më poshtë:

- a) bashkitë qendër të qarqeve të ndryshme;
- b) një bashki qendër qarku me bashkitë jo qendër qarku të një qarku tjetër ose dy bashki jo qendër qarku të qarqeve të ndryshme;
- c) lëvizja brenda qarkut <sup>254</sup>.

Transporti në linjat kryesore kryhet pa ndalime ose me ndalime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës. Linjat ushqyese lidhin dy bashki brenda një qarku, me qëndrime në stacionet e përcaktuara gjatë itinerarit të linjës, të përcaktuara në rrjetin e linjave. Transporti ndërqtetas kryhet nga persona juridikë, të organizuar në shoqëri transporti e të pajisur me licencë. Rrjeti i linjave ndërqtetëse (kryesore dhe ushqyese), stacionet e qëndrimit dhe numri i orareve për secilën linjë miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin çdo tre vjet<sup>255</sup>.

Nga analiza e transportit ndërqtetas (interurban), sipas informacioneve të marra nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, lëvizshmërinë më të shpeshtë Bashkia e Gramshit e ka me Elbasanin. Nga skema e paraqitur më poshtë shohim që Bashkia Gramshit ka 6 orare në ditë që


shkojnë drejt Elbasanit dhe 2 orare në ditë drejt Tiranës dhe Durrësit si dhe 1 orar drejt Korçës. Linjat e transportit ndërqytetas nisen nga sheshi Agjensia që ndodhet në hyrje të qytetit. Nga ky vendqendrim nisen autobuzët drejt Elbasanit, Tiranës dhe Durrësit kurse pranë spitalit niset autobuzi drejt korçës. Linjat e transportit ndërqytetas kanë nisur të zbatohen në janar të këtij viti. Duhet theksuar që janë miratuar edhe 2 linja ndërqytetëse ndonëse nuk janë pasqyruar në informacionin e marr nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Linjat e reja janë Gramsh-Kamëz dhe Gramsh- Vlorë të cilat kanë nga 1 orar.

Përsa i përket hyrjeve në bashkinë e Gramshit ngë bashkitë e tjera mund të përmendim 3 orare nga Elbasani drejt Gramshit si dhe 2 orare që nisen nga Tirana. Analiza e hyrje- daljeve bën të mundur të kuptojmë fluksin e lëvizjes së banorëve të qyteteve të ndryshme me njëra - tjetrën.

Duke iu referuar të dhënave nga bashkia, numri i banorëve që lëvizin në linjat ndërqytetase është afërsisht 430 banorë në ditë. Në këtë bashki lëvizin 19 automjete në ditë, të cilat kanë 574 vende gjithsej. Duke parë këto të dhëna mund të thuhet që lëvizshmëria në këtë qytet drejt bashkive të tjera ose anasjelltas është i lartë. Përsa i përket çmimit mund të themi që varion nga 200- 500 lek, ku çmimi është i lidhur drejtpërdrejt me destinacionin final.

Përsa i përket tarifave të transportit mbi udhëtarët, zbatohen mbi bazën e dispozitave të ligjit “për çmimet dhe tarifat”. Tarifat e transportit të udhëtareve me subvencion nga shteti miratohen nga Keshilli i Ministrave<sup>256</sup>.

Figura 58 Transporti ndërqytetës (nisja nga qyteti Gramshit)



Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës; Përpunoi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017  
 Analiza e infrastrukturës rrugore bazuar tek Kodit rrugor i Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit të gjitha rrugët automobilistike në territorin e Shqipërisë klasifikohen si më poshtë:

A. Autostradë

- B. Rrugë interurbane kryesore
- C. Rrugë interurbane dytësore
- D. Rrugë urbane kryesore
- E. Rrugë urbane dytësore
- F. Rrugë lokale<sup>257</sup>

Nga analiza së infrastrukturës rrugore në Bashkinë Gramsh ka 887.7 km rrugë lineare<sup>258</sup>. Nga plani rregullues i Bashkisë Gramsh, në vitin 2014, , i cili nuk është miratuar, bashkia e Gramshit ka patur 11 km linear, vihet re që infrastruktura rrugore është shumëfishuar.


Tabela 94 Infrastruktura rrugore e Bashkisë Gramsh sipas kodit rrugor të Republikës së Shqipërisë

Gjatësia e rrugës (km)	Ekzistuese
Rruge interurbane dytësore	52.5
Rruge urbane kryesore	1.9
Rruge urbane dytësore	5.3
Rrugë lokale	828
<b>Total</b>	<b>887.7</b>

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Nga tabela e mësipërme, shohim që shtrirjen lineare më të vogël e kanë rrugët urbane kryesore të cilat shtrihen në qendër të qytetit të Gramshit. Ndërsa shtrirjen më të madhe lineare e zënë rrugët lokale, me 828 km linear, të cilat shtrihen në periferi të qytetit dhe mbizotërojnë njësitë administrative me karakter rural (peisazhistik). Nga evindentimi i hierarkisë së kodit rrugor shihet mungesë e infrastrukturës urbane kryesore në qytetin e Gramshit, në mënyrë që aksesit të jetë më i mirë si p.sh korsitë e bicikletave, parkimi, trotuaret etj. Në propozimet e planit kjo infrastrukturë do të luaj një rol të veçantë në zhvillimin e kësaj bashkie.

Figura 59 Hierarkia e sistemit rrugor sipas Kodit Rrugor



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 16.2 Profilet e infrastrukturës rrugore bazuar Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë

**Rrugë interurbane dytësore:** Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsë lëvizjeje për sens dhe bankina.

**Rrugë lokale:** Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij Neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

**Rrugë urbane kryesore:** Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsë lëvizjeje dhe një korsë e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqëndruara.


**Rrugë urbane dytësore:** Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsë, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsë manovrimi jashtë karrexhatës.

Figura 60 Profil rrugë interurbane dytësore (majtas) dhe rrugë lokale (djathtas)




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Figura 61 Profil rrugë urbane kryesore



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Figura 62 Profil rrugë urbane dytësore



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

### 16.3 Analiza sipas funksionalitetit


Në aspektin e funksionit të akseve rrugore, mbizotërojnë rrugët peisazhistike (43.3 % të totalit). Kjo dëshmon që bashkia Gramsh ka potencial turistik, kjo vjen për arsye të terrenit të thyer ku shtrihet kjo bashki. Kjo infrastrukturë do të ketë një rol të veçantë në propozimet e planit rregullues në mënyrë që aksesit të jetë i mirë kryesisht në zonat me potencial turistik.

Tabela 95 Shpërndarja e rrugëve sipas funksionit dhe gjatësisë përkatëse

Gjatësia e rrugës (km)	Ekzistuese
Arterie	53.9
Bujqesore	121
E brendshme kryesore	95.8
E brendshme dytësore	58.4
Kolektor	293.9
Korridor shumëfunksional	0.4
Peisazhistike	499.5
Rekreative	24.6
Shërbimi	5.2
<b>Total</b>	<b>1152.7</b>

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPolis, 2017

Figura 63 Hierarkia e sistemit rrugor sipas funksionalitetit



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 16.4 Rrugët urbane dhe rurale


Aktualisht Bashkia Gramsh ka 435 ha. Në total **rrugët urbane (19.1 ha)** zënë një sipërfaqe më të vogël se **rrugët rurale (415.9 ha)**. Kjo ndodh sepse në territorin e Gramshit ka më shumë njësi administrative që kanë karakter rural (peisazhistik), por në vazhdim duhet t'iu jepet përparësi këtyre rrugëve duke parë që turizmi dhe blegtoria janë ndër të ardhurat kryesore të kësaj bashkie.

## 16.5 Pikat potenciale të rrezikut

Për të bërë një vlerësim të pikave të tjera potenciale të rrezikut, janë evidentuar të gjitha pikat ku rrugët interurbane dytësore kryqëzohen me rrugë lokale, pra në bashkinë Gramsh ka 72 pika konfliktuale të cilat janë burim aksidenti.



Figura 64 Kryqëzimet e rrugëve lokale rrugët interurbane dytësore




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 16.6 Gjëndja e infrastrukturës rrugore

Krahas llojit dhe funksionit të akseve rrugore, kjo analizë merr në konsideratë edhe gjëndjen fizike të infrastrukturës, në aspekt të cilësisë së shtrimit, pranisë së trotuareve, sinjalistikës, etj. Nga ky evidentim<sup>259</sup> rezulton se në Bashkinë e Gramshit vetëm 91.7 km rrugë janë të shtruar ( afersisht 8% ) dhe 1061 km janë të pashtuar. Kjo ndodh për arsye se pjesa më e madhe e rrugëve janë rrugë lokale, pra rrugë në të cilat nuk janë bërë shumë investime.

Figura 65 Cilësia e infrastrukturës rrugore Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

### 16.7 Lëvizshmëria (Mobiliteti) dhe transporti publik rreth-qytetas

Të dhënat statistikore për përdorimin e automjetit apo transportit publik, (INSTAT, 2011) tregojnë se 68.8 % e banorëve të Bashkisë Gramsh shkojnë në punë në këmbë ose me biçikletë, 10.9 % me autobus, minibus ose taksi dhe vetëm 9.1 % me automjete personale (makina ose motoçikleta). Kjo dëshmon për një kulturë automobilistike jo të mirë.

Transporti i udhëtarëve në linjat rrethqytetëse është shërbim i rregullt transporti, i cili plotëson nevojat e lëvizjes së popullsisë ndërmjet:

- a) njësi administrative përbërëse dhe qendrës së bashkisë së cilës i përkasin;
- b) njësi administrative përbërëse të së njëjtës bashki;
- c) fshatrave me njëri-tjetrin ose fshatrave në drejtim të qendrës së njësisë administrative së cilës i përkasin dhe/ose një njësi administrative tjetër të së njëjtës bashki;
- d) fshatrave dhe njësi administrative përbërëse, të bashkive të ndryshme, por që ndodhen në kufi me njëra-tjetrën<sup>260</sup>.

Hartimi i rrjetit të linjave rrethqytetëse dhe ndërqytetëse bazohet mbi të dhënat demografike e gjeografike, gjëndjes social-ekonomike, kërkesat për lëvizjen e popullatës, rrjetin rrugor dhe gjëndjen e infrastrukturës rrugore. Në procesin e hartimit të rrjetit të linjave rrethqytetëse merren parasysh lidhjet ndërmjet njësi të vetëqeverisjes vendore me qendrat e njësi administrative përbërëse dhe qendrat e njësi administrative përbërëse me fshatrat dhe fshatrat ndërmjet tyre.


Ky rrjet linjash transporti miratohet çdo tre vjet dhe nuk duhet të cenohet rrjetin e linjave qytetëse dhe ndërqytetëse<sup>261</sup>.

Nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave përcaktohen nga Keshilli Bashkiak brenda juridiksionit të vet (transporti rrethqytetas), në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave<sup>262</sup>.

Duke u bazuar në informacionet e bashkisë Gramsh, transporti rrethqytetas përbëhet nga 19 linja të licensuara për transportin taxi 8+1.

Nga linjat ekzistuese shihet që pjesa më e madhe e bashkisë ka akses nga shërbimi i transportit publik i cili është shumë i rëndësishëm në funksionimin normal të bashkisë. Pjesa perëndimore, jug-perëndimore (Grekan, Irmanj, Sarasel etj) si dhe pjesa lindore (Rashtan, Kishte, Prosnovisht etj) nuk kanë akses nga ky shërbim. Në propozimet e linjave të reja, ky lloj transporti do të mbulojë të gjithë territorin në mënyrë që banorët e njësive administrative dhe të fshatrave të kenë akses më të mirë me shërbimet që ndodhen në qytetin e Gramshit si dhe linjat të organizohen në mënyrë funksionale. Ky lloj transporti shtrihet në një gjatësi 294.8 km<sup>263</sup> linear.


Figura 66 Linjat e transportit publik rrethqytetas, Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Përsa i përket fluksit të levizjeve, siç shihet dhe në hartën më poshtë, fluksi më i madh është drejt pjesës veriore dhe jug perëndimore të bashkisë. Njësia matëse e fluksit është bërë me atë të numrit të orareve që nisen drejt Nja-ve si dhe drejt fshatrave të ndryshëm, ku numri më i madh i orareve që nisen nga Gramshi drejt Nja-ve ose anasjelltas është 4 orare në ditë. Kjo analizë tregon bashkëveprimin që ka Nja me qytetin e Gramshit si dhe fluksin që kalon në infrastrukturën rrugore me anë të këtij shërbimi.

Figura 67 Fluksi i levizjeve sipas numrit të orareve, Bashkia Gramsh




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Stacionet e transportit publik janë shumë të rëndësishme për qytetarët e qytetit dhe personave të ndryshme që vijnë në qytet, në mënyrë që të kuptojnë se nga cili vend do të nisen drejt destinacionit. Në qytetin e Gramshit ndodhen 3 stacione të transportit publik si dhe 1 vendqëndrim për taksitë që ndodhet në qendër të qytetit.

Në hyrje të qytetit të Gramshit tek Agjensia ndodhet stacioni i transportit publik ndërqytetas dhe linja rrethqytetase Gramsh- Poroçan. Në qytetin e Gramshit ndodhen edhe 2 stacione të transportit rrethqytetas ku 1 stacion ndodhet përball drejtorisë arsimore ku nisen linjat drejt Lenies, Marshan, Kukur etj si dhe linja ndërqytetase Gramsh- Korçë, kurse stacioni tjetër ndodhet në rrugën që të çon tek stadiumit, ku nisen linjat drejt Kushovës, Tunjës, Bratilës etj. Për ta bërë këtë lloj shërbimi sa më të mirë të aksesueshëm për banorët, në propozimet e planit do të behët i mundur planifikimi për ndërtimin e terminalit në mënyrë që ky shërbim të ketë akses më të lehtë për banorët e qytetit dhe jo vetëm.

Figura 68 Stacionet e Transportit publik rrethqytetas, Bashkia Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 16.8 Përfundime

- Me infrastrukturën e re që është ndërtuar, Gramshi shtrihet në pozicion të favorshëm gjeografik duke parë ndodhet 90 minuta larg Tiranës dhe Durrësit si dhe afersisht 50 minuta drejt Elbasanit .
- Me shtimin e 2 linjave të tjera drejt Kamzës dhe Vlorës, Bashkia e Gramshit ka akses të mirë në linjat ndërqytetase.
- Gjëndja e infrastrukturës rrugore është e dobët duke parë që vetëm 8 % e rrugëve në nivel bashkie janë të shtruar ( Asfalt).
- Nga të dhenat e INSTAT tregohet që 68.8 % e banorëve të bashkisë shkojnë në punë në këmbë.
- Në bashkinë e Gramshit ndodhen 3 stacione të transportit ndërqytetas dhe rrethqytetas dhe për ta bërë këtë shërbim më eficient do të propozohet ndërtimi i terminalit të transportit publik.

## 17. Analiza e periferialitetit

Analiza e periferialitetit është mjeti që ndihmon në identifikimin e shpërndarjes së pabarazive social-ekonomike brenda territorit administrativ që po studiohet. Kjo analizë bazohet në mbivendosjen e gjetjeve (shtresave) të analizave social-ekonomike dhe synon të klasifikojë zonat e ndryshme në qytet nga ato më të preferueshmet deri tek ato më të pafavorizuarat. Ky klasifikim e ndihmon bashkinë në përzgjedhjen e strategjive investuese dhe projekteve prioritare në PPV, që janë:

- largësia nga qendra e zonës së banuar;
- largësia nga qendrat e punësimit;
- lidhja me sistemin rrugor;
- furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale;
- niveli më i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore;
- plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës;
- niveli i kriminalitetit dhe sigurisë së jetës;
- probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social.

Mbivendosja e hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore, si dhe qendrave të punësimit dhe shërbimeve ekonomike krijon mundësinë që të identifikohen në territor zonat e favorizuara (të cilat mbulohen nga rrezet e shërbimit të infrastrukturave publike dhe gjenden në afërsi të zonave ekonomike) nga ato të pafavorizuarat, duke identifikuar kështu zonat ku ka më tepër nevojë për ndërhyrje dhe investime publike.

Kjo analizë, e mbivendosur me analizën demografike, krijon lehtësi në përlllogaritjen e numrit të banorëve që banojnë në zona të pafavorizuara dhe të mangësive infrastrukture që ato kanë, proces mbi të cilin bazohet vendimmarrja përsa i përket ndërhyrjeve prioritare në terren.

Analiza e periferialitetit ka fokus kryesor identifikimin e zonave të banimit periferike të bashkisë së Gramshit dhe evidentimin e problematikave kryesore të këtij qyteti.

### 17.1 Metodologjia

Si fillim është paraqitur rrjeti i infrastrukturës ekzistuese rrugore, rrjeti ekzistues i ujësjellësit dhe kanalizimeve, si dhe janë identifikuar institucionet arsimore dhe shëndetësore në territorin administrativ të bashkisë.

Për objektet arsimore dhe shëndetësore rrezja e mbulimit të këtij shërbimi është përcaktuar sipas standardeve. Gjithashtu, evidentohen edhe të gjitha akset kryesore të lëvizjes me zonat e influencës për shërbimet e ofruara sipas standardeve.<sup>264</sup> Skema e mëposhtme tregon mbivendosjen e këtyre elementeve qëndrore, siç janë institucionet arsimore, shëndetësore, si dhe infrastrukturën kryesore rrugore dhe nëntokësore.

Nga mbivendosjet e të gjitha hartave që tregojnë rrezet e shërbimit të infrastrukturave arsimore, sociale, shëndetësore, rrugore e nëntokësore rezultojnë të ndërthurura zona të caktuara.

Në varësi të mbulimit të tyre nga shërbimet e infrastrukturave publike mund të klasifikohen disa kategori në lidhje me periferialitetin: ato më periferiket, të cilat nuk mbulohen nga asnjë nga

shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga të gjitha shërbimet publike, ato të cilat mbulohen nga vetëm tri shërbime, ato që mbulohen nga dy shërbime ose një shërbim.

A. Arsim

S. Shëndetësi

U. Ujësjiellës-Kanalizime

I. Infrastrukturë rrugore

Më poshtë janë kategoritë bazë të identifikimit të periferialitetit në hartë:

- **Kategoria 1:** Zonat që mbulohen nga të gjitha shërbimet (A+S+U+I), të shërbyera shumë mirë
- **Kategoria 2:** Zonat që mbulohen nga tri shërbime (ASU, AUI, ASI, SUI), të shërbyera mirë
- **Kategoria 3:** Zonat që mbulohen nga dy shërbime (AS, AU, AI, SU, SI, UI), problematike me shërbimet publike
- **Kategoria 4:** Zonat që mbulohen nga një shërbim (A, S, U, I), periferike

Kategoritë bazë të klasifikimit të periferialitetit janë rezultat i ndërthurjeve të shërbimeve të ndryshme publike, sipas treguesve të planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore.<sup>265</sup>

Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore:

Tabela 96 Treguesit e planifikimit për infrastrukturën arsimore

Infrastruktura arsimore	Numri i banorëve që shërbehet nga një njësi shërbimi		Rrezja e shërbimit		Standardet e projektimit	
	Zona	Zona rurale	Zona	Zona rurale	Për ndërtesën	Për parcelën
Çerdhe	1000	1000	200-300m	200-300m	25m <sup>2</sup> -30m <sup>2</sup> /	900m <sup>2</sup> -
Kopësht	1500	1500	250-350m	500-600m	18m <sup>2</sup> -25m <sup>2</sup> /fëmijë	1000m <sup>2</sup> -1500m <sup>2</sup>
Shkollë 9-vjeçare	6000	6000	500-600m	1000-1500m	20m <sup>2</sup> -25m <sup>2</sup> /fëmijë	1500m <sup>2</sup> -7000m <sup>2</sup>
Shkollë e mesme	9000	9000	1000-1500m	2000-4500m	20m <sup>2</sup> -30m <sup>2</sup> /nxënës	2000m <sup>2</sup> -7000m <sup>2</sup>

Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM nr. 671

Tabela 97 Treguesit e planifikimit për infrastrukturën shëndetësore


Infrastruktura shëndetësore	Sipërfaqja (m <sup>2</sup> )	Treguesi “1 njësi/nr. banorësh”
Qendra shëndetësore	300 – 400	Një për 250-1,500
Ambulancë – konsultore- maternitet	400 – 6,000	
Ambulancë – konsultore	700 – 1,000	Një për 1,500 – 2,000
Poliklinikë	2,000 – 5,000	

Dispanseri	3,000	
Drejtori e higjienës epidemiologjike	2,000 – 3,000	
Qendër dezinfektimi, deratizimi	2,000	

Burimi: Rregullorja e Planifikimit- VKM nr. 671

Në kuadër të analizës së periferialitetit do të analizohen të gjitha njësitë administrative për mbulimin e tyre sipas kategorive të periferialitetit të cilat i përmendëm më sipër më pas do të zhvillohet dhe analizimi i përgjithshëm i bashkisë sipas kategorive të periferialitetit.

Figura 69 Mbulimi me shërbime sipas katër kategorive të periferialitetit në Njësinë Administrative Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 98 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Gramsh

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Gramsh	1	I-A-SH-U	6191	98.88%



	2	A-SH-U, I-SH-U	67	1.08%
	3	Sh-U, A-SH	3	0.04%
	4	SH	0	0.00%
			6261	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Për sa i përket NjA Gramsh rreth 99.5 % e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 1 dhe 2 të periferialitetit që do të thotë se pothuajse të gjithë vendbanimet e NjA Gramsh aksesohen shumë mirë nga shërbimet publike dhe vetëm 0.5% e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit që kanë akses të dobët në raport me shërbimet publike.

Tabela 99 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kodovjat

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
<b>Kodovjat</b>	1	I-A-SH-U	602	28.95%
	2	A-SH-U, I-A-SH	1267	60.92%
	3	A-SH	54	2.61%
	4	SH	156	7.51%
			2079	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Kodovjat rreth 30 % e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 1 të periferialitetit dhe rreth 60% në kategorinë 2 të periferialitetit. Pra rreth 90 % e vendbanimeve të NjA-së aksesohet nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike që do të thotë që kanë akses të mirë ndaj shërbimeve publike. Rreth 10% e vendbanimeve të NjA përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit , përkatësisht 2.6% dhe 7.5%. Kjo do të thotë se këto vendbanime kanë akses të dobët në raport me shërbimet publike ose mbulohen nga 1 ose 2 lloje shërbimesh publike.

Tabela 100 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kukur

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
<b>Kukur</b>	2	I-A-SH	1839	83.77%
	3	A-SH	316	14.39%
	4	SH	40	1.84%
			2196	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Kukur vërehet se në kategorinë e parë të periferialitetit nuk përfshihet asnjë vendbanim dhe kjo do të thotë se njëri nga shërbimet publike mungon tërësisht në NjA Kukur i cili është shërbimi i Ujësjellës-Kanalizimeve. Në kategorinë e 2 të periferialitetit përfshihen rreth 83.7% e vendbanimeve. si dhe rreth 16% e vendbanimeve përfshihet në kategoritë 3 dhe 4, që do të thotë se këto vendbanime mbulohen nga të paktën 1 ose 2 lloje shërbimesh publike.

Tabela 101 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Kushovë

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Kushovë	1	I-A-SH-U	308.17	55.48%
	2	A-SH-U, I-A-SH, I-SH-U	172.27	31.02%
	3	A-SH	0.00	0.00%
	4	SH	75.00	13.50%
			555.44	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Kushovë vërehet se në kategorinë 1 të periferialitetit përfshihen 55.5 % të vendbanimeve dhe rreth 31% e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 2. Pra rreth 86.5% e vendbanimeve të NjA Kushovë përfshihen në kategoritë 1 dhe 2 të periferialitetit që do të thotë që aksesohen mirë nga shërbimet publike. Rreth 13.5 % e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 4 të periferialitetit që do të thotë që këto vendbanime kanë akses vetëm nga një lloj shërbimi publik. Mund të themi se në NjA Kushovë kemi një numër më të madh të vendbanimeve që përfshihen në kategorinë 4 të periferialitetit ndërsa nuk kemi asnjë vendbanim të përfshirë në kategorinë 3.

Tabela 102 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Lenie

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Lenie	2	I-A-SH	604	86.22%
	3	A-SH	96	13.78%
	4	SH	0	0.00%
			700	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Lenie për sa i përket periferialitetit kemi një situatë të ngjashme me NjA Kukur ku nuk kemi vendbanime që përfshihen në kategorinë 1 të periferialitetit. Rreth 86.2% e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 2 të periferialitetit që do të thotë që aksesohen të paktën nga 3 lloje shërbimesh publike. Rreth 13.7% e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 3 të periferialitetit ndërsa në kategorinë 4 nuk përfshihet asnjë vendbanim. Në raport me NjA e tjera NjA Lenie ka përfshirje mjaft të lartë të vendbanimeve në kategorinë 3 që hyn tek vendbanimet që shërbehen nga të paktën 2 lloje shërbimesh publike.

Tabela 103 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Pishaj

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Pishaj	1	I-A-SH-U	2472	58.22%
	2	A-SH-U, I-A-SH, I-SH-U	1597	37.61%
	3	A-SH, SH-U	28	0.67%
	4	SH	149	3.50%
			4246	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Pishaj rreth 93.8% e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 1 dhe 2, përkatsisht 58.2% dhe 37.6% që do të thotë që këto vendbanime aksesohen nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike. Rreth 4.1% vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit.

Tabela 104 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Poroçan

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Poroçan	2	I-A-SH	777	62.25%
	3	A-SH	377	30.19%
	4	SH	94	7.56%
			1247	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

NjA Poroçan mund të themi se është një njësi problematike për sa i përket periferialitetit. Në këtë njësi nuk kemi asnjë vendbanim që përfshihet në kategorinë 1 të periferialitetit sepse mungon shërbimi i ujësjellesit dhe kanalizimeve. Rreth 62.2% e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 2 të periferialitetit që do të thotë që aksesohen nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike. Rreth 37 % e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit që është një shifër mjaft e lartë krahasuar me NjA-të e tjera.

Tabela 105 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Skënderbegas

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Skënderbegas	1	I-A-SH-U	10	0.92%
	2	I-A-SH	970	89.41%
	3	A-SH	31	2.82%
	4	SH	74	6.85%
			1085	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Skënderbegas rreth 90% e vendbanimeve përfshihen në katogritë 1 dhe 2 të periferialitetit që do të thotë se shërbehen nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike, që është një shifër e kënaqshme në raport me NjA-të e tjera. Gjithashtu rreth 10% e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit që do të thotë se aksesohen nga të paktën 1 shërbim publik.

Tabela 106 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Sult

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Sult	1	I-A-SH-U	300	52.82%
	2	I-A-SH, I-SH-U	206	36.26%
	3	A-SH	0	0.00%

	4	SH	62	10.92%
			569	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Sult vërehet se rreth 90% e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 1 dhe 2 të periferialitetit që do të thotë se këto zona shërbehen nga të paktën tre lloje shërbimesh publike. Gjithashtu rreth 10% e vendbanimeve përfshihen nga kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit që do të thotë që shërbehen nga të paktën vetëm një shërbim publik.


Tabela 107 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit NjA Tunjë

Njësia Administrative	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
Tunjë	1	I-A-SH-U	457	34.28%
	2	A-SH-U,I-A-SH	663	49.72%
	3	A-SH	32	2.41%
	4	SH	181	13.59%
			1333	100.00%

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Në NjA Tunjë vërehet se rreth 84% e vendbanimeve përfshihen në kategoritë e periferialitetit 1 dhe 2, përkatësisht 34.2% dhe 49.7% që do të thotë që aksesohen nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike. Rreth 16 % e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 ku rreth 14% i përket kategorisë 4 që do të thotë se këto zona aksesohen vetëm nga një shërbim publik. Kjo krahasuar me NjA-të e tjera është mjaft problematike.

Figura 70 Mbulimi me shërbime sipas katër kategorive të periferialitetit në Bashkinë Gramsh



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Tabela 108 Numri i Banorëve të shërbyer sipas katër kategorive të periferialitetit në Bashkinë Gramsh

Bashkia Gramsh	Kategoria e Periferialitetit	Kombinimi	Numri i Personave të Shërbyer nga kjo Kategori	%
	1	I-A-SH-U	10340	51.01%
2	A-SH-U, I-SH-U, I-A-SH	8162	40.26%	
3	A-SH, SH-U	937	4.62%	
4	SH	832	4.11%	
		20272	100.00%	

**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Sipas tabelës së mësipërme rreth 51% e vendbanimeve përfshihen në kategorinë 1 të periferialitetit, 40.2% në kategorinë 2, 4.6% në kategorinë 3 dhe 4.1 në kategorinë 4. Pra rreth 91% e vendbanimeve të bashkisë aksesohen nga të paktën 3 lloje shërbimesh publike ndërsa rreth 9% të vendbanimeve aksesohen nga të paktën një shërbim publik.

## 18. Përdorimi i tokës dhe sistemet e territorit


Në këtë seksion do të analizohen përdorimet e tokës dhe sistemet territoriale ekzistuese në Bashkinë Gramsh si dhe % që ka çdo përdorim apo sistem në raport me sipërfaqen e bashkisë.

Gjithashtu do të analizohen dhe konfliktet e përdorimeve të tokës të cilat formohen si pasojë e mbivendosjeve të përdorimeve. Si fillimi do të analizohen përdorimet e tokës për çdo Njësi Administrative dhe më pas do të japim një panoramë të përgjithshme të përdorimeve në shkallë bashkie.

### **18.1 Analiza e përdorimit ekzistues të tokës**

NjA Gramsh ndodhet në pjesën qendrore të bashkisë dhe ka një sipërfaqe prej 2.47 km<sup>2</sup> e cila është një sipërfaqe mjaft e vogël në krahasim me NjA-të e tjera. Kjo NjA përfshin të gjithë pjesën më vjetër të qytetit të Gramshit, por pjesët më të reja të qytetit dalin përtej kësaj NjA-je sepse me kalimin e kohës struktura urbane e qytetit ka pësuar ndryshime dhe rritje të saj. Në pjesën perendimore NjA Gramsh kufizohet me shtatin e Lumit Devoll, në kufirin lindor kufizohet me përdorimet natyrore siç janë shkurret e dendura dhe shkurret e rralla ndërsa në pjesën qendrore dhe skajet veriore e jugore ndodhen përdorimet e ndërtueshme të tokës siç janë Banimi, Shërbimet, Institucionet, Industria dhe Ekonomia, Arsimi, Shëndetsia dhe Ambjentet Rekreative. Nga perëndimi në lindje terreni ngrihet gradualisht dhe në pjesën qendrore ndërtimet kanë kryesisht përdorim Banim shumë familjarë të kombinuara me Shërbime të ndërtuara me intesitet më të lartë ndërsa në drejtim të lindjes intesiteti bie duke kaluar në ndërtime individuale. Gjithashtu në pjesën qendrore kemi praninë e kategorive të Shërbimeve Tregtare ose të Tregjeve të vegjël dhe të Arsimit e Shëndetsisë. Kategoria bazë Industri ndodhet kryesisht në hyrje dhe në dalje të qytetit me ish magazinat e Ndërmarrjes së Grumbullimit dhe Ish-Uzinën e Bativerive, por që aktualisht shumica e tyre është privatizuar dhe janë pa funksion. Ndërmjet qytetit dhe shtatit të Lumit Devoll ndodhen disa zona me kategori bazë të përdorimit Bujqësi të cilat kanë toka të kultivuara arë.

Figura 71 Përdorimi ekzistues i tokës i qytetit të Gramshit



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

NjA Pishaj ndodhet në pjesën veriore të Bashkisë Gramsh dhe ka një sipërfaqe prej 103 km<sup>2</sup>. Ka një terren kryesisht malor me përjashtim të pjesës perendimore të NjA-së që ka karakter fushorë sepse shtrihet Lugina e Devollit. Kufiri perendimorë i NjA-së është lugina e Devollit që ka përdorim ujëra si dhe përdorim bujqësor me toka të kultivuara gjithashtu të alternuara me vendbanimet kryesore të zonës. Gjithsesi përdorimi dominues i tokës mbetet kategoria natyrore me nënkategori shkurre të dendur dhe të rrallë.

Kjo NjA ka 20 fshatra: Fshat Pishaj, Trashovicë, Shëmrizë, Ostenth, Gurrëz, Cerunjë, Çekin, Qerret, Koçaj, Vinë, Fshat-Gramsh, Drizë, Cingar i Sipërm, Cingar i Poshtëm, Galigat, Kotorr, Gjergjovinë, Storre, Liras dhe Tërrol. Këto fshatra janë të pozicionuar kryesisht pranë luginës së Devollit dhe luginës së Holtës të cilat kanë në afërsi të tyre dhe toka bujqësore. Në këtë NjA kemi dhe prezencën e përdorime të tjera siç është industria e rëndë që përfshin ish uzinën armëve në fshatin Çekin.

NjA Kodovjat ndodhet në jug të Bashkisë Gramsh dhe ka një sipërfaqe 83km<sup>2</sup>. Pjesa perendimore e saj është pjesë e luginës së Devollit ndërsa në qendër të NjA-së kemi luginën e Përroit të Verçës. Për rrjedhojë këto zona të sipërpërmendura karakterizohen nga përdorimet e ujërave pra shtretërit e Lumit Devoll dhe Përroi i Verçës gjithashtu dhe nga tokat bujqësore. Në pjesët e tjera kemi terren malor i cili karakterizohet kryesisht nga përdorimi natyror i tokës me nënkategoritë pyll i dendur e i rrallë, kullota dhe shkurre të dendura dhe shkurre të rralla.

Kjo NjA ka 12 fshatra: Fshat Kodovjat, Bratilë, Bulçar, Kishtë, Kokël, Posnovisht, Shelcan, Bersnik i Poshtëm, Bersnik i Sipërm, Mashan, Broshtan dhe Zamishë. Këto fshatra ndodhën sërish përgjatë luginës së Lumit Devoll dhe luginës së Përroit të Verçës. Gjithashtu në afërsi të këtyre vendbanimeve janë të pozicionuara tokat bujqësore.

NjA Kukur ndodhet në pjesën lindore të Bashkisë Gramsh dhe ka një sipërfaqe prej 88 km<sup>2</sup>. Terreni i kësaj NjA-je është kryesisht malor ndërsa në pjesën qendrore terreni është më i ulët se në skaje ku terreni është mjaft i thyer. Në pjesën qendrore ndodhet lugina e Përroit të Verçës që është vazhdim i pjesës nga NjA Kodovjat. Përdorimi dominues i tokës është kategoria bazë natyrore që përfaqësohet nga nenkategoritë e pyjeve të dendur dhe të rralle si dhe nga kullotat dhe shkurret e rralla e të dendura.

Kjo NjA ka 10 fshatra: Fshat-Kukur, Grazhdan, Gribë, Kalaj, Mukaj, Rashtan, Rmath, Snosëm, Sojnik dhe Vreshtas. Këto vendbanime pozicionohen kryesisht në pjesën qendrore të NjA-së dhe karakterizohen me banime të ulta dhe në pak raste këto vendbanime janë të kombinuara me shërbime të vogla përveç se në rastin e Fshatit Kukur që është qendër e NjA-së. Në afërsi të vendbanimeve ndodhen dhe përdorimet bazë bujqësore që janë kryesisht tokat e kultivuara arë.

NjA Kushovë ndodhet në perëndim të Bashkisë së Gramshit dhe ka një sipërfaqe prej 56 km<sup>2</sup>. Kjo NjA si kufij lindorë të saj ka Përroin e Tomoricës që e ndan me NjA Skënderbegas. Në anën lindore të NjA-së terreni është i ulët ndërsa vjen në ngritje në drejtim të perëndimit. Si në NjA-të e tjera përdorimi dominues i tokës është përdorimi natyror i cili ndodhët kryesisht në zonat perëndimore dhe përfaqësohet nga kullotat, pyjet e dendura dhe të rralla si dhe nga shkurret e dendura dhe të rralla.

Kjo NjA ka 8 fshatra: Fshat-Kushovë, Bregas, Gjeraqinë, Dumderas, Brasnik, Ulovë, Kërpicë dhe Sotirë. Këto vendbanime kryesisht ndodhen në pjesën lindore dhe qendrore të saj, përgjatë degëzimit të Përroit të Tomoricës. Këto vendbanime janë vendbanime të ulëta me njësi ndërtimi individuale. Në Fshatin Kushovë kemi dhe prezencën e kategorisë së institucioneve dhe kategorisë së shërbimeve si qendër e NjA-ë

NjA Lenie ndodhet në pjesën jug-lindore të Bashkisë së Gramshit dhe ka një sipërfaqe prej 100 km<sup>2</sup>. Lenia karakterizohet kryesisht me një terren malor të theksuar në skajet e saj ndërsa në pjesën qendrore ka pllaja në të cilat terreni është më i ulët. Përdorimi dominues i tokës janë kategoritë natyrore kryesisht me pyje të dendura dhe të rralla me kullota dhe shkurre të dendur dhe të rrallë.

Kjo NjA ka 6 fshatra: Fshat-Lenie, Bicaj, Grabovë e Sipërme, Grabovë e Poshtme, Karatë dhe Valth. Këto vendbanime kryesisht ndodhen në pjesën qendrore të NjA-së në pjesën më të ulët të terrenit të saj të cilat kombinohen me kategorinë bazë të përdorimit bujqësi në afërsi të tyre.

NjA Poroçan ndodhet në pjesën veri-lindore të NjA-së dhe ka një sipërfaqe prej 82 km<sup>2</sup>. Poroçani kryesisht ka një terren të thyer malorë dhe kategoria bazë dominuese e përdorimit të tokës janë përdorimet natyrore të përfaqësuara kryesisht nga shkurret e dendura dhe të rrall si dhe kullotat. Zonat bujqësore kryesisht ndodhen në pjesën qendrore në afërsi të vendbanimeve të cilat janë kryesisht toka bujqësore të kultivuara arë.

Kjo NjA ka 5 fshatra: Poroçan, Lleshan, Gjërë, Kabash dhe Holtas. Këto vendbanime ndodhen kryesisht në pjesën qendrore të NjA-së dhe janë të karakterizuara nga vendbanime të ulëta me ndërtime individuale.



NjA Skenderbegas ndodhet në pjesën më jugore të Bashkisë Gramsh ka një sipërfaqe prej 78 km<sup>2</sup>. Kjo NjA ka një karkater të kombinuar midis zonave malore dhe fushore, por gjithsesi dominojnë zonat malore. Skënderbegasi kufizohet në pjesën veri perendimore dhe veri lindore përkatësisht nga Përroi i Tomorricës dhe Lumi Devoll ndërs skaji më jugorë i NjA-së është dhe skaji më malor ku dominojnë kategoritë bazë natyrore të përdorimit të tokës.

NjA Skenderbegas ka 13 fshatra: Skënderbegas, Bletëz, Ermenj, Fushëz, Harunas, Kotkë, Kullotas, Lemnushë, Nartë, Siman, Shemberdhenjë, Vidhan dhe Zenelas. Këto vendbanime pozicionohen kryesisht në pjesët qendrore dhe në skajet e NjA-së përgjatë luginave lumore. Vendbanimet kanë karakter të ulët me ndërtime individuale të kombinuara me shërbime tregtare si dhe insitucione dhe arsim e shëndetsi. Në afërsi të këtyre vendbanimeve kemi dhe zona me përdorim bujqësor të cilat kryesisht janë toka të kultivuara arë.

NjA Sult ndodhet në pjesën veri-perendimore të Bashkisë Gramsh dhe ka një sipërfaqe prej 62 km<sup>2</sup>. Kjo NjA ka si kufij lindor liqenin e hidrocentralit të Banjës që është pjesë e kaskadës së Devollit. Pjesa perendimore e NjA-së karakterizohet nga zona malore. Kategoritë bazë dominuese të përdorimit të tokës janë kategoritë natyrore siç janë pyjet e dendur dhe të rralla si dhe kullotat e shkurret e dendura e të rralla.

NjA Sult ka 9 fshatra: Fshat-Sult, Mazrek, Dushk, Kukuçovë, Kutërqar, Kodër Zgjupe, Zgjupe Fushë, Dufshan dhe Grekan. Këto vend banime ndodhen kryesisht përgjatë luginës së Lumit Devoll në pjesën lindore të NjA-së dhe janë të karakterizuara nga dendësia e ulët me ndërtime individuale. Zonat bujqësore kryesisht i kemi të përqendruara në afërsi të vendbanimeve sepse jeta e banorëve të zonës është e lidhur ngushtë me hapsirat bujqësore që kryesisht janë të përdorimit, tokë e kultivuar arë. Këto zona i kemi kryesisht në pjesën lindore të NjA-së.

NjA Tunjë ndodhet në pjesën perendimore të Bashkisë së Gramshit dhe ka një sipërfaqe prej 80 km<sup>2</sup>. Kryesisht karakterizohet me terrene malore ku pjesa qendrore është dhe pjesa më e ngritur e terrenit ndërsa në skaje terreni është më i ulët. Si kategori bazë dominuese janë përdorimet natyrore që përfaqsohen nga nenkategoritë pyje të dendur, pyje të rralle dhe kullota e shkurre të dendura e të rralla.

NjA Tunjë ka 12 fshatra: Fshat-Tunjë, Duzhë, Irmanj, Jançe Qënder, Jançe Mal, Katëris, Lubinjë, Oban, Përrenjas, Plepas, Sarasel dhe Tunjë e Re. Këto vendbanime ndodhen në anën perendimore dhe lindore të NjA-së të cilat janë vendbanime me ndërtime të ulëta individuale ndërsa kategoritë baze të përdorimit bujqësorë ndodhen kryesisht në pjesën perendimore dhe lindore të NjA-se si dhe në afërsi të zonave të banuara.

Tabela 109 Kategoritë bazë të përdorimit në Bashkinë Gramsh sipas sipërfaqes dhe në %


<b>KATEGORITË BAZË</b>	<b>SIPERFAQJA m<sup>2</sup></b>	<b>Sip %</b>
Aktivitete Shoqërore dhe Argëtim	54014.72625	0.0073%
Arsim	106082.6852	0.0143%
Banim	5135520.739	0.6940%
Bujqësi	101452985.1	13.7101%
Industri Ekonomi	446451.4095	0.0603%
Infrastrukturë Bujqësore	62139.25551	0.0084%

Infrastrukturë Energjitike	17696.25088	0.0024%
Infrastrukturë Telekomunikacioni	1471.736275	0.0002%
Infrastrukturë Transporti	4761241.295	0.6434%
Infrastrukturë Ujësjetës-Kanalizime	13200.86587	0.0018%
Institucione	26093.19524	0.0035%
Monumente Kulture	228.0636067	0.0000%
Shëndetësi	28228.91322	0.0038%
Shërbime	140421.4043	0.0190%
Tokë Natyrore	591054088.8	79.8735%
Ujëra	36574486.95	4.9426%
Varreza	84094.38616	0.0114%
Zonë ushtarake	29431.90534	0.0040%
TOTAL	739987877.7	100.0000%

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Sipas tabelës së mësipërme vërehet se Bashkia Gramsh ka një përqindje mjaft të lartë të territorit më përdorim tokë natyrore ku futen nënkategoritë siç janë pyjet e dendura dhe të rralla, kullota dhe shkurret e dendura e të rralla. Zonat bujqësore kanë një përqindje rreth 13.7% të cilat kryesisht janë toka të kultivuara arë. Rreth 5 % të territorit të bashkisë përfshihet në kategorinë bazë ujëra e cila përfaqësohet kryesisht me Lumin e Devollit dhe Përrenjt e Verçës, Holtës dhe Tomorricës. Kategoritë bazë banim dhe infrastrukturë transporti nxënë rreth 0.7 % të territorit e më pas me përqindje më të ulëta rradhiten kategoritë e tjera të përdorimeve siç janë arsimi, shëndetsi dhe industria e shërbimet.

Figura 72 Përdorimi ekzistues i tokës në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Zonat Natyrore ndodhen kryesisht të shpërndara në masë të madhe në të gjithë territorin e bashkisë, por kryesisht janë të pozicionuara në skajet e bashkisë aty ku territori është më malorë dhe i thyer. Përdorimet bujqësore dhe ujërat kryesisht ndodhen në pjesën qendrore të bashkisë përgjatë luginës së Lumit Devoll ku terreni është më i ulët. Zonat e banuara kryesisht ndodhen përgjate luginës së Devollit gjithashtu janë edhe të shpërndara në të gjithë territorin, por në një sipërfaqe shumë here më të vogël se sa përdorimet e tjera. Përdorimet e tjera siç janë Arsimi, Shëndetsia, Industria dhe Ekonomia dhe shërbimet kryesisht ndodhen në qendrat e vendbanimeve kryesore të bashkisë.


## 18.2 Sistemet Territoriale Gramsh

Tabela 110 Sistemet Territoriale ekzistuese Bashkinë Gramsh sipas sipërfaqes dhe në %

Sistemet Territoriale	Sip m <sup>2</sup>	Sip %
BUJQËSOR	101392708.7	13.70%
INFRASTRUKTUROR	4903207.154	0.66%
NATYROR	591054088.8	79.87%
UJOR	36587305.66	4.94%
URBAN	6050567.428	0.82%
TOTAL	739987877.7	100.00%

Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017


Figura 73 Sistemet territoriale ekzistuese në Bashkinë Gramsh



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Përsa i përket sistemeve territoriale ekzistuese vihet re që sistemi që ka përqindjen më të lartë në raport me sipërfaqen e bashkisë është sistemi natyror i cili përfshin rreth 80% të sipërfaqes. Zonat natyrore kryesisht janë të shpërndara në të gjithë territorin e bashkisë, por më të shumta janë ndër skaje ku edhe terreni është më malor dhe i thyer. Sistemi bujqësor përfshin rreth 13.7 % i cili pozicionohet kryesisht përgjatë luginës së Devollit ku terreni është më i ulët kryesisht me toka arë. Sistemi ujor përfshin rreth 4.94% të territorit të bashkisë ku përfshihen zonat e Lumit Devoll si dhe Përrenjt e Tomorricës, Holtës dhe Verçës. Sistemi urban përfshin rreth 0.82% të territorit dhe vendbanimet kryesisht shtrihen përgjate luginës së Devollit dhe zonave fushore si dhe në masë më të vogël në pjesët e tjera të territorit. Sistemi infrastrukturor përfshin rreth 0.6% të territorit i cili është i shpërndarë në të gjithë territorin e bashkisë.

Figura 74 Sistemet territoriale ekzistuese në Qytetin e Gramshit




Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Për sa i përket sistemeve territoriale në Qytetin e Gramshit mund të themi se sistemi urban është ai sistem që dominon, por kemi edhe prezencë të sistemeve të tjera. Sistemi natyror përfshin kryesisht kreshtat e kodrave mbi qytet në pjesën lindore të tij. Sistemi ujor pëfshin pjesën e Lumit Devoll në perëndim të qytetit, sistemi bujqësor përfshin tokat bujqësore në perëndim të qytetit si dhe sistemi infrastrukturor përfshin të gjitha llojet e infrastrukturave në qytet.

### 18.3 Mbivendosjet/kundravajtjet e përdorimit të tokës

Figura 75 Mbivendosjet/kundravajtjet e përdorimit të tokës



Burimi: Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Nga shpërndarja në territor e përdorimeve të ndryshme, vërehen disa mospërputhje të dukshme, siç është përdorimi i veçantë me funksion ekzistues varrezë pranë zonave të banuara. Mosrespektimi i kushteve higjieno- sanitare dhe distancave sipas VKM nr. 671, datë 29.07.2015, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, .

Kryesisht veprimtaria njerëzore në bashki ndodhë përgjatë luginës së Lumit Devoll dhe në këtë zonë vërehen problematikat e papërputhshmërisë së përdorimeve.

Si pasojë e ndërtimit të Hidrocentralit të Banjës kemi përmbytjen e disa zonave të banuara si dhe përmbytjen e disa tokave bujqësore të cilat janë kthyer në problem social për popullatën që jeton në ato zona, tashmë këto aktivitete nuk i përmbahen distancave të trupave ujorë që përcakton VKM 671.

Një tjetër lloj papërputhshmërie është konflikti Banim-Industri të cilin e gjejmë në periferi të qytetit në zonat ish industrial si dhe në afërsi të Ish-Uzinës së Demontimit të Armëve në fshatin Çekin. Gjithashtu konflikti Banim-Varreza ndodh si pasojë e mbivendosjes së këtyre përdorimeve dhe mosrespektimit të distancave sipas VKM 671.

## 19. Tipologjitë hapësinore

Analiza e tipologjive hapësinore evidenton mënyrat e ndërlidhjes së hapësirave në territor, kryesisht nga pikëpamja morfologjike. Për situatat komplekse të mbulesës së tokës dhe shtrirjes së vendbanimeve në Bashkinë Gramsh, një evidentim i tillë lehtëson të kuptuarin e territorit dhe procesin e përcaktimit të treguesve realistë të zhvillimit.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen e madhe hapësinore të bashkisë në raport me territorin para reformës administrativo-territoriale, kjo analizë trajton 3 nivele tipologjish:

- Nivelin territorial: Mënyra si lidhen vendbanimet me njëra-tjetrën në rang bashkie
- Nivelin e vendbanimeve rurale: Shtrirjet hapësinore të fshatrave, në raport me rrugët, relievin, etj.
- Nivel zone: Ndarja e tipologjive hapësinore në përputhje me njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrës së vendosjes së tyre në njësi strukturore, skemat e rrjetit rrugor dhe hapësirave publike, si dhe lartësisë së strukturave, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit të Territorit.

### 19.1 Bashkia Gramsh në nivel territorial

Struktura e lidhjes mes vendbanimeve në Bashkinë Gramsh është komplekse, si rezultat i terrenit të vështirë dhe mungesës së infrastrukturës rrugore dytësore e tretësore. Hierarkia e fshatrave dhe aksesit ndaj tyre përcaktohen nga prezenca e autostradës Cërrik-Korçë (Sh59), si dhe shtrati i lumit Devoll. Kështu, sistemi i fshatrave Mashal-Kodovjat-Kokël-Bratillë shtrihen përgjatë kësaj rruge, si rrjedhojë formojnë një ndër zonat me potencial më të lartë për rritje urbane e akomodim shërbimesh, së bashku me qytetin e Gramshit. 3 sisteme të tjera lineare lidhen me Gramshin nëpërmjet rrugëve peizazhistike, përgjatë lumenjve apo kurrizit malor:


1. Sistemi Gramsh-Llallë-Duzhë-Tunjë-Tunjë e Re-Hoxhallar formon një aglomerim vendbanimesh me potencial zhvillimi turistik e natyror, përgjatë itinerarit malor që lidh Gramshin me Lapardhanë e Beratin.
2. Sistemi Gramsh-Mirakë-Bregas-Kushovë-Sotirë, përveçse një itinerar peizazhistik përgjatë Devollit, mundëson lidhjen e qendrës me ujëvarën e Sotirës, dhe më tej përfundon në Çorovodë.
3. Sistemi Gramsh-Harunas-Skënderbegas-Ermenj-Vidhan shtrihet në terren miks fushor e malor përgjatë lumit Devoll dhe gjithashtu lidh me distancë të shkurtër qendrën me monumentet natyrore në Skënderbegas. Për këto sisteme është e rëndësishme të përmissohet aksesit dhe të caktohen funksione plotësuese, në shërbim të zhvillimit ekonomik e turizmit.

Krahas këtyre sistemeve të lidhura direkt me qytetin e Gramshit, vendbanimet e tjera janë të lidhura në formë lineare e kanë akses në autostradë. Përgjithësisht këto sisteme lidhin me Gramshin qendrat e njësive administrative apo disa fshatra me elemente të forta kulturore/natyrore, por gjëndja e tyre e aksesit dhe shërbimeve nuk është optimale. Mund të përmendim sistemet Cerujë-Gjerovinë-Kotorr-Fushëranges-Holtë-Poroçan; Cekin-Perikë-Xhams-Tërvol; Kodovjat-Zamshe-

Kukur; Bulçar-Teragjin-Grabovë e Poshtme-Lënie, etj. Në këto fshatra duhet theksuar hierarkia e qendrave fundore, si Poroçan, Tërvol, Lënie, Kukur, etj, si dhe duhet mundësuar rehabilitimi i rrjetit rrugor e shërbimeve, në funksion të potencialeve të zonës, por pa ndërhyrë masivisht në terren.

Së fundmi, një numër i madh fshatrash nuk zhvillojnë sisteme lidhjesh, por kanë lidhje individuale, me shtigje kundrejt rrugëve dytësore. Për këto raste duhet përmirësuar aksesit drejt fshatrave më të afërt ku mund të sigurohet shërbimi bazë. Të tillë janë fshatrat Sult, Përrenjas, Marez, Plepas, Irmanj, Dulshan, Ostenth, Holtas, Burfu, Cekreze, Rashtan, Sojnik, Snosem, etj.

Figura 76 Skema e lidhjeve territoriale, nivel bashkie



Burimi: MetroPOLIS, 2017

## 19.2 Tipologjitë rurale


Bashkia Gramsh përbëhet nga 10 njësi administrative, prej të cilave 9 janë të karakterit rural, dhe Gramshi është urban. Në territorin e bashkisë shtrihen 94 fshatra, të cilat kanë marrëdhënie të ndryshme të vendbanimeve brenda tyre, si dhe tipologji të ndryshme shtrirjeje përkundrejt rrjetit



rrugor e terrenit. Sa i takon mënyrës si lidhen vendbanimet brenda të njëjtit fshat, në Gramsh evidentohen 6 tipologji kryesore:

- 1) Tipologjia qendrore: Kjo tipologji i përgjigjet fshatrave që përbëhen nga një vendbanim i vetëm, kompakt. Ky rast është mjaft i përhapur, dhe përkon me fshatra që nuk kanë presion zhvillimi dhe që shtrihen në territor kodrinoro-malor.
- 2) Tipologjia satelitore: Ky rast nënkupton që fshati përbëhet nga disa vendbanime të shpërndara, por të lidhura hierarkisht me një qendër dominante. Këto lidhje janë tregues të tendencës për rritje të fshatrave, si dhe terrenit të vështirë, i cili kufizon vazhdimësinë urbane. Sfida kryesore e zhvillimit të fshatrave me shtrirje satelitore është përforcimi i infrastrukturës lidhëse, si dhe shmangia e inefiçencës në furnizimin me shërbime bazë, si infrastrukturë ujësjellësi e kanalizimesh, shërbim menaxhimi mbetjesh, ndriçim publik, etj.
- 3) Tipologjia nukleare: Këto tipologji hasen në fshatrat me shumë vendbanime të vogla, të shpërndara në territor në mënyrë sporadike, të palidhur mirë. Pavarësisht prezencës së një qendre ku është zhvilluar fillimisht fshati, presioni i rritjes në kohë ka çuar në shpërndarjen e vendbanimeve të reja në mënyrë të pastrukturuar dhe abuzuese ndaj territorit. Kjo tipologji kërkon adaptimin e ndërhyrjeve ristrukturuese dhe mbushëse urbane, për të mos copëzuar më tej terrenin bujqësor apo natyror.
- 4) Tipologjia qendrore e shpërhapur: Ky është një rast i veçantë i tipologjisë nukleare dhe satelitore, ku dominanca e një qendre është e dukshme, por ka shumë vendbanime të palidhura, ose të lidhura dobët me të, që janë të shpërndara në territor në mënyrë sporadike.
- 5) Tipologjia e shpërhapur përfaqëson dukurinë e shtrirjes së zgjeruar hapësinore të fshatrave, pa densifikim në qendër, por në formë të njëtrajtshme, jo kompakte, në truall bujqësor (ose natyror). Problematikat e inefiçencës së përdorimit të tokës dhe ofrimit të shërbimeve kërkojnë për ndërhyrje me karakter densifikues në këto raste.
- 6) Tipologjia aglomeruese haset në vendbanime të mëdha, ku përveç qendrës ekzistojnë edhe zona të tjera urbane, të trajtës satelitore, të cilat me rritjen e presionit të zhvillimit i afrohen zonës qendrore, duke formuar një sistem të pandërprerë urban. Kjo lloj marrëdhënieje hapësinore është e përshtatshme për fshatrat në rritje, duke qenë se realizon përdorimin më eficient të tokës dhe shpërndarjen më efikase të shërbimeve

Figura 77 Tipologjitë e marrëdhënieve të vendbanimeve rurale në Bashkinë Gramsh, sipas fshatrave



Burimi: MetroPOLIS, 2017

Në Bashkinë Gramsh dallohet dominancë e dukshme e tipologjisë qendrore, ku rreth 25 fshatra kanë një qendër kompakte, e nuk janë zhvilluar më tej në mënyrë të shpërhapur. Kjo ka ndodhur për shkak të terrenit malor të vështirë, si dhe stagnacionit ekonomik e urban të vendbanimeve. Dallohen fshatra mjaft periferikë, si Cerunjë, Gjergjovinë, Bërsnik i Sipërm, Kalaj, Grabovë e Sipërme, Vidhan, Kotkë, etj. Prania e kësaj tipologjie është tregues për mungesën e presionit të rritjes në këto vendbanime, pra ndërhyrjet në to propozohet të jenë të karakterit konsolidues, ristrukturues etj, pa nxitur intensifikim apo zgjerim.

Figura 78 Shembull i tipologjisë qendrore, Kotkë



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Në kontrast me tipologjinë qendrore, tipologjia e dytë më e pranishme në Gramsh është ajo e shpërhapur, e cila dallohet në 22 fshatra. Kjo tipologji haset kryesisht në zona natyrore, e shumë më pak në toka bujqësore. Mund të përmenden fshatra të vegjël, si Gurrëz, Tërvol, Mukaj, Gjeraqinë, Bërsnik, por edhe qendra njësisht administrative, si psh. Poroçani. Në këto raste propozohet të ristrukturohen lidhjet mes vendbanimeve brenda fshatrave, si dhe të densifikohen dhe zgjerohen qendrat historike të tyre, për të krijuar hierarki dhe për të nxitur kalimin drejt tipologjisë qendrore të shpërhapur, ose aglomeruese.


Figura 79 Shembull i tipologjisë së shpërhapur, Poroçani



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Ndërkaq, në 19% të fshatrave dallohet tipologjia nukleare, me një numër vendbanimesh të palidhura mirë, dhe pa hierarki të dukshme. Edhe kjo tipologji, krahas asaj të shpërhapur, është problematike në lidhje me përdorimin e territorit dhe hierarkizimin e funksioneve brenda fshatit. Kështu, në disa fshatra, si Posnovisht, Grazhdan, Snosëm, Lënie, Grabovë e Poshtme, Pishaj, Skënderbegas, etj, është e nevojshme të propozohen ndërhyrje ristrukturuese dhe mbushje urbane, për të realizuar qendërsi dhe akomoduar shërbime publike.

Figura 80 Shembull i tipologjisë nukleare, Grabovë e Poshtme




Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Tipologjitë satelitore dhe aglomeruese gjenden në një numër të madh fshatrash, si qendra njësisht, ashtu edhe vendbanime me shtrirje më të gjerë, apo fshatra të vegjël. Tipologjia satelitore haset në fshatrat Ostenth, Drizë, Sotirë, Mazrek, Prrenjas, etj. Këto raste kanë një qendër dominuese, dhe një ose disa qendra të tjera kompakte satelitore. Ndërhyrja që propozohet për këto tipologji është përmirësimi i lidhjes mes “qendrës” e satelitëve dhe zgjerimi i moderuar i nukleve, duke prioritarizuar densifikimin.

Rastet e aglomerimeve u takojnë fshatrave më të mëdhenj, si Kushovë, Kodovjat, Trashovicë, etj, por gjenden edhe në fshatra më të vegjël, si Cekin, Duzh, Lubinjë, etj. Zakonisht kjo tipologji gjendet në afërsi të qytetit të Gramshit e në zona më fushore, në brigjet e lumit Devoll. Ndërhyrjet e propozuara për këto vendbanime janë mbushja urbane e zgjatimeve aglomeruese të qendrës, si dhe ruajtja e strukturës ekzistuese të fshatit.

Figura 81 Shembull i tipologjisë aglomeruese, Kushovë



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Së fundmi, më pak e përhapur është tipologjia qëndrore e shpërhapur. Disa fshatra ku dallohet kjo tipologji janë Kukuri, Tunja, Kabashi, etj. Në këto raste, në ndryshim nga tipologjia nukleare, ku nuk ka tendenca zgjerimi, është e rëndësishme të realizohet konsolidimi i zonave, sigurimi i qendrave të shërbimeve, si dhe lidhja me rrugë lokale e vendbanimeve ekzistuese, pa nxitur shpërhapje të mëtejshme.


Figura 82 Shembull i tipologjisë qendrore të shpërhapur, Tunjë



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Ndërkaq, studimi i rrjetit rrugor në brendësi të vendbanimeve rurale tregon se rreth 36% e fshatrave në Bashkinë Gramsh kanë sistem organik shtrirjeje. Kjo do të thotë që vendbanimet ndjekin kryesisht format e terrenit, shtratin e lumenjve, etj, dhe nuk ka tendenca për rregullsi të brendshme në organizim urban.

Figura 83 Tipologjia e shtrirjes rrugore të vendbanimeve rurale



Burimi: Metropolis, 2017

Tipologjia rrugore organike nuk siguron akses optimal në gjithë territorin e fshatrave. Të gjithë njësitë administrative, qofshin ato më fushore apo thellësisht malore, e kanë tipologjinë rrugore organike mbizotëruese, jo vetëm në fshatrat e largët, por shpesh edhe në qendrat e tyre. Disa vendbanime rurale me shtrirje organike janë: Sult, Lënie, Poroçan, Skënderbegas, Bicaj, Bërsnik, Grabovë e Poshtme, Grekan, Dufshan, etj.

Figura 84 Tipologjia organike, Sult



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Gjithashtu, sistemi i tarracuar është mjaft i përhapur dhe dallohet në rastet kur vendbanimet shtrihen në disnivele të dukshme, dhe aksesohen nëpërmjet tarracave, me shkallë apo rampa. Këto vendbanime kanë vështirësi në sigurim shërbimesh, por përbëjnë vlerë peisazhiste të veçantë, e cila duhet të kultivohet. Disa fshatra me këtë lloj shtrirje janë: Tërvol, Rashtan, Holtas, Plepas, Posnovisht, Kukur, etj.

Figura 85 Tipologji e tarracuar, Posnovisht



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Tipologjia lineare dhe lineare e degëzuar gjendet në rreth 40% të vendbanimeve rurale, kryesisht në fshatrat që shtrihen përgjatë rrugëve interurbane kryesore. Fshatra të tillë, si Fshat Gramsh, Galigat, Ermenj, Grabovë e Sipërme, etj. kanë tipologji lineare, ku vendbanimi kryesor shtrihet linearisht përgjatë rrugës. Ndërkaq, në fshatrat me tipologji të degëzuar, si Kabash, Dushk, Bregas, Snosëm, Kushovë, Kodovjat, etj, krahas aksit kryesor, vendbanimi shtrihet edhe përgjatë degëzimeve të tij, duke formuar një trajtë më të konsoliduar. Në këto raste zona urbane është më e përkufizuar, gjithsesi në varësi të shtrirjes gjatësore, mund të ketë probleme në hierarkizim, caktim të një qendre funksionale për fshatin, si dhe ofrim të shërbimeve bazë. Në rastin e tipologjive lineare, është e rëndësishme të përcaktohet një kufi se deri ku do shtrihet vendbanimi, e më pas mund të përforcohen lidhjet me degëzime apo sistem rrjet, kur e lejon terreni. Tipologjitë e degëzuara kanë mundësi të adaptohen në tipologji rrjeti, duke mundësuar akses më të mirë dhe mundësi për të rritur densitetin, sidomos në qendrat e njësive administrative.


Figura 86 Tipologjitë lineare (Fushë Gramsh) dhe lineare e degëzuar (Kodovjat)



Burimi: MetroPOLIS dhe ASIG, 2017

Së fundmi, tipologjitë rrjet, ku niveli i ndërhyrjes në strukturën urbane të vendbanimeve është më i lartë, janë shumë pak të pranishme në territor. Tipologjia rrjet dallohet në shumë pak fshatra dhe i përket rrjeteve të çrregullta, të formuara në mënyrë spontane e jo të planifikuara.

Figura 87 Kombinimet e shtrirjes hapësinore dhe marrëdhënies mes vendbanimeve, nivel fshati



Burimi: MetroPOLIS, 2017

Analiza e vendbanimeve rurale, sa i takon strukturave të vendbanimeve dhe tipologjive të shtrirjes ndaj rrugës na jep një pasqyrë të mirë se si mund të ndërhyhet në këto fshatra, për të optimizuar potencialet që sjell morfologjia territoriale. Nëse analizohet si vendosen këto dy kritere ndaj njëra-tjetrës, vërehet që kombinimi më i përhapur është tipologjia e shpërhapur me strukturë rrugore organike, si dhe tipologjia e shpërhapur me strukturë rrugore të tarracuar. Kjo thekson karakterin malor ku shtrihen pjesa më e madhe e vendbanimeve.

Ndërkaq, tipologjitë aglomeruese kanë përgjithësisht rrjet rrugor linear të degëzuar ose linear. Ndërhyrjet në to duhet të jenë rristrukturuese e densifikuese, duke promovuar rrjetet drejtkëndore. Kombinimet e tjera mes llojit të strukturës e shtrirjes rrugore janë pothuajse të ekuilibruara, ku tipologjitë qendrore kanë rrjet rrugor linear, të tarracuar apo organik; tipologjitë nukleare kanë rrjet organik ose të tarracuar, e ato satelitore rrjet organik ose linear të degëzuar.

### 19.3 Tipologjitë në nivel zone

Për Bashkinë Gramsh është realizuar ndarja e zonave tipologjike sipas kritereve të njëtrajtshmërisë të përcaktuara në Rregulloren e Planifikimit, kombinuar me kritere të densitetit, funksionit



predominues, dhe shkallës së miksimit të tipologjive ndërtimore. Nisur nga këto kritere, klasifikimi i zonave tipologjike për Bashkinë Gramsh është bërë si më poshtë:

- Ndërtesa gjatësore me densitet të lartë (GjLa)
- Ndërtesa gjatësore me densitet të mesëm (GjMe)
- Ndërtesa gjatësore me densitet të ulët (GjUl)
- Ndërtesa gjatësore miks me zonë vilash/kullash (GjViKu)
- Ndërtesa gjatësore miks me vila (GjVi)
- Ndërtesa gjatësore miks me kulla (GjKu)
- Ndërtesa me kulla, densitet i mesëm (KuMe)
- Ndërtesa me kulla, miks me vila (KuVi)
- Vila miks me kulla, densitet i mesëm (ViKu)
- Vila miks me tipologji gjatësore (ViGj)
- Vila miks me tipologji gjatësore dhe kullash (ViGjKu)
- Vila me densitet të lartë (ViLa)
- Vila me densitet të mesme (ViMe)
- Vila me densitet të ulët (ViUl)
- Vila me densitet shumë të ulët (ViShUl)
- Vila me densitet shumë të ulët në tokë bujqësore/natyrore (ViShUIB/ViShUIN)
- Zona jo banim, si institucione (Is); zona industriale e ekonomike (EI), shërbime bujqësore (SB), Shërbimë (Sh), Hapësira publike e gjelbërim (HPGj), etj.

Nga pikëpamja ndërtimore, tipologjitë më të përhapura në Bashkinë Gramsh janë vilat me densitet të mesëm, të cilat zënë rreth 38 % të territorit të ndërtuar. Këto zona dallohen në qendrat e pjesës më të madhe të fshatrave, dhe përfaqësohen nga banesat individuale të tipit dubleks, ose banesa individuale 2-3 katëshe. Në këto zona realizohen intensitete deri  $0.5 \text{ m}^2/\text{m}^2$  dhe Ksht varjon 15-20%. Madhësia mesatare e parcelës është  $500\text{-}1000\text{m}^2$ , por në disa raste mund të jetë më e vogël. Ndërhyrjet në këto zona duhet të jenë në funksion të intensifikimit dhe ristrukturimit, për të ofruar hapësirat dhe strukturat publike që nevojiten.

Ndërkaq, dominojnë gjithashtu tipologjitë e vilave me densitet të ulët, në 35% të sipërfaqes së banuar. Kjo tipologji i takon zonave në afërsi të qendrave të fshatrave të mëdhenj, ose zgjerimit periferik të tyre. Mesatarisht, në këto zona dallohen intensitete bruto 0.1- 0.25, e Ksht 10-15%. Madhësia mesatare e parcelës është  $500\text{-}3000 \text{ m}^2$ , duke qenë se i përkasin zonave ish-bujqësore të ndërtuara.


Tipologjitë me densitet të lartë janë më pak të përhapura, e dallohen në qytetin e Gramshit dhe në qendrat e disa fshatrave të mëdhenj. Këto zona janë tregues të tendencave të rritjes së vendbanimeve, dhe duhen patur parasysh në propozimet e ndërhyrjeve për intensifikim e mbushje urbane. Zonat me vila me densitet të lartë kanë intensitet bruto më të vogël se 1 dhe më të madh se 0.5. Ksht varjon 20-30% dhe madhësia mesatare e parcelës është  $250\text{-}500\text{m}^2$ .

Tipologjia e vilave me densitet shumë të ulët është gjithashtu e përhapur në fshatra më periferikë. Në këto zona intensiteti bruto varion  $0.005\text{-}0.1$ . Ksht në këto zona përgjithësisht ka vlerë më të ulët se 5%, por mund të arrijë deri 10%. Madhësia mesatare e parcelës varion  $2000\text{-}5000 \text{ m}^2$ . Këto

tipologji u përkasin vendbanimeve të shpërhapura apo nukleare, e në mënyrat e ndërhyrjes duhet të konsolidohet e konservohet toka bujqësore, pa nxitur densifikim të mëtejshëm.


Tipologjitë e tjera të vilave, në tokë bujqësore apo natyrore, nuk janë shumë të pranishme në territor. Këto gjenden në tokë natyrore e bujqësore të shkëputur komplet nga vendbanimet dhe u përgjigjen treguesve shumë të ulët të zhvillimit. Edhe në këtë rast këto zona duhet të kufizohen e të mos lejohet shtimi i tyre apo zgjerimi në territor.

Figura 88 Shpërndarja e tipologjive hapësinore në Bashkinë Gramsh, sipas sipërfaqes



Burimi: Metropolis, 2017


Figura 89 Zonimi sipas tipologjisë ndërtimore, Bashkia Gramsh



Burimi: Metropolis, 2017

Krahas tipologjive ndërtimore, analiza e zonimit ka marrë parasysh edhe strukturën rrugore e të hapësirave për gjithë territorin e bashkisë. Rezultatet e këtij zonimi përputhen me karakterin hapësinor të fshatrave, të shpjguara në pikën më sipër.

Figura 90 Shpërndarja e tipologjive të strukturës rrugore në Bashkinë Gramsh, sipas sipërfaqeve



Burimi: MetroPOLIS, 2017


Kështu, në Bashkinë Gramsh mbi 50% e zonave tipologjike kanë një rrjet rrugor organik. Kjo do të thotë që sistemi rrugor i përgjigjet terrenit dhe ndërtesat vendosen në mënyrë sporadike. Në këtë kategori janë përfshirë edhe sistemet rrugore të tarracuara.

Ndërkaq, tipologjia lineare zë rreth 22% të njësive tipologjike, pra tendenca e zhvillimit përgjatë një rruge është e evidente në territor. Këto zona propozohet të prioritarizohen për rritje densiteti dhe diversifikim shërbimesh.


Mjaft të përhapura janë edhe tipologjitë nukleare. Këto i përkasin zonave me vila që janë të distancuara nga rrugët kryesore e në to aksesohet vetëm me rrugë të dedikuara. Shpesh zona të tilla u përkasin fshatrave të tërë. Kështu, është e rëndësishme që tipologjitë nukleare të plotësohen me shërbime e akses të cilësisë së mirë.

Ndërkaq, dallohen edhe mjaft tipologji rrjet. Pavarësisht se rrjetet rrugore drejtkëndore e të planifikuara gjenden vetëm në qytet, rrjetet e çrregullta hasen në 11% të zonave tipologjike. Në këto zona propozohet të nxitet densifikimi dhe shtimi i shërbimeve e hapësirave publike, për shkak të aksesit të lehtë në to.

Figura 91 Zonimi tipologjik sipas strukturës rrugore, nivel bashkie



**STRUKTURA E RRJETIT RRUGOR**




Burimi: MetroPOLIS, 2017

Në nivel qyteti miksimi i tipologjive është shumë i theksuar, duke kaluar nga zona qendrore me predominancë ndërtesash gjatësore, me strukturë të planifikuar, homogjene, dhe densitet të mesëm si dhe të ulët, e deri në periferinë me ndërthurje zonash vilash të densitetit të lartë, të mesëm, të ulët dhe shumë të ulët. Qendra administrative arrin të krijojë një qendërsi të dukshme të qytet, dhe është e rrethuar nga pjesë me miksim të theksuar tipologjish, me densitet të mesëm. Marrëdhënia

e zonave të banimit me zonat periferike të shërbimeve është relativisht problematike, për shkak të afërsisë së madhe dhe mungesës së brezave të mirëfilltë mbrojtës.

Figura 92 Zonimi sipas tipologjisë ndërtimore, Gramsh qendër




Burimi: MetroPOLIS, 2017

Në bazë të shpërndarjes së tipologjive, mund të bëhet një parashikim i rritjes së ardhshme spontane të qytetit. Së pari, mund të ndodhë rritja në sipërfaqen kodrinore lindore, me vila me densitet të ulët. Kjo nuk rekomandohet, për shkak të nevojës për infrastrukturë rrugore dhe pranisë së terrenit natyror. Së dyti, rritja mund të ndodhë në zonën bujqësore në perëndim të qytetit. Këto tendenca janë në fillimet e tyre, por nuk duhen nxitur, për shkak të mungesës së zonës ripariane të lumit Devoll dhe sipërfaqes së madhe bujqësore. Së treti, mund të ndodhë rritja në zonat me vila me densitet të lartë përreth qendrës. Këto zona kanë akses të mirë dhe mund të nxitet mbushja urbane e densifikimi deri në përmbushje të kapacitetit të tyre mbajtës. Së katërti, densifikimi i qendrës aktuale mund të jetë një tjetër drejtim rritjeje, por duke marrë në konsideratë tipologjinë homogjene dhe hapësirat publike cilësore, ka më tepër vlerë të ruhen në treguesit aktualë të ndryshimit. Së fundmi, drejtimet lineare të hyrjes e daljes në qytet mund të jenë zona potenciale rritjeje, në zonat me vila me densitet të mesëm në pjesën jugore si dhe në terrenin bujqësor në afërsi me të, ku tashmë ka tendenca zhvillimi nuklear. Vlejnë për t'u marrë në konsideratë zonat ekonomike në

veri e jug të qytetit, të cilat duhet të ristrukturohen e rigjenerohen, si dhe të shoqërohen me zonat respektive buferike.

Figura 93 Zonimi tipologjik sipas strukturës së rrjetit rrugor



Burimi: MetroPOLIS, 2017

Ndërkaq, rrjeti rrugor e struktura e hapësirave jep një pasqyrë të mirë të qytetit, ku mbi 60% e sipërfaqes është e shërbyer me rrjet drejtkëndor, apo rrjet të çrregullt. Këto zona përputhen me zonat e tipologjive gjatësore apo kullë, e zonave të institucioneve, të zhvilluara në mënyrë të planifikuar. Këto zona propozohet të rigjenerohen dhe të pësojnë ristrukturime të vogla, për të akomoduar hapësira publike të reja. Pjesa më e madhe e periferisë ka sistem rrugor linear, në zgjatimet jugore, e organik në pjesën kodrinore lindore. Sistemi linear përcakton drejtime të ardhshme zhvillimi, por duhet plotësohet me rrjet që i shërben brendësisë së zonave të banuara, në trajtë rrjeti drejtkëndor apo të degëzuar. Ndërkaq, zonat me tipologji organike propozohet të ristrukturohen e të mirëmbahen, duke formuar tarraca për fushëpamje optimale. Të tilla janë zonat me sistem të tarracuar në pjesën lindore të qytetit, të cilat propozohet t'i nënshtrohen ndërhyrjeve rigjeneruese e ristrukturuese.

## 19.4 Përfundime

Në nivel territorial, bashkia Gramsh nuk ka lidhshmëri të mirë, për shkak të infrastrukturës problematike dhe terrenit të vështirë. Shumë qendra njësisish administrative dhe fshatra me potencial për zhvillim turizmi e ekonomik janë të lidhur dobët me qendrën e njëri tjetrin.

3 sisteme kryesore lineare duhet të ristrukturohen, duke zhvilluar shërbime plotësuese mes fshatrave: Gramsh-Llallë-Duzhë-Tunjë-Tunjë e Re-Hoxhallar; Gramsh-Mirakë-Bregas-Kushovë-Sotirë; dhe Gramsh-Harunas-Skënderbegas-Ermenj-Vidhan.

Shumë fshatra janë të shpërndarë në mënyrë nukleare në territor dhe formojnë lidhje vetëm me rrugë dytësore. Këto lidhje duhet të përforcohen drejt qendrave më të afërta ku mund të merren shërbimet.

Sa i takon marrëdhënies mes vendbanimeve në nivel fshati, pjesa dominuese e fshatrave kanë tipologji qëndrore, ndjekur nga tipologjitë e shpërhapura dhe nukleare. Fshatrat me tipologji qëndrore propozohet t'i nënshtrohen ndërhyrjeve ristrukturoese dhe konsoliduese, pa nxitur intensifikim. Tipologjitë e shpërhapura kërkohet të densifikohen në mënyrë hierarkike, duke formuar qendra të dukshme dhe lidhje të mirë të vendbanimeve me to. Tipologjia nukleare i takon fshatrave periferike, ku është e nevojshme të zhvillohet bashkimi dhe hierakrizimi i nukleve, duke kaluar në trajtë aglomerimi.

Lidhja hapësinore e fshatrave bëhet kryesisht në mënyrë organike (36%), pra vendbanimet shtrihen duke ndjekur format e terrenit. Një pjesë e konsiderueshme fshatrash kanë strukturë të tarracuar, e cila përbën një potencial peizazhistik që duhet ruajtur. Ndërkaq, mbi 30% e fshatrave kanë tipologji lineare të degëzuar ose lineare. Në këto raste propozohet të caktohet një kufi i shtrirjes sipas modelit 'korridor', e të vendosen degëzime për kompaktësim, apo tipologji rrjet, aty ku e lejon territori.

Në bazë të zonimit të tipologjive ndërtimore, pjesa më e madhe e zonave në bashki kanë tipologji vilash me densitet të mesëm. Këto zona janë kryesisht qendrat e fshatrave e mund t'i nënshtrohen densifikimit apo ristrukturimit. Së dyti, mjaft të përhapura janë tipologjitë e vilave me densitet të ulët. Këto zona duhet t'i nënshtrohen konservimit, pa nxitur densifikim.

Në nivel qyteti, dallohen tipologji mjaft të larmishme, por homogjene, të ndërtesave gjatësore të densitetit të mesëm, të ulët, e të zonave të kullave të densitetit të mesëm e të ulët, krahas zonave të vilave. Është e nevojshme që këto tipologji të ruhen, duke shmangur miksimet urbane, sidomos sa i takon diferencave në lartësi dhe zënies së hapësirave të lira.

Gjithashtu, duhet trajtuar me kujdes zona bujqësore me tendenca zhvillimi vilash, në pjesën përfundimtare të qytetit, si dhe zona kodrinore përfundimtare, ku po zhvillohen vila me densitet të ulët. Këto, së bashku me shtrirjen lineare jugore, mund të jenë zonat e presionit të zhvillimit në qytet.

Qyteti ka një rrjet rrugor pothuajse tërësisht të rregullt, ku kombinohet tipologjia rrjet drejtkëndor dhe rrjet i çrregullt (në zonat e projektuara në periudhën komuniste), me tipologjinë lineare përgjatë rrugës kryesore, e atë lineare të degëzuar e organike në zonat periferike kodrinore. Vlen për të mirëmbajtur struktura ekzistuese, të plotësohet në formë rrjeti në pjesën jugore e lindore të qytetit, si dhe të trajtohet në mënyrë peizazhistike zona lindore, me sistem rrugor të tarracuar.




## 20. Metabolizmi i territorit

Analiza e Metabolizmit trajton flukset në territor/qytet urban. Sipas Nenit 2 të VKM nr. 671 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, metabolizmi I territorit është një model që përdoret për identifikimin dhe analizën e flukseve të materialeve dhe energjisë brenda territoreve të caktuara. Ky model u ofron studiuesve një kuadër nëpërmjet të cilit të studiojnë ndërveprimet e sistemeve natyrore dhe njerëzore në rajone të caktuara. Flukset e analizuar janë: fluksi i **energjisë**, fluksi i **ujit**, fluksi i **ushqimit** dhe fluksi i **mbetjeve**. Flukset analizohen nëpërmjet identifikimit të hyrjeve dhe daljeve për secilin fluks që merret në analizim. Hyrjet dhe daljet e secilit fluks krijojnë një tablo të plotë të mënyrës së funksionimit të territorit, duke evidentuar potencialet dhe burimet që e bëjnë territorin të funksionojë si një i tërë. **Fluksi i energjisë dhe fluksi i ujit do të analizohen si fillim në nivel rajoni dhe më pas në nivel bashkie**. Burimet e energjisë kanë ndikim dhe menaxhohen në rang kombëtar, pavarësisht territorit ku ndodhen. Uji që gjendet në sistemin urban (uji që analizon fluksi i ujit), vjen nëpërmjet burimeve nëntokësore (që nuk i përkasin territorit të një bashkie nga ana administrative) apo burimeve sipërfaqësore, duke kaluar në disa sisteme të ndryshme urbane. Në këtë rast, kur kalon në sisteme të ndryshme urbane (rasti i lumenjve), sjell me vete edhe ndotje që merr gjatë rrugës. Burimet ujore, menaxhohen në nivel baseni ujëmbledhës dhe në nivel kombëtar.

### 20.1 Energjia në Rajon

Rajon që përbëhet nga bashkitë: Rrogozhinë, Divjakë, Fier, Lushnje, Peqin, Belsh, Cërrik, Patos, Mallakastër, Ura Vajguore, Kuçovë, Berat, Gramsh, Elbasan, Përrenjas, Librazhd, Pogradec<sup>266</sup>, ka burime të shumta energjie. Pjesa kryesore e energjisë që përftohet nga hidrokarburet në Shqipëri është e përqendruar në këtë zonë. Kompanitë që operojnë në këtë territor për nxjerrjen e naftës janë: *Bankers Petroleum* (Patos-Marinëz), *TransAtlantic* (Ballsh, Cakran, Gorisht, Delvinë), *SherWood* (Kuçovë), *Transoilgroup* (Visokë); *Phoenix* (Amonicë). Energjia e hidrokarbureve zë një pjesë të rëndësishme. Po ashtu, energjia hidrike vazhdon të mbetet një nga burimet kryesore të energjisë. Lumenj si **Shkumbini, Osumi, Devolli** përdoren për prodhimin e energjisë hidrike nëpërmjet hidrocentraleve të instaluar dhe atyre që po ndërtohen. Energjia hidrike, vazhdon të mbetet burim kryesor energjie për konsumatorët familjarë, por edhe për bizneset industritë apo institucionet. Burimet alternative të energjisë si dielli, era, energjia gjeotermale shfrytëzohen shumë pak. Potencialet që kanë për t’u përdorur këto energji janë të mëdha. Energjia e erës ka potencial të përdoret në ultësirën perëndimore, Divjaka, Rrogozhina dhe Fieri (zona veriperëndimore) mund të përdoret për prodhimin e energjisë. I gjithë territori i Bashkisë Gramsh ka erëra me shpejtësi që variojnë nga 2.1-2.5m/s<sup>267</sup>. Pra shpejtësia e tyre nuk është e madhe. Energjia diellore është potencial thuajse në të gjithë pjesën perëndimore të Shqipërisë. Rrezatimi arrin vlera nga 1,450 kWh/m<sup>2</sup> deri në 1,650 kWh/m<sup>2</sup><sup>268</sup>. Numri i lartë i ditëve me diell është i favorshëm për prodhimin e energjisë diellore. Energjia gjeotermale mund të shfrytëzohet nëpërmjet burimeve gjeotermale. Në Gramsh gjenden edhe burime geotermale, temperatura e të cilëve arrin >80 °C. Përdorimi i kësaj energjie përveç efekteve pozitive, ka ndikim në mjedis dhe ekosistem, por nëse përdoren teknologjitë e duhura këto pasoja janë minimale. Nga përdorimi i energjisë gjeotermale efektet më të shpeshta negative janë ndotja e ajrit (nga gazërat që çlirohen) dhe ndotja e tokës.

Figura 94 Energjia në Rajon




**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

## 20.2 Uji në Rajon

Rajoni është i pasur me ujëra nëntokësore dhe sipërfaqësore. Ky territor përshkohet nga lumenj të rëndësishëm si Shkumbini, Seman, Devolli, Osumi, Vjosa dhe lumenjë më të vegjël. Pasuritë e mëdha ujore bëjnë që shfrytëzimi i tyre të jetë i lartë, në këtë zonë janë propozuar të ndërtohen pjesa më e madhe e HEC-eve. Shtresat nëntokësore ujëmbajtëse, akuifere ndërkokrrizore me përcjellshmëri të lartë uji, të cilat dallohen për një cilësi të lartë të ujërave nëntokësore, gjenden kryesisht në pjesën verilindore të këtij territori. Këto shtresa shfrytëzohen nëpërmjet burimeve për ujë të pijshëm apo përdorime të tjera. Shtresat nëntokësore, akuifere me porozitet karst-çarje dhe përcjellshmëri uji shumë të ndryshueshme shumë të lartë e të lartë, gjenden në zona të zhvilluara si qyteti i Elbasanit, Gramshit, qyteti i Kuçovës (zona urbane) dhe në pjesën jugperëndimore të Bashkisë Fier. Këto shtresa nëntokësore janë çënuara nga ndotja. Puset e përqendruara kryesisht në akuiferet karst-çarje ndikojnë në përcimin e ndotjes në shtresat nëntokësore.

Figura 95 Figura Uji në Rajon



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017


## 20.3 Analiza e Metabolizmit në Bashkinë Gramsh

Analiza e metabolizmit të territorit në Bashkinë e Gramshit merr në konsideratë disa faktorë kryesorë, që ndikojnë në flukset e energjisë, ujit, ushqimit dhe mbetjeve. Gramshi ka një sipërfaqe prej 692 km<sup>2</sup> dhe popullsi 36,305 banorë<sup>269</sup>. Flukset e analizuar në kuadër të analizës së metabolizmit janë: energjia, uji, ushqimi dhe mbetjet. Analizimi për secilën rrymë ndjek të njëjtën metodologji në parim, por për shkak të mungesës së informacioneve të caktuara, analiza pëson modifikime nga fluksi në fluks. Për të analizuar flukset janë vëzhguar hyrjet dhe daljet për secilin fluks, me qëllim të kuptuarin e problemeve mjedisore dhe humbjeve.

### 20.3.1 Fluksi i Energjisë

Fluksi i energjisë tregon sasinë e prodhuar dhe konsumin e energjisë në territorin e Bashkisë Gramsh. Ky fluks tregon edhe për energjinë potenciale që mund të përdoret, duke minimizuar në këtë mënyrë disa burime energjie të cilat kanë konsum më të lartë e janë të mbishfrytëzuara.

Figura 96 Fluksi i Energjisë në Bashkinë Gramsh



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

*Potencialet energjetike dhe prodhimi i energjisë në territorin e Bashkisë Gramsh:* Territori i Gramshit shtrihet në një zonë me pasuri ujore, sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për këtë arsye ka dhe një shfrytëzim të konsiderueshëm të ujërave të lumenjve për prodhimin e energjisë hidrike. Gjithashtu, parashikohet që mbi Lumin Devoll të ndërtohen hidrocentrale të vegjël (>1MW) dhe hidrocentrale të mëdhenj (<50MW), që do të rrisin më shumë nivelin e shfrytëzimit të ujërave sipërfaqësore. Por prodhimi i energjisë nuk duhet kufizuar vetëm në energji hidrike, sepse ka potencial për t'u mbështetur edhe në energji të tjera alternative. Gramshi ka potencial për të prodhuar edhe energji gjeotermale, pasi në territorin e kësaj bashkie gjenden burimi termal i Përroit të Holtës me temperature 24 °C. Territori i Gramshit është pjesë e zonës gjeotermale Kruja, e cila shtrihet në rreth 180km dhe ka një gjerësi 4-5 km. Shqipëria ka një rrezatim diellor të konsiderueshëm për t'u përdorur si burim energjie. Gramshi ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kE/m<sup>2</sup> në vit. Shpërndarja e mesatares ditore për rrezatimin global në stacionin meteorologjik të qarkut luhatet nga 1,615 në muaj (dhjetor) deri në 6,520 në muaj (korrik)<sup>270</sup>. Gjatë gjithë vitit ka afërsisht 3000-4000 orë me diell<sup>271</sup>. Energjia diellore shfrytëzohet në nivel kombëtar 0.1% dhe shfrytëzohet për prodhimi e ujit të ngrohtë sanitar dhe në mënyrë individuale me panele fotovoltaike<sup>272</sup>. Konsumi i energjisë dhe lloji i energjisë së përdorur për ngrohje: Energjia elektrike është një nga burimet primare të energjisë në Shqipëri. Për të llogaritur konsumin e energjisë për familje/vit jemi mbështetur mbi të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid). Duke iu referuar numrit të banorëve që gjenden për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh<sup>273</sup> dhe duke marrë parasysh që konsumi total i energjisë elektrike në Shqipëri për vitin 2011, është 2,587,907 MËh, mund të llogarisim sa energji elektrike konsumon mesatarisht një familje në vit. Për vitin 2011, sipas INSTAT, numri mesatar i personave në një familje është 4 anëtarë. Numri i Njërive

Ekonomike Familjare është **722, 600 familje**. Konsumi mesatar i energjisë elektrike për familje në një vit është: Konsumi i energjisë elektrike nga familjet (**2,587,535**)/nr. e familjeve (**722, 600**) = Energjia elektrike që konsumon një familje për një vit (3.6 MËh). Për të gjeneruar energjinë e konsumuar për çdo km<sup>2</sup>, shumëzohet nr. e familjeve në atë sipërfaqe me vlerën mesatare vjetore të konsumit të energjisë elektrike. Një sasi e konsiderueshme e energjisë së konsumuar shkon për ngrohje. Sipas të dhënave të INSTAT, burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje në nivel Qarku, nga njësi ekonomike familjare (NjEF), vazhdon të jetë energjia e përfutur nga drutë e zjarrit. 77% të NjEF-ve në Qarkun Elbasan përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, ndjekur nga gazi (13%) dhe më pas nga energjia elektrike (7%)<sup>274</sup>.

Tabela 111 Rezultatet e Censurit të Popullsisë dhe Banesave 2011

Popullsia banuese gjithsej	2,821,977
Popullsia banuese gjithsej e numëruar	2,800,138
Numri gjithsej i Njësive Ekonomike Familjare	722,600

Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

Tabela 112 Njësitë Ekonomike Familjare sipas llojit kryesor të energjisë së përdorur për ngrohjen e zonës urbane dhe rurale

Lloji kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje	Zona urbane dhe rurale		
	Gjithsej	Urbane	Rurale
Gjithsej	38,493	19,023	19,470
Dru	23,655	6,824	16,831
Energji elektrike nga rrjeti	3,183	2,918	265
Gaz	9,016	7,146	1,870
Lloj tjetër energjie (panel diellor, qymyr, naftë, etj.)	110	69	41
Pa ngrohje	2,529	2,066	463


Burimi: INSTAT, 2011 (Censusi)

### 20.3.2 Fluksi i ujit

Fluksi i ujit tregon për bilancin e prodhimit të ujit nga burime sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Bashkisë Gramsh dhe sasinë e konsumit të tij. Uji përdoret për qëllime teknologjike, për pirje, *imbotilim (uji i mbushur në shishe)*, dhe përdoret nga banorët, bizneset, industrinë, institucionet etj. Për të bërë një llogaritje të përafërt të sasisë së ujit që ndodhet në organizmin urban (në këtë rast, territorin e Bashkisë Gramsh) mund të marrim sasinë totale të ujërave në territor (burime sipërfaqësore dhe nëntokësore) dhe sasinë e përdorimit të ujërave. Sasia ujërave nëntokësore llogaritet nga burimet që shfrytëzohen në territor<sup>275</sup>. Qyteti, zona industriale, zona ekonomike dhe tokat bujqësore, ku ndodhin zhvillimet më të mëdha shtrihen mbi shtresa nëntokësore ujëmbajtëse. Ujërat sipërfaqësore zënë një sipërfaqe prej 36.6 km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Në ujërat sipërfaqësore të Gramshit bënë pjesë lumi Devoll dhe degë

të tij si: Përroi i Tomorricës, i Holtës, i Verrcës dhe Përroi i Grabovës. Në pasuritë ujore të Bashkisë vend të rëndësishëm zënë dhe liqenet, si: Liqeni i Zi, Liqeni i Dushkut.

Figura 97 Fluksi i Ujit në Bashkinë Gramsh



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017


Qyteti dhe zona industrial (zona ish-industriale) shtrihen përgjatë luginës së Devollit dhe pjesa më e madhe e tyre është e përqëndrar në qytetin e Gramshit. Territori i Gramshit është i pasur me ujëra nëntokësore. Qyteti i Gramshit, zonat ekonomike dhe industrial shtrihen mbi akuiferë me porozitet ndërkokrrizore dhe përcjellshmëri uji shumë të lartë - të lartë. Burimet e ujërave nëntokësore ndodhen kryesisht në këto shtresa nëntokësore. Edhe shpimet janë bërë në këto shtresa. Për të kuptuar përdorimin e ujit nga qytetarët dhe bizneset, i referohemi studimit të sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujërave të zeza. Nga të dhënat e marra nga ndërmarrja e ujësjellës - kanalizimeve, Bashkia Gramsh ka mbulim të pjesshëm të shërbimit të ujësjellësit. Në Njësinë Administrative Pishaj, rrjeti i kanalizimeve ekziston në Fshatin Cekin (50%), Cerujë, Qerret, Pishaj (30%) dhe Shemrizë (20%). Në Njësinë Administrative Kodovjat rrjeti mbulon rreth 30% të sipërfaqes dhe ekziston vetëm në fshatrat Kodovjat dhe Bersnik. Pjesa tjetër e fshatrave të komunes përdor ose gropa septike ose shkarkon direkt në Lumin Devoll. Njësitë e tjera Administrative (Kushovë, Skënderbegas, Sult dhe Lenie) janë me gropa septike, të cilat janë kolektive ose individuale. Rrjeti kryesor i ujësjellësit shtrihet përgjatë luginës së Devollit nga burimi i Kërpicës në Gramsh. Ndonëse të gjitha njësitë administrative iu ofrohet shërbimi i ujësjellësit, mbeten ende disa fshatra të cilët nuk mbulohen nga ky shërbimin. Në zonat që nuk ofrohet ky shërbim, banorët e sigurojnë ujin nëpërmjet puseve individuale, burimeve ose krojeve malore. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Gramsh, shfrytëzon pellgjet ujëmbajtëse nëntokësore përgjatë lumit Devoll. Për të llogaritur konsumin e ujit të pijshëm në nivel bashkie jemi mbështetur në të dhënat UK Gramsh dhe në të dhënat e INSTAT, Censusi 2011 (Grid) për

popullsinë, numrin e banorëve për çdo km<sup>2</sup> në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Konsumi mesatar ditorë i ujit të pijshëm për konsumatorët familjarë (banorë) është 100 litra/banorë/ditë.

### 20.3.3 Fluksi i ushqimit

Fluksi i ushqimit analizon të dhënat për importin, prodhimin, përpunimin, konsumin, humbjen dhe eksportin e ushqimeve. Për sa i përket fluksit të ushqimit në Bashkinë Gramsh, analizojmë të dhënat bujqësore dhe blegtorale, që prodhohen në territor, pasi zënë një peshë kryesore në fluksin e ushqimit. Importet realizohen në nivel kombëtar dhe nuk ka shifra të sakta për përthithjen e tyre në nivel vendor. Të dhënat për përthithjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale janë në nivel qarku.

Figura 98 Fluksi i ushqimit në Bashkinë Gramsh



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017


Në këtë rast për të llogaritur fluksin e ushqimit mund të fokusohemi më tepër në të dhënat mbi produktet bujqësore dhe blegtorale si dhe infrastrukturën ndihmëse, siç janë pikat e grumbullimit dhe të përpunimit të këtyre produkteve, sasinë e produkteve që shkon në treg dhe sasinë e produkteve që shkon për eksport. Sipas të dhënave të Bashkisë Gramsh, në territorin e kësaj bashkie prodhohen produkte bujqësore (kryesisht drufrutorë) dhe blegtorale që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Toka bujqësore në Bashkinë Gramsh zë një sipërfaqe prej 10,142 ha, ndërsa zona natyrore dhe ajo bujqësore e pa kultivuar, e cila mund të përdoret për mbjelljen e pemëve frutore, zë një sipërfaqe prej 59,841 ha. Kjo tregon që Bashkia Gramsh ka territor të përshtatshëm për kultivimin e pemëve frutore dhe të perimeve të ndryshme. Për të llogaritur fluksin e ushqimit janë përdorur të dhënat të INSTAT (prodhimet) dhe të dhënat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit dhe Administrimit të ujërave (sasia që shkon në treg dhe eksport). Fluksi i ushqimit është realizuar

vetëm për disa kultura, pasi të dhënat nuk janë të plota dhe nuk mund të kuptohen hyrjet dhe daljet. Sasia e produkteve që konsumohet (treg dhe eksport) është më e lartë se sasia e produkteve që prodhohen në territorin e Bashkisë Gramsh. Kjo ndodh sepse një pjesë e produkteve që konsumohen nuk prodhohen në territorin e Gramshit. Arsye tjetër është se burimi i të dhënave është i ndryshëm. Prodhimet janë përcaktuar nga INSTAT, ndërsa të dhënat për treg dhe eksport janë marrë nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

### 20.3.4 Fluksi i Mbetjeve

Fluksi i mbetjeve analizon sasinë e mbetjeve që importohen, prodhohen, riciklohen dhe përpunohen. Shërbimi i grumbullimit të mbetjeve urbane ofrohet për territorin e qytetit (Bashkia e Gramshit para ndarjes territoriale). Edhe në këtë territor shërbimi ofrohet në nivelin 60-70%. Venddepozitimi i mbetjeve në Gramsh ndodhet rreth 3 km larg qendrës së qytetit pranë brigjeve të Lumit Devoll në pjesën lindore të territorit.

Figura 99 Fluksi i mbetjeve në Bashkinë Gramsh



**Burimi:** Bashkia Gramsh dhe MetroPOLIS, 2017

Ky venddepozitim është klasifikuar si jo sanitar, mbetjet të cilat depozitohen aty janë mbetje të ngurta urbane, por edhe mbetje të tjera. Në territorin e Bashkisë së Gramshit ka një makinë teknologjike e cila kryesisht operon në zonën e qytetit ndërkohë në Nja-të e tjera venddepozitimet janë pa kriter dhe gjenden në mënyrë spontane në territoret përkatës. Për të llogaritur gjenerimin e mbetjeve urbane në territorin e Bashkisë Gramsh, jemi mbështetur sërish në rrjetin e INSTAT për të dhënat e popullsisë në çdo km<sup>2</sup>. Sasia mesatare e mbetjeve që gjeneron një person në ditë është 0.7 kg. Sasia më e madhe e mbetjeve të gjeneruara ndodh normalisht në zonat më të populluara, siç është qyteti i Gramshit. Sasia e gjeneruar në zonën urbane të qytetit të Gramshit arrin në vlerën 1.607-2,382 ton/vit. Ndotja që iu shkaktohet ujërave nëntokësore nga mbetjet urbane është e lartë për shkak të depërtimit të lëngut të ndotur të mbetjeve nga vend depozitimi (jo sanitar) i vendosur



pranë shtratit të lumit, pra në zonën ku akuiferi afrohet maksimalisht me sipërfaqen e tokës. Po ashtu, shpimet për puse dhe gropa septike në territor ulin nivelin e filtrimit të ndotjes para mbërritjes në shtresat nëntokësore dhe rritin ndotjen në ujërat nëntokësore. Procesi i riciklimit është i komplikuar për arsye se mbetjet nuk ndahen që në burim dhe nuk ka stimuj për realizimin e këtij procesi.

### 20.3.5 Përfundime

Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në nivel Qarkun është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përfitohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Gramshi ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kW/m<sup>2</sup>, energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Gramshi shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale si ai i Përroit të Holtës. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen. Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Gramshit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren pusët. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Gramsh është sa gjysma e sasisë së ujit që prodhohet. Ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë Njërive Administrative Poroçan, Kukur, Lenië, Skënderbegas dhe Pishaj, ku ndodhin edhe aktivitetet më të mëdha industriale përgjatë Lumit Devoll. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës. Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Gramshit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.

## 21. Analiza SWOT

### ○ Pika të Forta

- Prania e aksit kryesorë rrugor Elbasan-Gramsh-Korcë që e lidh qytetin me dy pole të rëndësishëm ekonomik;
- Ndërtimi i hidrocentralit të Banjës me efekt në infrastrukturë.
- Tokë e përshtatshme për zhvillimin e kulturave të ndryshme bujqësore
- Burimet ujore në të gjitha njësitë administrative.
- Diellëzimi i mjaftueshëm i cili ndihmon në rritjen e pemëve, rritjen e produkteve bujqësore Mundësia për zhvillimin e shumë kulturave bujqësore.
- Sasi të konsiderueshme kullotash të cilat ndihmojnë në lehtësimin e zhvillimit të blegtorisë.

- Prania e pasurive të burime ujore: Liqeni i Dushkut; Liqeni i Zi; Ujëvara e Sotires; Kanioni i Holtës, për të zhvilluar turizmin liqenor, kurativ dhe eksplorues.
- Prania e zonës së mbrojtur; Parku i Tomorrit për të zhvilluar turizmin malor dhe kulturor.
- Prania e monumenteve kulturore: Kisha në Grabovë; kalaja e Irmajit për të zhvilluar turizmin kulturor.
- Ekzistenca e objekteve sociale si pallati i sportit, pallati i kulturës, stadium, hapësira pranë konviktit të shkollës së mesme etj.;
- Ekzistenca e moshës së re në qytet si nxënësit e shkollave 9-vjecare dhe shkollës së mesme e cila ka nevojë për socializim dhe nxitje për mos largim nga qyteti.
- Diversitet i formave të ndryshme natyrore dhe një peisazh i larmishëm (liqen, fushë, kodrër, mal etj.);
- Prani e shumë burimeve ujore (lumi i Tomorricës, lumi i Devollit, liqeni i Dushkut, liqeni i Zi si dhe një sërë përrenjsh);
- Kushte të mira ambjentale (cilësia e ajrit dhe ambiente të pastra përreth);
- Larmishmëri të biodiversitetit (flora dhe fauna).

○ **Pikat të Dobëta**

- Infrastruktura e dobët lidhës ndërmjet qytetit të Gramshit dhe qendrave të tjera të banuara (njësivë administrative dhe fshatrave);
- Amortizimi i një pjesë të rrjetit rrugorë dhe mungesa e disa rrugëve të brëndshme që lidhin qytetin;
- Mungesa e parkut të parkimit të makinave (furgonat që lidhen me njësitë përreth);
- Mos funksionimi i instancave të duhura për mirëmbajtjen e rrugëve.
- Sasi të konsiderueshme tokash pjellore të pashfrytëzuara në mënyrë efektive;
- Probleme me kanalet ujitëse pavarësisht zotërimit të shumë burimeve ujore;
- Infrastruktura e dobët e rrjetit rrugorë;
- Prodhimi në sasi të vogla të specialiteteve të zonës nga pamundësia e depertimit në treg;
- Mungesa e qendrave të grumbullimit të produkteve bujqësore, baxhove, etj.
- Infrastruktura rrugore lidhese me pikat turistike është në gjëndje jo të mirë, ku rrugët të cilat të cojnë në këto vende janë të pashtruara dhe e bëjnë udhëtimin për në këto zona të gjatë dhe të vështirë për turistët.
- Nuk ka një infrastrukture akomoduese për turistët (hoteleri, restorante, shërbim mjekësor).
- Kemi një munges të bujtinave dhe iniciativave nga vetë banorët që janë të vendosur në afërsit me këto pika turistike për të ofruar shërbimin e akomodimit për turistët.
- Programi i varfër me aktivitete sociale dhe kulturore për të rinjtë e qytetit;
- Gjëndja jo e mirë e objekteve ekzistuese kulturore.
- Ndotja industrial në qytetin e Gramshit që shkaktohet nga ish- ndërmarjet industrial, nga aktiviteti prodhimit të baterive duke dëmtuar tokat nga kimikate dhe elemente të dëmshëm;
- Mbetjet biologjike në qytetin e Gramshit nga subjektet me veprimtari (sallameri, baxho, prodhimeve ushqimore, thertore etj.) duke krijuar kushte për zhvillimin e insekteve dhe përhapur sëmundje;
- Mungesa e pikave të grumbullimit dhe mostrajtimi i mbetjeve urbane.

- Ndotja e ujërave të lumit Devoll nga hedhja e mbetjeve urbane në afërsi të qytetit dhe shkarkimi i ujërave të zeza.
- **Mundësitë**
  - Ndërtimi i urave dhe riskonstruksioni i një pjesë të rrugës Gramsh-Elbasan;
  - Rikonstruksioni i rrugës Gramsh-Korcë;
  - Mundësi komunikimi dhe shkëmbimi ndërmjet njësive administrative;
  - Afërsia e njësive ndërmjet tyre që sjell lehtësi në bashkpunim;
  - Të qenurit një zonë e cila njihet për disa kultura bujqësore, blegtoriale si ulliri, sherebela, prodhimet artizanale me atë të bimëve sjell dhe evidentimin e tyre ndër njësitë e tjera;
  - Ka tendenca për zhvillimin e turizmit kurativ në Liqenin e Zi, nga banorë të zonës dhe nga jashtë;
  - Ndërtimi i hidrocentralit të Banjës (liqeni) duke zhvilluar turizmin rekreativ (shëtitore, peshkim, plazh, vrapim etj.);
  - Zona potenciale si: Mali i Tomorrit, mali i Valamarës për zhvillimin e aktivitete sportive.
  - Hapësira të mjaftueshme publike për zhvillimin e aktiviteteve sociale;
  - Hapja e një qendre infomacioni për aktivitetet social-kulturore, por jo vetëm;
  - Zhvillimi i festivaleve me tematiaka të ndryshme;
  - Mjedis i përshtatshëm klimaterik për rritjen e florës dhe faunës;
  - Prania e hapësirave publike brënda qytetit të Gramshit;
  - Klimë e përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sportive në të katërta stinët.
- **Rreziqet**
  - Prania e një terreni malor vështirëson lidhjen midis qendrave përreth dhe qytetit të Gramshit si dhe bllokim të disa rrugëve nga dëborat në sezonin e dimrit (Gramsh-Lenie, Gramsh-Kukur);
  - Dëmtimi i rrugëve nga gërryerja e ujërave sipërfaqësore ( Gramsh-Kukur, Gramsh-Lënie);
  - Mungesa e bashkpunimit ndërmjet njësive administrative;
  - Mungesë politikash kompesimi, bashkpunimi ndërmjet bizneseve private dhe banorëve.
  - Mungesa e tregtimit të produkteve si p.sh rakia, reçelërat etj;
  - Mungesa e promovimit të potencialeve të pikave turisike dhe cfarë ato ofrojnë.
  - Mos ekzistenca e zyrave informuese pranë njësive vendore;
  - Mos prania e personelit të kualifikuar vendas për të zhvilluar guida natyrore dhe turistike.
  - Largimi i të rinjve për shkollim në qytete të tjera ose jashtë vendit;
  - Prerja e paligjshme e pyjeve nga banorë e zonës;
  - Degradimi gradual i hapësirave publike;
  - Modifikim i mjedisit nga ndërtimi i hidrocentralit të Banjës;
  - Erozioni aktiv i cili mund të sjelli degradimin e habitateve.

## 22. Konkluzione dhe Rekomandime për Planin

## ***Vendbanimet***

Analiza e shpërhapjes së popullsisë në Bashkinë Gramsh e fokusuar në tre periudhat kryesore para viteve '88, '88-2007 dhe 2008-2015, tregon disa rezultate që shkojnë sipas trendeve në pjesën tjetër të vendit. Para viteve '90 njësitë administrative me sipërfaqen më të madhe të vendbanimeve në territorin e Bashkisë rezultojnë Nj. A Pishaj. Ndërsa sipërfaqen më të vogël e regjistrojnë Sultë, Poroçan, Lenie, Kushovë. Gjithashtu edhe për periudhën 1988-2007 Nj. A Pishaj rezultojnë të ketë sipërfaqen më të madhe. Gjatë kësaj periudhe vihet re një shtim i vendbanimeve në Kodovjat dhe Kukur. Nga viti 2007 deri në vitin 2015 ka ndryshime të theksuar në statistika. Të gjitha njësitë pësojnë një dyfishim të sipërfaqes së përgjithshme të tyre, por sërisht Nj. A Pishaj mbetet njësi më e madhe ndërsa Nj. A Sultë më e vogla.

Sipas tabelës së llogaritjes së sipërfaqes totale të Bashkisë Gramsh, sipërfaqja totale e bashkisë ka pësuar një rritje me 30%. Ndryshimet e ndodhura pas viteve '90 lidhen me përmbyshjen e sistemit totalitar para këtyre viteve, pasi kemi lëvizjen e lire të popullsisë. Popullsia është shpërngulur nga zonat e thella malore drejt qendrave kryesore të cilat ofrojnë relief më të përshtatshëm dhe më të urbanizuara.

## ***Analiza e përgjithshme e territorit***

Nga studimi i problematikës gjeologjike në Bashkinë Gramsh që përfshin ndërtimin gjeologjik, kushtet gjeologo-inxhinierike, faktorët e rrezikut gjeologjik, karakteristikat e akuiferëve e resurset dinamike të ujrave nëntokësorë, por dhe sipërfaqësorë dhe praninë e gjeomonumenteve mund të nxjerrim këto përfundime:

- Në këtë rajon megjithëse shfaqet prania e një game të gjerë shkëmbinjsh duke filluar nga ata magmatikë e deri në depozitime Kuaternare të krijuar prej Triasikut të mesëm (afërsisht 242 milion vjet më parë) e deri në kohët e sotme e që i përkasin tre zonave tektonike të Albanideve të brendshme e të jashtme, formacionet kryesore shkëmbore që mbizotërojnë janë ato flishoidale.
- Depozitimet flishoidale shfaqen që nga lloji i flishit i vjetër i Jurasikut të sipërm-Kretakut të poshtëm, por mbizotëruer janë llojet e flisheve që i përkasin zonave Krasta Cukali, Kruja dhe Jonike. Në kuadër të planit rregullues ky lloj formacioni shkëmbor duhet marrë seriozisht në konsideratë. Ai përfshihet në llojin e ***shkëmbinjve mestarisht të fortë dhe ndërtojnë kryesisht zonën kodrinore e pjesërisht atë malore, në të cilat mundësa e lindjes së fenomenit të rrezikut gjeologjik është më e madhe.***
- Në zonën kodrinore për momentin dallohet një hapësirë mbizotëruese, ku momentalisht nuk dallohen dëmtime në banesa të ndodhura nga fenomene të rrezikut gjeologjik, dhe pjesa tjetër ku këto fenomene (rrëshqitje, erozion) janë të shfaqura. Mungesa e shfaqjes së fenomeneve të tilla ndodh për faktin se ndërtimet nuk e kanë prishur ekuilibrin e shpateve. Ky ekuilibër duhet vazhduar të ruhet dhe në të ardhmen. Rritja e ekzagjeruar e dëndësisë së ndërtimeve, lartësisë së ndërtesave dhe sipërfaqes së tyre mund të çojë në prishje të ekuilibrit të sipërpërmendur.
- Zona përfshihet në rajonizimin sizmik VII-VIII ballë, çka e ekspozon ndaj një rreziku sizmik të lartë. Shkaku kryesor për këtë është afërsia me thyerjen Vlorë – Elbasan – Shkup. Kjo gjithashtu duhet marrë parasysh nga plani rregullues.

- Rreziku i erozionit lumor sugjeron që në brigjet lumore të mos parashikohen ndërtime, por të planifikohen mbjellje pemësh, me rrënjë të cilat të mundësojnë në rritjen e kohezionit të dherave pa kohezion që janë depozituar në brigjet e lumenjve duke ulur kështu erozionin dhe minimizimin e rrezikut.
- Gjithashtu fenomenet e erozionit dhe rrëshqitjeve në këtë rajon janë ndikuar mjaft nga shpyllëzimet, prandaj plani duhet të nxisë pyllëzimin, sidomos në zona të planifikuara për ekskursionet turistike në rrugëtimet drejt gjeomonumenteve të zonës.
- Bazuar në këto që u thanë më sipër plani mund të parashikojë ndërtime jo shumë të larta në këtë zonë, maksimumi i të cilave të mos i kalojë 5 – 6 kate, ndërtesa të cilat duhet të ndërtohen në terrene të studiuara mirë në pikëpamjen gjeologo - inxhinierike, në nivelin e ujrave nëntokësore në rënien e shtresave shkëmbore e sidomos të shtresëzimit të flisheve. Megjithatë lartësia dominuese e ndërtesave nuk duhet ti kalojë 3-4 kate.
- Bashkia e Gramshit merr sasinë më të madhe të ujit të pijshëm nga burime që burojnë nga akuiferët karstikë. Këto zënë 5% të burimeve, por mbajnë mbi 90% të resurseve dinamike. Problemi i këtyre lloj akuiferësh është se ata janë mjaft të ekspozuar ndaj ndotjeve, prandaj planifikimi duhet të marrë parasysh mos parashikimin e ndërtesave apo objekteve të infrastrukturës në hapësirat e këtyre akuiferëve.
- Plani rregullues duhet të marrë parasysh dhe mbrojtjen nga ndotja të rrjedhave sipërfaqësore të cilat gjithashtu përbëjnë rezerva të rëndësishme ujore. Kjo duhet bërë duke marrë parasysh orientimin e duhur të derdhjeve të kanalizimeve të zonave të banuara, dhe gjithashtu duke caktuar një zonë për një landfill për grumbullimin e mbetjeve urbane, të cilat sot shkarkohen në brigjet e lumit dhe në liqenin e Banjës.

### ***Rëndësia kombëtare në territor***

Bashkia Gramsh ka një sërë pontencialesh të rëndësishme së veçantë kombëtare të cilat gjenden brenda territorit të saj. Gjithësesi, këto elementë nuk shfrytëzohen në mënyrën e duhur për të rritur të ardhurat ekonomike të banorëve. Veçanërisht, monumentet e kulturës nuk kanë akses të mirëfilltë dhe i mungon promovimi. Gjithashtu, edhe potencialet natyrore nuk kanë një akses të mirë si dhe nuk kanë infrastruktura mbështetëse për të lejuar zhvillimin e turizmit. Bashkia Gramsh ka jo vetëm monumente të spikatura natyrore, Ujëvara e Sotirës, Kanioni I Holtës, por dhe ofron një turizëm mjaft tërheqës malor.

Ndërkohë, përse i përket shfrytëzimit të energjitikës, Bashkia Gramsh ka burime të shumta ujore të cilat kanë filluar të shfrytëzohen për hidrocentrale, për shembull, Hidrocentali I Banjës. Gjithësesi, këto hidrocentrale duhet të kenë kujdes të veçantë përse i përket dëmtimit të mjedisit dhe të ekosistemeve.

### ***Uji***

Bashkia e Gramshit është e pasur me burime ujore sipërfaqësore e nëntokësore, të cilat kanë problematikat e tyre. Një faktor që vlen të studiohet për Devollin (nga pikëpamja mjedisore dhe e zhvillimit të turizmit) është mundësia e ndërprerjes së rrjedhës së tij nga barrierat fizike, përkatësisht hidrocentralet (HEC-et) në degëzimet e tij. HEC-et që ndërpresin Devollin, në prodhim, në ndërtim, ose të projektuara, ndodhen jashtë dhe brenda kufijve të bashkisë. Këto HEC-

e kanë kapacitete të ndryshme nga më pak se 1MW deri mbi 50MW. Shumë prej HEC-eve të vogla janë planifikuar në degët kryesore të Devollit që depërtojnë deri në burimet e tij në Bashkinë e Korçës (Kamenicë, Sul, Miras, Qytezë, etj.). HEC-et mund të ndikojnë në shtimin e erozionit detar, për shkak të uljes së sasisë së sedimentit të transportuar (HEC si barrierë fizike) në grykëderdhje, zvogëlimin e inerteve të transportuara në det, si dhe në pengimin e lëvizjes së peshqve dhe të emigrimit të faunës në rrjedhën e lumit mbas barrierës. Për më tepër, ato ndikojnë në tjetërsimin e ekosistemit (jo vetëm lumor) të zonës në të cilën ndërtohen.

Akuiferët e Lumit Devoll, sidomos Akuiferi Karstik i Tomorrit, ka një rëndësi të veçantë për shkak se shërben si burim furnizimi me ujë për qytetin e Gramshit dhe komunat përreth. Si i tillë, duhet treguar kujdes për çdo mundësi të ndotjes së tij, ndotje të cilat mund të shkaktohen nga njerëzit ose industria. Ndaj për akuiferë të këtij niveli rëndësie duhet të tregohet një kujdes i veçantë, veçanërisht për monitorimin e tyre. Monitorimi i vazhdueshëm do të jepte një pasqyrë të qartë për mënyrën e shfrytëzimit dhe cilësisë së akuiferit.

*Duke parë keqmanaxhimin e burimeve ujore në 20 vitet e fundit, dhe rrezikshmërinë që paraqet ndotja e burimeve ujore nëntokësore për shëndetin e popullsisë, rivlerësimi i ndërtimit të HEC-eve, dhënies së lejeve për karriera lumore, përfshirë edhe projekte për shmangien e ndotjes nga lumi (p.sh. derdhjen e ujërave të ndotura urbane dhe mbetjeve industriale) dhe nga burimet ujore nëntokësore apo rehabilitimin e tyre, duhet të kenë përparësi për Bashkinë. Në këto projekte, Gramshi duhet të krijojë nisma bashkëpunimi me Bashkitë e tjera që preken nga lumi i Devollit me qëllim manaxhimin e integruar të tij.*

### **Toka**

Bashkia e Gramshit ka një larmi të gjerë tokash, si: fushore, kodrinore dhe malore, të cilat përdoren për prodhimin e **drithërave** (grurit, misrit), pemtarisë, perimeve, vreshtarisë (rrushit) dhe blegtorisë (rritja e bagëtive të imta e të trasha si lopët dhe dhentë). Megjithatë, bashkia përballet çdo ditë e më tepër me nevojën e shmangies së **degradimit të tokës**, që në Gramsh është fenomen i zakonshëm për shkak të shkëmbinjëve me fortësi mesatare dhe pjerrësisë të theksuar. Ky fenomen theksohet edhe më tej në rastet e punimit të tokave në pjerrësi, duke e thelluar dhe më shumë fenomenet, si: erozioni, shkarjet dhe shembjet e tokës. Për shkak të shirave dhe mungesës së manaxhimit të ujërave sipërfaqesore dhe nëntokësore, risku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë<sup>276</sup>. Gjatë viteve të fundit, në Gramsh mbetet i lartë edhe rreziku i erozionit së tokës, i cili shoqërohet edhe me depozitime të ngurta gjatë periudhave me shi<sup>277</sup>. Dëmtimet në brigjet e lumenjve janë rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të bimësisë përgjatë bregut të tyre. Niveli i humbjes së tokës në brigjet e lumenjve është i lartë, ndëkohë që mirëmbajtja e lumit lë për të dëshiruar. Gjendja rëndohet sidomos në rastet kur ka reshje të shumta e të rrëmbyeshme<sup>278</sup>. Njëkohësisht, në zona të caktuara, në të cilën ka qenë e zhvilluar industria, si zona përreth Ish-Uzinës mekanike të Çekinit, nuk mungon ndotja.

Për të rritur prodhimin bujqësor në territorin e bashkisë pa cënuar qëndrueshmërinë e tokave, lipset që Bashkia të ofrojë shërbimin e agronomisë nëpër fshatra bujqësore, duke u ofruar informacionin e duhur bujqve. Ky shërbim i ndihmon ata që të shtojnë prodhimin bujqësor nëpërmjet praktikave moderne bujqësore, edhe në toka kodrinore si ato të Gramshit. Me qëllim shmangien e degradimit të mëtejshëm të tokës bujqësore dhe jo bujqësore, nevojitet që Bashkia të promovojë zhvillimin

rural brenda territorit dhe të garantojë zhvillimin e një bujqësie më të qëndrueshme nëpërmjet praktikave prodhuese të qëndrueshme që respektojnë mjedisin, siç është përcaktuar në Politikën e Përbashkët për Bujqësinë të BE-së<sup>279</sup>.

Njëkohësisht, rekomandohet që Bashkia të hartojë planin e zhvillimit territorial duke patur parasysh parimin e mbrojtjes së tokës bujqësore (shndërrimin e tokës bujqësore në truall vetëm në raste kur janë konsumuar të gjitha mundësitë e tjera). Me qëllim shmangien e rrezikut që mund t'u kanoset banorëve të Bashkisë nëpërmjet konsumit të produkteve ushqimore të kultivuara në toka të ndotura, rekomandohet që përreth dhe në brendësi të zonave të ndotura në territorin e Bashkisë, të kryhen studime që synojnë përcaktimin e nivelit dhe shtrirjes gjeografike të ndotjes dhe të merren masa të menjëhershme për rehabilitimin e tyre.

### ***Menaxhimi i Mbetjeve***

Fillimisht, Bashkia Gramsh ka nevojë për të hartuar Planin e Manaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane, kjo si nevojë për një studim të plotë mbi shtrirjen e infrastrukturës së shërbimit të manaxhimit të mbetjeve në të gjithë territorin e Bashkisë.

Venddepozitimi aktual duhet ti nënshtrohet rehabilitimit mjedisor të tij, dhe të mendohet për të gjetur një zgjidhje për venddepozitimin e ri të mbetjeve, i cili duhet të jetë në standartet e një landfilli sanitar të menaxhuar.

Mbetjet industriale, edhe pse nuk janë kompetencë e bashkisë, institucionet vendore duhet të hyjnë në diskutime për të gjetur një zgjidhje sa më të përshtatshme, kryesisht në zonat ish industriale të Çekinit dhe Gramshit

Aktualisht nuk ka të dhëna mbi sasinë dhe mënyrat e riciklimit të mbetjeve në territorin e bashkisë, riciklimi ndodh në mënyrë joformale, ndaj shikohet e arsyeshme që bashkë me hartimin e planit të manaxhimit të mbetjeve të formalizohet sektori i riciklimit.

Zonat me nivel të lartë ndotjeje, sidomos industriale, në Çekin dhe Gramsh përbën një problem serioz për mjedisin dhe shëndetin publik të banorëve. Mbetjet e trashëguara në këto zona duhet të jenë pjesë e skemës së re, që duhet të përvetësojë Bashkia e Gramshit për manaxhimin e integruar të mbetjeve.

### ***Demografia***

- Bashkia e Gramshit në 1 janar 2016, regjistroi një numër popullsie rezidente prej 24,484 banorë, prej të cilëve 12,5 mijë meshkuj dhe 11,9 mijë femra. Sipas shpërndarjes urban/rurale rreth 35% e popullatës së bashkisë klasifikohet si popullsi urbane dhe diferenca prej 65% si popullsi rurale. Ndërkohë sipas strukturës moshore rreth 68% e popullatës i përket grupmoshës (15-64) vjec dhe 22% grupmoshës (0-14) vjec, tregues këta që demonstrojnë se popullata e bashkisë ka potenciale të larta të popullsisë ekonomiksht aktive, përfshirja e të cilëve në tregun e punës do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e performancës ekonomike dhe mirëqënien e popullatës. Struktura aktuale demografike e popullsisë rezidente si dhe mosha mesatare e saj relativisht e re tregojnë së popullsia e zonës është akoma e re.

- Gjithsesi procesi i vazhdueshëm i emigrimit, ritmet e larta të migrimit të brëndshëm si dhe rënia e lindshmërisë e vdekshmërisë, kanë ndikuar jo vetëm në rënie të numrit të popullsisë, por edhe në ndryshimin drastik të strukturës së saj demografike.
- Një faktor shumë i rëndësishëm në përcaktimin e stokut neto të popullatës së qarqeve/bashkive është edhe migrimi i brëndshëm i popullsisë, pra levizjet e popullatës nga një qark/bashki në tjetrin.
- Sipas projeksioneve të popullsisë, skenari i rritjes së mesme, popullsia e qarkut/bashkisë do të pësojë rënie, me një ritëm mesatar vjetor rënie me rreth 1.3% dhe si faktor kryesor mendohet të jetë migracioni i brëndshëm
- Popullsia rezidente e Bashkisë Gramsh deri në vitin 2021, do të performojë tregues të varesisë totale të ulët, duke ruajtur të ashtuqajturin fenomenin e “dividentit demografik”.

Për të përfituar nga ky “divident demografik”, kërkohen politika të bashkërenduara në nivel qendror e lokal, për të mundësuar, arsimimin, trajnimin dhe përfshirjen në tregun e punës të kësaj kategori të popullatës, me qëllim rritjen dhe përmirësimin në vazhdimësi të mirëqënies së saj dhe komunitetit në tërësi.

### ***Transporti***

- Me infrastrukturën e re që është ndërtuar, Gramshi shtrihet në pozicion të favorshëm gjeografik duke parë ndodhet 90 minuta larg Tiranës dhe Durrësit si dhe afërsisht 50 minuta drejt Elbasanit .
- Me shtimin e 2 linjave të tjera drejt Kamzës dhe Vlorës, Bashkia e Gramshit ka akses të mirë në linjat ndërqytetase.
- Gjëndja e infrastrukturës rrugore është e dobët duke parë që vetëm 8 % e rrugëve në nivel bashkie janë të shtruar ( Asfalt).
- Nga të dhënat e INSTAT tregohet që 68.8 % e banorëve të bashkisë shkojnë në punë në këmbë.
- Në bashkinë e Gramshit ndodhen 3 stacione të transportit ndërqytetas dhe rrethqytetas dhe për ta bërë këtë shërbim më eficient do të propozohet ndërtimi i terminalit të transportit publik.

### ***Elementët e fortë në territor***

Bashkia Gramsh ka një pozicion të favorshëm gjeografik pas ndodhet në distanca të vogla nga qytetet e mëdha të vendit dhe rrugët janë në përgjithësi me cilësi të mirë. Gjithashtu në këtë bashki kemi shumë pasuri natyrore e kulturore të cilat kanë ndikuar në zhvillimin e vendbanimeve, por edhe paraqesin potenciale për zhvillimin e turizmit malor dhe kulturor. Duke qënë se në përgjithësi kjo bashki mbetet në përgjithësi e pazbuluar nga masa turistike, duhet patur kujdes me ndërhyrjet turistike, pasi vlerat duhet të mbrohen krahas promovimit të tyre.

### ***Planet e mëparshme***

- Shtrirja perspektive e qytetit të parashikohet në jug të qytetit ekzistues.
- Të zgjerohet vija e verdhe e qytetit duke futur brenda saj edhe ato territore që janë shume afër me qytetin dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetit të Gramshit,



duke shtuar në këtë mënyre sipërfaqen e teritorit të qytetit me sipërfaqe të domosdoshme për funksionimin normal të tij.

- Të merren masa për mbrojtjen e nivelit të ndotjes së ajrit nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë.
- Territori i ish zonës industriale në hyrje të qytetit (veri) të parashikohet për krijimin e zonës ekonomike të qytetit dhe për zgjerimin dhe sistemimin e zonës së transportit të jashtëm.
- Territori i ish SMT dhe uzinës 85 si edhe territori i repatrit ushtarak të parshikohet për krijimin e zonave të reja të banimit si edhe për funksione publike të cilat sot i mungojnë qytetit të Gramshit.
- Të rivlerësohet ideja e zonës industriale në perspektivën e parashikuar nga plani rregullues (projekt ide) i vitit 1987 në bazë të kushteve të reja të pronësisë mbi truallin, të ruhet dhe të zhvillohet për zhvillimin perspektiv ekonomik të qytetit.
- Hyrja e qytetit të rivlerësohet.
- Të rivlerësohet ideja e krijimit të unazës së rrethit të qytetit në drejtimin veri – jug e propozuar nga plani rregullues (projekt ide) i vitit 1987.
- Të rivlerësohet qendra e qytetit në bazë të zhvillimeve të reja social - ekonomike dhe administrative, si edhe të rivlerësohet ideja e krijimit të një shëtitoreje në pjesën perendimore të zonës së qendrës në buzë të lumit Devoll.
- Ndërtimi i zonave të reja të banimit të jetë në përputhje me terrenin dhe preferencat e banorëve si edhe të respektohet tradita pozitive e lartësise të kateve të objekteve të banimit.
- Zona e re e varrezave të parashikohet në jug të qytetit.

### ***Periferialiteti***

Përsa i përket periferialitetit mund të themi se në terma të përgjithshëm vendbanimet e Bashkisë Gramsh në rreth 90% të tyre përfshihen në kategoritë 1 dhe 2 të periferialitetit që do të thotë se shërbehen nga 4 ose nga 3 lloje shërbimesh publike. Rreth 10 % e vendbanimeve përfshihen në kategoritë 3 dhe 4 të periferialitetit që do të thotë se këto vendbanime kanë akses të dobët ndaj shërbimeve publike. Më problematike gjëndja paraqitet në NjA-të: Kukur, Lenie dhe Poroçan si dhe Skendebegas ku vendbanimet nuk përfshihen fare në kategorinë e parë të periferialitetit.

### ***Përdorimet e tokës dhe Sistemet***

Në kuadër të përgjithshëm mund të vërehet se përdorimi bazë dominues në bashkinë Gramsh janë përdorimet natyrore si pasojë e relievit të thyer malor që ka, të cilat janë të shpërndara në masë të madhe në të gjithë territorin, por dominojnë kryesisht në skaje të bashkisë. Këto përdorime përfshijnë rreth 80 % të territorit dhe me nënkategori siç janë: Pyjet e Dendura, Pyje e Rralla, Kullotat, Shkurret e Dendura dhe Shkurret e Rralla.

Përdorimet bujqësore që përfaqsojnë sistemin bujqësor kryesisht pozicionohen në zonat përgjatë luginave të Lumit Devoll dhe Përrenjve të Tomorricës, Verçës dhe Holtës ku terreni përgjithësisht është më i ulët dhe aksesohet lehtësisht nga burimet ujore. Këto përdorime përfshijnë një masë prej 13.7% të territorit kryesisht me nënkategorinë, e tokave të kultivuara arë.

Përdorimet ujore që përfaqësojnë sistemin ujqor përfshijnë rreth 5% të territorit. Si pjesë e këtij sistemi janë Lumi Devoll, Përrenjt e Holtës, Tomoricës dhe Verçës si dhe Liqenin e Dushkut dhe Liqenin e Zi.

Sistemi urban përfshin rreth 0.85% të territorit ku zonat kryesore urbane janë të pozicionuara kryesisht përgjatë luginës së Devollit ku edhe terreni është më I përshtatshëm, në këtë zonë ndodhet dhe Qyteti i Gramshit. Kategoritë bazë që përfaqësojnë sistemin Urban janë Banimi, Shërbimet, Institucionet, Arsimi, Shëndetsia të cilat përgjithshmit ndodhen të kombinuara me banimin në qendër të zonave urbane.

Sistemi Infrastrukturore përfshin rreth 0.65% të territorit dhe përfaqësohet nga të gjitha llojet e infrastrukturave, por kryesisht nga Kategorisa bazë Infrastrukturore Rrugore.

### ***Tipologjitë hapsinore***

Në nivel territorial, bashkia Gramsh nuk ka lidhshmëri të mirë, për shkak të infrastrukturës problematike dhe terrenit të vështirë. Shumë qendra njësisht administrative dhe fshatra me potencial për zhvillim turizmi e ekonomik janë të lidhur dobët me qendrën e njëri - tjetrin.

3 sisteme kryesore lineare duhet të ristrukturohen, duke zhvilluar shërbime plotësuese mes fshatrave: Gramsh-Llallë-Duzhë-Tunjë-Tunjë e Re-Hoxhallar; Gramsh-Mirakë-Bregas-Kushovë-Sotirë; dhe Gramsh-Harunas-Skënderbegas-Ermenj-Vidhan.

Shumë fshatra janë të shpërndarë në mënyrë nukleare në territor dhe formojnë lidhje vetëm me rrugë dytësore. Këto lidhje duhet të përforcohen drejt qendrave më të afërta ku mund të merren shërbimet.

Sa i takon marrëdhënies mes vendbanimeve në nivel fshati, pjesa dominuese e fshatrave kanë tipologji qëndrore, ndjekur nga tipologjitë e shpërhapura dhe nukleare. Fshatrat me tipologji qëndrore propozohet t'i nënshtrohen ndërhyrjeve ristrukturoese dhe konsoliduese, pa nxitur intensifikim. Tipologjitë e shpërhapura kërkohet të densifikohen në mënyrë hierarkike, duke formuar qendra të dukshme dhe lidhje të mirë të vendbanimeve me to. Tipologjia nukleare i takon fshatrave periferike, ku është e nevojshme të zhvillohet bashkimi dhe hierarkizimi i nukleve, duke kaluar në trajtë aglomerimi.

Lidhja hapësinore e fshatrave bëhet kryesisht në mënyrë organike (36%), pra vendbanimet shtrihen duke ndjekur format e terrenit. Një pjesë e konsiderueshme fshatrash kanë strukturë të tarracuar, e cila përbën një potencial peizazhistik që duhet ruajtur. Ndërkaq, mbi 30% e fshatrave kanë tipologji lineare të degëzuar ose lineare. Në këto raste propozohet të caktohet një kufi i shtrirjes sipas modelit 'korridor', e të vendosen degëzime për kompaktësim, apo tipologji rrjet, aty ku e lejon territori.

Në bazë të zonimit të tipologjive ndërtimore, pjesa më e madhe e zonave në bashki kanë tipologji vilash me densitet të mesëm. Këto zona janë kryesisht qendrat e fshatrave e mund t'i nënshtrohen densifikimit apo ristrukturimit. Së dyti, mjaft të përhapura janë tipologjitë e vilave me densitet të ulët. Këto zona duhet t'i nënshtrohen konservimit, pa nxitur densifikim.

Në nivel qyteti, dallohen tipologji mjaft të larmishme, por homogjene, të ndërtesave gjatësore të densitetit të mesëm, të ulët, e të zonave të kullave të densitetit të mesëm e të ulët, krahas zonave të vilave. Është e nevojshme që këto tipologji të ruhen, duke shmangur miksimet urbane, sidomos sa i takon diferencave në lartësi dhe zënies së hapësirave të lira.

Gjithashtu, duhet trajtuar me kujdes zona bujqësore me tendenca zhvillimi vilash, në pjesën perëndimore të qytetit, si dhe zona kodrinore perëndimore, ku po zhvillohen vila me densitet të ulët. Këto, së bashku me shtrirjen lineare jugore, mund të jenë zonat e presionit të zhvillimit në qytet.

Qyteti ka një rrjet rrugor pothuajse tërësisht të rregullt, ku kombinohet tipologjia rrjet drejtkëndor dhe rrjet i çrregullt (në zonat e projektuara në periudhën komuniste), me tipologjinë lineare përgjatë rrugës kryesore, e atë lineare të degëzuar e organike në zonat periferike kodrinore. Vlen për të mirëmbajtur struktura ekzistuese, të plotësohet në formë rrjeti në pjesën jugore e lindore të qytetit, si dhe të trajtohet në mënyrë peizazhistike zona lindore, me sistem rrugor të tarracuar.

### ***Ndriçimi Publik***

Përsa i përket gjëndjes aktuale të shërbimit të ndriçimit publik vërehet se rreth 15-20% e sistemit të këtij ndriçimi është jashtë funksioni si pasojë e amortizimit të sistemit dhe dëmtimit të tij. Në qytetin e Gramshit aktualisht ndriçohen rreth 14 km linear rrugë, 5 sheshe publike dhe 1 lulishte. Në total numri i shtyllave është 330 ku 70 prej tyre janë LED.

Ndriçimi publik ofrohet edhe në NjA-të Pishaj, Kodovjat, Lenie dhe Tunjë, por në këto zona ky rrjet ka probleme të shumta me amortizimin dhe dëmtimin e tij.

### ***Metabolizmi i Territorit***

Sasia e energjisë së konsumuar për ngrohje në nivel Qarkun është e lartë, ku 77% e NjFE-ve, përdorin drutë e zjarrit për t'u ngrohur, 13 % përdorin gazin dhe 7% përdorin energjinë elektrike. Nëse përdoren të gjitha burimet alternative të energjisë, do të kemi një konsum më të ulët të energjisë që përfitohet nga drutë e zjarrit apo energjia elektrike. Gramshi ndodhet ndërmjet izolinjave 1,450-1,550 kW/m<sup>2</sup>, energji potenciale për t'u përdorur për ngrohjet e banesave. Gramshi shtrihet në zonën gjeotermale Kruja dhe ka potencial për përdorimin e energjisë gjeotermale nëpërmjet burimeve gjeotermale si ai i Përroit të Holtës. Energjia e eksportuar në nivel kombëtar përbën vetëm 8,6% të energjisë së importuar. Ky është një tregues që përveç humbjeve në rrjet, burimet alternative të energjisë nuk shfrytëzohen. Sistemi i furnizimit me ujë mbulon 100% të popullsisë në qytetin e Gramshit, por ky shërbim nuk shtrihet në të gjithë territorin e bashkisë. Sistemi i furnizimit me ujë është pjesërisht konvencional (kryesisht në zonën urbane dhe një pjesë në zonat rurale). Ky sistem duhet të shtrihet në zonat ku mbulimi me ujë është problematik (ofrohet shërbimi pjesërisht ose nuk ofrohet fare), ndërsa një pjesë (në rastet kur është e mundur) mund të përdoren pusët. Kërkesa aktuale për ujë në Bashkinë Gramsh është sa gjysma e sasisë së prodhuar të ujit. Ky është një tregues i kapaciteteve të larta prodhuese të ujit të pijshëm. Një menaxhim më i mirë i ofrimit të shërbimit do të sigurojë ujë të pijshëm në të gjithë territorin e Bashkisë Gramsh. Zona ujëmbajtëse shtrihet përgjatë Njësisë Administrative Poroçan, Kukur, Lenië, Skënderbegas dhe Pishaj, ku ndodhin edhe aktivitetet më të mëdha industriale përgjatë Lumit Devoll. Kjo rrit mundësinë e ndotjes së ujërave nëntokësore dhe ndotjes së tokës. Fluksi i ushqimit tregon që në territorin e Gramshit produktet bujqësore që kanë prodhime të larta janë

drithërat perimet, foragjerët dhe drufrutorët. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, kulturat më të përshtatshme bujqësore janë: drithërat, perimet e serave, fasulet, duhani, foragjerët, drufrutorët (vreshta, ullinj, pjeshkë). Prodhimin më të lartë nga produktet blegtorale e ka qumështi.

## **Aneke**

### **Planifikimi me pjesmarrje dhe aktorët e përfshirë në proces**

Në bazë të ligjit nr 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” dhe në bazë të VKM 671 “Për Rregulloren e Planifikimit të Territorit” është e detyrueshme ligjërisht që në kuadër të Planit të përgjithshëm vendor të organizohen takime të hapura dhe dëgjesa publike në mënyrë që aktorët të ndryshëm të shfaqin problematikat dhe propozimet e tyre dhe të përfshihen në procesin e planifikimit në bashkinë e tyre. Ky process synon që të ketë një përfshirje sa më të madhe të aktorëve lokal.

Si pjesë e këtij procesi kanë qënë aktorët të ndryshëm të cilët kanë krijuar dhe forumin këshillimor me urdhër të kryetarit të bashkisë.

Si pjesë e procesit të planifikimit në kuadër të planit të përgjithshëm vendor kanë qënë këto aktorë:

1. Përfaqësues të institucionit të Bashkisë si aktori kryesor që luan rol kyç në mbarvajtjen e procesit të Planit të Përgjithshëm Vendor
2. Drejtoria e Planifikimit të Territorit pranë institucionit të Bashkisë
3. Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
4. Përfaqësues të Drejtorisë Arsimore
5. Specialistë të Sektorit Bujqësor.
6. Specialistë së Sektorit Pyjor
7. Përfaqësues nga Biznesi Vendas.
8. Përfaqësues nga Grupi i Ndërtuesave të Qytetit.
9. Përfaqësues nga Drejtoria e Kulturës
10. Përfaqësues nga Drejtoria Mjedisore
11. Përfaqësues nga Komuniteti Lokal
12. Përfaqësues nga Këshilli Bashkiak
13. OJF të ndryshme

## Raporte nga dëgjesat publike dhe konsultat

Raporti i dëgjesës së parë publike



# **RAPORT**

## **DËGJESA E PARË PUBLIKE PËR HARTIMIN E NISMËS SË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR**

**Gramsh, me 30.08.2017**

Sot më date 30/08/2017 u realizua dëgjesa e pare publike mbi nismën e Planit të Përgjithshëm për Bashkinë Gramsh. Kjo dëgjesë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Gramsh znj. Luljeta Dollani;
- Specialistët e Sektorit te Studimit dhe Projektimit Urban;
- Administratorët e Njësive Administrative Pishaj, Porocan, sult, Kukur, Kodovjat, Lenie, Skenderbegas, Kushove, Tunje;
- Komisionit Qytetarë;
- Grupet e Interesit: biznesi privat, OJF, etj;
- Perfaqesues te Agjensise Kombetare te Planifikimit te Territorit;
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me fjalimin e Kryetarit të Bashkisë znj. Luljeta Dollani, në të cilin falenderon të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Ndër të tjera, theksohen nga kryetari arsyet e ndërmarrjes së nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit Administrativ nga Bashkia Gramsh. Si hap i dyte i degjeses ishte mbajtja e prezantimit nga përfaqesuesit e Metropolis Studio sh.p.k, të cilët trajtuan një sere çështjesh, si më poshtë:

- Qëllimin e PPV
- Territori i Bashkisë Gramsh
- Dokumentet përfundimtare

- Grupet e punës
- Proceset dhe afatet kohore
- Takime këshilluese, teknike dhe organizative
- Forumi këshillimor vendor
- Buxheti
- Si dhe dëgjesa publike që u zhvillua sot.

Në këtë dëgjese të parë u fol mbi nismën e PPV-së.

Procesi i miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Gramsh do të bëhet me 1 (një) ndalesë, që do të çojë në hartimin e plotë të dokumentit të planifikimit vendor dhe më pas miratimin e tij.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u dhanë sugjerimet si:

- Puna për hartimin e planit të fillojë me studimin e elementeve natyrore dhe vendbanimet për gjatë luginës kryesore të qytetit;
- Në çdo vendimmarrje të jenë të pranishëm banorët, Kryeplak i fshatit, etj, të zonave përkatëse që do të studiohen;
- Specialistët e bashkisë dhe përfaqësuesit e studios të njihen me problematikat kryesore të secilës zone dhe të nevojave të banorëve;
- T’i jepet një rëndësi e veçantë mjedisit dhe zonave turistike të bashkisë tonë;
- Të planifikohen zonat e zhvillimit për çdo njësi banimi, duke prekur edhe zonat më të thella malore;
- Me anë të dëgjësive publike të arrihet një nderveprim i mirë midis plotësimit të nevojave të qytetarëve dhe çështjeve që do të përfshihen në planin e përgjithshëm vendor.

Dëgjesa pasardhëse do të zhvillohet në muajin shtator për dokumentin e Analizës.

Dëgjesa tjetra do të zhvillohet në muajt shtator-nëntor 2017, ku do të jetë informimi mbi Planin, Rregulloren dhe VSM dhe do të zhvillohen 2-3 takime. Është parashikuar që finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor dhe VSM të jetë në fund të muajt dhejtor 2017. Në të gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Metropolis Studio shpk, të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim proces-verbali u mbajtë nga juristi z. Elidjan Koci.

## **Për Sektorin e Studimit dhe Projektimit Urban:**

Ing. Ali Cohodari

Ing. Dhorë Nishku

Ing. Fiorentina Xhangolli

Ing. Manjola Xhelili

Ing. Eva Ismailaj

Top. Gezim Dollani

Jurist Elidjan Koci

Foto nga dëgjesa e pare publike





Raporti i dëgjësës së dytë publike



## **RAPORT**

### **DËGJESA E DYTË PUBLIKE PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR**

**Gramsh, me 22.09.2017**

Sot më date 22.09/2017 u realizua dëgjesa e dyte publike mbi hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Gramsh. Kjo dëgjësë u realizua në prani të:

- Kryetarit të Bashkisë Gramsh znj. Luljeta Dollani;
- Specialistët e Sektorit të Studimit dhe Projektimit Urban;
- Administratorët e Njësive Administrative Pishaj, Porocan, sult, Kukur, Kodovjat, Lenie, Skenderbegas, Kushove, Tunje;
- Komisionit Qytetarë;



- Grupet e Interesit: biznesi privat, OJF, etj;
- Përfaqesues të Agjensise Kombëtare të Planifikimit të Territorit;
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me një përmbledhje të shkurtër për ato çështje që u diskutuan në degjuesen e parë publike, si një hyrje për të gjithë të pranishmit, në të cilën u mbyll edhe faza e parë që është mbledhja e të gjithë informacionit. Si hap i dytë i degjueses ishte mbajtja e prezantimit nga përfaqesuesit e Metropolis Studio sh.p.k, të cilët trajtuan një sërë çështjesh, si më poshtë:

- Bashkia Gramsh në raport me rajonin;
- Planet vendore të hartuara me parë;
- Kendveshtrimi i përgjithshëm;
- Analiza e infrastruktures;
- Analiza e përdorimit të tokës;
- Analiza ekonomike;
- Demografia;
- Turizmi;
- Shërbimet sociale;
- Analiza e metabolizmit.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u dhanë sugjerimet si:

- Të analizohet një strategji për lidhjen e Bashkisë së Gramshit me Bashkitë e tjera fqinje, si një mënyrë zhvillimi ekonomik, turistik;
- Të ndërtohet rruga lidhëse Gramsh-Berat nëpërmjet Njësive administrative të Sultit;
- Të shikohet me prioritet infrastruktura në zonat malore, e cila po bëhet pengesë gjithnjë e më shumë për jetesën në këto zona, si edhe mbylljen e shumë shkollave;
- Të hartohet një strategji për zhvillimin e sistemit arsimor si edhe përmirësimi i kushteve të të gjitha shkollave në Bashkinë Gramsh, duke përmbushur standartet e nevojshme;
- Të parashikohen godina dhe vende të vecanta për zhvillimin e arsimit parashkollor;
- Të shikohet mundësia e ngritjes së një shkolle profesionale në disa degje kryesore;
- Të studiohet me kujdes zhvillimi i turizmit dhe i agroturizmit.

Dëgjesa pasardhëse do të zhvillohet në muajin Tetor.

Është parashikuar që finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor dhe VSM të jetë në fund të muajt dhejtor 2017. Në të gjitha këto takime, do të jenë të pranishëm edhe specialistët e Metropolis Studio shpk, të cilët do të marrin pjesë në diskutimet e hapura për auditorin.

Në këtë takim proces-verbali u mbajte nga juristi z.Elidjan Koci.

#### **Për Sektorin e Studimit dhe Projektimit Urban:**

Ing. Ali Cohodari

Ing. Dhori Nishku

Ing. Fiorentina Xhangolli


Ing. Manjola Xhelili

Ing. Eva Ismailaj

Top. Gezim Dollani

Jurist Elidjan Koci

Foto nga dëgjesa e dytë publike





Raporti i dëgjësës së parë të VSM



## **RAPORT**

### **DËGJESA E PARË PUBLIKE PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR NË KUADËR TË HARTIMIT TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË TERRITORIT TË BASHKISË GRAMSH**

**Gramsh, me 29.09.2017**

Sot më date 29.09.2017 u realizua dëgjesa e pare publike per Vleresimin Strategjik Mjedisor ne kuader te Hartimit te Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Gramsh. Kjo dëgjësë u realizua në prani të:

- Specialistët e Sektorit te Studimit dhe Projektimit Urban;
- Perfaqesues te ARM Elbasan;

- Administratorët e Njësite Administrative Pishaj, Porocan, sult, Kukur, Kodovjat, Lenie, Skenderbegas, Kushove, Tunje;
- Komisionit Qytetarë;
- Grupet e Interesit: biznesi privat, OJF, etj;
- Perfaqesues te Agjensise Kombetare te Planifikimit te Territorit;
- Si dhe pjesëmarrës të tjerë të interesuar.

Dëgjesa u nis me nje prezantim te grupit te punes per Vleresimin Strategjik Mjedisor pjese e Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Gramsh, perfaqesues te Metropolis Studio sh.p.k, të cilët trajtuan një sere çështjesh, si më poshtë:

- Baza ligjore dhe Metodologjia;
- Analiza e gjendjes se mjedisit;
- Territori dhe Toka Bujqesore;
- Burimet ujore Siperfaqesore dhe nentokesore;
- Ajri;
- Pyje, Kullotat dhe Peisazhi;
- Biodiversiteti dhe Zonat e Mbrojtura;
- Ndryshimet Klimatike;
- Menaxhimi i Mbetjeve;
- Sistemi Ujesjelles-Kanalizime;
- Presionet mjedisore;
- Perfundimet e analizave.

Për auditorin u la një hapësirë për diskutim të hapur, ku u dhanë sugjerimet si:

- Te gjendet nje zgjidhje permanente per menaxhimin e mbetjeve urbane, nje venddepozitim i cili ploteson standartet, grumbullimi i ketyre mbetjeve si ne qytet ashtu edhe nga Njesite Administrative;
- Te behet lidhja me Impjantin e Trajtimit te Ujrave te Ndotura e te gjithë sistemit te kanalizimeve dhe me pas trajtimi i tyre, duke ulur ndotjen e ujit te liqenit te Banjes dhe ruajtjen e ketij ekosistemi te ri ne gjendje te paster;

- Te rishikohet ceshtja ne lidhje me hidrocentralet, numri i tyre, pasi pervec efektit pozitiv ne prodhimin e energjise elektrike, ndertimi i hidrocentraleve con ne shkaterrimin e habitatit natyror tokesor dhe ujqor ne zonen ku ai do te shtrihet;
- Ujesjellesi kerkon nje rikontruksion te plote per shkak te amortizimit te tubacioneve dhe permiresimit te cilesise se ujqit te pijshem;
- Te paraqitet nje plan studimi dhe rehabilitimi per zonen e “Ish Uzines se Pilave”, per shkak te ndotjes dhe impaktit negativ mjedisor qe kjo zone shkakton;
- Te parashikohet nje vend per depozitimn e mbetjeve inerte;
- Te parashikohet nje plan rehabilitimi dhe zhvillimi per zonen rreth liqenit te Banjes duke e kthyer ate ne nje atraksion turistik per vendin;

Degjesa e radhes per Vleresimin Strategjik Mjedisor te Bashkise Gramsh eshte parashikuar te zhvillohet gjate muajit Dhjetor.

Në këtë takim proces-verbali u mbajte nga juristi z.Elidjan Koci.

**Për Sektorin e Studimit dhe Projektimit Urban:**

Ing. Ali Cohodari

Ing. Dhori Nishku

Ing. Fiorentina Xhangolli

Ing. Manjola Xhelili

Ing. Eva Ismailaj

Top. Gezim Dollani

Jurist Elidjan Koci

Foto nga dëgjesa e parë publike e VSM



Raporti i dëgjesës së tretë publike

**Takimi i kryer me përfaqësues të**

**Administratës së Zonave të Mbrojtura Elbasan (AdZM-Elbasan)**

**Përfaqësuesi i AdZM-Elbasan:** Ing. Harun Sulmina   Ing. Kastriot Qyra (Specialistët e ZM të bashkisë Gramsh)

**Përfaqësues të MetroPOLIS:** Kristi Bashmili, Aida Ciro

Çështjet e ngritura në takim:

- Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura dhe Monumenteve të Natyrës në Territorin e Bashkisë Gramsh;
- Numri, sipërfaqja e Zonave të Mbrojtura në territorin e Bashkisë Gramsh
- Gjendja dhe menaxhimi i Zonave të Mbrojtura në territorin e Bashkisë
- Mundësia për zgjerim/ shtim të Zonave të Mbrojtura në territorin e Bashkisë;

Z. Sulmina ngriti si problematike dëmtimin e Monumenteve të Natyrës, dhe vështirësitë në menaxhimin e tyre, gjithashtu theksi u vu në rishikimin e listës së Monumenteve të Natyrës, pas disa nuk janë më në gjendje optimale për të mbajtur status të tillë, psh Arra e Tunjës.

Problem tjetër i ngritur në takim, ishte problematikat që sjellin turiztët në zonat e mbrojtura të bashkisë, kryesisht më hedhjen e mbetjeve të ngurta në vende jot ë posacme dhe pranë Monumenteve të natyrës dhe Gjeomonumenteve. Në këtë problematik u fol gjatë për ujëvarën e Sotirës dhe Kanionin e Holtës, ku impakti negative nga vizitorët është edhe më i ndjeshëm.

Në takim u fol edhe për mundësinë e shtimit të zonave të mbrojtura mjedisore në territorin e bashkisë së Gramshit dhe rrethinat e tij. Nuk u futëm në detaje, por në mënyrë sipërfaqësore u fol për zonën e Lenies dhe në pjesën e Grabovës.

Gjithashtu takimi shërbeu për marrjen e të dhënave zyrtare/teknike për Zonat e Mbrojtura dhe specie e ndryshme florë/faunë në territorin e Bashkisë Gramsh. Me specialistët e AdZM Elbasan ndërruam kontaktet, E-mail dhe nr. Telefoni për të rritur shpejtësinë e komunikimit dhe shpërdarjen dhe konsultimin e informacioneve të ndryshme.

Gramsh me 10 Tetor 2017

Takim Konsultues me Stafin e Bashkisë Gramsh dhe Administratorët e NjA-ve të Bashkisë për evidentimin e problematikave kryesore dhe identifikimin e projekteve në territorin e bashkisë

Pjesmarrës: Staf i Bashkisë Gramsh; Administratorët e NjA-ve të Bashkisë; Përfaqësues të MetroPOLIS sh.p.k.

Si fillim u fol kryesisht për problematikat e të cilat lidhen me qytetin si dhe me rrjetin rrugor në shkallë qyteti dhe bashkie. Si dhe u ra dakort për akset kryesore rrugore në të cilat synohet të investohet si në shkallë qyteti dhe në shkallë bashkie.

Në këtë seksion një rëndësi e veçantë i u kushtua bypassit të qyteti dhe aksit orbital të bashkisë të cilat janë ndër projektet më kryesore që ndërmerr plani.

Gjithashtu u diskutua mbi projektet e tjera madhore dhe nevojat imediate që paraqet qyteti i Gramshit siç ishin:

- Hapësira e varrezave të reja;
- Ndërtimi i qendrës agro-përpunuese,
- Ndërtimi i zgjatimit të bulevardit të qytetit
- Ndërtimi i parkut të madh të qytetit.
- Ndërtimi i zonës mikse të banimit në hyrje dhe dalje të qytetit.
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellesit,
- Rikonstruksioni i pallatit të sportit dhe i stadiumit të qytetit
- Ndërtimi i terminalit të autobuzave.

Gjithashtu si pjesë e diskutimit ishin dhe projektet për NjA-të e bashkisë ku u diskutuan këto çështje:

- Ndërtimi i shesheve kryesore të fshatrave.
- Ndërtimi dhe rikonstruksioni objekteve arsimore.
- Ndërtimi dhe rikonstruksioni i objekteve shëndetsore.
- Ndërtimi dhe rikonstrksioni i rrjetit të kanalizimeve dhe ujësjellësit si dhe i gropave septike dhe pus-shpimeve sipas standarteve higjenosanitare dhe të planifikimit.

Si rezultat i këtij konsultimi u shqyrtuan problematikat kryesore të zonës sidhe u vendosen projektet prioritare të bashkisë.



---

- 
- <sup>1</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014
- <sup>2</sup> Bashkia Gramsh, 2016
- <sup>3</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014
- <sup>4</sup> Bashkia Gramsh, 2016
- <sup>5</sup> <http://ëëë.level.org.nz/energy/reneëable-electricity-generation/ëind-turbine-systems/>
- <sup>6</sup> <http://ëëë.akbn.gov.al/energja-e-eres/>
- <sup>7</sup> Bashkia Gramsh, 2016
- <sup>8</sup> <http://ëëë.mappery.com/Solar-Radiation-Map-of-Albania>
- <sup>9</sup> Bashkësia e strukturave gjeologjike brenda territorit të Shqipërisë
- <sup>10</sup> Devoll Hydropoëer Project, Environment and Social Management Plan, Public Version, fq. 108, Tetor 2013
- <sup>11</sup> Devoll Hydropoëer Project, Environment and Social Management Plan, Public Version, fq. 2-3, Tetor 2013
- <sup>12</sup> Vezir Muharremaj, “Shkenca e Tokës II” fq. 161, 2014
- <sup>13</sup> <http://ëëë.geo.edu.al/neëëeb/?fq=hartatotal>
- <sup>14</sup> Ligjit Nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"
- <sup>15</sup> Ministria e Mjedisit, *Plani i menaxhimit të parkut kombëtar “Mali i Tomorrit”*, Draft 2014
- <sup>16</sup> MM, *Plani i menaxhimit të parkut kombëtar “Mali i Tomorrit”*, Draft 2014
- <sup>17</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>18</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>19</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>20</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>21</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>22</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>23</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>24</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>25</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>26</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>27</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>28</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>29</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>30</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>31</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>32</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>33</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016
- <sup>34</sup> <http://ëëë.travelgramsh.org/home/irmajit-castle/kalaja-e-irmajit>
- <sup>35</sup> Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Elbasan, Raport Vjetor , Gusht 28.12.2015

- 
- <sup>36</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku i Elbasanit, Tiranë 2014
- <sup>37</sup> AKM, Raporti i Gjëndjes në Mjedis, 2015
- <sup>38</sup> SHGJSH, Drejtoria e Hidrogeologjisë, Sektori i Monitorimit të Rrjetit Lumor, *Monitorimi i Dinamikës së Shtratit në Lumenjtë e Shqipërisë në rrjedhën e mesme dhe të poshtme të rrjedhës dhe propozimi i masave për stabilizimin e gjëndjes*, Shkurt, 2016
- <sup>39</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>40</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014.
- <sup>41</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>42</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>43</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>44</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>45</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014
- <sup>46</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014
- <sup>47</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>48</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>49</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Berat*, 2014
- <sup>50</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>51</sup> Bashkia Gramsh, 2017
- <sup>52</sup> SHGJSH: Deri më sot ende nuk janë kryer studime që përcaktojnë sasinë e ujit të shfrytëzuar nga puse të tilla
- <sup>53</sup> SHGJSH, 2014
- <sup>54</sup> SHGJSH Elbasan
- <sup>55</sup> Shërbimi Gjeologjik Shqiptar 2014, *Gjeoresurset dhe Gjeorreziqet në Qarqet e Shqipërisë, Qarku Elbasan*, 2014
- <sup>56</sup> AKM 2014
- <sup>57</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
- <sup>58</sup> David J. Noëak, USDA Forest Service, Syracuse, NY, *The Effects of Urban Trees on Air Quality*, 2002
- <sup>59</sup> US EPA, <https://ëëë.epa.gov/greenvehicles/greenhouse-gas-emissions-typical-passenger-vehicle-0>
- <sup>60</sup> US EPA (United States Environmental Protection Agency), Average Annual Emissions and Fuel Consumption for Gasoline-Fueled Passenger Cars and Light Trucks, 2008
- <sup>61</sup> INSTAT, 2010
- <sup>62</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
- <sup>63</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
- <sup>64</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
- <sup>65</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016
- <sup>66</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March
- <sup>67</sup> Bëhet fjalë për naftën që përdoret për makina.
- <sup>68</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
- <sup>69</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
- <sup>70</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
- <sup>71</sup> Inspektoriati Qëndror Teknik
- <sup>72</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
- <sup>73</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.
- <sup>74</sup> AKM 2014, Informacion për cilësinë e lëndëve diegëse.

---

<sup>75</sup> Environmental Center for Administration and Technology, Tirana 2008

<sup>76</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

<sup>77</sup> Ministria e Mjedisit dhe UNDP, Third National Communication of Albania to UNFCCC, Third Draft, March 2016

<sup>78</sup> Sipas studimit të ECAT në vitin 2008. Nga fushata pilot mbi shkarkimet e gazrave nga marmitat e makinave zhvilluar në qytetin e Tiranës në vitin 2008, është studiuar sasia e shkarkimeve në ajër nga makinat me moshë të ndryshme. Studimi ka testuar 1,036 automjete me vite prodhimi të ndryshme. 880 makina përdornin si lëndë djegëse naftën dhe 156 benzinën.

<sup>79</sup> ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008

<sup>80</sup> ECAT, Kontrolli - mirëmbajtja dhe siguria e automjeteve, Tiranë 2008

<sup>81</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>82</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>83</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>84</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>85</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>86</sup> US National Library of Medicine, Korrik 2016, [https://toxtoen.nlm.nih.gov/text\\_version/chemicals.php?id=6](https://toxtoen.nlm.nih.gov/text_version/chemicals.php?id=6)

<sup>87</sup> Bashkia Gramsh, Struktura e fondit pyjorë dhe kullor të transeuar sipas VKM nr. 433, datë 8/6/2016 "Për transferimin e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë"

<sup>88</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>89</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>90</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>91</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>92</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>93</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>94</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>95</sup> Bashkia Gramsh, Drejotria e Pyjeve

<sup>96</sup> Korridor konsiderohet një fashë e gjelbër e cila ka sipërfaqe relativisht të madhe dhe, krahas funksionit për kalimin e jetës së egër, mund të shërbejë edhe si habitat për jetën e egër. Korridor lidhës është një rrip në sipërfaqe të vogël i cili kryen vetëm funksionin e kalimit të jetës së egër dhe nuk ka hapësirë për t'u konsideruar një habitat për të zhvilluar jetën e egër.

<sup>97</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>98</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>99</sup> AKZM, 2016

<sup>100</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>101</sup> VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit

<sup>102</sup> VKM Nr. 102, dt. 12.02.2015. Për Krijimin dhe Funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-së.

<sup>103</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

<sup>104</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016

<sup>105</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, 2016

<sup>106</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

---

<sup>107</sup> Ministria e Mjedisit, *Plani i menaxhimit të parkut kombëtar "Mali i Tomorrit"*, Draft 2014

<sup>108</sup> Ministria e Mjedisit, *Plani i menaxhimit të parkut kombëtar "Mali i Tomorrit"*, Draft 2014

<sup>109</sup> MM, *Plani i menaxhimit të parkut kombëtar "Mali i Tomorrit"*, Draft 2014

<sup>110</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>111</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>112</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>113</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>114</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>115</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>116</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>117</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>118</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>119</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>120</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>121</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>122</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>123</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>124</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>125</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>126</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>127</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>128</sup> Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura 2016

<sup>129</sup>MM 2009 – 2013

<sup>130</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>131</sup> Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>132</sup>AKZM, 2016

<sup>133</sup>Ligj nr. 81/2017 "Per zonat e mbrojtura"

<sup>134</sup>VKM Nr.31, datë 20.01.2016 për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit

<sup>135</sup> Ligji Nr 9587, datë 20.7.2006 'Për Mbrojtjen e Biodiversitet'

<sup>136</sup> VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.

<sup>137</sup> VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen

- 
- e Biodiversitetit.
- 138 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 139 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 140 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 141 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 142 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 143 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 144 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 145 Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
- 146 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 147 VKM nr 31, dt. 20. 01. 2016, Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit.
- 148 Libri i Kuq i Faunës Shqiptare, 2007
- 149 Norconsult, VNMS – Projekti Hidroenegjetik I Devollit, 2014
- 150 Norconsult, VNMS – Projekti Hidroenegjetik I Devollit, 2014
- 151 Norconsult, VNMS – Projekti Hidroenegjetik I Devollit, 2014
- <sup>152</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>153</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>154</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>155</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>156</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>157</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>158</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>159</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve
- <sup>160</sup> Bashkia Gramsh, Drejtorja e Pyjeve

- 
- <sup>161</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2013
- <sup>162</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014
- <sup>163</sup> Agim Binaj, Pirro Veizi, Enkeleida Beqiraj, Fran Gjoka, Elian Kasa, *Economic losses from soil degradation in agricultural areas in Albania*, *Agric. Econ.* – Czech, 60, 2014 (6): 287–293
- <sup>164</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014
- <sup>165</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014
- <sup>166</sup> Strategjia
- <sup>167</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014
- <sup>168</sup> Gjeoresurset dhe gjeorreziqet, Qarku Dibër, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014
- <sup>169</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014
- <sup>170</sup> EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, *Agricultural Policy Perspectives Brief*, N°5\* / December 2013
- <sup>171</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>172</sup> The World Bank, *Looking Beyond the Horizon*
- <sup>173</sup> ECN 2008
- <sup>174</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>175</sup> The World Bank, *Looking Beyond the Horizon*
- <sup>176</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>177</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>178</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>179</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>180</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>181</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>182</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>183</sup> Republic of Albania, Ministry of Environment, *Third National Communication of Albania to UNFCCC*, draft 2016
- <sup>184</sup> The World Bank, *Reducing the Vulnerability of Albania's Agricultural Systems to Climate Change*
- <sup>185</sup> SZHT Bashkia Gramsh, 2017
- <sup>186</sup> United Nations Economic Commission for Europe Albania Environmental Performance Review, Second Review, United Nations, New York and Geneva, 2012, *Raporti South-Eastern European mining related risks: Identification and verification of environmental hot spots*.
- <sup>187</sup> Gjeoresurset dhe gjeorreziqet, Qarku Elbasan, SHGJSH, 2014
- <sup>188</sup> National Library of Medicine, US
- <sup>189</sup> National Library of Medicine, US
- <sup>190</sup> United States Environmental Protection Agency
- <sup>191</sup> Agency for Toxic Substances and Disease Registry, 2017
- <sup>192</sup> Ministria e Mbrojtjes, 2017.
- <sup>193</sup> A desktop study on the environmental and public health impact of Syria's conflict
- <sup>194</sup> Bashkia Gramsh, 2017
- <sup>195</sup> SCADA - *Supervisory Control and Data Acquisition*.
- <sup>196</sup> Në vijë ajrore nga Google Earth
- <sup>197</sup> Bashkia Gramsh, 2016
- <sup>198</sup> Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve, Gusht 2010

---

<sup>199</sup> Ilogaritjet autori, duke ruajtur peshat specifike të ndarjes së popullsisë në bashki e komuna me të dhënat e censusit të popullsisë-2011

<sup>200</sup> Shënim: Niveli i popullsisë me arsim bazik përfundimtar është shprehës i nivelit arsimor përfundimtar për popullsinë dhe tregon sa % e saj nuk e ka vazhduar arsimin në nivele më të larta. Ai shpreh raportin e numrit të personave që kanë kryer arsimin fillor dhe tetë ose nëntë vjeçar, ndaj popullsisë 15 vjeç e lart, në %.

<sup>201</sup> Aksesuar nga Instat (Censusi, 2011) për herë të fundit në Tetor, 2016

<sup>202</sup> Departamenti i Shtetit Amerikan <http://ëëë.ers.usda.gov/topics/rural-economy-population/employment-education/rural-education.aspx>

<sup>203</sup> Bashkia Gramsh, Tetor 2016

<sup>204</sup> Informacion i marrë nga Bashkia Elbasan Mars, 2015

<sup>205</sup> Sipas vkm 671, neni 83

<sup>206</sup> Sipas VKM nr. 481, sipërfaqja e ndërtesës duhet të jetë brenda intervalit 18 m<sup>2</sup>-25m<sup>2</sup>/fëmijë dhe madhësia e parcelës për kopshtet duhet të jetë brenda intervalit 1000m<sup>2</sup> -1500m<sup>2</sup>, ku

<sup>207</sup> Ministria e Arsimit (të dhëna në GIS) aksesuar për herë të fundit Tetor 2015

<sup>208</sup> Të dhëna të kalkuluar nga informacionet e marra nga Bashkia Gramsh (tetor 2016

) në raport me rregulloren e planifikimit dhe VKM nr. 671, pika neni 81, pika 5

<sup>209</sup> Po aty, pika ë

<sup>210</sup> Po aty

<sup>211</sup> Dokumenti i strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020, fq 67

<sup>212</sup> Një raport hulumtues i UNICEF për cilësinë e arsimit parashkollor në Shqipëri, rekomandon që për grupet 3-4 vjeç raport fëmijë/edukatorë të jetë 10 dhe për fëmijët në moshë pak më të rritur mund të jetë edhe më i lartë. Për më tepër shiko: <http://ëëë.unicef.org/albania/ECD-mb-standards-survey-oct13.pdf>

<sup>213</sup> <http://data.ëorlbank.org/indicator/SE.PRM.ENRL.TC.ZS>

<sup>214</sup> <http://data.ëorlbank.org/indicator/SE.SEC.ENRL.TC.ZS>

<sup>215</sup> Instat 2015

<sup>216</sup> Instat, Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2000-2014

<sup>217</sup> Open Data Albania 2015, Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror dhe privat, Shqipëria dhe vendet e rajonit

<sup>218</sup> Instat, anketa Strukturore e Ndërmarrjeve, 2000-2014

<sup>219</sup> VKM Nr. 77, III, pika 13

<sup>220</sup> Të dhëna, Census 2011, llogaritur nga CO-PLAN, 2016

<sup>221</sup> [http://healthgrouper.com/documents/4417/Albania\\_country\\_report-Final.pdf](http://healthgrouper.com/documents/4417/Albania_country_report-Final.pdf)

<sup>222</sup> [http://ec.europa.eu/health/reports/docs/health\\_glance\\_2014\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/health/reports/docs/health_glance_2014_en.pdf)

<sup>223</sup> Të dhëna të llogaritura sipas informacioneve të marra nga Bashkia e Gramshit, aksesuar për herë të fundit në Tetor, 2016

<sup>224</sup> Raporti infermierë për 1000 banorë, Banka Botërore, 2012 <http://data.ëorlbank.org/indicator/SH.MED.NUMË.P3?contextual=region&end=2013&locations=AL&start=2012>

<sup>225</sup> OECD, 2011 Health at a Glance [http://ëëë.oecd-ilibrary.org/sites/health\\_glance-2011-en/03/07/index.html?contentType=&itemId=%2Fcontent%2Fchapter%2Fhealth\\_glance-2011-26-en&mimeType=text%2Fhtml&containerItemId=%2Fcontent%2Fserial%2F19991312&accessItemIds=](http://ëëë.oecd-ilibrary.org/sites/health_glance-2011-en/03/07/index.html?contentType=&itemId=%2Fcontent%2Fchapter%2Fhealth_glance-2011-26-en&mimeType=text%2Fhtml&containerItemId=%2Fcontent%2Fserial%2F19991312&accessItemIds=)



---

<sup>226</sup> VKM 671, Neni 83, pika d

<sup>227</sup> Instat, Censusi 2011 dhe Bashkia Gramsh, 2016

<sup>229</sup> [https://ëëë.ined.fr/en/everything\\_about\\_population/data/europe-developed-countries/birth-death-infant-mortality/](https://ëëë.ined.fr/en/everything_about_population/data/europe-developed-countries/birth-death-infant-mortality/)

<sup>230</sup> Censusi, Instat 2011

<sup>231</sup> Anketa e Matjes së Nivelit të Jetesës, AMNJ 2012

<sup>232</sup> Shiko me shumë te: [http://ëëë.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi\\_i\\_varferise\\_2012\\_.pdf](http://ëëë.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf)

<sup>233</sup> Instat, 2012 [http://ëëë.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi\\_i\\_varferise\\_2012\\_.pdf](http://ëëë.instat.gov.al/media/206688/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf)

<sup>234</sup> ILO, UNDP, MPCSSHCB, Sistemi i mbledhjes së informacionit - grumbullimi i të dhënave për grupet vulnerabël në rrezik përjashtimi nga tregu i punës, 2012

<sup>235</sup> UNDP, 2014 SOCIAL HOUSING IN ALBANIA: A SITUATION ANALYSIS <http://ëëë.al.undp.org/content/albania/en/home/library/analysis-of-situation-of-social-housing-in-albania.html>

<sup>236</sup> Census, 2011

<sup>237</sup> Treguesit makroekonomik si PBB, VSHP, shpërnarja dhe lloji i ndërmarrjeve ekonomike janë analizuar në nivel Qarku, përkatësisht Qarku Elbasan ku bën pjesë dhe Bashkia Gramsh, si niveli më i detajuar i informacionit referuar të dhënave statistikore të INSTAT.

<sup>238</sup> Referuar metodologjise dhe termave të INSTAT.

<sup>239</sup> INSTAT, 2012

<sup>240</sup> Të dhënat i referohen gjysmës së parë të vitit 2017

<sup>241</sup> Ky seksion i analizës mbështetet në metodologjitë e përdorura nga ESPON/BE

<sup>242</sup> Siç përcaktohet në metodologjinë e ESPON, Potential of Rural Regions

<sup>243</sup> Densiteti i punësimit shprehet si numri i të punësuarve për njësi hapësinore (kriteret për këtë janë pjesë e metodologjive specifike që mund të përdoren).

<sup>244</sup> Produktiviteti, sipas përkufizimit, është efektiviteti i përpjekjeve produktive i matur në lidhje me normën e prodhimit për njësi të inputit.

<sup>245</sup> Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Nëntor 2014 “*Analiza e skemave mbështetëse. Politikat dhe strategjitë e ndërhyrjeve në bujqësi*”  
Ligjin nr.9199, datë 26.2.2004 “**Për prodhimin, përpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio"**,

<sup>247</sup> EU Commission, *Overvieë of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5\* / December 2013

Lushaj Sh, 2005 “Fragmentimi dhe Konsolidimi i Tokës”

Lushaj Sh, Zdruli P, 2007 “Land and Soil Resources of Albania: Current problems and future trends”( Status and prospect of Soil information” in South-eastern Europe) 2005 “Fragmentimi dhe Konsolidimi i Tokës”

Ligji Nr. 9817, date 22.10.2007 “Për Bujqesine dhe Zhvillimin Rural”

---

<sup>248</sup><http://shqiptarja.com/sociale/2750/lame-29-5--e-nd-rtimeve-n--shqip-ri-jan--zona-informale-310114.html#sthash.T2OE7DĒa.dpuf>

<sup>249</sup><http://shqiptarja.com/sociale/2750/lame-29-5--e-nd-rtimeve-n--shqip-ri-jan--zona-informale-310114.html#sthash.T2OE7DĒa.dpuf>

<sup>250</sup> Sipas të dhënave që disponojmë nga Bashkia këto informacione janë vënë në dispozicion. Në bazë të shkresës me prot nr 47/17 datë 14/09/ 2017 nga Metropolis sh.p.k drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme “ **Kërkesë për marrje informacioni nga Ministria e Punëve të Brendshme për Inventarin e Pronave Publike të Bashkisë Gramsh**” nuk kemi marrë informacion dhe dhe si rezultat përdorëm të dhënat e që disponon Bashkia Gramsh.

<sup>251</sup> Ligji nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës.

<sup>252</sup> Google map, Shtator, 2017

<sup>253</sup> *Souerces: Esri, HERE, DeLorme, USGS, Intermap, increment P Corp., NRCAN, Esri Japan, METI, Esri China ( Hong Kong), Esri (Thailand), Tom Tom, MapmyIndia, © OpenStreetMap contributors, and the GIS User Community*

<sup>254</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, i ndryshuar*

<sup>255</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, i ndryshuar*

<sup>256</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, neni 9, fq 5*

<sup>257</sup> Ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 i Kodit Rugor Të Republikës Së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.10 488

<sup>258</sup> Bashkia Gramsh dhe MetroPolis 2017, analiza e infrastrukturës rrugore, matur nga GIS

<sup>259</sup> Evidentim nga ortofoton e vitit 2007 dhe 2015, ASIG

<sup>260</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, i ndryshuar*

<sup>261</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, i ndryshuar*

<sup>262</sup> *Ligji nr. 8308, date 18.3.1998 “Për transportet Rugore”, i ndryshuar*

<sup>263</sup> Vlera është nxjerr nga analiza në GIS

<sup>264</sup> Burimi: “Rregullorja e planifikimit”- VKM nr. 671

<sup>265</sup> Burimi: “Rregullorja e planifikimit”- VKM nr. 671

<sup>266</sup> Bashkia Elbasan 2005, Detyra e Projektimit për Planin Urbanistik të Bashkisë Elbasan, Bashkia Elbasan

<sup>267</sup> Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Energjia e Erës

<sup>268</sup> Të dhënat janë marrë nga Bashkia Elbasan, 2015

---

<sup>269</sup> Burimi i informacionit për hartën e fluksit të energjisë është marrë nga SHGJSH (biomasa), AKBN dhe TAP (hidrokarburet, energjia e erës, energjia e diellit dhe energjia gjeotermale), [ëë.riverëatch.eu](http://ëë.riverëatch.eu) (HEC-et), Atlasi Gjeotremal (burimet gjeotermale), Bashkia Gramsh dhe Co-PLAN (sipërfaqet ujore)

<sup>270</sup> INSTAT, 2015

<sup>271</sup> Bashkia Gramsh

<sup>272</sup> Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave, Atlasi i Burimeve Gjeotermale në Shqipëri, Tiranë 2004

<sup>273</sup> Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Energji të rinovueshme, energjia diellore

<sup>274</sup> Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Strategjia Kombëtare e Energjisë 2013-2020, Tiranë 2012

<sup>275</sup> INSTAT, Censusi 2011

<sup>276</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014

<sup>277</sup> Gjeoresurset dhe gjeorrezimet, Qarku Dibër, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, 2014

<sup>278</sup> Agjencia Kombëtare e Mjedisti (AKM), *Raporti i Gjëndjes në Mjedis*, 2014

<sup>279</sup> EU Commission, *Overview of CAP Reform 2014-2020*, Agricultural Policy Perspectives Brief, N°5\* / December 2013